Shaban Çupi

GAFUR LUMA
Kujtime e dëshmi

2019

Shaban Çupi:

Gafur Luma
(Kujtime e dëshmi)

Libri botohet në 20 vjetorin e rënies së dëshmorit

2019

,,Bijtë dhe bijat e Kosovës, shekuj e dekada, sa herë që qe e duhur, iu përgjigjën zërit të masave, kërkesës së popullit dhe qenien e tyre e vunë përballë rreziqeve për ta mbrojtur, për ta realizuar lirinë. Me penë shkruan historinë, me gjak ngjyrosën flamurin e kuq kombëtar, me eshtra bënë muranë të pakapërcyeshme për armiq e pushtues, shfarosës e asimilues"

Zëri i Kosovës, janar 1985

Gafur Luma (1961-1999)

Në vend të parathënies

Gafur Luma u lind më 12 prill të vitit 1961 në fshatin Qafshqipe (Gllo-boshicë) të komunës së Kaçanikut. Shkollën fillore e ka kryer në fshatin e lindjes, ndërsa të mesmen në Kaçanik. I ka të kryer tri vite të studimeve në Fakultetin Elektroteknik të Prishtinës.

Për veprimtari ilegale politike nga pushteti serb-jugosllav u burgos dy herë, në nëntorin e vitit 1985 dhe në gushtin e vitit 1998 dhe u dënua me gjithësej 10 vjet burg. Ka mbajtur burg në Gjilan, Prishtinë, Prizren, Gurakoc dhe, në fund, në burgun famëkeq të Dubravës, ku u vra në masakrën mbi të burgosurit shqiptarë në maj të vitit 1999. Përkundër torturave të rënda që ka përjetuar, shumë shokë të tij mbetën të pazbuluar, të cilët më vonë iu bashkuan radhëve të UÇK-së. Në vitin 1992, Gafuri u martua me Hydajete Luzhën nga Begraca, komuna e Kaçanikut, me të cilën kishte dy fëmijë: Lirimin e Kaltrinën.

Në 19-vjetorin e rënies dhe në 57-vjetorin e lindjes, në respekt të veprës së pavdekshme të dëshmorit Gafur Luma, në vitin 2018, botuam librin (poemën) “Buzëqeshje lirie”, ndërsa në 20 vjetorin e rënies po e botojmë librin monografik ,,Gafur Luma-kujtime e dëshmi” në të cilin libër kemi mbledhur të dhëna domethënëse dhe argumentuese për dëshmorin. Ky libër është i mbështetur kryesishtë në të dhëna arkivore si dhe në dëshmi nga shokët veprimtarë të Gafurit.

Bashkëveprimtari i tij më i ngushtë, Remzi Elezi, duke kujtuar aktivitetet me Gafurin në shkollë të mesme, përkatësisht në gjimnazin ,,Skënderbeu", thotë:

Me Gafur Lumën kemi qenë shokë klase që nga viti i dytë i shkollës së mesme, pra që nga viti 1977. Por, nga viti 1978, në klasën tonë ka filluar një aktivitet i angazhuar, pra me një qëllim të caktuar politik sidomos në leximin e librave nga më të ndryshëm që të ngjallnim atdhedashurinë dhe kundërshtonim degjenerimin e rinisë nga propaganda jugosllave. Në vitin 1978 kjo punë bëhej spontanisht, por gjithnjë duke u masivizuar dhe duke marrë formë edhe organizative. Ne organizonim mësimin e këngëve patriotike nëpërmjet kopjimit nëpër audiokaseta dhe bënim shpërndarjen e tyre. Propagandonim që të përcillej Radio Tirana dhe emisionet e historisë për Kosovën. Kështu tentonim të zhvishnim mitin për Titon dhe propagandimin e tyre se çështjet kombëtare janë të zgjidhura në Jugosllavi.

Fillimisht kemi bashkëpunuar me këta persona: Hyrijete Isufi, Vjosa Kyçyku, Laura Vinca, Ali Luzha, Gafur Luma, Zejnulla Burrniku, Rasim Çaka, Ibrahim Hoxha, Muhabi Malsiu e Hazbi Loku. Kur grupi filloi të merr formë më organizative ishte pranvera e vitit 1979. Por, kur Titoja vdiq në majin e vitit 1980, dhe ne organizuam tërë gjeneratën e maturantëve që të mos shkojmë për të vizituar varrin e Titos për homazhe në Beograd, lirisht mund të them se kjo ishte kryengritja e parë politike në Kosovë pas vitit 1968, kujton Remzi Elezi.

Nga hulumtimi i veprimtarisë atdhetare të dëshmorit Gafur Luma kemi konstatuar se ai ka vepruar në këto katër fusha:

1.Ka ngritur celula ilegale (kjo veprimtari ndëshkohej me ligjet e regjimit pushtues, sipas nenit 136 - veprimtari armiqësore),
2.Ka propaganduar idenë për Kosovën Republikë (ndëshkohej nga regjimi sipas nenit 133 - propagandë armiqësore),
3.Ka vepruar në mënyrë klandestine në përgatitjen e kryengritjes së armatosur (kjo veprimtari ndëshkohej sipas nenit 125 – terrorizëm),
4.Ka vepruar paralelisht dhe legalisht edhe në organizimet legale politike të kohës.

Gafur Luma ka vepruar në disa celula ilegale. Nga viti 1979 ka vepruar në celulë me Ferid Qallakun. Pas rënies së Feridit në burg, në vitin 1981, Gafuri ka vepruar në një celulë me Remzi Elezin, i cili më parë kishte vepruar me Berat Luzhën e Kadri Luzhën. Ka vepruar në celulë edhe me Remzi Krrabën, Bajram Dernjanin e Menduh Kaloshin. Deri më tani është argumentuar se materiale për lexim ilegal u ka dhënë edhe Muhamet Malsiut, Kadri Imishtit, Nezir Demës, Raif Lumës, Nevait Lumës e Nejazi Lumës. Aksione konkrete në shpërndarje të pamfleteve dhe veprime të tjera konspirative ka pasur edhe me ilegalin Bexhet Luzha.

Gafuri kishte punuar ilegalisht edhe me studentë të Fakultetit Elektroteknik në Prishtinë, me Murat Gjocajn e Shefqet Halitin, nga Istogu, si dhe me Zenun Muriqin nga Peja, Avdyl Bajramin nga Vërbani dhe Zejnullah Burrnikun nga Kaçaniku. [1] Krahas tyre, Gafuri ka vepruar edhe me Ali Ahmetin e Kërçovës

[1] Të dhënat janë marrë nga Ferid Qallaku, Remzi Krraba, Remzi Elezi, Murat Gjocaj, Bajram Dernjani, si dhe në Arkivin e Kosovës

(Komandantin e UÇ-Kombëtare të vitit 2001) derisa ka qëndruar një kohë në Zvicër në verën e vitit 1985.[2] Mbi të gjitha, Gafuri një lloj celule e kishte edhe brenda familjes së tij, duke filluar nga motrat e vëllezërit e deri te xhaxhai, Raifi [3] dhe farefisi.

Krahas këtyre celulave të organizuara ilegale, Gafur Luma ka përdorur edhe metodën e agjitacionit në popull, veçanërisht te shokët e papërfshirë në organizim, duke i zgjeruar "rrathët koncentrik" të frontit të lirisë dhe të çlirimit të Atdheut.

Pas vitit 1990, legalisht ka vepruar në subjekte të ndryshme në komunën e Kaçanikut si në LDK, Këshillin Komunal për Financim, N/KMLDNJ, Shoqatën Humanitare ,,Nëna Terezë" dhe bashkëpunim konkret ka pasur me Hebib Shehun, Bedri Kyçykun, Mejdi Dalloshin, Berat Luzhën, Naser Kukën, Ibush Vishin, Misim Sopën, etj. Ndërsa në Ferizaj, ka pasur bashkëpunim me Xhabir Morinën, Elmi Reçicën, Bajrush Xhemajlin, Muzafer Likën, Rrahim Sadikun, kryesisht me ish të burgosur politik nga burgu i parë, duke mos lënë anash as shokë nga Ferizaj që shquheshin në fushën publicistike e kulturore, si Bardh Frangu e shokë të tjerë veprimtarë.

Në aspektin ushtarak, në konspiracion të thellë, Gafur Luma ishte i lidhur me komandantin e UÇK-së Azem Sylën, Xheladin Gashin ,,Plakun", Ekrem Jasharin[4] dhe Bexhet Luzhën. [5] Një nga ndërlidhësit e tij ndërmjet Azem Sylës e Gafur Lumës, pos Bexhet

[2] Proceverbalet e UDB-së, Arkivi i Kosovës
[3] Informatë nga Raif Luma e Zyber Luma
[4] Informatë nga Ekrem Jashari,Ferizaj
[5] Informatë nga Bexhet Luzha, Kaçanik

Luzhës, ishte edhe Isak Sherifi nga Tetova [6] dhe vetëm hulumtimet më të thella dhe më të detajuara, do të nxjerrin në sipërfaqe veprimtarinë e plotë ilegale të dëshmorit Gafur Luma.

Familja dhe shtëpia e tij ishte çerdhe lirie me vlerë kombëtare. Nëpër shtëpinë e tij dhe nëpërmjet tij, kaluan personalitete të luftës dhe qëndresës kombëtare, si: Azem Syla, Xheladin Gashi, Bislim Zogaj, Ekrem Jashari, Rexhep Bislimi (dëshmor), Hyrë Emini (dëshmore), Xhemajl Rudi, Bafti Sopa, Bashkim Mazreku, etj. Kjo familje, pos Gafurit, dha edhe Dëshmorin Qani Luma, kurse vëllai i tij i tretë, Emin Luma (tash i ndjerë), ishte gjithashtu luftëtar i UÇK-së.

Gafur Luma shpërndau shumë materiale ilegale, duke filluar nga *traktet,* që u shpërndanë ilegalisht në vitin 1979 me kryetitull: "*Lexoje, shpërndaje, armikut mos ia dorëzo".* Shpërndau revistën ilegale *"Liria",* organin *"Pararoja"*, materialin *"Armiku na ka në dorë vetëm aq sa e lejojmë ne vet",* përmbledhjen me poezi ilegale "*Këngët e lirisë"*, programin dhe statutin e organizatës, librin *"Titistët"*, revistat ilegale "*Zëri i Kosovës"*, "*Zëri i Popullit", "Shqipëria e Re"* e shumë literaturë e materiale tjera ilegale.

Gafur Luma, gjatë veprimtarisë së tij politike ilegale, ishte anëtar i OMLK-së, i LPRK-së dhe i UÇK-së. Gjatë kësaj veprimtarie ka vepruar me dy emra konspirativ - pseudonime: Agimi dhe Avdiu. Pseudonimin "Agimi" e ka bartur që nga viti 1979, kurse "Avdiu" e merr kur zgjedhet sekretar për propagandë dhe agjitacion me rastin e themelimit të Komitetit të

[6] Informatë nga Isak Sherifi, Tetovë

Rrethit për Kaçanik, më 8 nëntor 1985.[7] Komiteti i Rrethit ishte komitet lokal i organizatës ilegale "Komiteti Organizativ", në krye me Xhabir Morinën dhe tashmë dëshmorët e kombit, Fehmi Lladrovci, Xhavit Haziri e të tjerë.

Gafur Luma ishte një veprimtar i orëve të para të veprimtarisë për çlirimin e atdheut. Veprimtaria e tij atdhetare ka filluar që nga viti 1979, sa ishte nxënës i shkollës së mesme në Kaçanik, në celulën ilegale me Ferid Qallakun, nga fshati Gajre, komuna e Kaçanikut, gjithashtu, i burgosur politik. Veprimtaria atdhetare e Gafurit përfshinë një periudhë kohore 20-vjeçare dhe përfundon më 22 maj 1999, kur vritet në masakrën e regjimit serb mbi të burgosurit shqiptarë në Burgun e Dubravës.

Gafur Luma është Dëshmor i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Shkolla fillore në fshatin e tij, Qafshqipe, ku ka punuar disa vite, mbanë me krenari emrin e tij.

Gafuri ishte si *Nositi* i Lasgushit dhe si *Këmbana* e Dritëroit. Nëpër vështirësi krijohej burrëria e tij, siç thoshte Hygoi. Në kohën e gënjeshtrës e deklamonte të vërtetën dhe besonte se, edhe nëse armiku i këputë të gjitha lulet, pranverën s`mund ta ndalë, siç thoshte Neruda. Me energjinë e tij djaloshare donte të prodhonte Republikën, shtetin tonë. Ishte një idealist, por ishte realist, ishte si ajo substanca që ndryshon vazhdimisht, duke mbetur e njëjta në bërthamë. Ai synonte që, nga objekti historik, të kalonte në subjekt historibërës. Nuk

[7] Komiteti i Rrethit për Kaçanik i Komitetit Organizativ u formua më 8 nëntor 1985 në Sllatinë të Lepencit. Në themelimin e këtij Komiteti morën pjesë Remzi Elezi, Gafur Luma, Remzi Krraba e Bajram Dernjani

pajtohej me fatin e trungut shqiptar, të shtrirë përdhe, siç thoshte Vaso Pashë Shkodrani. Ishte guri i sprovës së Hegelit. Ai nuk dëshironte që të kishte fatin e refugjatit të kacavarur në anijen e historisë. Ai nuk e pranonte rolin e Kirenarit, siç thoshte Noli, por të Marathonomakut.

Gafuri e dinte se dhuna koloniale nuk ka për qëllim vetëm për t`i mbajtur në fre njerëzit e robëruar, por synonte edhe t`i dehumanizonte ata, siç thoshte Fanoni. Kahdo që udhëtonte, buzëqeshja e tij jepte shpresë e forcë, shfaqte humanizëm. E dinte se veprat e mëdha duan dashuri, përkushtim dhe pafundësi sakrificash. Herët e kishte sfiduar "lëkurën e ujkut" dhe vuajtjet ia kishin nxjerrë "lëngun e keq" nga trupi, siç thotë Shpëtim Pollozhani. I dallonte sakrilegjet dhe sakramentet dhe e kishte kuptuar thellë thënien e tribunit Sali Bajra se, ata që nuk kanë bërë punë të mira, vetëvetiu vdesin si njerëz dhe si emra. Nuk dëshironte t`i përngjante Gregor Zamzës së Kafkës, por përherë kërkonte momentin e "aktualitetit revolucionar", momentin e çlirimit. Pajtohej me Feliks Gran se të varfërit nuk janë as për t`i poshtëruar, as për t`i shfrytëzuar. Nuk i përshtatej mjedisit, nuk e donte lirinë e gaforres, por synonte, thjeshtë; të ishte shqiptar. Gafuri nuk ikte nga vetja e tij. Ai ishte Uni, ishte bota shqiptare, një liburnë ilire që çante dallgë. Ishte një digë që sfidonte tufanet. Nuk donte të vonohej në histori. Ishte në Lëvizje dhe, si i tillë, kishte një rreth të gjerë shokësh veprimtarë. Lirinë e Atdheut e donte më tepër se veten. Nga 38 vjet të jetës së tij, 20 vjet ishte në shërbim të Atdheut, në shërbim të lirisë, në shërbim të çlirimit dhe bashkimit të kombit shqiptar.

I përjetshëm kujtimi për dëshmorin Gafur Luma dhe për të gjithë dëshmorët e kombit!

Shaban Çupi, Paldenicë, Hani i Elezit

KAPITULLI I - Shtigjeve të jetës

Në agun e 12 prillit të vitit 1961, derisa bora e Sharrit ende dyluftonte me lulevjollcat që mbinin fushave e maleve të Qafës së Shqipes, nënë Zylfijes dhe babait Merxhanit u lindi më i bukuri djalë Avdilgafur Luma, të cilin që nga fëmijëria; prindërit, vëllezërit, motrat, farefisi dhe shokët e tij do ta thërrasin shkurt, me emrin Gafur. Me këtë emër ai do të njihet jo vetëm në Qafshqipen e Kaçanikut ku u lind e u rrit, por edhe anë e kënd kah udhëtoi dhe këndoi këngën e lirisë.

Aty, rrënjëve të Sharrit, ku bora që herët kërcnonte me dimër të gjatë, rritej Gafuri, rritej gëzimi i familjes, krahas vëllezërve dhe motrave të tij të cilat i donte shumë. Jeta në këtë fshat ishte e vështirë. Të mirat materiale siguroheshin me vështirësi dhe për këto të mira, babai i tij Merxhani punonte punë të rënda në minierën e Radushës, në horizontet e thella të kësaj miniere.

Krah i fortë i shtëpisë ishte padyshim nëna e tij Zylfija e cila me thonjë e duar, e kryesisht me punë veku, mbante familjen, dhe rriste fëmijët e saj, i rriste, siç thoshte, ,,për udhë të hajrit". Bagëtia ishte një pasuri tjetër e kësaj familje, kryesisht lopë e dele dhe pa ato nuk rrinin kurrë. Jeta familjare, organizohej në familje me shumë kurora, ku pos babait të tij Merxhanit, jetonin edhe mixhallarët e Gafurit: Sula, Idrizi e Raifi, duke iu

gjetur në afërsi njëri tjetrit si në gëzime, si në hidhërime.

Për herë të parë, mësimi shqip në këtë fshat u zhvillua në vitin 1946, në mejtepin e xhamisë së fshatit, ndërsa në vitin 1966 u ndërtua objekti i ri shkollor, aty ku është edhe sot.[8] Meqenëse fund i Luftës së Dytë Botërore (LDB), banorët e këtij fshati i gjeti tërësisht analfabet, sepse kurr s`kishte pasur shkollë shqipe deri atëherë, edhe mësuesit e parë që punuan në këtë fshat, nuk ishin të këtij vendi, por anëve të tjera të atdheut dhe procesi edukativo-arsimor zhvillohej në kushte të rënda.

Krahas kësaj gjendje të vështirë, pas LDB-së, pushteti i ri që erdhi, nga banorët e këtij fshati, ashtu si në tërë Kosovën, kërkonte ,,tepricën" e pasurisë e në fakt, njerëzit nuk mund ta siguronin as të domosdoshmën, bukën. Në këto rrethana, shumë familje kërkonin hapësira të tjera të mbijetesës duke mos përjashtuar as rrugët e Anadollit.

Si në çdo vendbanim tjetër të Kosovës, edhe në këtë fshat, nuk mungoi aksioni i famshëm antishqiptar i dorëzimit të armëve i kohës së Rankoviqit, sepse projekti fashist i Çubriloviqit, synonte t`i shkulë me rrënjë popullsinë shqiptare rrëzë bjeshkëve të Sharrit historik.

Gafur Luma, mësimet e para i mori në fshatin e tij të lindjes, përkatësisht te mësuesi Musli Luma i lindur në vitin 1947. Mësuesi Musli arriti që në vitin 1968 të përfundoj Shkollën Normale në Tetovë dhe fillimisht u punësuan në fshatin Jazhincë, ndërsa më pas u punësua në fshatin e tij në Gllboshicë (Qafshqipe) dhe për nxënës do ta ketë Gafur Lumën. Në kujtim të nxënësit të tij, tanimë dëshmor, ai thotë:

[8] Informatë nga Musli Luma e datës 14.1.2018

Gafurin e kisha nxënës. Ai ishte i çetë, i matur, i kujdesshëm dhe natyrisht nxënës i shkëlqyeshëm. Me mua ishte i afërt, jo vetëm si nxënës, por edhe kur u rrit e u burrërua, madje edhe kur filloi të merret me punë ilegale. Gafuri kishte një besim në mua dhe ate e shprehte pavarësisht se sa e rëndë ishte situata nëpër të cilën kalonim. Ishte inteligjent, gjerat i kuptonte në thellësi. Kam shumë kujtime të mira, edhe sot e ndjejë zbrazëtinë e tij.[9]

Gafur Luma, shkollën fillore e kreu në vendlindje, në rrënjët e Sharrit vigan, në majën e të cilit kishte shkelur shpeshherë për të vështruar Kosovën, Shkupin, Pollogun e Korabin. Kishte dëshirë shtatlarti Gafur të njihte bukuritë e atdheut, nga peisazhet e të cilit, që herët zbuloi se ky atdhe, kaq i bukur e aq historik, para banorëve të tij shfaqte një ,,buzëqeshje të ngrirë".

Sa e sa herë Gafuri si fëmijë, nëpër odat e fshatit, ku pleqtë mblidheshin dhe kuvendonin me njëri tjetrin, kishte dëgjuar për emrin e trimit Arif Dragomaci, bashkëfshatarin e tij, i vrarë në Zhelinë të Tetovës në vitin 1948 nga komunistët jugosllav. Arif Dragomaci ishte një patriot në luftë me bandat çetniko-partizane e për të cilin banorët e këtij fshati thonin se ishte një luftëtarë me nam dhe i drejtë. Po në këto oda, kur bora zinte shtigjet, dëgjonte për luftën e Avdyl Durës e Ramë Bekës, gjithashtu të vrarë nga jugosllavët në vitin 1949. Mësonte për veprimtarët e NDSH-së në krye me Halim Shurdhanin, Rexhep Bunjakun, Islam Bravën, Nazmi Bravën e plotë të tjerë. Kishte dëgjuar e çka jo për Kaçanikun dhe rrethinën e tij, për këtë pjesë të

[9] Informatë nga Musli Luma e datës 14.1.2018, Qafshipe

Shqipërisë i cili nëpër të gjitha fazat e historisë i kishte dhënë gjak lirisë së atdheut. Krahas kësaj, s`kishte si të mos i mbante në mend edhe rrëfimet e më të vjetërve për kohën e Rankoviqit kur shqiptarët shkallmoheshin në dru për dorëzim arme si dhe shpërnguljet e dhunshme të shqiptarëve gjithandej për në Turqi.

Në kërkim të rrënjëve iliro-dardane, Gafur Luma jo rrallë vizitonte gjurmët e lashta të të parëve tanë në kalanë e këtij fshati, për të cilën nuk din kush të shpjegoj se sa e vjetër është ajo. Mblidhte, analizonte e krahasonte mikrotoponimet e këtij vendbanimi që ishin përcjellur nga brezi në brez, si: Livadhi i Lleshit, Te Kalaja, Laki i Zanogës, Kepi i Shkallës, Kepi i Kullës, Qafa e Kalasë, Maja e Rrasës, Firina, etj, ku secila gjurmë dëshmonte për lashtësinë ilirike të këtyre vendbanimeve.

I etur për diturinë, pas shkollës fillore që e kreu me sukses në vendlindjen e tij, në shtatorin e vitit 1976 regjistrohet në gjimnazin e Kaçanikut i cili më parë kishte emrin ,,Skënderbeu", por që politika pansllave e kishte shartuar në një emër tjetër neveritës. Pranë këtij gjimnazi, Gafur Luma u njoh me shokë të tjerë, të cilët me kalimin e kohës do t`i bëhen edhe shokë të idealit. Meqë gjimnazi, nga vendlindja e Gafurit ishte larg dhe kushtet për të udhëtuar të rënda, ai fillimisht vendoset në konviktin e komunës e më vonë banon në një banesë private në Lagjen e Bobëve të Kaçanikut, në banesën e kusheririt të tij Nevaitit. Përkundër këtyre vështirësive, Gafuri nuk iu nda mësimit sepse me kohë kishte kuptuar se arsimimi i shqiptarëve ishte domosdoshmëri e kohës dhe siç deklarojnë shokët e paralelës të gjimnazit matematikor, Gafuri ishte lexues i pasionuar, lexonte

libra nga më të ndryshëm dhe përcjellte shtypin ditor.

Gafur Luma, kujton mësuesi i tij i parë, Musli Luma, edhe kur shkoi në shkollë të mesme në Kaçanik, çdo herë e shihja me libër, por edhe me gazetën e përditshme ,,Rilindja". Ishte lexues i pasionuar. E dija që mësimit e studimit nuk do t`i ndahet edhe në të ardhmen. Në sytë e Gafurit dhe në buzëqeshjen e tij, shihja vrullin rinor, shihja energjinë e tij të pashterrshme, shihja një kuadër me vlerë të atdheut, por...[10]

Se Gafur Luma ishte një lexues i pasionuar, dëshmohet edhe me bibliotekën e tij të pasur e cila përkundër bastisjeve që ia bëri pushtuesi dhe konfiskimit të tyre, kanë mbetur libra me vlerë, qoftë nga lëmia profesionale, qoftë nga ato politike e kulturore, tanimë si trashëgimi historike e dëshmorit.

Si gjimnazist i shkëlqyer, s`kishte si të mos i donte profesorët në zë të Kaçanikut të cilët që në vitet e 60-ta të shekullit XX, kishin rënë ndesh me politikën jugosllave që zbatohej në Kosovë, si Bedri Kyçyku dhe tribunin Sali Bajra dhe s`kishte si të mos e mësonte edhe ai këngën tanimë të ngulitur pothuajse në çdo shtëpi kaçanikase:

,,Dy lule ka Kaçaniku
Sali Bajrën e Bedri Kyçyku"

I donte dhe i respektonte këta atdhedashës që kishin ngritur në rrethana shumë të rënda shkollën e mesme profesionale me një emër tepër karakteristikë ,,Voskopoja". I nderonte të gjithë ata që gjimnazin e pagëzuan me emrin e heroit kombëtar ,,Skënderbeu",

[10] Informatë e datës 14.1.2018, Qafshqipe

por njëkohësisht i urrente të tjerët që këtij gjimnazi ia ndrruan emrin dhunshëm dhe e emërtuan me një emër fyes për shqiptarët. Nderonte dhe respektonte veprimtarinë e Sali Bajrës i cili jo vetëm që kishte udhëhequr Kaçanikun në rrethana të vështira, por Saliu s`kishte lënë gurë pa rrokullisur për zhvillimin e gjithmbarshëm të komunës dhe jo vetëm të sajë. Sali Bajra politikën e tij progresiste e kishte ngritur deri në atë nivel saqë për mbrojtje të shqiptarëve nga dhuna sallavomaqedonase, në Han të Elezit, më saktësisht në vendin e quajtur ,,Vrazhivir" kishte ngritur ,,rampën" për maqedonasit që donin të hynin në Kosovë. Të gjitha këto të bëra, jo vetëm që llafoseshin nëpër oda të fshatrave të kësaj komune, por të bërat e Sali Bajrës dhe shokëve të tij, përmendeshin edhe në mesin e nxënësve, duke marrë gjithnjë e më shumë edhe formën mitike.

Viti 1978 shënonte 100 vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe ky shekull jubilar i Lidhjes u manifestua gjithanshmërisht në Kosovë dhe jo vetëm. Revista letrare ,,Jeta e Re" botoi dramën e Ekrem Kryeziut ,,Epoka para gjyqit", ndërsa trupa teatrale e Kosovës e shfaqi para publikut, duke e shënuar si është më së miri këtë ngjarje me rëndësi të madhe historike.

Këto ngjarje të mëdha kulturore e historike dhe shumë të tjera si këto, s`kishin si mos të linin gjurmë edhe në shpirtin e njomë të Gafur Lumës dhe të rinjëve të tjerë që po rriteshin e burrëroheshin në Grykën e Kaçanikut e cila shquhej me luftën e Idriz Seferit te ,,Guri i Shpum" në vitin 1910 e cila jo vetëm që ishte përcjellur te brezat si histori, por e njëjta ishte ngjizur edhe në këngë:

Kaçanikut i raftë pika

Nuk e dijtka ç`ka a frika
Nandë sahat tuj u therë me thika
Therë me thika nandë sahat
Ka ra kali not në gjak!

Kjo periudhë 18 vjeçare, pra nga viti 1961-1979 paraqet fazën e parë dhe tejet domethënëse të jetës së dëshmorit Gafur Luma. Kjo periudhë kishte në brumin e sajë; legjenda, rrëfime, tregime e ngjarje rinore që i përjeton çdo i ri. Kështu ishte edhe për Gafurr Lumën.

Nëpër këto rrethana kulturore e politike, Gafur Luma në vitin 1979 po e fillonte vitin e katërt të gjimnazit në Kaçanik, vit i cili jo vetëm që do të maturonte Gafur Luma, por ky vit shënonte edhe kthesën e madhe, shënonte udhën e lirisë prej së cilës Gafuri nuk do të ndahet për 20 vite me radhë, deri në sakrificën sublime të tij më 22 maj 1999.

Fotografi e dëshmorit Gafur Luma (në mes) në shkollë fillore dhe një fotografi tjetër e më vonëshme

Gafur Luma në shkollë të mesme

Gafur Luma në vitin e tretë të gjimnazit në vitin 1979

KAPITULLI II - Veprimtaria politike ilegale e dëshmorit Gafur Luma
(vjeshtë 1979 - pranverë 1990)

Shtatori i vitit 1979, paraqet fillimin e vitit të katërt të shkollës së mesme në drejtim matematikor të dëshmorit Gafur Luma. Krahas kësaj, ky shtator rikthente dashurinë ndërmjet shokëve e shoqeve të klasës, të cilët jo vetëm që lexonin literaturën e domosdoshme të mësimnxënies së rregullt, por ata kishin hapëruar shtigjeve edhe më të zgjeruara, kërkonin atë që kishte humbur që në tetorin e vitit 1912.[11]

[11] Më 26 tetor 1912, komuna e Kaçanikut pushtohet nga pushtuesi serb, një muaj para se të shpallej Pavarësia e Shqipërisë në Vlorë.

Në këto rrethana kulturore e politike, Gafur Luma sa ishte nxënës i shkollës së mesme dhe banonte në banesën private në Lagjen e Bobëve, bie në kontakt me atdhetarin Ferid Qallaku nga fshati Gajre të Kaçanikut, i cili që herët, që nga viti 1976 ishte i angazhuar në veprimtarinë ilegale për Republikën e Kosovës dhe i ndërlidhur me tanimë heroin Kadri Zeka.[12]

Njohja e Gafur Lumës me veprimtarin dhe revolucionarin Ferid Qallakun, krijonte një moment të ri në jetën e Gafurit, krijonte një situatë të re shpirtërore, pasiqë Ferid Qallaku ishte njëri nga militantët domethënës të Organizatës ilegale politike, i angazhuar me tërë fuqinë në zgjerimin e radhëve liridashëse, shpërndarës i trakteve ilegale dhe njëri nga organizatorët e demonstratave të 5 majit të vitit 1981 në Kaçanik dhe më pas i arrestuar dhe i dënuar me 8 vite burg të rëndë.

Duke kujtuar veprimtarinë ilegale të dëshmorit Gafur Luma, bashkëveprimtari i tij **Ferid Qallaku** nga fshati Gajre i Kaçanikut, ish i burgosur politik, thotë [13] :
Njohja ime e parë me dëshmorin Gafur Luma ka ndodhur në vjeshtën e vitit 1979 atëherë kur me erdhi në vizitë në laboratorin e Fabrikës së Gelqeres " Lepenci " në Kaçanik. Ai erdhi me disa shokë të tij gjimnazistë ; Ibush Luzha, Remzi Elezi, Muhamet Malsiu dhe një tjetër nga Tushajt por s`më kujtohet emri. Unë që më parë isha në dijeni nga shoku i celulës Kadri Luzha se ai kishte një grup të gjerë shokësh në shkollë të mesme dhe që punonte me ata. Njëkohësisht unë mbaja

[12] Kurrë nuk e harroj takimin ilegal me Heroin Kadri Zeka në vitin 1979, m`u në atë vend kur forcat e UÇK-së me 28 shkurt 1999 vranë komandantin serb të stacionit policor të Kaçanikut, kujton Ferid Qallaku

[13] Shënimet janë marrë në muajin prill 2016

ligjërata dy herë në javë për nxënësit e drejtimit Kimi - Teknologji, për procesin teknologjik dhe analizat kimike me gëlqere, gjithnjë në prani të arsimtarit të tyre, Ramadan Thaçit. Ndërkohë me nxënës bëja punë patriotike u shpjegoja për çështjen tonë të pa zgjidhur kombëtare, u flisja për historinë e popullit shqiptar, i udhëzoja që të përcjellnin programet e Radio Tiranës, u jepja literaturë e revista legale e ilegale, ndërkohë i nxisja ta mësonin kiminë. Gafur Luma që në bisedën e parë me la përshtypjen e një djali të sinqertë, i zgjuar, kurreshtar e i çiltër me një buzëqeshje të ëmbël dhe nga shtati ishte më i gjatë se shokët e tij. Pastaj e pyeta për familjen dhe si udhëtonte. Më tregoi se udhëtonte me kushëririn e tij Nevaitin i cili punonte si shofer në fabrikën tonë, ndërsa banonte në një banesë private në fshatin Bob. Kështuqë filluam të shihemi e të komunikojmë në mënyrë të rregullt ngase edhe unë e kisha një banesë ilegale në fshatin Bob. Me Gafur Lumën, në veprimtarinë ilegale vepronte edhe Kadri Luzha nga fshati Begracë. Gjatë kontakteve në vazhdimësi dhe ngritjes organizative, Gafuri fillimisht mbante pseudonimin " Agimi ", kurse unë e kisha " Agroni ". Takimet, për çështje konspirative, zakonisht i mbanim natën dhe këmbenim literaturë dhe informacione të ndryshme. Kishte raste kur takimet ilegale me Gafurin i mbaja edhe te shkolla në fshatin e tij të lindjes, në Gllboshicë (Qafshqipe). Në rrjedhë të aktivitetit patriotik, Gafur Luma dhe anëtari tjetër i celulës, Remzi Krraba janë edhe shpërndarësit e 100 ekzemplarëve të revistës ilegale ,,Liria", të cilat unë i pata marrë nga Hydajet Hyseni në Prishtinë. Në

aksione, si celulë e organizuar, kemi marrë pjesë edhe herave të tjera, thot ai.
Pas rënies sime në burg, (qershor 1981) kujton më tej Ferid Qallaku, Gafur Luma rregullisht e ka vizituar familjen time dhe është kujdesur për çdo gjë të mundshme. Kur isha në burgun e Mitrovicës së Kosovës, bashkë me Nevaitin, dy herë ka ardhur dhe më ka vizituar dhe më ka pyetur me kënd me u lidhë për të vepruar më tej, si dhe më informonte për rrjedhat aktuale politike. E kam sugjeruar që të vazhdoj aktivitetin ilegal me Remzi Krrabën e disa patriot e simpatizant të cilët edhe Ai i njihte. Kjo duhej të bëhej ngase i gjithë trupi organizativ me gjithë udhëheqjen ishim të burgosur, prandaj pjesët e tresheve që kishin shpëtuar nga burgosja duhej të lidheshin mes vehte dhe të riorganizoheshin. Së treti herë ka ardhur të më vizitoj në burgun e Mitrovicës së bashku me Remzi Krrabën, madje gjatë vizitës biseduam mundësinë e ikjes time prej burgut. U thashë të më sjellin një thikë patenti dhe ta vendosin në pastën e dhëmbëve. Remzi Krraba e kishte siguruar thikën, por kur ka ardhur të ma dorëzoj në burg, mua më patën transferuar në burgun e Sarajevës, kujton veprimtari i dalluar i çështjes kombëtare Ferid Qallaku nga fshati Gajre i Kaçanikut.
Grykë e Kaçanikut – derë stuhish;
Kjo grykë legjendare – varr perandorish.
Në gjoksin tënd të gurtë, fole e trimërisë,
Nuk u shua kurrë, zjarri i lirisë.
Një pjesë nga një poezi e Ferid Qallakut, botuar ilegalisht në ,,Këngët e lirisë" 1980

Nga kujtimet e veprimtarit Ferid Qallaku, mësojmë se në celulën e veprimit për Republikën e Kosovës, nga vjeshta e vitit 1979 ishte i organizuar Gafur Luma dhe ishte në lidhje të drejtëpërdrejtë me Feridin. Për ngritje ideore, krahas Udhëzimeve për konspiracion, Traktit Liria si dhe trakteve e broshurave të tjera që ju shpërndaheshin radhëve të organizuara, Gafur Luma lexon edhe librat që në atë kohë ishin të ndaluara si: ,,Shota e Azem Galica", ,,Isa Boletini", revistën ,,Shqipëria e Re" dhe revistën tjetër krejtësisht ilegale ,,Liria". Celula ku vepronte Gafur Luma ishte njësia bazë e veprimit dhe në dokumentet ilegale shkruhej se,, *Celulat revolucionare janë shkëndija të cilat formojnë zjarrin e madh të revolucionit. Në celula revolucionare mund të organizohen nga tre deri në pesë anëtarë për të punuar sistematikisht në shërbim të çështjes, po nuk është mirë që celula të ketë shumë anëtarë''*

Në vazhdim, për të pasqyruar sadopak gjendjen shoqërore, politike e pushtuese që mbretëronte në atë kohë, e në anën tjetër edhe luftën e ilegales për çlirim, po sjellim disa shkrime të revistës ilegale *Liria* dhe misionin e saj për liri. Brenda kësaj reviste që shtypej e shpërndahej ilegalisht nga OMLK-ja, ku tanimë militonte Gafur Luma, gjejmë një Kosovë tjetër, gjejmë një Kosovë shqiptare, gjejmë një Kosovë antijugosllave dhe nëpërmjet këtyre shkrimeve e leximeve u brumos e u frymëzua edhe vet Gafur Luma. Brenda këtyre shkrimeve dhe shkrimeve të tjera kombëtare që dëshmori do t`i ketë nëpër duar e organizime, e gjejmë Gafurin e kërkuar, atë Gafurin ilegal, militant e konspirativ, e gjejmë Gafurrin e vërtetë i cili gjatë 20

viteve të veprimtarisë së tij kombëtare Gafurri e *Liria* u ngjizën e u bënë një.

...Liri! Liri thërrasin sot të gjithë popujt e robëruar të botës…Të gjithë shtypësit e robëruesit kudo në botë që fundin e tyre do ta gjejnë në zjarrin e madh të luftës popullore.

Liri! Liri thirri në shekuj populli shqiptar për Atdheun e tij të dashur. Gjaku lumë u derdh për lirinë e shtrenjtë në tokën e shqipes.

Liri thërret sot Kosova e robëruar, Kosova e shumëvuajtur e martire, Kosova trime. Bijtë e Kosovës luftuan në shekuj për liri, kundër armiqve të shumtë e të egër që lakmonin fushat tona të gjera, malet tona të bukura, pasuritë e shumta që ka në vete toka jonë e dashur. Me këto lakmi të çmendura krajlët e Serbisë e Malit të Zi, me ndihmën e imperializmit evropian, me gjithë luftën heroike të popullit shqiptar, arritën të shkëpusin nga trungu i Shqipërisë gati gjysmën e saj dhe ta fusin nën robërinë e tyre të egër.

Të nisur nga këto lakmi krajlët revizionistë të Beogradit me tradhti dhe me hekur e zjarr e futën sërish nën një robëri të re po aq të egër popullin e Kosovës dhe viseve shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi.

Por, populli ynë, që në historinë e tij nuk iu nënshtrua kurrë asnjë robëruesi, sigurisht që nuk u pajtua asnjëherë me sunduesit e rinj revizionistë e shovinistë të tërbuar. Prandaj, populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi ka luftuar vazhdimisht dhe lufton pa pushuar, në forma të ndryshme, kundër pushtuesve të sotëm revizionistë, për çlirim kombëtar e shoqëror. Kjo luftë do të rritet gjithnjë e më shumë, do të zgjerohet e thellohet çdo ditë. Ajo do të marrë zjarr e do t'i djegë në flakën e

saj armiqtë e tradhtarët dhe do t'i sjellë fitoren e sigurt popullit tonë, lirinë e ëndërruar në shekuj. Kosovën pa pushtues, pa shtypës e shfrytëzues, të lirë e të bashkuar...
Organi "Liria" po del me qëllim që ta ndihmojë këtë luftë të popullit tonë për të drejta e liri.
"Liria" në gjithë punën e saj do të frymëzohet nga aspiratat e larta të popullit...
"Liria" do të jetë një tribunë e vërtetë që ka për qëllim të ndihmojë bashkimin e gjithë popullit në luftë kundër pushtuesve dhe tradhtarëve.
"Liria" do të luftojë pa mëshirë kundër armiqve të popullit tonë dhe do të demaskojë propagandën e poshtër demagogjike e mashtruese të tyre.
"Liria" do t'i tregojë popullit qartë cilët janë armiqtë e vërtetë të tij, kush i rrëmbeu lirinë, kush e vrau dhe e mashtroi, kush e dëboi nga vatrat e veta, kush e varfëroi dhe e çoi në këtë gjendje të mjeruar, kush i përplas nëpër burgjet e errëta jugosllave bijtë e tij, kush e shtyp dhe e shfrytëzon kaq egërsisht dhe do t'i tregojë cila është rruga e shpëtimit nga robëria e tmerrshme.
"Liria" do t'i mbrojë me guxim interesat e popullit tonë të robëruar para çdo armiku.
"Liria" jonë do të jetë gjithë jetën tribunë e së vërtetës, e drejtësisë dhe zëri i lirisë së vërtetë të popullit tonë.
"Liria" do të punojë e luftojë me vullnet të hekurt për edukimin dhe kalitjen e popullit me një patriotizëm të flaktë e revolucionar.
"Liria" do të ngrejë lart me krenari traditat e shkëlqyera luftarake të së kaluarës së lavdishme të popullit tonë, përpjekjet e luftërat e tij për liri e bashkim kombëtar.
"Liria" do të pasqyrojë urrejtjen e madhe që ka mbushur

gjokset shqiptare kundër regjimit shtypës e shfrytëzues, luftën e popullit që bëhet në forma të ndryshme kundër këtij regjimi, do t'i sqarojë masat mbi gjendjen brenda dhe jashtë vendit si dhe do t'i orientojë ato në situatat e ndryshme...

Këtë mision ka "Liria" jonë.

...Menjëherë pas luftës klika gjakatare e Tito - Rankoviçit ndërmorri masa të papara për ta shfarosur, dëbuar e shkombëtarizuar popullin tonë në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi dhe për të realizuar, në këtë mënyrë ëndërrat e çmenduara të paraardhësve të tyre shovinistë. Zhdukja mizore e dhjetra mija shqiptarëve gjatë dhe pas luftës, dëbimi me dhunë për në Turqi e vende të tjera të qindra e mija të tjerëve, rrahja e poshtrimi i pothuajse të gjithë burrave kosovarë gjatë aksionit famëkeq të armëve, plaçkitja e pamëshirshme e pasurive tona natyrore, grabitja e dhunshme e tokës dhe bereqetit janë vetëm disa nga masat që xhelatët titistë ushtruan mbi kurrizin e popullit tonë...

...Pushtuesit revizionistë jugosllavë dhe shërbëtorët e tyre shqiptarë, kohëve të fundit kanë ndërmarrë kundër popullit tonë një varg masash të dhunës e të demagogjisë. Këto masa të revizionistëve nuk janë të panjohura për popullin tonë dhe nuk e çudisin atë. Gjatë gjithë sundimit të tyre të egër, revizionistët jugosllavë nuk kanë lënë metodë e mjet pa përdorur me qëllim që ta shtypin e shfrytëzojnë sa më egërsisht popullin tonë dhe të shuajnë çdo aspiratë e përpjekje të tij për çlirim kombëtar e shoqëror...

...Nga ana tjetër tokat shqiptare popullohen vazhdimisht me popullsi sllave. Në mënyrë të veçantë shovinistët

maqedonas po përpiqen me çdo kusht të grumbullojnë gjithë diasporën maqedonase dhe ta vendosin atë në viset shqiptare. Në këtë mënyrë shovinistët jugosllavë synojnë të ndryshojnë strukturën nacionale të popullsisë së tokave shqiptare dhe t'i shpallin pastaj tokat tona si toka serbe, malazeze apo maqedonase...

...I bashkuar si një trup i vetëm, populli ynë do ta vazhdojë luftën e tij deri në fitoren e plotë dhe do ta çojë në vend amanetin e shenjtë të Isa Buletinit, Bajram Currit e Shotë Galicës, të Ali Kelmendit, Asim Vokshit, Emin Durakut e mijëra dëshmorëve të ndritur, që jetën e tyre ia falën lirisë së shtrenjtë...

...Vëllezërit tanë shqiptarë në Jugosllavi vuajnë. Një nga vendet më të prapambetura në Jugosllavi është Kosova. Edhe shqiptarët në Maqedoni vuajnë, por tashti, pas tërmetit të 15 prillit të këtij viti, më keq akoma janë vëllezërit tanë shqiptarë në Mal të Zi. Zemra jonë lëngon për ta. Si të mos na dhemb zemra për mijëra vëllezërit tanë në Hot e në Grudë, në Ulqin e në Tivar, kur tash që po vjen dimri nuk do të kenë çati për të futur kokën...

...Të pakënaqur punëtorët, të pakënaqur fshatarët, i pakënaqur e i revoltuar i gjithë populli. Në një gjendje të tillë të padurueshme, ku populli është mbështetur për muri, e thika po e prek në asht, mjafton një shkëndijë e vogël që të merrte flakë e tërë Kosova. Këtë shkëndijë kaherë të pritur, e ndezën më 11 mars studentët trima të Universitetit të Kosovës...

...Edhe pse kërkesat dhe parullat e demonstratës së parë ishin kryesisht me karakter social dhe ekonomik, ajo u cilësua si armiqësore dhe jo vetëm që nuk u përfillën fare kërkesat e studentëve, jo vetëm që nuk u mor asnjë masë për përmirësimin e gjendjes së tyre, por ndaj

demonstruesve u përdor dhuna policore. Kjo dhe arrestimet që u bënë, e shtuan edhe më shumë pakënaqësinë dhe revoltën e studentëve, e cila shpërtheu me forcë e vendosmëri edhe më të madhe në demonstratën e 26 marsit. Studentëve në këtë demonstratë iu bashkua edhe një numër jo i vogël i punëtorëve, nxënësve dhe qytetarëve të tjerë. Përveç parullave të mëparshme, në përgjithësi ekonomike e sociale, kësaj here u ngritën edhe kërkesa dhe parulla politike. Demonstrata e 26 marsit ishte më popullore dhe mori edhe më shumë karakter politik...

...Dhuna dhe terrori i egër fashist jo vetëm nuk frikësoi rininë tonë të zjarrtë dhe popullin tonë trim, por përkundrazi, e shtuan edhe më shumë pezmin dhe urrejtjen e tyre ndaj armiqve dhe tradhtarëve. Benzina që iu hodh zjarrit që kishte shpërthyer, sigurisht që nuk do ta shuante atë, por do ta shtonte edhe më tepër. Dhe kështu ndodhi. Kupa e pakënaqësisë dhe revoltës ishte mbushur edhe më parë, por tani, pas dhunës që u përdor ndaj rinisë, ajo nuk zinte më. Në këmbë u ngrit i gjithë populli. Demonstrata e greva të shumta shpërthyen anë e kënd Kosovës. Demonstruesit hodhën parullën: "PUNËTORË, STUDENTË, FSHATARË, JEMI NJË E TË PANDARË!" dhe ashtu u bë. Dhjetëra mijëra punëtorë, fshatarë, studentë, nxënës, zejtarë e intelektualë u bashkuan si një trup i vetëm në një bllok të fuqishëm e të paparë...
...Ditën e 1 prillit, nga të gjitha anët e Prishtinës, lumenj të mëdhenj demonstruesish, duke çarë përmes reve të gazit lotsjellës, plumbave dhe bajonetave, u derdhën në qendrën e qytetit, u bashkuan dhe formuan aty një det të madh e të paparë. Pamja që mori qendra e Prishtinës

sonë heroike ishte vërtet madhështore. Nuk mund të shihej aty asgjë tjetër përveç kazmave, lopatave e çekanëve që ngriheshin kërcënueshëm para selisë së tradhtarëve të Kosovës, përveç grushteve të fuqishëm të më se 20 mijë demonstruesve të të gjitha moshave e profesioneve, që ishin bashkuar në një grusht të vetëm e kolosal. Nuk mund të dëgjohej aty asgjë tjetër përveç korit madhështor të popullit që kumbonte në të gjithë qytetin, përveç brohoritjeve të fuqishme:

"Kushte për studentët" "Kushte për punëtorët",”Çmimeve, stop", "Duam punë", "Ktheni kurbetçinjtë", "Mjaftë shtypje e shfrytëzim", "Poshtë robëria –– rroftë liria", "Lironani shokët", "Kërkojmë llogari", "Të burgosurit kosovarë ktheni në Kosovë", "Trepça është jona", "Kosova është jona" , "Kosova - kosovarëve", "Kosova - Republikë", "Duam vetëvendosje", "Të gjithë shqiptarët jemi një", "Jemi shqiptarë, s'jemi jugosllavë"...

...Ata që kishin menduar se me tanke e aeroplanë mund t'i frikësojnë bijtë e shqipes, u mashtruan keq. Ajo që ndodhi më 2 prill, duhet të jetë mësim i mirë për çdo armik dhe tradhtar. Në Prishtinë dhe në shumë qytete të Kosovës, atë ditë punëtorët nuk dolën në punë, nxënësit nuk shkuan në mësim por dolën masovikisht në demonstrata të reja, u ngritën barrikada forcave të ushtrisë dhe të policisë armike dhe u përleshën me to me heroizëm të paparë. Në këmbë ishte i madh e i vogël. Përballë tankeve e mitralozave, populli tundte grushtin e tij të fuqishëm. Pothuajse të gjitha dyert e shtëpive ishin të hapura për bijtë e nënave. Dora e madhe e popullit u sillte vazhdimisht bukë e ujë luftëtarëve të tij. Infermierë dhe mjekë mantel dhe zemërbardhë të spitalit të Prishtinës u sillnin pa ndërprerë ushqime, fashë e barëra

demonstruesve, u mjekonin dhe u lidhnin plagët trimave dhe trimëreshave... Kishin arsye ata oficerë e ushtarë të huaj që kapnin kokën dhe fërkonin sytë. Bijat e bijtë e Kosovës kreshnike, duarthatë po zemër zjarrtë, ua hapnin gjoksin plumbave të armikut, hidheshin edhe mbi tanke. Djemtë petrita të Kosovës dhe vajzat e saj shqiponja, e veshën përsëri xhamadanin e Mic Sokolit, Selam Labit dhe Vojo Kushit, i treguan edhe një herë botës se vërtet të gjithë shqiptaret e shqiptarët janë Shotë Galica e Mic Sokola...

...Demonstratat që shpërthyen anë e kënd Kosovës u shuan në gjak. Qindra bij e bija të popullit u vranë, u plagosën dhe u lënduan rëndë, por lufta e drejtë e popullit për të drejta e liri nuk u shua. Në përkrahje të kërkesave të drejta të popullit, në shumë qytete të Kosovës shpërthyen greva e demonstrata të tjera, kurse vëllezërit tanë në kurbet organizuan dhe po vazhdojnë të organizojnë demonstrata të fuqishme dhe mitingje të shumta proteste nëpër vendet e ndryshme të botës. Populli ynë po e vazhdon luftën e tij në forma të ndryshme, dhe do ta vazhdojë atë deri në realizimin e plotë të kërkesave dhe aspiratave të tij, deri në fitoren e tij të plotë...

Anëtari tjetër i celulës së veprimtarit Ferid Qallaku, ishte edhe atdhetari **Remzi Krraba**[14] (1948) ish i burgosur politik nga fshati Stagovë i Kaçanikut. Ai kujton se si anëtar i organizuar nga Feridi, jam që nga viti 1977 dhe takimet e përditshme me Feridin i kisha në fabrikën e gëlqeres në Kaçanik, ndërsa ato konspirative i mbanim në Dushkajë për mbi Tunel të Runjevës, te

[14] Shënim i datës 15.5.2017 dhe 2.7.20017, Stagovë

Vorret e Tronëve nën magjistrale, te Tuneli i Trenit nën Gurin e Shpum. Gjatë kësaj periudhe jemi marrë me ngritje organizative si në lexim të materialeve ilegale që vinin nga organizata dhe përvetësimin e anëtarëve të tjerë. Më kujtohet së gjatë kësaj periudhe kam lexuar librin ,,Isa Boletini", ,,Ramadan Zaskoci"[15], ,,Shotë e Azem Galica", ,,Njeriun me top", ,,Shqipëria e Re", revistën ,,Liria" disa trakte me emrin ,,Liria" si dhe librin e Enver Hoxhës ,, Vetadministrimi jugosllav teori dhe praktikë kapitaliste".

Shkrimi i parullave në muret e gjimnazit në Kaçanik, në fund të vitit 1979[16], si: Poshtë Tito! Poshtë LKJ! Rroftë populli shqiptar! e që më vonë e kemi mësuar se janë shkruar nga grupi i Ibush Vishit, ishin një ngjarje e madhe dhe një komunikim i hapur me publikun. Edhe pse parullat në murë u fshin nga UDB-a, njerëzit në komunikim mes vete, madje vet ne, prodhonim edhe parulla të tjera gjatë komentimi të tyre.

Jam marrë edhe me shpërndarjen e Traktit rreth vizitës së Titos në Kosovë në vitin 1979, trakt i shtypur nga

[15] Ramadan Zaskoci nga Mamzi (Kukës), i dalluar në lëvizjen antiosmane e antiserbe në vitet 1876-1914, mori pjesë në lëvizjen kundër Mehmet Ali pashë Maxharrit në Prizren e Gjakovë (1878) dhe në mbrojtjen e tokave shqiptare nga shovenistët malazezë (1879) si dhe në luftimet kundër ushtrive osmane (1881), por sidomos në krye të malësorëve lumjanë, bashkë me krerë të tjerë, në luftimet kundër forcave osmane që hynë në Lumë në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit të 20 (1903 -1904, 1909, 1910) dhe atyre serbe në nëntor 1912. Qe ndër udhëheqësit e kryengritjes së shtatorit 1913 kundër pushtuesve serbë.(Burimi: Ëikipedia)

[16] Komiteti komunal i LK (Lidhjes së Komunistëve) vlerësoi se në komunën e Kaçanikut kanë organizuar dhe ekzistuar dhe ekzistojnë forma të ndryshme të veprimtarisë armiqësore me karakter nacionalist, irredentist e informbyroist dhe mbeturinat e tyre, duke filluar prej vitit 1946, vitit 1948, vitit 1969, dhe shkrimit të parullave në muret e QAMO-s në vitin 1979…(Burimi: Latif Nallbani ,,Reshat Shehu'' fq.104)

OMLK-ja me titull Lexoje, shpërndaje, armikut mos ia dorëzo, Trakt tre faqësh i cili ndër të tjera shkruante se,, *Këto ditë armiku i madh i popullit tonë, kryerevizionisti jugosllav J.B.Tito, bëri një vizitë në Kosovën tonë të robëruar... Xhelati Tito, erdhi edhe të ndërsej këlyshët e tij kundër popullit tonë të mbushur plotë urrejtje ndaj shtypësve e shfrytëzuesëve të tij, kundër patriotëve, revolucionarëve... për të shtypur ndjenjat kombëtare e klasore revolucionare në Kosovë... Kjo politikë kolonialiste, shtypëse e shfrytëzuese ndaj popullit tonë, ka ngjallur urrejtjen e tij kundër robëruesve*...Në një rast tjetër, më kujtohet, kur Feridi më sollë tri kutia të faksit (detergjentit). Në ato kuti të detergjentit, për shkaqe sigurie, ishin vendosur mbi 15 gazeta ilegale ,,Liria" nr.3.4.5 dhe ato i shpërndava në fabrikën e gëlqeres në Kaçanik dhe nëpër shokë të tjerë, si: Nesim Bela, Idriz Krasniqit, Rrahman Krivanjeva, etj.

Po gjatë kësaj periudhe, pra para se të shpërthenin demonstratat e vitit 1981, aktivitetin e kam zhvilluar në mesin e punëtorëve, në aktivizimin e tyre sindikal për rritje lineare të pagave në mes të punëtorëve dhe udhëheqësve të kombinatit. Një kërkesë të tillë e patëm përcjellur deri në Komitetin Krahinor të Kosovës, por natyrisht mbetëm pa përgjigje. Por, kur pas demonstratave, udhëheqja politike e krahinës kërkonte dënimin e demonstratave, atëherë ne u thamë atyre që së pari na e jepni përgjigjen rreth pagave lineare e pastaj diskutojmë për demonstratat.

Kur për nderë të 1 Majit-Ditës së Punëtorëve, në dyertë e mëdhaja të punëtorisë në fabrikë u ngjitën parolla për 1 majin, por në gjuhën serbe, Feridi më angazhoi që ata t`i shkyejë dhe këtë aksion e kreva më 2 maj të vitit 1980.

Për këtë aksion të Remzi Krrabës shkruan edhe Naser Kuka në librin e tij ,, Nga lëvizja ilegale te UÇK"...Remziu në mbrëmjen e 1 majit, në aksionin për heqjen nga vendet publike të mbishkrimeve serbisht, të cilat ishin vendosur në vendet publike të fabrikës kishte qenë krejtësisht i suksesshëm, s`kishte lënë afishe pa e bërë copë e grimë...

Për shpërthimin e demonstratave të 11 marsit 1981 në Prishtinë, më gjerësisht më njoftoi Feridi më 12 mars. Ndërkohë marrim aksionin për shpërndarje të pamfleteve më 26 mars 1981 në Ferizaj dhe aktiviteti ynë përqëndrohet në organizimin e demonstratave edhe në Kaçanik. Fillimisht, objektivin tonë e përqëndruam në shkollën e mesme ,,Skënderbeu" dhe në mesin e punëtorëve që ata të jenë përkrahës të demonstratave. Ata arritën që në Kaçanik të shpërthejnë më 5 maj 1981, ku Feridi jo vetëm që mori pjesë, por në demonstrata doli edhe me uniformë ushtarake nga Mbrojtja Territoriale.

Hyrja e Ferid Çallakut në demonstratë, njërit ndër veprimtarët e hershëm të kauzës sonë kombëtare, do të shënonte kulmin e efektit mobilizues që demonstrata e kishte arritur, thot Naser Kuka.[17]

Për këtë vepër, nga Gjyqi ushtarak në Nish, Feridi dënohet për pjesëmarrje në demonstrata me 2 vite e gjysëm burg. Ndërkohë, në nivel të Kosovës, zbulohet Organizata dhe burgoset Hydajet Hyseni, Jakup Krasniqi, Mehmet Hajrizi, Berat Luzha e të tjerët me radhë dhe në këtë rrjedhë, zbulohet edhe veprimtaria e Ferid Qallakut. Këto arrestime dhe arrestimet në masë në vazhdim, dëmtuan rëndë lëvizjen ilegale, por celula ku

[17] Naser Kuka „Nga lëvizja ilegale te UÇK'' Prishtinë 2012, fq.107

vepronim ne, mbeti e pa dëmtuar. Ne që mbetëm të pazbuluar, vazhduam veprimtarinë në rrethana jo të lehta me anëtarë të tjerë. Bashkë me vëllaun e Feridit, Qazimin e kemi vizituar Feridin në burgun e Mitrovicës dhe bënim përpjekje që ai të ikë nga burgu. Thikën me patent që i duhej Feridit, ia siguruam dhe derisa ne po përgatiteshim të shkojmë për vizitë dhe nëpërmjet pastës së dhëmbëve t`ia dërgojmë thikën, atë e transferuan në burgun e Foqës në Sarajevë. Fillimisht Feridi ishte në burgun e Nishit, përshkak të pjesmarrjes në demonstrata të 5 majit me uniformë ushtarake, por kur zbulohet veprimtaria e tij në OMLK e kthejnë në burgun hetues të Mitrovicës.Pas burgosjes së Feridit, ndërlidhem në veprimtari me Fadil Hysën nga Stagova ku në përvjetor të demonstratave të 5 majit 1982 kam shpërndarë pamflete me Milaim Jahën (tani i ndjerë) në Kaçanik të Vjetër, në Lagjen e Gabrricëve, në Lagjen e Përzhajve, në Lagjen e Reqëve, në Lagjen e Çardakut si dhe në Kogjaj, Te Lushi e në Fushë të Pajtimit. Një pamflet ia dhashë edhe prof. Mejdi Dalloshit në Kaçanik, tani dëshmor, ndërsa nga Mejdiu, herave të tjera kam marrë romane të ndryshme. Takime dhe bashkëpunim të vazhdueshëm kam pasur edhe me Idriz Krasniqin pasiqë ishim punëtorë të së njëjtës organizatë në Fabrikën e Gëlqeres në Kaçanik. Madje, Idrizi ka tentuar të ndërtoj edhe një geshtetner të thjeshtë.

Veprimtaria ime me Fadil Hysën ishte e dendur, por më kryesorja ishte puna me geshtetnerin [18] (aparat për

[18] Fadil Hysaj me ndihmën e Shaban Jusufit, Muhamer Shabanit, Nazife Xhemajlit e Riza Llapashticës e bart aparatin e fotokopjimit prej Fushë Kosovës deri në Stagovë. E kishte për detyrë që këtë ta aftësonte për punë pasi ishte teknik i makinerisë.Ka shumëzuar materialin me titull ,,Eksploatimi i Trepçës'' në dy

shumzimin e materialeve) që shokët patën arritur ta marrin dikund. Në fillim të nëntorit 1981, në shtëpinë time kemi shtypur materialin me titull ,, Eksploatimi i Trepçës", si tekst provues, pasiqë nuk dinim si punohej me geshtetner me qëllim që për Vitin e Ri 1983, ai trakt të shpërndahet në gjithë Kosovën. Matricën e tekstit e ka shtypur organizata. Fadili më tha që duhet të shtypen 5000 ekzemplarë, ndërsa letrën e kemi siguruar në Prishtinë, Prizren e Shkup, në të gjitha vendet ngapak, që të mos biem në sy, pasiqë kjo punë e letrës përcillej nga UDB-a. Me geshtetnerin që e provonim, ne shtypëm disa fleta, por për provë i veçuam dy; variantin më të dobët dhe më të mirin, Fadili ia dërgon Bajrush Xhemajlit në Prishtinë. Gjatë arrestimit të Bajrush Xhemajlit, në xhep i gjenden edhe këto dy pamflete. Pasi zbulohet organizata në dhjetor të vitit 1982 dhe pas arrestimit të Bajrush Xhemajlit, Rrahim Sadikut, Fadil Hysës, Shaban Jusufit, Nazife Xhemajit e shumë të tjerëve, zbulohem edhe unë, shkaku i geshtetnerit që ishte te unë, pasiqë gjatë hetimeve se ku janë shtypur ato dy pamflete, del se geshtetneri është në shtëpinë time. Unë arrestohem, aty ku sot është busti i dëshmorit Qamil Ilazit në Kaçanik dhe policia më dërgojnë në stacionin policor ku brenda gjeta Fadil Hysën të arrestuar i cili ishte nën pranga në të njëjtën ditë por, paradite. Shumë shpejtë na ndanë saqë nuk mundëm të merremi vesh për asgjë. Mua në pyetje më morën Halit Loku dhe Adem Goga. Duke përdorur pozicionin tim prej punëtori të thjeshtë në fabrikë që kam të kryer vetëm shkollën fillore, nuk pranova që kam geshtener në shtëpi

---

kopje.(Dr.Sabile Keçmezi-Basha ,,Organizatat dhe grupet ilegale në Kosovë 1981-1989, Prishtinë 2003, fq.141)

dhe as që e di se çka është dhe përçka shërben ai. Por kur na ballafaquan me Fadilin, ai më tha: Remzi, geshtenerin që e kanë sjellur prej Fushë Kosovës duhet me e dorzuar. Unë përsëri nuk pranova që kam geshtetner në shtëpi dhe i thash Fadilit nëse e din se ka geshtetner në shtëpinë time, shko e merre. Pastaj sërish na ndanë dhe filluan torturat ndaj nesh dhe sërish na ballafaquan dhe përsëri Fadili i torturuar rëndë, më tha që geshteneri duhet të dorëzohet pasiqë ti nuk e ke ditur se për çka shërben ai, që në fakt ishte edhe rrethanë lehtësuese për mua, dhe në fund pranova një gjë të tillë. Mua më dënuan për kundërvjatje me 60 ditë burg pasiqë edhe në hetuesi deklarova se Fadili atyre ditëve ishte ndarë nga familja e tij dhe meqenëse ndërkohë kishte marrë banesë në Ferizaj, kam menduar se janë sende shtëpiake. Burgun 60 ditor e kam mbajtur në Prishtinë dhe Gurakoc ku jam takuar me Fatmir Bytyqin dhe Sulejman Bytyqin të dënuar si studentë të vitit të katërt për politikë.

Në fakt UDB-a nuk arriti të zbulojë veprimtarinë time të më hershme. Pas daljes nga burgu, në pranverë të vitit 1983, dhe kontaktet që kishim me Feridin në Mitrovicë, para se ai të transferohej në Foqë, u morëm vesh që lidhja ime organizative

të mbetet në treshen e Gafur Lumës dhe Remzi Elezit.

Por ndërkohë, lidhje ilegale kam pasur edhe me Skender Luzhën nga Begraca ku nga Skënderi kam marrë për lexim libra e fletushka ilegale. Me Skënder Luzhën takimet i kam mbajtur ,,Te plepat '' afër spitalit të Prishtinës dhe në atë kohë ai ka pasur kontakte me Bexhet Luzhën e Remzi Elezin. Skënder Luzha është zbuluar në valën e arrestimeve të nëntorit 1985 dhe

është në aktakuzë të Xhabir Morinës dhe me sa e di unë, kur celula jonë për një kohë mbeti në vakum, Skenderi i ka mbajtur lidhjet me qendrën.
Takimet ilegale me Gafur Lumën i kam mbajtur në këto vende:Te Reka e Dubravës në bjeshkë, pastaj Përmbi Sepetin, por kur Gafurri shkoi në fakultet, takimet i kam mbajtur te Fabrika e Silkaporit e cila ishte në ndërtim e sipër. Lidhjen time ilegale që e kisha në Llap me Shefki Sejdiun, pasiqë Remzi Elezi ishte në Prishtinë, ia dhash Remziut, ndërsa lidhja e tij ilegale me Mefail Vishin, kaloi në celulën time, kujton Remzi Krraba, duke shtuar se betim para meje kanë dhënë edhe këto anëtarë nga komuna e Kaçanikut, si: Sami Malsiu, Remzi Koraqi e Sami Troni.
Kur UDB-a vrau në Kodër të Trimave, Rexhep Malën e Nuhi Berishën, Gafurr Luma tha se intenzitetin e aktivitetit ilegal duhet ngadalësuar pasiqë Lëvizja është dëmtuar rëndë.
Takimet i mbaja me Gafur Lumën, por ku Gafuri ishte i nxanun, takimin e mbaja me Remzi Elezin. Takimet ishin të rregullta 2-3 herë në javë. Komiteti Organizativ kërkonte që anëtarët të merrem specifikisht me punë të veçanta, të bëhet ndarja e punës. Studentit Sami Troni i njohur me pseudonimin ,,Sadiku" nga Kovaqeci iu caktua detyra e tipografisë, përkatësisht shtypshkronjës. Sami Malsiut ,, Salihu" iu caktua detyra e furnizimit me material mbështetës, sidomos dorëza të gjinekologjisë të cilat na duheshin për shpërndarje të pamfleteve. Gjithashtu edhe Remzi Koraqit ,,Ramadani" iu caktuan detyrat përkatëse. Pasiqë më dihej dhe flitej gjithandej ndër të arrestuar se janë nxënë në ,,kokën" e organizatës dikun 114 pseudonime, këto pseudonime më

janë kërkuar shumë edhe në hetuesi në burgosjen e vitit 1985 nga udbashi Halit Loku. Iu thashë se nuk njoh pseudonime të tillë dhe s`ka premtuar koha e veprimit sepse u arrestuam shpejtë se po të kisha mundësi do t`i organizoja 3000 të tjerë...
Nga Remzi Elezi kam marrë 7 ekzemplarë të librit ,,Titistët" njërën ia kam dhënë prof. Mejdi Dalloshit, tjetrën Misim Sopës e Idriz Krasniqit me porosi që t`ju shpërndahet edhe të tjerëve. Nga Remzi Elezi kam marrë edhe disa numra të *Zërit të Kosovës, Projektprogramin e Projektstatutin e Organizatës,* revistën *Pararoja*, ndërsa *Tezat e Konspiracionit* i kam lexuar që në kohën e veprimtarisë me Ferid Qallakun. Të njëjtat materiale që i lexoja unë ia jepja edhe Sami Tronit, Remzi Koraqit e Sami Malsiut.
Konstituimi i Komitetit të Rrethit për Kaçanik u bë me datën 8 nëntor 1985 në Sllatinë të Lepencit. Morëm pjesë Remzi Elezi, Gafur Luma, Bajram Dernjani dhe unë. Takimi është mbajtur me një shtëpi të pabanueshme diku pas orës 22 të natës dhe dritë kemi pasur një qiri.
Jam arrestuar me 17 nëntor 1985 dhe për tri ditë me radhë në Gjilan më kanë pyetur për pseudonimin ,,Dema" ose ,,Punëtori". Më pyesnin, a mos njeh ndonjë shok me emrin ,,Ramizi", ,,Avdiu", ,,Salihu" apo ,,Ramadani". A mos ke marrë ndonjë libër ose gazetë të ndaluar? Meqë krijova bindjen se pyetjet ishin shumë të përgjithësuara, nuk pranova se njoh njerëz me emra të tillë dhe se nuk kam lidhje me ilegalen dhe pas tri dite u lirova. Por, arrestohem për së dyti pas një muaj dite, saktësisht me 17 dhjetor 1985.
Remzi, 413 vetë i kemi arrestuar deri më tani, më tha udbashi Halit Loku, dhe deri tani me sukses ke fshehur

veprimtarinë tënde, por tani është vërtetuar se ti je i përfshirë në organizatën ilegale dhe pseudonimi juaj është ,,Dema" dhe aty për aty m`i vendosën prangat. Hetimet i kam kryer në burgun e Gjilanit, ndërsa dënohem në Gjykatën Qarkut në Prishtinë me 3 vjet e gjysmë burg. Në burgun e Gjilanit kam qëndruar në katin e parë, në dhomën nr. 17. Në dhomë kam qëndruar me Kadri Labinishtin, Agron Morinën, Jahir Halitin, Fadil Hysën, Osman Bekën, Osman Hajredinin. Hetuesit e mi ishin: Afet Rexhallari, Halit Loku, Qenan Hajdini, Izet Imeri, Ramadan Sinani dhe Ramadan Gjilekari. Dhomat edhe pse të vogla, 5 X 3, ishin të stërmbushur nga 8 deri në 10 të burgosur. Nëntori, dhjetori, janari e shkurti ishin muajtë kur ra organizata jonë dhe të mbushej mendja se nuk mbet kush jashtë prej shokëve. Por, po në janarin e acartë të vitit 1986, djalëria shqiptare, gjeti forcë, gjeti guxim dhe mbushi Kosovën me pamflete në përkujtim të rënies së dëshmorëve Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla e Kadri Zeka, Rexhep Mala, Nuhi Berisha e Bajram Bahtiri, ku në Traktin me titull ,, Popull trim shqiptar nën Jugosllavi", ndër të tjera thuhej:

,,...*Robëria shekullore është bërë një barrë e rëndë mbi kurrizin tonë, barrë e padurueshme. Kjo robëri mund të hiqet qafësh vetëm duke thyer njëherë e përgjithmonë prangat e robërisë serbomadhe. Për t`i thyer këto pranga duhet të bashkohemi të gjithë tok, pa dallim moshe e gjinie dhe si një grusht të marshojmë drejt fitores...*"

Duke vepruar brenda kësaj celule (Remzi Elezi, Gafur Luma, Remzi Krraba) dhe duke krijuar secili edhe celula të tjera, vepruam derisa u zbuluam në vjeshtën e vitit 1985 si anëtarë të Komitetit të Rrethit të Kaçanikut i cili

Komitet vepronte brenda organizatës së Komitetit Organizativ, që në Sekretariat të kësaj organizate ishin personalitetet tanimë të dëshmuar në histori, si: Fehmi Lladrovci, Xhavit Haziri, Xhabir Morina, Bashkim Mazreku e Bajram Limani, kujton 70 vjeçari Remzi Krraba, veteran i organizimit ilegal politik në komunën e Kaçanikut dhe njëkohësisht veteran i UÇK-së.
Se sa e vështirë ishte veprimtaria ilegale për Republikën e Kosovës, sa rreziqe barte mbi shpinën e saj rinia e Kosovës e asaj kohe, në vazhdim sjellim një shkrim të ish të burgosurit politik Rrahim Sadikut, publikuar në Facebook më 15 dhjetor 2018:

Në 36 vjetorin e burgosjes nga SPB –ja (UDB-ja) jugosllave

KUJTIME
(nëntor 1981 - 15 dhjetor 1982)

Gjatë pjesës së parë të muajt nëntor 1981 kishim përgatitur, në një banesë ilegale në Lagjen e Trimave, me Hydajet Hysenin, Berat Luzhën e Mexhid Salihajn, Revistën "Liria" dhe e kishim dërguar për ta shtypur në Zvicër. E kishim lënë të takoheshim pas disa ditësh po aty, për të parë si kishte shkuar puna e materialeve të përgatitura dhe për t'u marrë vesh për punë të mëtejme. Ishim unë e Mexhid Salihaj që po shkonim në atë takim, rrugëve të tërthorëta, por të veshur me xhupe e me kravata dhe ngado njerëzit na shikonin disi me frikë, disi çuditshëm e me kurreshtje. E hetuam se diçka nuk ishte në rregull, po vazhduam rrugën. Kur arritëm te banesa, u shtangëm. Fusha rreth banesës, oborri e vet banesa ishin sikur mbi to ishin hedhur granata. Ngado letra, pjesë mobilesh, lecka. U shtangëm. Nga të gjitha

dyert e nga muret shihnim koka që na shikonin me kërshëri. Prej një rrugice erdhi një djalosh i veshur keq e u ndal afër nesh e na kërkoi cigare. Mexhidi ia zgjati një e ai na tha me zë të ulët të iknim sa më parë sepse sapo kishte përfunduar bastisja e asaj shtëpie dhe se shumë shokë tashmë ishin burgosur. Ai u largua duke falënderuar për cigaren e ne u kthyem prapa me të shpejtë. Më vonë u informuam se kishte shumë arrestime e ato po vazhdonin ende.

Po bëhej burgosja e shumë veprimtarëve ilegalë, me të cilët kisha punuar, organizuar, medituar e ëndërruar për një Kosovë ndryshe, për një ardhmëri të kombit tonë ndryshe dhe për një ecuri ndryshe të gjithë asaj që donim dhe e kishim vizion. Muajt e parë, pas burgosjes së tyre, prita me ankth se si do të shkonte puna, sepse e dija që torturat nëpër burgjet jugosllave ishin të rënda e mund të dilte në dosjet e policisë edhe emri im. Por, kaluan muaj e kush nuk u muar me mua, prandaj e mendova se për një kohë rreziku i burgosjes kishte kaluar dhe iu ktheva veprimtarisë. Vura kontakte me bashkëveprimtarët dhe vendosëm të konsolidoheshim sa më parë. Së pari duhej vënë lidhjet me anëtarët tanë që vepronin kudo në trojet shqiptare të mbetura nën robëri, për të shkuar tutje në zgjërim, veprime konkrete e organizime që të ndihej nga pushteti se ne ishim duke e vazhduar veprimtarinë. Me kohë, sa ishim duke e përgatitur revistën “Liria”, kishim menduar mundësinë e burgosjes dhe kishim lënë vendtakime me ata që do të mbeteshin në liri, për të lidhur organizatën dhe punën e saj. Kishim caktuar adresën e takimeve, orën dhe fjalëkalimin me të cilin do të identifikoheshim. Mora detyrë të merrja lidhjen me Komitetin e Prishtinës, te

vendtakimi i parë, që ishte në rrugën për Gërmi, në një rrugicë mbi Muzeun e Vjetër të Kosovës. Dola një javë rresht te vendi i caktuar dhe raportova se nuk po paraqitej askush. Por, pas një kohe erdhi në shtëpinë time, në Komogllavë një i ri, që tha se do të bisedonte me mua në katër sy dhe sa mbetëm vetëm ma tha fjalëkalimin e duhur. Megjithatë ngurrova. Mund ishte ndonjë provokator. I thash se kishte gabuar adresë, se unë nuk merresha me veprimtari ilegale e se kisha punën e gazetarit e të kryefamiljarit dhe se këto më mjaftonin. Ai mbeti shumë i zhgënjyer dhe doli. Në rrugë i thash se ishte mirë të ma linte emrin e adresën, që ta njoftoja nëse mësoja diçka nga ato që i interesonin atij. Ai më shënoi ato që kërkova dhe shkoi. Shkova te shokët pa humbur kohë e u thash të verifikonin atë person e nëse ishte i duhuri, të vazhdonin të kontaktonin me të. Pas dy ditësh më njoftuan se lidhja ishte vendosur dhe se shtrirja e organizatës sonë nuk ishte ndërprerë askund, po kishte edhe anëtarësime të reja. Vazhduam takimet ilegale, shpërndarjen e materialeve propagandistike, shkrimin e parollave në institucione e rrugë dhe veprimtari të tjera, që kishin ndikim te armiku e që i shtynin ata të merrnin masa të shumta represive, burgosje, maltretime e largime nga puna. Burgjet ishin plot dhe një pjesë e madhe e rinisë shqiptare po vuante dënimet anembanë Jugosllavisë. Në shkrimet që botoja në “Rilindje” kisha shpesh vërejtje se kishin konotacione nacionaliste. Një ditë madje më hoqën të drejtën e analizës javore të gazetës, sepse e kisha cilësuar si destruktiv një shkrim ku thuhej se varrezat serbe të një fshati ishin dëmtuar nga shqiptarët, kur as nuk kishte të dyshuar as ndonjë

vendim gjyqësor për këtë. Megjithatë, kohën më të madhe e kaloja duke udhëhequr mbledhje me grupe ilegale, duke shkruar fjalime që lexoheshin në takime të ndryshme e duke përpiluar parolla që shkruheshin kudo ku aktivistët arrinin ta bënin këtë.

Me Bajrush Xhemailin, që kishte një kohë të gjatë duke jetuar në ilegalitet dhe me Muhamer Shabanin, e vendosëm që me rastin e 28 nëntorit 1982, të nxirrnin një numër të Revistës "Liria" dhe ta shtypnim në Kosovë. E vendosëm këtë sepse dërgimi i materialeve jashtë e sidomos sjella e revistave brenda e rrezikonte jetën e shumë veprimtarëve. Nisëm të mblidhnim materiale dhe unë i kërkova Zeqir Gërvallës një poemë patriotike, e cila ishte një himn për trimërinë, guximin dhe sakrificën. Ai ma dha poemën dhe më dha leje ta botoja me kusht që vetëm unë e askush tjetër, as ndonjëri në redaksi, të mos e dinte se kush ishte autori. I thash se do të mbetej ashtu si donte ai dhe ashtu edhe mbeti. Mandej një njeri, që nuk u paraqit me emër të vërtetë, më solli një kopje të elaboratit të Ivo Andriqit për shpërnguljen e shfarosjen totale të shqiptarëve nga historia. Nisa ta përktheja atë. Pas një kohe erdhi edhe një punim analitik për punën, kapacitetet, prodhimet dhe ndarjen e mjeteve financiare e në vlerë ari, që arrinte Trepça secilin vit. Artikulli ishte në gjuhën sllovene dhe ishte botuar në Slloveni. Nisa ta përktheja edhe atë. Angazhuam edhe ndonjë gazetar apo analist të na shkruante për temat që na interesonin dhe pas një kohe vërshuan shkrime nga të gjitha anët, të gjitha me pseudonime. Tashti na duhej të siguronim makinat për shtypjen e revistës. Na tha njëri se në "Agrokosova Komerc", në Lagjen Lakrishte, ishte një shumëzues

shumë i mirë. Shkuan disa veta, kinse për të kërkuar punë atje dhe pasi e shikuan aparatin, njoftuan se mund të na kryente punë. Dhe një natë një grup aktivistësh, të udhëhequr nga Gursel Sylejmani, shkuan në Lakrishte dhe pasi e siguruan vendin, thyen xhamin e madh të një zyreje të "Agrokosova Komercit" dhe përmes zhurmës së madhe që shkaktoi xhami dhe qyetatarët që shikon me shqetësim, e ngarkuam aparatin në krah dhe e bartën afër një kilometër ashtu, edhe pse ishte shumë i rëndë, ku morën një makinë dhe e dërguan në bazën e caktuar. Por, doli mandej se askush nga ata tek të cilët kishim besim, nuk dinte të punonte me atë aparat shtypës. Disa që mund të dinin ta përdorinin, nuk mund t'i mernim për shkak të konspiracionit.

Vendosëm të merrnim një aparat tjertër për shumëzim. Aktivistët hulumtuan dhe e gjetën një aparat që mund të na hynte në punë mu afër burgut, përballë vendqëndrimit të policisë që ruante hyrjen. Ishte rrezik, po të gjithëve na e mori mendja se ia vlente dhe aksioni u krye përmes plumbave. Për fat nuk patëm as të vrarë e as të plagosur, por menjëherë doli se as për këtë makinë nuk kishim njeri adekuat që ta vinte në punë. Po afrohej Festa e Pavarësisë, revista ishte gati e nuk mund ta shtypnin. Vendosëm të bënin edhe një rrëmbin të një aparati shumëzues. Kësaj here u gjet një para Fakultetit Teknik dhe dy veta shkuan e u interesuan se si punonte ai, si përgatitej letra, ku jepeshin urdhrat e shumëzimit e veprime të tjera që duheshin kryer derisa të realizohej shtypja. Duke dalë nga ajo zyrë, njëri prej tyre e la pak hapur një dritare dhe rreth mesnatës aksioni u krye me sukses. Por, doli edhe problemi i

letrës, sepse libraritë dhe depotë që e shisnin atë kishin urdhër të evidenconin ata që blenin letra me shumicë, kështu që pakngapak erdhën letrat në banesën e Bajrush Xhemajlit, ku do të shtypej revista. Shkova dhe me Bajrushin e Muhamerin (Shabanin) përgatitëm thyerjen teknike të revistës. Punuam dy mbrëmje pa fjetur dhe kur çdo gjë ishte gati, thash se derisa të shpërndahej revista nuk do të dukesha andej, kur të ishte gati ajo, le të ma sillnin një kopje të saj në shtëpi dhe dola.

Prita disa ditë, e asnjë lajm nuk erdhi. Nisa të shqetësohesha, po nuk shkoja atje ku duhej të shtypej revista, pasi dyshoja se mund të bija më në sy. Festa shkoi pa e marrë njerëzit në duar revistën tonë, që e kishim bërë gati me aq sakrifica.

Më 15 dhjetor 1982 u zgjova i lodhur, sepse kisha punuar deri vonë. Në autobusin e fshatit u takova me Mustafë Xhemajlin dhe e pashë se ishte brengosur shumë. Me zë të ulët më tha se me sa duket, Bajrushi ishte arrestuar, pasi në mëngjes herët e kishin kontrolluar edhe shtëpinë e tyre në fshat. Shtoi se ishte rrezik të na arrestonin edhe neve. Le të na arrestojnë – ia ktheva. Në stacionin e autobusëve nuk pamë policë. Dolëm shëti qendrës së Ferizajt, pimë kafe e nuk na u afrua askush i dyshimtë. Vazhduam mandej për Prishtinë, shkuam në Pallatin e Shtypit, pimë kafe e biseduam me gazetarë, po nuk ndodhi gjë. Dolëm e shkuan në Televizion, ku punonte Mustafa, hymë zyreve e nuk hetuam as edhe një shenjë të dyshimtë. Mustafa nisi të punonte e unë dola e i mora disa shënime për artikujt që do të shkruaja e u ktheva te Mustafa dhe së bashku u kthyem përsëri në “Rilindje”. Unë fillova të

shkruaja e porosita edhe nga një kafe. I përfundova artikujt dhe i thashë Mustafës të më priste se nuk vonohesha e shkova t'i dorëzoja në redaksi. Rrugës erdhi e më përqafoi shefi im e më tha të shkoja me të te sekretari, sepse nuk kisha nënshkruar se i posedoja mjetet e Redaksisë që kisha në Shkup, ku kisha qenë disa vite korrespondent. Po bisedonim miqësisht, po me të hyrë te sekretari, shefi shpejtoi të mbyllte derën pas meje dhe unë u gjenda midis tetë apo nëntë vetëve të panjohur. Sekretari nuk ishte aty. E kuptova se ishin njerëz të sigurimit jugosllav dhe nuk e humba torruan. Ua bëra me kokë me shenjë se po e kuptoja gjendjen. Njëri më tha të mos tentoja të largohesha nga aty se do t'i detyroja të më vrisnin. Mandej njëri i tha shefit të na porosiste nga një kafe dhe shtoi se ndoshta nuk po i njihja, po ata ishin nga shërbimi i shtetit dhe kishin një bisedë të shkurtër me mua. Dhe kafetë erdhën e pasi i pin u ngrehën menjëherë, u përqafuan me shefin tim dhe më dolën gjysma para e gjysma prapa dhe u drejtuan kah shkallët e jo kah lifti dhe dolëm në oborr të Pallatit të Shtypit. Aty po më priste një veturë policie dhe sa hap e mbyll sytë isha në Burgun e Qarkut të Prishtinës, që ishte aty afër...

Në anën tjetër, **Berat Luzha**, një veprimtar i dalluar i ilegales në Kosovë e që në nivelin vertikal të Organizatës ishte anëtar i Komitetit Drejtues të Organizatës, kujton se Gafur Luma qysh si nxënës i shkollës së mesme në Kaçanik, duke qenë në grupin e nxënësve përparimtarë e atdhetarë, ai nuk do të qëndrojë anash, nuk do të frikësohet për asnjë çast, por do t'i kushtohet e përkushtohet, me zell çështjes sonë madhore kombëtare.

Kështu, edhe futet në organizmat e fshehta të kohës, për ta dhënë edhe Ai kontributin e tij të madh, veçanërisht në propagandimin e ideve dhe të idealeve kombëtare, duke shtuar se me Gafur Lumën, Kadri Luzha ishte i ngarkuar nga Organizata që të mbulonte aktivitetin me nxënësit e shkollës së mesme, andaj edhe Feridi edhe Kadriu kanë pasur kontakte me Avdylgafur Lumën dhe Remzi Elezin dhe që të dy, nga viti 1980 kanë qenë të përfshirë në veprimtarinë ilegale.

Remzi Elezi nga Sllatina e Lepencit të Kaçanikut, është ndër shokët më të afërt të dëshmorit Gafur Luma në veprimtarinë atdhetare ilegale. Jetëgjatësia e veprimtarisë ilegale e Gafurit deri në burgosjen e parë ishte pikërisht me Remziun, duke filluar nga shkolla e mesme, pastaj pjesëmarrja në demonstrata, shtrirja ilegale e veprimtarisë, kontaktet ilegale me shokë, banesat ilegale, shtypi ilegal, e deri te mbledhjet konspirative. Remzi Elezi dhe Gafur Luma ishin ajo ,,dyshja" e pandashme në veprimtari, ishin ata që vepruan në mënyrë kontinuele dhe pandashëm. Gafur Luma vinte si pjesë e organizuar e ilegalitetit nga Ferid Qallaku i fshatit Gajre të Kaçanikut, kurse Remzi Elezi vinte nga Berat Luzha nga fshati Begracë i të njëjtës komunë. Si të tillë ata dinin shumë për njëri tjetrin sepse për të gjitha kontaktet me bashkëmendimtarë e informonin njëri tjetrin dhe pastaj puna degëzohej me veprimtarë dhe celula të tjera. Përkundër arrestimeve të shokëve të tyre si Ferid Qallakut, Berat Luzhës e Kadri Luzhës dhe dënimet e rënda që morën ata nga gjykata pushtuese, këta vendosën të vazhdonin veprimtarinë ilegale pa marrë parasysh tagrin që duhej paguar dhe burim i lidhjeve të pazbuluara ishin pikërisht nga

shokët që tanimë ishin nën pranga si Berat Luzha e Ferid Qallaku, andaj ka të drejtë Dr. Sabile Keçmezi-Basha kur thotë se ,,ilegalja shqiptare ishte njëra ndër ilegalet më të organizuara që vepronte në shtetet ballkanike".

Remzi Elezi ka një jetëgjatësi më të madhe të veprimtarisë me Gafur Lumën, andaj konsiderojmë se Remzi Elezi është njëri nga levat më domethënëse në ndriçimin e veprimtarisë ilegale të dëshmorit. Në kujtim të veprimtarisë atdhetare ilagale të dëshmorit Gafur Luma, ai thotë[19]:

Me Gafur Lumën kemi qenë shokë klase që nga viti i dytë i shkollës së mesme, në vitin 1977. Por, nga viti 1978, në klasën tonë ka filluar të merr formë grupi ynë, në fillim spontanisht, gjithnjë duke u masivizuar dhe duke marrë formë edhe organizative.

Fillimisht kemi bashkëpunuar me këta persona: Remzi Elezi, Hyrjete Isufi, Vjosa Kyçyku, Laura Vinca, Ali Luzha, Gafur Luma, Zejnulla Burrniku, Rasim Çaka, Ibrahim Hoxha, Muhabi Malsiu, Hazbi Loku. Kur grupi filloi të merr formë më organizative ishte pranvera e vitit 1979.

Në këtë kohë, nga pushteti, bëheshin organizime për Titon dhe emri i tij shkruhej me gurë qëlqeror nëpër kodrina nga aksionistët e rinisë. Ne organizonim prishjen e tyre.

Kur në vitin 1979 po ,,stoliseshin" me gurë të gëlqerosur kodrinat e Kaçanikut me emrin e satrapit ,,Tito" i thash Gafurit se këtë emër duhet ta heqim, por pa më treguar, pas dy dite, gjerisa unë po bëja planin,

[19] Informatat nga Remzi Elezit janë marrë në majin e vitit 2017 në Kaçanik

Gafuri veç e kishte kryer punën. Ditën tjetër më tha: Emri,, Tito ”në kodra nuk po shihet asgjëkundi. E mora me mend se ai ua kishte bërë hallin.

Gjatë kësaj kohe, fryma jugosllave kishte depërtuar te një pjesë e rinisë shqiptare dhe ky degjenerim vazhdonte edhe me këndimin e këngëve serbe. Ne organizonim mësimin e këngëve patriotike nëpërmjet kopjimit nëpër audio kaseta dhe bënim shpërndarjen e tyre. Krahas këtyre aktiviteteve merreshim edhe me leximin e librave nga më të ndryshme dhe shpërndarjen e tyre. Leximi i librave të zgjedhura, ngjallnin atdhedashurinë. Propagandonim që të përcillej Radio Tirana dhe emisionet e historisë për Kosovën. Kështu tentonim të zhvishnim mitin për Titon dhe propagandimin e tyre se çështjet kombëtare janë të zgjidhura në Jugosllavi.

Kur një ditë bëra një shkrim të gjatë për ,,Rilindje”, kërkova nga redaksia që ose të ma botojnë shkrimin, ose t`ma dërgojnë një gazetar për bisedë më të zgjeruar. Redaksia më dërgoi Berat Luzhën i cili erdhi për një ditë, por qëndroi dy të tjera. Ishte nëntori i vitit 1979. Në bisedë e sipër i tregova Beratit që merrem edhe me poezi e pastaj ai m`i kërkoi që t`i lexonte. Berati jo vetëm që i lexoi dhe i analizoi me vëmendje, sikur minatori që hulumton minierën, por disa sosh aty për aty i redaktoi dhe më motivoi edhe më shumë që të merrem me poezi, ndërsa njërën nga ato që i kushtohej Kosovës, ma propozoi që ta botoj në panoramën poetike ,,Goca e Kaçanikut” të Klubit letrar ,,Hivzi Sylejmani” i themeluar në vitin 1979.

Kosovës
Gjaku i damarëve të mi

ec
nëpër kapilarë
të Kosovës sime anembanë.
Lulja e kopshtit tim
ujit
gjakun e trimave dëshmorë
Kosovë
lulja ime
Këngë që më gëzon
gjaku i damarëve të mi
e unë...
një rruzë e kuqe
në Ty.

Këto ishin kontaktet e para me veprimtarin Berat Luzha i cili në atë kohë ishte korespondent i gazetës ,,Rilindja" dhe nën ,,velon" e gazetarit, fshihte veprimtarinë e thellë ilegale për çlirimin e Kosovës nga kthetrat jugosllave. Nga kjo kohë kam vepruar ilegalisht në celulë me veprimtarin Berat Luzha.

Pas këtij takimi me Berat Luzhën, filluam t`i lexojmë edhe gazetat që vinin ilegalisht nga Shqipëria si *Shqipëria e Re*, *Zëri i Popullit*, *Drita* dhe libra historik. Ne arritëm që fundi i vitit 1979 , gjeneratën tonë ta gjej krejtësisht antitititiste dhe me formim të theksuar kombëtar.

Në të njëjtën kohë, Gafur Luma bie në kontakt me Ferid Qallakun dhe më ka njoftuar për kontaktin e tij.Në këtë kohë, Berat Luzha dhe Ferid Qallaku nuk na ngarkonin me shumë detyra. Te ata, hetohej një maturi dhe i ruheshin vrullit tonë rinor që të mos dekonspiroheshim, por kur Titoja vdiq në majin e vitit 1980 dhe ne organizuam tërë gjeneratën e maturantëve që të mos

shkojmë për të vizituar varrin e Titos për homazhe në Beograd, lirisht mund të them se kjo ishte kryengritja e parë politike në Kosovë pas vitit 1968.
Pas kryerjes së maturës, ne e vazhduam aktivitetin ilegal, unë me Berat Luzhën, ndërsa Gafuri me Ferid Qallakun. Në tetor të vitit 1980 shkuam në shërbimin ushtarak dhe ngjarjet e vitit 1981 na gjetën në armatën jugosllave.
Ansambli i këngëve dhe i valleve ,,Kukësi i Ri" kishte disa ditë që jepte koncerte nëpër Kosovë. Atë natë që unë shkoja ushtar, Kukësi i Ri jepte koncert në Ferizaj, andaj përkundër kohës së kufizuar, arrita që ta përcjellë. Biletat për koncertin, mua dhe Kadri Luzhës na i siguroi Berat Luzha. Në pranverën e po atij viti, kam përcjellur bashkë me Berat Luzhën Ansamblin nga Shkodra i cili shkëlqeu me këngën ,, Ushton Gryka e Kaçanikut" e cila në komunën e Kaçanikut u shndërrua në himn. Gafur Luma ka përcjellur vetëm Ansamblin nga Shkodra, ndërsa ,,Kukësin e Ri" nuk ka mundur, pasi siç thash shkonim ushtarë, ndërsa të nesërmen ishte planifikuar koncerti në Kaçanik. Ishte një dashuri madhe për Shqipërinë, për këngët, vallet dhe melosin tonë popullor. E keqja ishte se ne ishim të detyruar të kryenim shërbimin ushtarak në kazermat e pushtuesit ku shqiptari trajtohej si qytetarë i rendit të dytë. Përkundër kësaj, në konspiracion të thellë edhe brenda ushtrisë armike, në mesin e shqiptarëve, në veçanti me Basri Maxhunin nga Vushtrria, gjenim mundësinë dhe propagandonim për lirinë e Kosovës.
Shpërthimi i demonstratave të vitit 1981 solli edhe arrestime. Berat Luzha ishte burgosur si i dyshuar për

pjesëmarrje në demonstratën e 2 prillit të vitit 1981[20], por në mungesë të provave, pas dy muaj dite, lirohet, por i merret një revole. Gjatë këtyre hetimeve, UDB-a nuk arriti të zbuloj veprimtarinë e organizuar të Beratit, por e pezullojnë nga puna në ,,Rilindje".



Berat Luzha, fotografi pas lirimit nga burgu dymujor (2 prill - 2 qershor 1981).

Rreth këtij arrestimi, Berat Luzha, kujton:

Pas akuzës për vrasje të milicit (nuk gjetën prova), pastaj për pjesëmarrje në grupin që kryen vepra penale - demonstratë (nuk gjetën prova), më dënuan për armëbartje pa leje.

Milicia speciale, e ardhur po atë ditë nga Beogradi (më 2 prill), më zuri në rrugë dhe më gjeti një revole në brez. Pasi më rrahën egërsisht në rrugë dhjetra milicë, më dorëzuan në stacionin e milicisë, te milicët shqiptarë. Ata në hyrje më morën gjërat personale (mes tjerash

[20] Burimet sekrete jugosllave bëjnë të ditur se, vetëm gjatë një aksioni të zhvilluar midis 3-4 prillit, forcat policore-ushtarake jugosllave të instaluara në Kosovë, vranë 8 demonstrues, plagosën 75 të tjerë, arrestuan 807 vetë, ku ndaj 28 u zhvillua procedurë e shpejtë hetimore, ndërsa ndaj 698 personave tjerë është ndërmarrë masa disiplinore (Qerim Lita ,, Çështja shqiptare në RSFJ 1981-1990'' fq. 13)

letërnjoftimin dhe orën e dorës digjitale, të cilat kurrë më nuk m'i kthyen), më morën në pyetje me akuzë për vrasjen e një milici. Pos tjerash, njëfarë Bajram Gorani më ra disa herë, duke më thënë: - Ti po do me e prishë Jugosllavinë, a?
Natën e kalova në gjendje të rëndë në qelinë e Sekretariatit bashkë me rreth 15 demonstrantë. Pasi më transferuan në paraburgim, rreth një javë më vonë erdhën hetuesit (UDB-ashët) nga Kaçaniku dhe Ferizaj, të cilët m'u drejtuan: - Të lypëm për qielli, të gjetëm në tokë! Dhe, filluan torturat tjera...! [21]
Në shtator të vitit 1981[22] , vazhdon rrëfimin e tij Remzi Elezi, u kthyem nga shërbimi dhe u regjistruam në fakultetin e Prishtinës. Krahas studimeve, ne merreshim me aktivitet ilegal, por Ferid Qallaku tanimë gjendej në burg. Unë dhe Kadri Luzha vepronim në celulën e Berat Luzhës. Në celulë u ndanë detyrat. Mua m`u caktua që të punojë me Gafur Lumën, Ali Luzhën, Zejnulla Burrnikun, Rasim Çakën, Muhamet Malsiun, ndërsa Kadri Luzha më propozoi që të marr si kandidat nga ai edhe Ekrem Rakën. Kandidatët ishin faza përfundimtare për të kaluar si anëtar i Organizatës ku vepronim ilegalisht e ku përgjegjësitë ishin edhe më të mëdhaja. Në ndërkohë zbulohet oganizata dhe për pasojë riburgoset më 19 dhjetor 1981 edhe Berat Luzha

[21] Shkrimi është marrë nga FCB me datën 3.6.2018
[22] Derisa Remzi Elezi e Gafurr Luma ishin në përfundim të shërbimin ushtarak, Naser Kuka e Hysen Shehu më 25 gusht 1981 në Nikaj, Soponicë e Doganaj shkruan shumë parulla si: Rroftë RS e Kosovës, Poshtë shovinizmi serb dhe tradhëtarët, Rroftë rinia heroike e Kosovës, Kosova Republikë, Poshtë gjyqi tradhtar! (Më gjerësisht shih Naser Kuka,,Nga lëvizja ilegale te UÇK'' fq.132)

dhe Kadri Luzha. Për ne u krijuan rrethana dhe sfida të reja.
Në këto rrethana tepër të rënda arrestimesh, njoftova Gafurin për aq sa dija dhe morëm vendim të përbashkët që nëse mbetemi të pazbuluar nga shokët, tanimë në tortura udbeske, veprimtaria jonë ilegale të vazhdoj. Dhe ashtu vepruam deri në zbulimin tonë në nëntorin e vitit 1985.
Shokët që i kisha kandidat, nga arrestimet dhe dënimet e rënda që jepeshin nga gjykata e pushtuesit, një pjesë u aktivizuan, një pjesë tjetër hezitoi, por ne vazhduam duke i zgjeruar radhët në Kaçanik, Ferizaj dhe Universitet.
Në vitin 1982, radhët u zgjeruan me Remzi Krrabën lidhje e hershme me Ferid Qallakun, Behxhet Luzhën, Skënder Luzhën e Shefqet Prushin. Në Ferizaj me Hyzer Haxhiun, Ruzhdi Shkodrën e Hajdin Imerin.
Në fund të vitit 1982, derisa isha duke prerë drunjë në mal bashkë me vëllaun tim Zenelin, gjithashtu i antarësuar në organizatë bashkë me vëllaun tjetër Azemin, vjen vëllau i vogël dhe më tha se më ka dërguar Azemi me të thënë me ardhë në shtëpi sepse ka ardhur një mysafir, një shok i yt.
Unë u ktheva menjëherë në shtëpi, por mysafirin që kishte ardhur në shtëpi, nuk e kisha parë kurrë, pra nuk e njihja. Në momentin e parë që mbetëm vetëm, ai më tha se jam Bexhet Luzha, kusheriri i Berat Luzhës dhe Berati nga burgu më ka porositur me u ndërlidh në veprimtari me ty dhe tha fjalkalimin.
Para se të burgosej Berat Luzha, ne kishim krijuar një fjalëkalim sekret që në rast të burgosjes së njërës palë personi që paraqitet për ndërlidhje, gjatë përshëndetjes

të përmend fjalëkalimin kushtuqë me Bexhet Luzhën, krijuam besimin reciprok dhe më pas vendosëm t`i bashkojmë forcat tona.
Gjatë studimeve në Prishtinë, unë me Gafur Lumën kishim një numër shokësh të përbashkët edhe nga Kaçaniku edhe nga vendet e tjera. Banesat tona në konviktin numër 3 ishin ndër më të frekuentuarat me studentë. Në përvjetorin e demonstratave të vitit 1981, i kishim përgatitur shokët tanë dhe studentët kolegë në shënimin e një vjetorit të 11 marsit. Jemi bërë bashkë *Te Baraka* e cila gjendej ndërmjet kuzhinës dhe sallës së 1 Tetorit. Dy të shtëna nga revolja ishte shenja e fillimit të demonstratës dhe filluan brohoritjet, gjegjësisht parullat që ishin përdorur në demonstratat e vitit 1981 e ndër më kryesoret ishte Kosova Republikë! Forcat policore, arritën që këtë demonstratë ta shpërndajnë diku në pasditen e 11 marsit 1982. Në mbrëmje, Gafuri na strehoi në banesën e Nejazi Lumës dhe të ndjerit Mendu Kaloshit në Prishtinë.
Ne po vepronim ilegalisht edhe me Avdyl Bajramin nga Vitia, Zenun Muriqin nga Peja, Basri Magjunin me të cilin isha bërë shok që në vitin 1980 sa isha ushtar i APJ-së në kazermën e Panqevës. Veprimtarinë e ngritëm edhe me Murat Gjocin dhe Shefqet Halitin nga Istogu me të cilët Gafuri dhe Zejnulla Burrniku ishin shokë të grupit në Fakultetin Elektroteknik dhe njëkohësisht shokë të dhomës në konvikt. Ne me Gafurin kishim edhe shokë të tjerë e sidomos nga qytetet e Anamoravës të cilëve mjerisht ua kam harruar emrat, madje tre prej tyre në dhomën e Zenun Muriqit janë betuar para flamurit kombëtarë nën prezencën time.

Ne kishim trashëguar një disiplinë të rrept nga veprimtaria jonë ilegale, unë e Bexheti me Beratin, ndërsa Gafuri me Feridin. Për të ardhur deri te antarësimi i një personi në organizatën tonë, anëtari duhej t`i plotësonte shumë kushte duke filluar nga ajo se duhej të ishte njeri i besës, i moralshëm, lexues i pasionuar, i gatshëm për sakrificë dhe skajshmërisht i sjellshëm. Këto kritere, këto parime në njëfarë mënyre, na pengonin që të zhvilloheshim dhe zgjeronim më me shpejtësi radhët e ilegales.

Ne kishin përvojën e disa organizatave, në të cilët qenë infiltruar agjentët e UDB-së dhe i kishin dëmtuar rëndë duke i përcjellë dhe raportuar gjithë gjendjen brenda Organizatës, derisa e kapnin në kurthe, thotë Mehmet Hajrizi, njëri nga themeluesit e OMLK-së, andaj ne dëshironim të ishim një kala më e mbyllur që të mos mund të hynte çdokush, por njerëzit verifikoheshin në derë të saj. Ky verifikim bëhej për familjen e tij dhe për vetë kandidatin.[23]

Në rrjedhë të veprimtarisë sonë ilegale, në Kaçanik u njohëm me Daut Rakocin, Fevzi Krasniqin, Ekrem Kyçykun të cilët ishin në lidhje me Misim Sopën, Mejdi Dalloshin, Hysen Shurdhanin, Hysen Shehun e të tjerë.

Këto kontakte janë vendosur në gushtin e vitit 1982, ku unë, Gafur Luma, Zejnulla Burrniku, Rasim Çaka, Ali Luzha, Muhabi Malsiu, Ibrahim Hoxha kishim dalur në afërsi të staneve të Dubravës për të qëndruar disa ditë. Në të njëjtën kohë kishte dalur edhe Ekrem Kyçyku[24],

[23] Agim Sylejmani „Në rrugë drejt lirisë'' Prishtinë 2016, fq.52

[24] Ekremi arrestohet si pjesëmarrës i demonstratave në Kaçanik më 6 maj 1981 dhe lirohet pas një viti, më 6 maj 1982, informatë në Ekrem Kyçyku e datës 6.7.2017

Daut Rakoci e Fevzi Krasniqi, dhe ky i fundit më tregoi se kishte qenë në lidhje ilegale me Ferid Qallakun.
Me ata unë kam mbajtur lidhje deri në burgosjen tonë, në nëntorin e vitit 1985. Në anën tjetër e kam angazhuar Remzi Krrabën që të jetë në lidhje të përhershme me Idriz Krasniqin, ngase dhe baca Idriz ishte në grup me ata.
Gjatë një takimi të mëvonshëm me Daut Rakocin, ai më tregoi se ata i përkisnin grupimit politik të PKMLSHJ-së. Ndërkohë kemi lexuar edhe materialet të këtij grupimi politik. Kështuqë, me ata, ne kemi pasur kontakte deri në vitin 1984 dhe me riorganizimin e ilegales, posaqërisht pas rënies në kontakt ilegal me Xhabir Morinën, Emrush Xhemailin, Hajdin Abazin e Agron Morinën nga Ferizaj, të cilin kontakt e ka vendosur Bexhet Luzha në vjeshtën e vitit 1983 me direktivat nga burgu të Berat Luzhës, doli si domosdoshmëri themelimi i Komiteteve të Rrethit, kështuqë ata nuk u përfshinë në riorganizimin e ri. Bexhet Luzha në shkurtin e vitit 1984 kalon në ilegalitet, pasiqë arrestohet Avdyl Bajrami nga Vitia, dhe Bexheti largohet nga Kosova dikund në marsin e vitit 1984.

Gafur Luma e Remzi Elezi

Nga e majta: Bexhet Luzha, Elmi Zeka nga Abrija e Skënderait dhe Remzi Elezi, fotografi e vitit 1992.



Dekreti numër 1 e 2 i PKMLSHJ-së i cili pos që u shpërnda vendbanimeve të tjera në Kosovë, ky material ilegal u shpërnda edhe në Kaçanik nga Naser Kuka e Hysen Shehu në muajin tetor të vitit 1981



Derisa Dekreti numër 1 dekoronte me titullin e dëshmorit të gjithë ata që ranë në demonstratat e marsit dhe prillit 1981, Dekreti numër 2 kërkonte bashkimin e të gjitha forcave progresive shqiptare në Jugosllavi
Ndërsa gazeta ilegale ,,Revolucioni" e botuar ilegalisht nga PKMLSHJ në vitin 1981, pos që i dërgoi NOTË proteste Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve dhe Qeverisë së Jugosllavisë, një letër të tillë ua dërgoi edhe Komitetit Krahinor të Kosovës, të gjitha Komiteteve Komunale si dhe Sekretariateve të punëve të brendëshme, në të cilën letër arsyetonin kërkesën Kosova-Republikë dhe njëkohësisht kërkonin që edhe këto struktura ta përkrahin këtë kërkesë popullore. Por, siç dihet tanimë ,, *Qeveria jugosllave akoma qëndron nën ndikimin e hegjemonizimit kolonialist maqedono-malazezo-serbomadh, dhe se përpara ia fillojnë aksionit për zhdukjen e dymilion e më tepër të shqiptarëve, se sa t`i shkëpus tokat shqiptare nga zinxhirët e tyre kolonialistë*" [25] -thuhej në një pjesë shkrimi të ,,Revolucionit"

[25] ,,Revolucioni'' organ i Komitetit Qendror të PKML Shqiptare në Jugosllavi, 1981

ÇRREGULLIME TË REJA NË PRISHTINË

● Provokuesit nuk hasën në përkrahje. — Dënim unanim nga an... e qytetarëve dhe rinisë

Kandër intervenare të popullit: grup demonstruesish dje në Prishtinë

Faksimil nga gazeta ,,Rilindja" e datës 12 mars 1982 rreth demonstratës së zhvilluar më 11 mars në Prishtinë në të cilën Gafur Luma mori pjesë

Pra, nga vet dokumentacionet e asaj kohe, konstatojmë se të gjitha organet federative dhe krahinore ishin të njoftuar se brenda popullit qarkullon kërkesa për Kosovën Republikë, por udhëheqësia kosovare, ishte largë këtyre kërkesave, ata ishin shkëputur nga masat popullore dhe ranë në prehërin e unitarizmit dhe hegjemonizmit jugosllav, duke i dënuar këtë kërkesë si nacionaliste, irredentiste e seperatiste dhe për pasojë u burgosën me mijëra djem e vasha shqiptare duke i dënuar me 666 shekuj burg.

Kadri Luzha, ish i burgosur politik nga fshati Begracë i Kaçanikut, kujton[26]:

[26] Shënimet janë marrë në prillin e vitit 2016

Dëshmorin Gafur Luma natyrisht që e kam njohur sepse ishim në të njëjtën shkollë, pra në gjimnazin ,,Skënderbeu" në Kaçanik. Në atë kohë, unë isha i organizuar në Organizatën ilegale politike të OMLK-së dhe shokët më patën ngarkuar që aktivitetin atdhetar për liri të Kosovës ta përhapë në mesin e nxënësve. Në vitin 1980, unë isha në vitin e tretë në shkollë të mesme, ndërsa Remzi Elezi ishte viti i katërt. Kontaktin ilegal të drejtpërdrejtë e kam pasur me Remzi Elezin të cilit ia kam dhënë për lexim materialet ilegale: *Lirinë* , *Zërin e Populllit* dhe *Yllin*. Gafur Luma ishte në celulë me Ferid Qallakun, kështu që nuk ndërhynim kur e dinim se dikush është në ndonjë celulë të shokut tjetër. E tëra kjo bëhej për shkaqe konspirative.
Ndërsa **Muhamet Malsiu**[27], shok shkolle në gjimnazin e Kaçanikut me dëshmorin Gafurr Luma, kujton se:
Gafurin e kam njohur që në shkollë të mesme, në vitin e dytë në gjimnaz. Në atë kohë unë isha njohur edhe me Remzi Elezin e Ferid Qallakun. Gjatë kësaj kohe sa kemi qenë në gjimnaz, por edhe më vonë kur Gafuri shkoi në studime, ndër të tjera kemi shkëmbyer edhe literaturë ilegale të kohës si: Liria, Lajmëtari i lirisë, librin e Adem Demaçit ,, Gjarpinjtë e gjakut" botuar në revistën ,,Jeta e Re", por edhe literaturë tjetër që vinte nga Tirana si librin e Ajet Haxhiut ,, Shotë e Azem Galica", libri i Skënder Luarasit ,, Isa Boletini" dhe njëkohësisht lexonim librat e Kadaresë, Fatos Arapit, Lasgush Poradecit, Skënder Drinit, etj.
Të kujtosh Gafur Lumën, don të thotë të kujtosh një njeri të urtë, të sjellshëm, të disiplinuar, të saktë, të

[27] Shënim i marrë në muajin maj 2017

sinqertë, punëtor dhe mbi të gjitha njeriun me vizion të qartë politik dhe atdhetar i devotshëm. Unë mendoj se prej të gjithë shokëve që kam njohur në atë kohë, Gafuri ka qenë njeri i kompletuar dhe ndër të paktët që ka pasur një mendim të qartë politik. Në anën tjetër, Gafurin dhe familjen e tij e kujtoj edhe si strehë e sigurtë e shokëve ilegal, kujton veterani dhe invalidi i UÇK-së, Muhamet Malsiu.

Pas përfundimit të shkollës së mesme, Avdylgafur Luma, në shtatorin e vitit 1980, ftohet në shërbimin ushtarak jugosllav në Pulë të Kroacisë dhe pas kryerjes së këtij shërbimi të dhunshëm, në tetor të vitit 1981 fillon studimet në Fakultetin Elektroteknik në Prishtinë dhe arrin t`i përfundoj tre vite.

Gafur Luma gjatë shërbimit ushtarak në Pulë të Kroacisë

Krahas studimeve në Prishtinë, Gafur Luma, kërkon edhe rrethe të tjera shokësh si me Menduh Kaloshin dhe të tjerë që nuk i dimë, por me një synim që studentët e dalluar t`i aktivizon në rrjetën e ilegales shqiptare. Gafur Luma ka vepruar në dy rrafshe, atë legal duke i brumosur njerëzit me ideologji kombëtare për aq sa ishte e mundur, dhe në vijën ilegale që në fakt ishte substanca e veprimtarisë, por që kërkonte më shumë konspiracion, përgjegjësi, disiplinë, gatishmëri,

përballje dhe arrestim. Revista ilegale ,,Liria" ishte ajo udhërrëfyesja, që më shpejtë brumoste rininë me idealin e lirisë, njëkohësisht mbi këtë ideologji kombëtare u formua edhe shpirti qëndrestar dhe luftarak i Gafurit për 20 vite me radhë. Në një numër të sajë të radhës, thuhej:

,, Rini punëtore, fshatare, shkollore e studenteske e Kosovës trime, rini e barrikadave dhe e aksioneve heroike revolucionare, ti i vure gjoksin e para tiranëve shtypës e gjakatarë, ti e para derdhe gjakun rinor në përleshjet e përgjakshme me armikun . Dhjetëra vite me radhë armiqtë u munduan, me çdo mjet e me çdo formë, të të degjenerojnë, të të fusin në një jetë të shthurur, pa ideale e pa kuptim, por ti ruajte me besnikëri traditën e të parëve, trimërinë e baballarëve, idealin e aspiratat e popullit që të lindi, dhe në ngjarjet e fundit shembe për tokë gjithë ato përpjekje të ethshme e të vazhdueshme të armikut kundër teje, i tregove gjithë botës se në Kosovë po rritet e ngrihet një rini e madhe, e fortë, e bashkuar, trime dhe e vendosur, që nuk do ta durojnë më shtypjen dhe robërinë...

Demonstratat që shpërthyen anë e kënd Kosovës u shuan në gjak. Qindra bij e bija të popullit u vranë, u plagosën dhe u lënduan rëndë, por lufta e drejtë e popullit për të drejta e liri nuk u shua. Në përkrahje të kërkesave të drejta të popullit, në shumë qytete të Kosovës shpërthyen greva e demonstrata të tjera, kurse vëllezërit tanë në kurbet organizuan dhe po vazhdojnë të organizojnë demonstrata të fuqishme dhe mitingje të shumta proteste nëpër vendet e ndryshme të botës. Populli ynë po e vazhdon luftën e tij në forma të ndryshme, dhe do ta vazhdojë atë deri në realizimin e

plotë të kërkesave dhe aspiratave të tij, deri në fitoren e tij të plotë...
Populli shqiptar, në historinë e tij të gjatë ka vuajtur shumë nga pushtuesit e huaj, gjithmonë ka luftuar kundër shovinistëve e zullumqarëve të huaj, por ai vetë kurrë nuk ka qenë pushtues, kurrë nuk ka qenë shovinist e zullumqar ndaj të tjerëve...
Populli ynë nuk dëshiron luftë e gjakderdhje. Prandaj, kërkesat e tij i bëri në rrugë paqësore. Por, udhëheqja shoviniste e Beogradit me qëllim që ta frikësojë atë, këtyre kërkesave iu përgjigj me dhunën dhe terrorin më të egër fashist. Por, ajo duhet ta dijë mirë dhe ta mbajë parasysh se masat e dhunës policore dhe ushtarake që u ndërmorën e po vazhdojnë akoma, vrasjet, burgosjet masive dhe torturat çnjerëzore, kërcënimet e vazhdueshme me tanke, aeroplanë e masa të ashpra ligjore, jo vetëm që nuk e frikësojnë popullin tonë, por e zemërojnë dhe e egërsojnë atë edhe më shumë, jo vetëm që nuk mund ta qetësojnë, por e detyrojnë që, për realizimin e kërkesave (nga të cilat nuk lëvizi dot), të mendojë edhe në rrugë dhe me mjete të tjera...''
Derisa demonstratat gjithpopullore për Republikë zhvilloheshin gjithandej, ndërsa dhuna, burgosjet e terrori nga policia jugosllave vazhdonte, OMLK-ja shpërndau edhe Traktin-Liria ku thuhej se:
Rrugët e Prishtinës heroike u kthyen këto ditë përsëri në arena të përleshjeve të rinisë sonë revolucionare dhe regjimit gjakatar të revizionistëve jugosllavë. Dhjetëra mijë bijë e bija të Kosovës martire u bashkuan si një trup i vetëm dhe me grushtet ngritur lartë, zbriten në fushëbeteja. Vetëm brenda dy javësh rrugët e Prishtinës u lanë dy herë me gjakun e pastër të rinsë sonë...

Kjo revistë dhe Traktet që shpërndaheshin dorë në dorë nëpër Kosovë e që Gafur Luma numrin e saj të parë e kishte pasur që në vitin 1980, si dhe trakte e komunikata të ndryshme, pos që i lexon, arrin që t`ia jep edhe studentit të Fakultetit Juridik, Bajram Dernjanit nga fshati Paldenicë të Hanit të Elezit.
Në rrjedhë të kujtimeve për dëshmorin Gafur Luma, bashkëveprimtari **Bajram Dernjani** [28] ish i burgosur politik nga fshati Paldenicë i Hanit të Elezit, kujton se:
Me Gafur Lumën jam njohur që në shkollën e mesme në Kaçanik, por kontaktet konkrete i kam pasur gjatë studimeve në Prishtinë, më konkretisht në banesën e Menduh Kaloshit (tani i ndjerë) nga fshati Guranë, student i mjekësisë. Në këtë banesë, bashkë me Menduh Kaloshin dhe Gafur Lumën kemi trajtuar tema nga më të ndryshmet dhe kemi lexuar e komentuar materiale ilegale. Në kuadër të këtyre takimeve, Gafur Lumës i tregova se në trevën e Hanit të Elezit kemi një grup ilegal që vepron që nga viti 1981, por që vepron i shkëputur. Atëherë, vazhdon kujtimet e tij Bajram Dernjani, Gafur Luma më propozoi që të takohem me Remzi Elezin nga fshati Sllatinë i Kaçanikut të cilin gjithashtu e njihja nga shkolla e mesme dhe shumë shpejt realizuam një takim të tillë dhe konkretizuam shumë gjëra për shkrirjen e grupit tonë me organizatën të cilën e udhëhiqte, në nivel qendre, Xhabir Morina nga Ferizaj.
Bajram Dernjani kujton se Gafur Luma mbi të gjitha ishte një atdhetar i devotshëm, e donte atdheun dhe lirinë e tij, donte bashkimin e atdheut në një shtet, ishte

[28] Shënimet janë marrë në vitin 2016

largëpamës dhe shumë tolerantë, ishte modeli i një veprimtari për lirinë e atdheut.
Ai dallohej nga të rinjtë tjerë të cilët të ndikuar nga propaganda titiste mendonin se shqiptarët i gëzonin të gjitha të drejtat, se ishin të barabartë me popujt e tjerë të Jugosllavisë. Për Gafur Lumën shqiptarët në RSFJ, ishin të robëruar, të pabarabartë dhe të diskriminuar. Për të Kosova dhe viset tjera shqiptare mbeteshin të okupuara, për këtë populli duhej organizuar dhe për t` u çliruar nga sundimi një shekullor sllav. Që nga mosha e re ishte i organizuar në lëvizjen ilegale për liri, pa u frikësuar se mundë ta përjashtojnë nga shkolla, ta burgosin, ekzekutojnë.
Gjatë studimeve në Prishtinë 1982-85, unë takohesha me atë rregullisht, bisedonim për situatën në Kosovë ndërsa brengë e veçantë për ne ishte si të forcohej lëvizja ilegale për çlirim e dëmtuar rëndë me burgosjet e mëdha që ndodhën pas demonstratave të mars – prillit 1981.
Pas shumë takimeve dhe bisedave vendosëm që ne si grup të bashkpunonim ngushtë me OMLK , organizatën ilegale ku ai vepronte.
Në vitin 1985, unë u antarësova në Komitetin Organizativ të MLK-së, në përputhje me vendimet e grupit tonë. Takimet tona ishin të shpeshta, ne vazhdonim veprimtarinë, bisedonim me grupe të rinjësh studentë, shpërndanim trakte dhe literaturë tjeter ilegale, të ndaluar nga regjimi Jugosllav.
Për shkak të angazhimeve të shumëta që kishte, diku në maj të vitit 1985 Gafuri më propozon që veprimtarinë e mëtejme ta vazhdoj me shokun tjetër Remzi Elezin.

Para se të arrestoheshim Gafur Lumën e kam takuar dy herë, herën e parë më vizitoi në fshat pas përfundimit të studimeve, herën tjetër më 8 nëntor 1985 kur u themelua Komiteti i Rrethit për Kaçanik.
Në fshat biseduam për veprimtarinë tonë në Han të Elezit. Ai u gëzua shumë kur e njoftova se ne e kishim mbuluar këtë territor me anëtar dhe simpatizant, si rezulltat i punës së bërë nga viti 1981.
U kordinuam për mbledhjen që do të mbahej në Sllatinë. Do të bëheshim bashkë te Fusha e Pajtimit: unë, ai dhe Remzi Krraba të cilin nuk e njihja.
Para se të na arrestonin, hera e fundit që u pamë ishte me 8 nëntor 1985, në mbledhjen themeluese të Komitetit të rrethit për Kaçanik. Gafur Luma u zgjodh sekretar për agjitacion dhe propagandë, Remzi Elezi sekretar organizativ, unë, Bajram Dernjani anëtar i kryesisë, ndërsa Remzi Krraba u përzgjodh arkatar.
Formimi i Komitetit të rrethit ishte një sukses i madh për të gjithë ne. Veprimtaria jonë do të vazhdonte më e përqëndruar dhe më e organizuar.
Por, udbash të shumët, kolaboracionist që mbronin sundimin sllav në Kosovë ishin vënë në ndjekje të luftëtarëve të lirisë, ata kishin arritur të zbulonin shumë nga veprimtarët e OMLK-së.
Arrestimet filluan me 4 nëntor 1985. U burgosën dhjetra veprimtarë në të gjitha viset shqiptare në Jugosllavi. Ndër të parët që u arrestua ishte edhe Gafur Luma. Dënimi dhe burgu nuk e mposhtën. Ai nuk u dorëzua, vazhdoi misionin që kishte edhe pas daljes nga burgu. Betimit se do të sakrifikonte gjithçka për lirinë e Kosovës, iu përmbajt deri në fund.

I bindur se shqiptarët nuk mund të çliroheshin pa organizim të luftës së armatosur që nga fillimi, ju bashkua Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
Si një veprimtar i hershëm i çështjes kombëtare gjithnjë mbahej në shënjestër të UDB –së gjakatare.
U arrestua kur më së shumti i duhej Kosovës, në momentet kur po zgjerohej dhe masovizohej Ushtria Çlirimtare e Kosovës.
Të tmerruar nga sukseset e UÇK-së, ushtria dhe policia serbe filluan masakrat kundër popullit shqiptar të Kosovës, u vranë, e u masakruan mijëra burra, pleq, gra, fëmijë. U shkelën të gjitha konventat ndërkombëtare, ligjet e luftës. Serbët nuk përjashtuan as të burgosurit. Në masakrën e njohur në burgun e Dubravës dha jetën për të mos vdekur kurrë edhe luftëtari i palodhshëm i lirisë, Gafur Luma.
I takon popullit tonë që këtij luftëtari të palodhshëm t`i njohë të gjitha meritat, të shpallet dhe të njihet titulli Hero i kombit. Është në nderin e kombit tonë që në radhët e veta kishte një burrë trim dhe luftëtar të lirisë siç ishte Gafur Luma, kujton Bajram Dernjani veprimtar i dalluar i çështjes kombëtare nga viti 1981 e këndej.
Një kujtim domethënës për dëshmorin Gafur Luma shpreh edhe **Murat Gjocaj** nga Istogu, përndryshe pjesëmarrës në aksione me Gafurin dhe njëkohësisht ka banuar në një dhomë të përbashkët në konvikt të Prishtinës, ai kujton:
Kam pasur nderin që të jem shok i Gafur Lumës, cimer i dhomës në Konviktin nr.3 në Prishtinë dhe kolegë në Fakultetin Teknik. Krahas të tjerave, kujtoj se ishte përvjetori i dytë apo i tretë (s`më kujtohet saktësishtë) i

demonstratave të 81-shit. Kishim siguruar në rrugë ilegale një numër të caktuar pamfletesh që ftonin studentët në demonstrata të sërishme dhe rezistencë ndaj pushtetit të atëhershëm jugosllav. Gafur Luma, Zejnullah Burrniku dhe unë Murat Gjocaj ishim të ngarkuar nga Lëvizja që t`i shpërndanim pamfletet në Konviktin nr.3. Pasi paraprakisht bëm planin, në mbrëmje i shpërndamë ato në konspiracion maksimal. Duhej të ishim shumë të kujdesshëm dhe në fshehtësi sa më të madhe t`i shpërndanim e të mos binim në sy të të tjerëve se kishte mjaft sy vëzhgues që kontrollonin hyrjen dhe korridoret e konviktit. Të nesërmen u bë alarm në konvikt dhe shihnim fytyra të dyshmita që silleshin në hapsirat e Konviktit. Ne vazhduam me ritmin e përditshëm të jetës në ligjërata dhe në Menzen e studentëve sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Pas disa ditësh, në një mbrëmje, derisa po bisedonim me disa shokë biseda të ndryshme, u fol edhe për pamfletet të cilat ishin shpërndarë në konvikt. Disa shokë të një dhome te të cilët kishim besim, por që nuk ua kishim treguar aksionin tonë, filluan të tregojnë se si i kishin parë pamfletet kah dikush i fuste nën dyer, por që s`kishin guxim as t`i merrnin ato. Pastaj ne, filluam t`i glorifikonim shpërndarësit e pamfleteve e të bënim shaka mes veti se si njëri nga ata kur ka parë se si po ua hudhin nën derë pamfletin, kishte mbuluar kokën nën jorgan. Ishin kohë të vështira edhe pse këta shokë i njihnim për shokë të mirë, ne nuk u dekonspiruam para tyre.

Me dëshmorin Gafur Luma, kam edhe një kujtim të një natyre më relaksuese. Një ditë derisa po shkonim në ligjërata herët, blemë nga një byrek, por derisa po

kalonim disa pengesa, Gafuri u rrëzua me kokë në bari, por dorën ku e kishte byrekun e mbante lartë që ta mbronte byrekun. Ne e ngacmonim atë duke i thënë se më shumë i kushtove rëndësi byrekut se kokës. Bashkë me ne, qeshte edhe ai, me atë buzëqeshjen e tij karakteristike. Sa të lumtur e ndjenim vehten atëherë! Sa shumë shpresa kishim! Sa idealist që ishim! Sa shumë që e donim atdheun tonë!-kujton Murat Gjocaj.

Nga e djathta: Gafur Luma, Shefqet Halitaj nga fshati Tomoc komuna e Istogut, Zejnullah Burrniku nga Runjeva e Kaçanikut dhe Murat Gjocaj nga Tomoci i Istogut. Fotografi e vitit 1982, Prishtinë

Kadri Imishti, nga Hani i Elezit, kujton[29]

[29] Shënim i datës 2.7.2017

Me Gafur Lumën ishim shokë në shkollë të mesme në Kaçanik. Si klasë, lexonim literaturë të ndryshme,madje edhe të ndaluar. Në vitin 1980 nga Gafur Luma, kam marrë në lexim revistën ilegale ,,Liria". Këtë revistë, Gafuri na e ka dhënë mua dhe Nezir Demës në shkollë. Ishte një befasi për ne, pasiqë në atë kohë nuk e dinim se ekziston ndonjë organizatë ilegale që vepronte në Kosovë.
Kur drejtoria e shkollës, kërkoi nga ne që në Beograd ta nderojmë varrin e Titos, ne kemi reaguar si klasë, nuk donim të shkonim. Ishte një lloj proteste që askund tjetër nuk ishte dëgjuar. Kur po ktheheshim nga Beogradi, bashkë me nxënës të tjerë u ndalëm në Vranjë. Është një moment i rëndësishëm për t`u cekur se në Vranjë kemi kënduar zëshëm këngën ,,Hej Kaçanik o shkëmb e gurë". Kalimtarët vranjas na dëgjonin me kurreshtje. Ndër këto zëra dallohej zëri i dëshmorit Gafur Luma.
Pas kryerjes së shkollës së mesme, aktivitetin e kemi zhvilluar edhe në Prishtinë. Shpesh dilnim ,,Te përmendorja" dhe këndonim këngë me shokë e shoqe. Për këtë gjë, personeli i Konviktit na dha edhe vërejtje e krahas kësaj na i ndërruan edhe dhomat në Konvikt.
Në marsin e vitit 1982, u organizuan demonstratat në një vjetorin e vitit 1982. Në ato demonstrata kam marrë pjesë edhe unë bashkë me Gafur Lumën dhe shokë të tjerë. E mbaj mend se kur brohorisnim parullën ,,Kosova Republikë" gjatë demonstratës në Prishtinë, Gafuri kërkonte nga unë që të lëshoj zërin edhe më shumë, të brohoras edhe më tepër.

Kur u lirua nga burgu i parë, me disa shokë shkuam ta vizitojmë. Përpos që na mirëpriti, na këshillonte që t`i ruhemi kontakteve që të mos dekonspirohemi.
Pos me Gafur Lumën, kontakte ilegale kam pasur edhe me veprimtarin Hysen Shehun nga Kaçaniku, kujton Kadri Imishti.

Fotografi e vitit 1980, disa ditë para se të përfundonin maturën, i pari nga e djathta (ulur) është Gafur Luma
u

Nga shtypi ilegal

Në anën tjetër, Remzi Elezi nga Sllatina e Kaçanikut, i cili në vazhdim të veprimtarisë së tij ilegale kishte rënë në kontakt me Agron Morinën nga Ferizaj, Gafur Lumën e pajisë me materiale tjera ilegale nga Komiteti Organizativ, një organizatë e cila tanimë tentonte t`i shkrinte grupet e vogla në një organizim më të madh. Në rrjedhë të aktivitetit ilegal, në fshatin Sllatinë, formohet edhe Komiteti i Rrethit për Kaçanik, natyrisht si shtrirje horizontale dhe strukturale e Komitetit Organizativ.

Për të shkuar në vendin e takimit në Sllatinë, fillimisht në Fushë të Pajtimit, jam takuar me Gafur Lumën dhe Remzi Krrabën dhe me një makinë tjetër që erdhi e na

mori, shkuam për Sllatinë ku na priste Remzi Elezi, kujton Bajram Dernjani.
Në këtë mbledhje konstituive marrin pjesë: Remzi Elezi, Avdylgafur Luma, Bajram Dernjani dhe Remzi Krraba. Në këtë mbledhje, Remzi Elezi zgjedhet sekretar organizativ, ndërsa Avdilgafur Luma merr detyrën e sekretarit për propagandë dhe agjitacion ku edhe i caktohet emri konspirativ ,,Avdiu", Remzi Krraba angazhohet si arkëtar, ndërsa Bajram Dernjani mbetet anëtar i Komitetit. Bajram Dernjani kujton se në këtë mbledhje e cila ka edhe procesverbalin, por që ka mbetur i pazbuluar gjatë hetimeve, është debatuar situata në përgjithësi në komunën e Kaçanikut edhe më gjerë dhe mjaft aktiv në analizën e kësaj situate ishte edhe Gafur Luma.
Remzi Elezi dëshmon se është e vërtetë se procesverbali nga mbledhja themeluese e Komitetit të Rrethit për Kaçanik ka mbetur i pazbuluar nga UDB-ja, por meqë ai ishte i shkruar në paloma dhe i fshehur në tokë, kur dola nga burgu, përkundër masave të sigurisë, lagështia e kishte dëmtuar në tërësi, sqaron ai.
Duke shfaqur nevojën për ngritjen e një baze të tipografisë, Komiteti i Rrethit për Kaçanik, një makinë shkrimi e sigurojnë nga Grupi i Paldenicës, përkatësisht nga anëtari i organizatës Shaban Çupi dhe në mes fshatit Biçec e Nikë, Bajram Dernjani e Sejdi Dernjani ia dorëzojnë atë Remzi Elezit, sekretarit organizativ të Komitetit të Rrethit për Kaçanik. Në fakt, Grupi i Paldenicës në përbërje të Bajram Dernjani (jurist), Shaban Çupi (arsimtar), Sejdi Dernjani (elektricist) e Naser Dernjani (arsimtar) dhe anëtarë të tjerë që mbetën të pazbuluar, kishin vepruar të pavarur që nga

viti 1981 e këtej dhe kishin arritur që me mjaft sukses të shtrihen në shumë pjesë të trevës së Hanit të Elezit. Komiteti i Rrethit për Kaçanik do të masivizohet edhe me Remzi Krrabën nga fshati Stagovë, një veprimtar i hershëm dhe në lidhje ilegale në celulën e Ferid Qallakut që nga viti 1977, pastaj Mefail Vishin, Ismail Malsiun, Kadri Rakën, Emrush Tafilin, Muhamet Qorrin dhe të tjerë, që gjatë hetuesisë mbetën të pazbuluar, dhe gjatë ngritjes organizative, grupi në fjalë shkëmbejnë materiale të tjera ilegale si *Projektprogramin* dhe *Projektstatutin* e organizatës, revistën *Liria* e *Pararoja*, shumë ekzemplarë të revistës *Zëri i Kosovës*, *Këngët e Lirisë*, *Pushkën amanet*, librin *Titistët*, *Traktin për vrasjen e Zija Shemsiut*, *Traktin kundër tradhtisë, Armiku na ka në dorë vetëm aq sa e lejojmë ne vetë* apo siç njihej ndryshe si *Tezat e Konspiracionit,* Traktin *Liria* si dhe materiale të tjera ilegale nga Fronti Nacional Çlirimtarë ku vepronte tanimë dëshmori Afrim Zhitia. Ndërsa me rastin e trevjetorit të demonstratave të vitit 1981, në një trakt të shpërndarë, ndër të tjera thuhej se:

,,*Para tri vjetësh, rinia, studentët, klasa punëtore dhe fshatarët, si një grusht i bashkuar,u ngritën në këmbë për të kërkuar të drejta e liri në Kosovën e robëruar nga shovenistët serbo-mëdhenjë. U ngrit populli në këmbë më i fortë se kurrë, më i vendosur se kurrë për të kërkuar me vendosmëri realizimin e të drejtës jetike, statusin e Republikës së Kosovës, për Republikën ku do të përfshiheshin shqiptarët që jetojnë në trojet e veta por të shkapërderdhura në tri republika të Jugosllavisë...Mirëpo, çka ngjau! thuhej më tej në traktin e shpërndarë, në vend se kërkesa e popullit shqiptar të merren me arsye e*

maturi, në vend që palët të shtrohen në bisedime, populli shqiptar u shkel me tanke, u vra edhe një herë, u sakatos edhe një herë...''

Ndërsa *,,Zeri i Kosovës''* në numrin 6 të vitit 1985, shkruante*:*

Punëtorët, fshatarët, studentët formuan lëgurën më të fortë që i rezistoi veprimit rrënimtar të pushtuesit. Zëri i tyre u shkri në njëri-tjetin. Radhët u ngjeshën dhe si një trup i vetëm u përleshën me policinë dhe ushtrinë e Beogradit. Nga kjo përleshje gjaku i tyre i kuq, si flamuri kombëtar vërshoi rrugëve dhe për Republikë u bë një. Këto rrëke gjaku, nga një anë, përgjithnjë ndanë popullin nga i huaji dhe tradhëtarët, ndërsa në anën tjetër ai gjak hoqi çdo iluzion dhe u bë simbol i një bashkimi të përjeshëm. Me këtë gjak të derdhur bashkarisht u shkrua parulla famëmadhe: Punëtorë, studentë, fshatarë .- jemi një e të pandarë!

Ndërsa numri 10 i *Zërit të Kosovës* të vitit 1984, krahas një shkrimi më të gjatë për flamurin, ai përcillet edhe me vargje si:

Më ngadalë o shpend
Përmbi plagë m`u ulë,
Merr nga gjaku im
Shtoje mbi flamur...

Kurse në ballinën e *Zërit të Kosovës*, qëndronte kushtrimi i dëshmorit Jusuf Gërvalla:

Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetim më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s`do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme.

Në anën tjetër, faqe të tëra të *Zërit të Kosovës* shkruanin për burgosjen dhe dënimet e rënda që merrte djalëria

kosovare në gjyqet e pushtuesit. Numri i 6 korrikut të vitit 1984 sjellte një faqe të plotë me dënime të tilla ku ndër të tjera thuhej se: *Kohëve të fundit në Kosovë u intensifikuan proceset gjyqësore kundër forcave revolucionare që luftojnë për të drejtat e popullit si dhe për realizmin e kërkesës së tij për Republikë... Terrori gjyqësor në Kosovë po vazhdon që prej Pranverës `81 me një hov edhe më të madh dhe të paparë deri më tash, vetëm brenda muajit dhjetor, janar e shkurt të dimrit që shkoi u arrestuan afër 500 veta, ndërsa deri më tash u dënuan mbi 200 vetë...*

Një nga skicat[30] e shumta të *Zërit të Kosovës* ku krahas shkrimit, pasqyrohej edhe me vizatim ndjenja revolucionare e punëtorëve, studentëve dhe fshatarëve në frontin e Republikës.

[30] Burimi: Zëri i Kosovës nr.6 1985

Një numër të tillë të *Zërit të Kosovës* e lexoi edhe Gafur Luma

Shkrimtari Adem Istrefi në Shqipëri, në vitin 1984, botoi romanin ,,*Lëshoma hisen e diellit*" libër ky me një titull këlthitës e ultimatum i cili me gjuhën e fakteve, me thëniet e përjetuesve të ngjarjeve rrënqethëse, duke reflektuar periudhën e pas Shpalljes së Pavarësisë, kur më së tepërmi shkelen e copëtohen tokat tona, kur përgjaket e shtypet populli ynë liridashës, kur bajonetat e serbomëdhenjëve përshkojnë edhe foshnjet një djep...[31]

Për këtë hise të diellit, për këtë hise lirie, në Kosovën martire veprohej e luftohej. Për këtë hise dielli, motra mbeti pa të vëllanë, gruaja pa burrë e nuset plakeshin të reja dhe derisa, siç thot Avni Klinaku në një poezi të tij, Penelopa greke priste njerinë, Penelopa shqiptare prêt lirinë. Për këtë hise dielli, shkrumoheshin nënat pranë gurëve të oxhakut, për këtë hise të diellit, ferrat mbulonin shtëpitë... Por çdo kërkesë për liri që shqiptari e synonte ta ketë si të tjerët, ai ndiqej, burgosej e torturohej dhe në shpirtin e këtyre njerëzve të mirë, ndodhte dhe zhvillohej ajo dilema hamletiane shqiptare:

Qyqja loke e jemja bijë
A të kaj vendin, atë kaj ty
Hot e Grudë nër Mal të Zi...

Dhe përballë kësaj dileme hamletiane, shqiptarët u përcaktuan për vendin, për vatanin, u ngjizen me lirinë e atdheut, këtë e dëshmuan edhe ngjarjet që pasuan më vonë.

,,Diku nga fundi i vitit 1982, pasi u godit lëvizja

[31] Zëri i Kosovës nr.6. korrik 1984 fq.12

studentore, doli si domosdoshmëri se duhej ripërtërirë lëvizja klandestine, prandaj krijuam Këshillin Organizativ. Në atë këshill, të themeluar në Drenicë, kanë qenë të zgjedhur Shaban Shala, si sekretar politik, Fehmi Lladrovci, si sekretar organizativ dhe unë, si përfaqësues në kontaktet me grupet e tjera",-kujton Ali Ahmeti.[32]

,,Fakti është se, që nga fillesa e janarit të vitit 1983, kur Këshilli Organizativ mori formën e tij të strukturuar e deri në fillimin e vitit më pas, kishim 237 anëtarë dhe këta jo simpatizantë, por anëtarë aktivë. Kjo ishte një rritje tejet e ndjeshme në një kohë tepër të shkurtër.Për një kohë të shkurtër, në botën e Lëvizjes klandestine Atdhetare u shfaqën disa organizime të të njëjtit trung, ku spikatnin: Këshilli Organizativ, i përfaqësuar nga Fehmi Lladrovci, Ali Ahmeti dhe Shaban Shala; ,,Komiteti i trojeve", që ishte në lidhje me Këshillin Organizativ, ku ishin Pasho Maksuti, Fatmir Ibrahimi dhe Bajram Limani; ,,Komitetet Lokale", përfaqësuar nga Xhavit Haziri, Bashkim Mazreku dhe Nuhi Ahmeti, si dhe ,,Komiteti Organizativ", përfaqësuar nga Xhabir Morina dhe Hajdin Abazi.[33]

Pas takimeve të njëpasnjëshme të krerëve të këtyre organizimeve në muajin prill të vitit 1985, në një banesë ilegale në Prishtinë, arrihet marrëveshja për bashkimin e grupeve ilegale. U deshën më shumë se tre muaj bisedime, takime, debate, shikime dhe rishikime programesh dhe platformash, bisedime të përsëritura

[32] Bedri Islami,,Lëvizja-Lindje e përgjakur''(Bashkëbisedim me Ibrahim Kelmendin) Tetovë 2012, fq.133

[33] Bedri Islami ,,Lëvizja-lindje e përgjakur'' (Bashkëbisedë me Ibrahim Kelmendin),Tetovë 2012 fq.133

dhe, së fundi pas një kohe shumë të gjatë përpjekjesh, në Kosovë u krijua për herë të parë një organizatë unike atdhetare ilegale.[34]

Nga bashkimi i këtyre grupeve kishte lindur edhe udhëheqja e re. U zgjodh Sekretariati i Komitetit Organizativ i përbërë prej 5 anëtarëve dhe udhëheqësia e tij. Xhabir Morina u zgjodh sekretar politik i organizatës, Bashkim Mazreku - sekretar organizativ, Fehmi Lladrovci-sekretar për çështje ushtarake, Xhavit Haziri-sekretar për propagandë, informim dhe shtyp, Bajram Limani-sekretar për sigurimin e bazave.[35]Ali Ahmeti u caktua në drejtimin dhe krijimin e lidhjeve me strukturat që vepronin në Perëndim, së bashku me Emrush Xhemajlin.[36]

Disa gjëra u përcaktuan që në takimin vendimtar të prillit 1985, si: struktura organizative, projektprogrami, projektstatuti, si dhe caktimi i disa shokëve në sektorë të rëndësishëm. Hajdin Abazi dhe Ymer Grainca u caktuan si anëtarë të Këshillit, që në rast të burgosjeve dhe arrestimeve, të bënin detyrën e sekretariatit, së bashku me Ali Ahmetin dhe Emrush Xhemajlin...[37] Në sektorin e lidhjembajtjeve u caktua Elmi Reçica, Nuhi Ahmeti dhe Fatmir Ibrahimi, në sektorin e shtypit dhe të tipografisë Avdulla Dërguti, etj.[38]

Në vazhdë të këtij aktiviteti të madh kombëtar, që ideja e lirisë dhe e Republikës të përhapej në çdo shtëpi

[34] Bedri Islami ,,Lëvizja-lindje e përgjakur'' (Bashkëbisedë me Ibrahim Kelmendin),Tetovë 2012 fq.151

[35] Bedri Islami,,Lëvizja –lindje e përgjakur'' Tetovë 2012, fq.151-152

[36] Po aty fq.152

[37] Bedri Islami ,,Lëvizja-lindja e përgjakur'' fq. 152

[38] Bedri Islami ,,Lëvizja-lindja e përgjakur'' fq. 152

shqiptare, te çdo punëtor, student e fshatar, me 4 nëntor 1985 zbulohet organizata e cila kishte një shtrirje në të gjitha viset shqiptare pra, Komiteti Organizativ e në këtë rast zbulohet edhe Komiteti i Rrethit për Kaçanik dhe krahas arrestimit të anëtarëve të tjerë, me 12 nëntor 1985 arrestohet edhe Avdilgafur Luma. E arrestuan në mal, derisa po prente drunjë për shtëpi, bashkë me motrat e tij.
Gafurrin e arrestuar e dërgojnë në burgun e Prishtinës, në të cilin burg kishin qëndruar qindra e qindra atdhetarë të devotshëm, në mesin e tyre edhe simboli i qëndresës shqiptare Adem Demaçi:
...Para meje doli një godinë e çuditshme në formë të një patkoi. Përmes ,,patkoit" shkonte një mur dhe mbi mur qëndronte vëzhgimorja, me dritare të mëdha, në të katër anët. Poshtë, në këndin pranë derës së vëzhgimores shkëlqente drita e kuqe e nxehses elektrike. Në midis qëndronte gardiani. Papritmas u hap një derë që qëndronte në këndin ku bashkohej muri ndarës me pjesën përballë meje të burgut dhe në oborrin çerek patkoi dolën një grup njerëzish me qeleshe, me bereta në kokë dhe mbathur sa me opinga të Pirotit sa me këpucë. Këta, shkonin njëri pas tjetrit me duarët prapa, me kokat pjerrur dhe herë pas here dëgjohej nga ndonjë kollitje midis tyre. Ja, shtëpia ime, mendova... Për çudinë time, ndërtesa patkua e burgut kishte kulmin e rrafshët të mbuluar me rërë e me zhavor. Ja thash, një problem për analizë... Përse kulmi i burgut të jetë i rrafshët? Mundohesha të gjeja çfardo problemi tjetër për të menduar, vetëm e vetëm për t`u larguar nga tema ime kryesore: çfarë më priste? Në këto rropatje e sipër mendimesh u hap dera e zyrës dhe i trandur u ktheva e

pashë trupin e madh të kuqaloshit dhe sytë e tij të kaltër. Për një çast, ai u step, hëngri paksa buzën me dhëmbë dhe m`u ngërmua: Kush të tha ta hapësh dritaren?!
Vetë ...
Këtu, -uli paksa ai tonin, -ti, nuk ke se çfarë të hapësh, përveç gojës! A more vesh?[39]
...dhe kështu në burgun ,,patkua" të Prishtinës filluan hetimet ndaj Gafur Lumës. Këtu, nga kuqaloshët, kërkohej që Gafur Lumës t`i hapej goja. Këtu kërkohej që jeta e Gafurr Lumës të zbërthehej nga peri në gjilpërë. Këtu filluan shoshitjet herë ditën e më shumë natën. Këtu njeriu për njeriun ishte më tepër se ujk. Këtu ,,buka bëhej miell"...
Arrestimet e 4 nëntorit 1985 ishin masive dhe ndodhën në të njëjtën kohë në të gjithë hapësirën ku vepronte Organizata. Ishte një goditje e rëndë për Lëvizjen, pasiqë Komiteti Organizativ, arriti t`i bashkojë shumë grupe, bashkim i cili dëmtonte armikun, andaj edhe godija ishte e rëndë.
Arrestimet e filluara në nëntor 1985, përfunduan në muajin mars të vitit 1986 dhë nën pranga u gjenden mbi 500 shokë. Rreth këtyre arrestimeve, një shkrim analitik kishte edhe ,,*Pararoja* "organ i Komitetit Organizativ të MLK-së në numrin 1 të vitit 1986, ku ndër të tjera thuhej:
... Përkundër këtyre arrrestimeve, armiku s`mundi t`ia arrijë cakut që të zë tërë Komitetin Organizativ, por sa herë që lëvizja revolucionare e popullit tonë është gati të unisohet, armiku e ka goditur dhe e ka penguar këtë

[39] Adem Dema ,, Dashuria kuantike e filanit'',Prishtinë 2012, fq. 120

aspiratë. Megjithatë, organizata jonë ka arritur sukses të madh në bashkimin dhe shkrirjen e pjesës dërmuese. Prandaj, objektivë kryesore e armikut ishte goditja e qendrës sonë të fortë organizative që kështu të paralizohej bashkimi i arritur, që Lëvizja sërish të kthehet në një gjendje të mëparshme ku të mbretëroj primitivizmi, mosuniteti e përçarja...[40]

Komiteti i Rrethit i Komitetit Organizativ për Kaçanik gjatë kësaj periudhe zhvilloi aktivitet të dendur politik në këtë anë. Senzibilizoi situatën në një masë të caktuar dhe arriti që rreth vetes të angazhonte një numër të konsiderueshëm anëtarësh. Mirëpo aktiviteti i grupit nuk ngeli pa u vërejtur dhe pa i shqetësuar organet e pushtetit të atëhershëm okupues. UDB-ja organizoi një mori spiunësh dhe në fund të vitit 1985 u ranë në gjurmë dhe i arrestuan.[41], shkruan Dr.Sabile Keçmezi-Basha.

Pas hetimeve në Prishtinë, Gjilan e Prizren, më 13 prill 1986, ndaj Gafur Lumës, Prokuroria Publike e Qarkut të Prishtinës ngriti aktakuzën për 23 anëtarë të grupit dhe i dyti nga radha është Gafur Luma. Prokuror i aktakuzës ku dënohej rinia dhe inteligjenca shqiptare ishte Ismet Kabashi[42], ndërsa trupi gjykues i të pestëve përfaqësohej prej Shefki Sylës. Aktakuza e ngarkonte Gafurin ,,bashkim për veprimtari armiqësore", vepër e cila ndëshkohej nga neni 136 dhe ndërlidhej me nenin 114,

[40] ,,Pararoja'' nr. 1. 1986, organ i Komitetit Organizativ të MLK-së

[41] Dr. Sabile Keçmezi-Basha ,, Organizatat dhe grupet ilegale në Kosovë 1981-1989'' Prishtinë 2003, fq.146

[42] Ismet Kabashi, pra prokurori që na akuzonte për armiq, nacionalist, irredentist e seperatist vetëm pse kemi kërkuar që Kosova të bëhet Republikë, pas luftës së vitit 1999 emërohet Kryeprokuror i Republikës së Kosovës dhe nga ky pozicion, në vitin 2014, doli në penzion?!

nen i cili të dënonte për ,,kundërrevolucion".
Përkundër këtij terrori, veprimtarët e organizatës, gjetën forcë mobilzuese dhe në valën e arrestimeve, shpërndanë anë e kënd atdheut Traktin me titull ,,*UDB-a ndjekë bijtë e popullit"*. Në Trakt sqarohej mirë dhe detalisht se çfarë maltretimesh, reprezaljesh iu bënë qytetarëve, studentëve, punëtorëve, fshatarëve dhe mbarë popullit tonë duke arrestuar, burgosur e torturuar një numër të madhë studentësh, punëtorësh e fshatarësh.[43]
Grupi akuzohej se kanë vepruar armiqësisht ndaj Jugosllavisë, integritetit territorial të saj, kanë minuar sistemin shoqëroro-ekonomik të përcaktuar me kushtetutë, të thyejnë vllazërimin dhe bashkimin e kombeve dhe kombësive dhe në mënyrë kundër kushtetutare të ndryshojnë rregullimin federativ të RSFJ-së, ku Krahinën autonome të Kosovës ta shpallin Republikë dhe pastaj atë t`ia bashkangjesin Shqipërisë.
Krahas kësaj, u formuan edhe sektorët e tjerë si ai i propagandës, i shpërndarjes së literaturës, ai informativ, sektori ushtarak, ai për sigurimin e banesave dhe ai i financave.[44]
Gjithë kjo veprimtari ilegale dhe rezultatet që dha bashkimi i tyre, s`kishte si të mos i alarmonte organet e ndjekjes së pushtuesit, andaj me të gjitha forcat investiguese, armiku vepron në shkatërrimin e kësaj organizate e cila meriton një studim të veçantë shkencor, por ne po rikthehemi dhe përqëndrohemi vetëm në Komitetin e Rrethit për Kaçanik, e në veçanti për veprimtarinë e dëshmorit Gafur Luma, si pjesë e këtij organizimi ilegal politik.

[43] Burimi: Zëri i Kosovës, i muajit nëntor-dhjetor 1985
[44] Po aty fq. 133

Komiteti i Rrethit për Kaçanik, në kuadër të cilit ishte edhe komuna e sotme e Hanit të Elezit, dhe veprimtarët e saj, në forma të ndryshme kanë vepruar në mënyrë kontinuele që nga viti 1979 e derisa u zbulua veprimtaria e Komitetit në nëntorin e vitit 1985. Meqenëse Komiteti Organizativ i MLK-së ishte një organizatë e madhe ku deri në muajin dhjetor 1985 u arrestuan 413 vetë[45], për të minimizuar jehonën e saj në popull, UDB-a u përkujdes që të arrestuarit t`i dënoj në grupe më të vogla. Kështu ndodhi edhe me Komitetin e Kaçanikut.
Që në orët e hershme të mëngjesit të datës 9 qershor 1986, në burg ishte një disiplinë më e veçantë se herave të tjera. Na nxorën nga qelitë e burgut, shumë herë duke na mbështetur me kokë për muri. Duartë na i lidhën shtrëngueshëm me pranga dhe na futën rrëmbimthi në ,,marica". Nga shoku nuk guxoje as kokën ta ktheje, jo më të flisje. Gjykata e Qarkut e Prishtinës në qershorin e atij viti, pothuajse ishte në shtetrrethim, ishte mbushur përplot milicë. Në gjyq na futën jo nga hymja e zakonshme, por nga hymja mbrapa objektit. Salla ku po gjykoheshin nacionalistët, irredentistët e seperatistët ishte mbushur dëng. Mes dy të burgosurve ishte një polic. Me shokun as me sy s`mund të ,, flisje". Të gjithë u ngritëm në këmbë dhe prokurori lexonte aktakuzën ndaj të akuzuarve që kërkonin që Kosova të bëhej Republikë... Ndërsa gazeta ,,Rilindja" e (keq)njoftonte opinionin se ,,Në gjyqin e Qarkut të Prishtinës, para trupit gjykues të të pestëve, sot fillon procesi gjyqësor ndaj njëzet e tre vetave (në mesin e të cilëve janë edhe dy të mitur) të cilët përgjigjen për veprimtari armiqësore nga pozitat e

[45] Sipas informatës së Remzi Krrabës: Gjatë arrestimit tim, UDB-a më tha se ti Remzi Krraba je i 413-ti.

nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar... Të akuzuarit nga ana e Kaçanikut, Ferizajt e Prishtinës, në mesin e të cilëve ka studentë, nxënës, arsimtarë, me punë e të papunë, përgjigjen për organizimin e grupit, bashkim për veprimtari armiqësore, aktivitet propagandistik, terrorizëm, mbajtje paleje të armëve, ose materialit plasës... Se ata a kishin ndërmend të shkatërrojnë me forcë Jugosllavinë, me anë të armëve, flet edhe fakti, i cili përmendet në aktakuzë, se disa prej anëtarëve, siguruan pushkë, punuan mjete ekspozive të cilat kishin për qëllim të shqetësojnë qytetarët dhe të rrënojnë objekte. Njëri prej këtyre mekanizmave qe kurdisur në ndërtesën e Kuvendit Komunal të Ferizajt, dy planifikuan të vendosin mjete shpërthyese në Shtëpinë e Mallrave dhe në Stacionin e Autobusëve në Kaçanik, e njëri është dashur të ngrejë në ajër largpërçuesin dhe gazpërçuesin, i cili prej centraleve të Kosovës, shkon për Maqedoni...[46]
Pasi i erdhi radha Gafur Lumës, gjykatësi e pyeti: I akuzuar, a e pranoni aktakuzën?
Gafur Luma: Jo, aktakuza nuk është e mbështetur në prova, por në dhunë, ne nuk jemi irredentistë e seperatistë, por qytetarë të këtij vendi që e duam përparimin tonë kombëtarë, e duam që Kosova të bëhet Republikë, si republikat e tjera !
Dhe kështu njëri pas tjetrit merreshin në pyetje të akuzuarit dhe radha i erdhi prof. Ramadan Hazirit nga Ferizaj:
Gjykatësi: I akuzuar, pse të dridhet koka?
Ramadan Haziri: Nga torturat e UDB-së në vitin 1964, atëherë kur më arrrestuan për Flamurin, për këtë flamur

[46] „Rilindja'' e datës 9.6.1986

me shkabë që e keni në gjykatën tuaj. Është e vërtetë që gjithë këta të rinjë, këta studentë të zot, mësues e profesorë, e duan Republikën e Kosovës, por mos i dënoni sepse asgjë të dhunëshme nuk kemi bërë, kemi shprehur vetëm kërkesat tona politike. Ashtu siç erdhi dita e flamurit më 1968, ashtu do të realizohet edhe Republika, andaj mos i dënoni këta djem!
Çka t`u ka dashur pushka? - e pyeti gjykatësi me plotë ironin e tij , Ramadan Hazirin.
Unë, në fakt u kam kërkuar një pushkë tw shkurtw shokëve, një pushkë gjuetie për ujq, dhelpra e derra, por ja që shokët më kishin sjellur një të gjatë për arinjë,- u përgjigj prof. Ramadan Haziri.
Avokati: Xhemajl Krasniqi, mbrojtës i Ramadan Hazirit. I akuzuari Ramadan Haziri është profesor historie, i ndjekur nga pushteti dhe i arrestuar disa herë nga UDB-a. Ai e njeh mirë historinë tonë, mbi të gjitha njeh mirë torturat e Rankoviqit mbi shqiptarët, andaj dhuna shtetërore e ka detyruar Ramadan Hazirin që të merret me këtë veprimtari...
Policët që i kisha njërin në krahun e djathtë e tjetrin në të majtin, folën ndërmjet veti: ,,E hëngri edhe ky". E kishin fjalën për avokatin Xhemajl Krasniqin përndryshe bashkëveprimtar i Sali Bajrës viteve të `60 -ta.
Ata që patën rast të njohin Ramadan Hazirin, e të tillët nuk janë të paktë, shkruante gazeta ilegale ,,*Punëtorët*" në numrin 12 të saj, kanë gjithmonë parasysh intelektualin e shquar, historianin e ditur që me ligjërimet e tij i shërbente aq shumë përhapjes së diturisë. Fjalët e tij të zjarrta u jepnin njerzëve shpresë e kurajo në arritjen e fitores së popullit tonë...
Po ti Kadri Raka, sqaro veprimtarinë tuaj nacionaliste

para gjyqit...
Është e vërtetë që unë si i mitur kam shkruar parulla kah kam mundur si në shtratin e Neredimës e gjetiu si Kosova-Republikë, Poshtë serbomëdhenjtë, Poshtë spiunët, KR, Lironi shokët nga burgjet e të ngjashme si dhe kam shpërndarë trakte...
Të kujtohet përmbajtja e traktit, e pyeti gjykatësi.
Po, u përgjigj Kadri Raka:
S`janë shqiptarë or popull, s`janë shqiptarë ata që ja hedhin hekurat në dorë lules së Kosovës - Rinisë.
Ç`të duash i ke ata, serbomëdhenjë e sllavomëdhenjë, tradhëtar e spiun edhe xhelat të popullit i ke, veç shqiptarë nuk i ke...
Mjaftë, ndërhyri me kërcnim gjykatësi, mjaft, kjo është jashtë temës së ...
Ju keni planifikuar që të ngritni në ajër Shtëpinë e Mallrave dhe Stacionin e Autobusëve në Kaçanik, akuzoi gjykatësi.
Kjo është gënjeshtër e juaja, kjo është sajim i UDB-së, kjo aspak s`është e vërtetë, u përgjigj Kadri Raka dhe Emrush Tafili.
Kështu, kush më shumë e kush më pak, kush më fortë e kush më lehtë, paraqitën mbrojtjen e tyre nga 9 qershori e deri më 17 qershor të vitit 1986 të akuzuarit si armiqë të popullit shqiptarë.
Dhe më 17 qershor 1986, që të 23 të akuzuarit u ngritën në këmbë dhe trupi gjykues i shpalli dënimet, për ironi, në emër të popullit:

1. Remzi Elezi, student , dënohet me 7 vjet burg
2. Gafur Luma, student, me 4 vjet
3. Remzi Krraba, punëtor, me 3 vjet e 6 muaj

4. Bajram Dernjani, student, me 5 vjet
5. Shaban Çupi, mësues, me 4 vjet e 6 muaj
6. Mefail Vishi, shkolla e mesme, me 2 vjet për të mitur
7. Ismail Malsiu,student, me 6 vjet
8. Muhamet Qorri, shkolla e mesme, me 4 vjet
9. Emrush Tafili, shkolla e mesme, me 5 vjet
10. Kadri Raka, shkolla e mesme, me 2 vjet e 6 muaj për të mitur
11. Ruzhdi Shkodra, student, me 7 vjet
12. Hyzer Haxhiu, referent, me 4 vjet
13. Nexhat Xhokli, student, me 4 vjet
14. Muzafer Lika, student, me 4 vjet
15. Ramadan Haziri, profesor, me 11 vjet
16. Sylejman Bytyçi, ingjinier, me 9 vjet
17. Jahir Haliti, mësues, me 1 vjet

NË PRISHTINË U GJYKUA GRUPI I NACIONALISTËVE

FAJËSIA E ARGUMENTUAR

Gjashtëmbëdhjetë veta, dje me rastin e kumtimit të aktgjykimit, u shpallën fajtorë për veprimtari armiqësore, kurse pesë sish u liruan nga akuza

Grupit armiqësor ilegal, që [illegible] nga pozitat e nacionalizmit [illegible] ekstremizmit shqiptar, pjesëtarë[illegible] organizatave të ashtuquajtura [illegible] Marksistë Leninistët e Kosovës» [illegible] «Lëvizja për Republikën Soci[illegible] të Shqiptarëve në Jugoslla[illegible] pasi u vërtetuan shumë fakte të [illegible], Gjyqi i Qarkut të Prishti[illegible] dje ua shqiptoi aktgjykimin.

Trupi gjykues i të pestëve, që e [illegible] Shefki Sylaj, pas shqyrti[illegible] kryesor gjashtëmbëdhjetë veta [illegible] shpalli fajtorë për veprën penale, [illegible] për veprimtari armiqëso[illegible], propagandë armiqësore, shka-

NË GJYKATËN E QARKUT NË PEJË

VAZHDOI GJYKIMI I GRUPIT ARMIQËSOR

Pejë, 17 qershor

Para kolegjit të të pestëve (kry[illegible] nga Ukë Muçaj, gjyqtar), [illegible], në Gjykatën e Qarkut në Pejë, vazhdoi gjykimi i 7 të akuzuarve për veprimtari armiqësore. U mo[illegible] në pyetje Salih Kabashi, Ra[illegible] Shala, Rifat Birinxhiku dhe [illegible] Bujupi, të cilët në mbroj[illegible] e tyre tentuan të mohojnë ak[illegible] dhe pohimet që kishin [illegible] më parë në hetuesi. Gjithas[illegible] u morën në pyetje tre dëshmi[illegible]. Nesër gjykimi vazhdon me [illegible] e provave të tjera.

tërrim i objekteve ekonomike e terrorizëm. Një i akuzuar u fajësua për hajni, ndërsa pesë të tjerë, në mungesë të provave, u liruan nga akuza, u shpallën të pafajshëm.

Ramadan Haziri nga Ferizaj u dënuan me 11 vjet, vendasi i tij Sylejman Bytyçi – 9, Remzi Elezi nga Sllatina e Kaçanikut – 7, Ruzhdi Shkodra nga Ferizaj, 7, Ismajl Malsiu nga fshati Rekë e Kaçanikut - 6, Bajram Dërmjani nga Paldenica - 5, Emrush Tafili nga Kaçaniku – 5, Shaban Çupi nga Paldenica, 4 vjet e gjysmë, Avdylgafur Luma nga Glloboçica – 4, Muhamet Çorri nga Reka – 4, Hyzer Haxhiu nga Ferizaj – 4, Nexhat Gjokli nga Ferizaj – 4, vendasi i tij Muzafer Lika, 4, Remzi Krraba nga Stagova – 3 vjet e gjysmë, po ashtu iu shqiptuan dënimet edhe të miturve. M.V. nga Dubrava – 2 e K. R. nga Kaçaniku -2 vjet e gjysmë burg për të mitur. I akuzuari Jahir Haliti nga Prelezi i Ferizajt, i cili akuzohej për propagandë armiqësore, u shpall fajtor për hajni dhe u dënua me 1 vit burg.

Metush Krasniqi, i cili ngarkohej për propagandë armiqësore, në mungesë të provave, u lirua nga akuza. Po ashtu të pafajshëm u shpallën Xhemajl Azemi, Daut Shkodra, Skënder Osmani e Ahmet Bekteshi, ndaj të cilëve nuk u argumentua vepra penale – mbajtja pa leje e armëve dhe e materialit plasës, që u vihej në barrë.

A.M.

Faksimil nga gazeta ,,Rilindja” për dënimet e shqiptuara nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës më 17 qershor 1986, të të cilin e quante ,,fajësi e argumentuar”, kurse ,,Zëri i Kosovës” ilegal, dënimet e shqiptuara i quante ,,Terror gjyqësor në Kosovë”

Struktura e të dënuarëve të Komitetit të Rrethit për Kaçanik, proces i cili zgjati prej 9 qershorit deri më 17 qershor është si vijon:
6 student, 2 mësues, 1 profesor, 1 ingjinier, 5 me shkollë të mesme,1 referent dhe 1 punëtor. Të akuzuarit e tjerë, si: Xhemajl Azemi, Ahmet Bekteshi, Skënder Osmani, Daut Shkodra, Nuhi Ramadani u liruan në mungesë provash në gjyq, e në mesin e tyre edhe Heroi i Kosovës, Metush Krasniqi i dënuar më parë me 18 vite burg. Ai për 6 muaj ditë me radhë, torturohet mizorisht nga UDB-a dhe në mungesë të provave ai lirohet në gjyq, por vdes pas tre muaj dite në shtëpi, në tetorin e vitit 1986, si pasojë direkte e këtyre torturave.
Grupi i dënuar, për Republikën e Kosovës, mori gjithësejt 84 vite burg të rëndë, të cilin edhe e mbajtën burgjeve të ndryshme të Jugosllavisë së atëhershme. Gjykimi i Komitetit të Rrethit në Kaçanik, në masat popullore kaçanikase e më gjërë, pati një jehonë të theksuar, ndërsa armiqësia ndaj pushtuesit u shtua edhe më shumë, sepse:
Në vitin 1981 iu shqiptuan dënimet, demonstruesve të Kaçanikut për pjesëmarrje në demonstratën e 5 majit 1981, si: Xhemajl Fiqi, Hysen Shurdhani, Ekrem Kyçyku, Ferid Qallaku, Emrush Mulaku, Fadil Dullovi, Suzane Bytyçi, Mubera Shehu, Elife Luzha, Naser Tusha, Avdullah Qallaku, Ramiz Shehu, Fatime Sopa[47], etj. Po në fund të këtij viti u zbulua grupi ku vepronin Berat Luzha, Ferid Qallaku e Kadri Luzha, në vitin 1982 u dënua grupi ku veproi Naser Kuka e Hysen Shehu, në të

[47] Naser Kuka „ Nga lëvizja ilegale te UÇK'' Prishtinë 2012, fq.. 111

njëjtin vit u arrestua dhe u dënua për të dytën herë tanimë dëshmori Gafurr Loku, në dhjetor të vitit 1983 u dënua grupi ku vepronte Fadil Hysaj nga Stagova, në qershor të vitit 1984 iu shqiptuan dënimet grupit ku vepronin Ibush Vishi, Agim Vishi e Bexhet Imishti, në nëntor të vitit 1985 u zbulua Komiteti i Rrethit i Komitetit Organizativ në krye me Remzi Elezin, në vitin 1987 u zbulua grupi i Heset Malsiut, Agim Dautit, Hysret Kyçykut dhe Ibrahim Currit, Mehmet Ballazhit e Nexhat Ballazhit nga Hani i Elezit, në vitin 1988 riburgoset Naser Kuka me grupin e tij, në vitin 1989 burgoset agimi i lirisë, Agim Bajrami,...e të gjitha këto veprime e sakrifica atdhetare, kaçanikasit i kishin treguar qartë pushtuesit se një ditë ,, do të ushtoj Gryka e Kaçanikut" se një ditë ,,do të marrin flakë edhe gurët e malit", se një ditë liria e Kosovës do të lindë, ashtu siç lindi UÇK-ja përkatësisht Brigada 162 ,,Agim Bajrami"e bashkë me atë edhe Republika e Kosovës.

Pra, Komiteti i Rrethit për Kaçanik i Komitetit Organizativ, ishte një hallkë domethënëse në luftën për liri, ashtu siç janë me vlerë të gjitha grupet dhe individët që u dënuan padrejtësisht nëpër gjykatat e pushtuesit serbo-jugosllav.

Të burgosurit mbaheshin në kushte të rënda burgu, mbaheshin në burg hetues, në izolim. Në të njëjtën dhomë të burgut, i burgosuri politik qëndronte me vrasës, vjedhës, dhunues e të sëmurë psiqik dhe për të ilustruar këtë sjellim dy dëshmi, atë të dëshmorit Enver Topalli dhe të kryengritësit Hydajet Hyseni.

Enver Topalli:

,,Gjashtë muaj i pata kaluar në qelinë numër 7 të burgut të Nishit me njëfarë Pavlloviqi, psikopat, i cili, në vend të

bukës hante bërllok, që të bëhej sa më i ,,fortë" dhe, siç thoshte, ta ,,çlironte" Kosovën nga shqiptarët. Atë çdo ditë gardianët e nxisnin që të dëshmonte forcën e tij prej ,,boksieri" mbi të burgosurit shqiptarë. Edhe sikur ai të më sulmonte natën në gjumë, zor se dikush do të kërkonte fajësi prej tij"[48]

Hydajet Hyseni:

,,Më marrin pa kurrfarë arsyeje dhe më dërgojnë në dhomën tjetër , ku ishte një i burgosur (Bojoviq), që ishte po ashtu i sëmurë psikik, i cili ishte i njohur se tinëzisht i sulmonte të burgosurit, pa kurrfarë preteksti. Këtë e dinin edhe të burgosurit, edhe personeli i burgut. E dinin, por ja që unë duhej të vendosesha pikërisht në dhomë e tij..."[49]

Ushqimin që e hanin të burgosurit ishte jokalorik, papastërtia në dhoma e madhe, nevojat fiziologjike i kryenin në kibëll, zgjebja bënte kërdinë, ndërsa dritaret, që të pengohej drita e diellit izoloheshin me llamarinë ose xham qorr dhe për çdo ,,thyerje" të rendit shtëpiak, i burgosuri politik torturohej në koridor të burgut nga 3-6 gardianë.

Përkundër presioneve të mekanizmave të pushtetit pushtues që i burgosuri politik të izolohet dhe distancohet edhe nga familja, ata kurr nuk hoqën dorë nga bijtë e tyre. Edhe ashtu të skamur që ishin, vizitat nëpër burgje ua bënin me rregull. Na shoqëronin nga një burg në tjetrin, duke u sakrifikuar bashkë me ne. Kështu ishte edhe me familjen e Gafur Lumës me babë Merxhanin, nënë Zylfijen, vëllezërit Eminin, Qaniun e

[48] Sabile Keçmezi-Basha ,, Organizatat dhe grupet ilegale në Kosovë 1981-1989'' Prishtinë 2003, fq. 52

[49] Po aty fq. 52

Zilfin, motrat Hamdijen, Nexhmijen, Zarijen e Hirmeten, ndërsa në burgun e dytë me gruan Hydajeten, djalin Lirimin e vajzën Katrinën.

Nëpër këto rrethana e peripeti vuajtjesh e qëndrese, Gafur Luma dënimin e shqiptuar nga burgosja e parë e vuan në Gjilan, Prizren, Prishtinë dhe Gurakoc gjithnjë i dashur, dhe i respektuar nga të gjithë.

Dëshmori Gafur Luma, bashkë me 23 anëtarë të grupit në Gjyqin e
Qarkut të Prishtinës në qershor të vitit 1986

Gjykimi i anëtarëve të Komitetit Organizativ në Prishtinë, ku Komiteti i Rrethit për Kaçanik ishte pjesë e këtij organizimi, por dënimet bëheshin veç e veç e në grupe sa më të vogla që të mos shkaktohej revoltë popullore

Proletarë të të gjitha vendeve dhe popuj të shtypur, bashkohuni!

ZERI i KOSOVES

ORGAN I LEVIZJES PER REPUBLIKEN SOCIALISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI

VRASJET NEPER BURGJE NUK E MPOSHTIN POPULLIN TONE

ZIJAH SHEMSIU (1950–1985)



K O M U N I K A T E

POPULL I KOSOVËS

Në festën e Majit të Kuq 1905 u shkrua një faqe e pikëllueshme por edhe e lavdishme e historisë sonë, në përpjekjen e vazhdueshme që po bënë UDB-ja gjakatare për t'i nënshtruar me lajka e tortura revolucionarët tanë të burgosur. Ka këto tortura ra viktimë edhe patrioti Zijah Shemsiu i cili s'u nënshtrua dot dhe nuk trathtoi kurr idealet e larta për liri.

Zijah Shemsiu në gjygjet e pushtuesve serbë në Beograd në vitin 1934 ishte dënuar me 13 vjet burgim si aktivist i LRSSJU-së. Këtë trim, luftëtar të lirisë, me 06 maj 1905 e sollën të vdekur nga burgu i Beogradit dhe nën kontrollin e UDB-ës u varros në vendlindje në Përlepnicë të Gjilanit. Ai vdiq nga torturat çnjerëzore të cilat UDB-ja gjakatare i ka traditë ndaj bijve Tu luftëtarë të lirisë.

Kosovë t'u hapë edhe një plagë e dhimbshme, një plagë që pikon gjak e që mbjellë urrejtje ndaj pushtuesve shovenist!

Armiku n'të bëhet kurrë mik. Ai gjithnjë përpiqet, duke përdorë çdo mjet, të të mashtroj, të të nënshtroj. Kështu veprojnë pushtuesit tanë serbo-maqedono-malazezë të cilët para syve na hiqen si miq, ndërsa pas shpine na e rrëmbejnë pasurinë kombëtare, na e bastardojnë kulturën, na shajnë e na vrasin! Edhe kur me tanksa e merconarë specialist vërsulen mbi demonstruesit, i vrasin o i masakrojnë, edhe kur bëjnë terror mbi popullin hiqen si miq të tij, dhe këto i bëjnë „për të mirën e popullit"!!!

Këta pushtuesi, të vrasin natën e të qajnë ditën. Edhe tash që e vranë Zijah Shemsiun pushtuesit janë të „pafajshëm" me gjarpëri gjithënjë kur kafshon kërkon ta fshehë kokën. Revizionistët dhe pushtuesit serbo-jugosllav e fshehin dhe heshtin kët krim para popullit shqiptar, opinjonit jugosllav dhe atij botëror.

Populli shqiptar i Kosovës është kalitur në luftëra, i di mirë këto lajka, i njeh mirë kush janë fajtorët e vërtetë. Se armik i popullit s'mundet kurr të jetë ai që lufton për të mirën e tij. Armik është ai që na vranë e masakron e jo ai që flijon jetën për çlirimin e popullit tonë.

Populli me pikëllim shkruan gjithëçka në kujtesën e tij për t'u hakmarrë një ditë.

Lum Ti popull shqiptar që ke bij si Zijah Shemsiun!

Për lirinë e popullit, asnjë revolucionar s'do ta kursejë jetën!

Lavdi Zijah Shemsiut dhe të gjithë të rënëve për lirinë e popullit shqiptar!

RROFTË REPUBLIKA SOCIALISTE E KOSOVËS!

Ja liri, ja vdekje!

[illegible]

Faksimil nga trakti i shpërndarë, në maj të vitit 1985, me rastin e vrasjes së Zija Shemsiut në CZ e Beogradit, të cilin e lexoi dhe e shpërndau dëshmori Gafur Luma

PARAROJA

„P A R A R O J A"

Gazeta ilegale ,,Pararoja" nr.1 1985, e cila shtypej për radhët e organizuara dhe e njëjta u lexua edhe nga Gafur Luma

LIRIA

"L I R I A"

Revista ilegale ,,Liria" e vitit 1980 e cila u ruajt për 38 vite me radhë te Nevait Luma në fshatin Gllboshicë. Këtë material ilegal dhe materiale të tjera, Gafur Luma ia ka dhënë për lexim dhe strehim Nevait Lumës i cili me besnikëri i ka ruajtur deri në ditët e sotme. Rreth kujtimeve me dëshmorin Gafur Luma, **Nevait Luma**

(1956), kujton[50]: Me Gafurin ishim kusherinjë dhe fqinjë. Në vitin 1979, unë u punësova në Fabrikën e Gëlqerës në Kaçanik dhe meqë fshati im ishte largë për udhëtim të përditshëm, në fshatin Bob të Kaçanikut, kisha një banesë private. Në atë kohë, Gafuri ishte nxnës i shkollës së mesme dhe si i tillë ai ka banuar gratis në banesën time dhe që nga kjo kohë e kam njohur edhe më shumë atë. Në vitin 1980, Gafuri ma dha për lexim revistën ilegale ,,Liria" pastaj ,,Shqipëria e Re" dhe disa gazeta të tjera, natyrisht ilegale dhe jo vetëm që i lexova por edhe i strehova. I kam strehuar në çatinë e shtëpisë, sepse ishte frika nga bastisjet. Nga këto meteriale ilegale, kohës arriti t`i rezistoj vetëm ,,Liria" e vitit 1980 e cila le të mbetet si dëshmi e kohës për dëshmorin Gafur Luma.
Përpos me Gafurin, në banesë vinte edhe Ferid Qallaku, ku punonim në të njejtën fabrikë, por unë vozitja një kamion dhe bartja gurë qëlqeror, isha punëtor i thjeshtë. I dija aktivitetet që zhvillonin Gafuri e Feridi. Kur u burgosë Ferid Qallaku kemi shkuar ta vizitojmë në burgun e Mitrovicës bashkë me Gafurin, nënën e Feridit dhe vëllaun e tij, Qazimin, kujton Nevait Luma.

[50] Informatë e datës 14.1.2018, Qafshipe

ZERI i KOSOVES

ASNJË MASË REPRESIVE
NUK MUND TA NDALË POPULLIN
TONË PËR REALIZIMIN E KËRKESËS
"KOSOVA REPUBLIKË"

Zëri i Kosovës, 1985

Nëpër titujt e materialeve ilegale

Duhet shtypur një libër të veçantë, për të shtjelluar përmbajtjen e materialeve të cilat i lexuam sa vepruam në Lëvizjen ilegale. Por, për të sqaruar sado pak përmbajtjen e këtyre materialeve, ne po i shkruajmë vetëm titujt sepse edhe nga titulli afërsisht kuptohet përmbajtja e këtyre materialeve, të cilat ndikonin në formësimin tonë atdhetarë.

Mbi bazën e këtyre shkrimeve, nga viti 1979 e këndej, u formësua personaliteti i dëshmorit Gafur Luma. U formësua dëshmori i lirisë. Madje, edhe po të duash, e ke vështirë ta profilizosh ndryshe rrugëtimin dhe konceptin ideologjik të Gafur Lumës.

- Liria
- Asnjë masë e revizionistëve nuk mund ta mposhtë popullin tonë heroik
- Gjendje e rëndë në ekonominë e Kosovës
- Një faqe e lavdishme e luftës për liri e pavarësi
- Të burgosurit kosovarë të kthehen në Kosovë
- Plagët e hapët që kërkon shërim
- Vepër me rëndësi të madhe teorike dhe praktike
- Populli afgan do të fitojë
- Kush janë luftëtarët e lirisë në Kosovë dhe ç`duan ata
- Jemi shqiptarë e asgjë tjetër
- Shqiptarët nuk janë jugosllavë
- Të mos ngatërrohen kombi dhe feja
- Krizë e degjenerim në Jugosllavinë titiste
- Maskaradë e pasigurisë evropiane
- Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe do të triumfojë
- Cila është e vërteta
- Jo rinia, por tradhtarët janë plehu i Kosovës
- Demonstratat e Kosovës janë vepër e popullit të saj
- Kush po e nxitë nacionalizmin
- Rroftë Republika e Kosovës
- Kriminelët akuzojnë për vandalizëm
- Zëri i popullit - zëri i së vërtetës
- Populli ynë kërkon liri e jo luftë
- Tradhtarët shqiptarë mbrojnë interesat e pushtuesit
- Ai ra për të mos vdekur kurrë

- Punëtorët kosovarë në perëndim shpalosin flamurin e luftës
- Regjistrimi i popullsisë në Kosovë u bë nën hijen e tankeve
- Kosovë, sa hije të ka xhamadani i trimërisë
- Armiku na ka në dorë vetëm aq sa e lejojmë ne vetë
- Librin: Titistët
- Revistën ,,Shqipëria e Re"
- Revistën ,,Ylli "
- Revistën ,, Punëtori"
- Projektprogrami dhe projektstatuti i Komitetit Organizativ
- Trakti i Frontit Nacional Çlirimtar të Kosovës
- Trakti për vrasjen e Zija Shemsiut
- Jehona e ngjarjeve të Kosovës në shtypin e huaj
- Përpara drejtë fitores
- Pse shpërngulen nga Kosova serbët dhe malazezët
- Jemi patriotë, s`jemi shovinist
- Popull shqiptarë i Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi
- Cilët janë shovinistët e vërtetë
- Populli shqiptar në Jugosllavi asnjëherë nuk vendosi për fatin e tij
- Si mbeti Kosova nën sundimin e Serbisë
- Thika e diplomacisë evropiane copëton atdheun tonë
- Si e shihte PKJ të drejtën për vetëvendosje, para dhe gjatë luftës
- Çka u vendos në AVNOJ dhe çka në Bujan
- Pas ,,çlirimit", Kosova përsëri në ankand

- Tradhtarët e vjetër dhe tradhtarët e rinj
- Jugosllavët të vrasin natën e të qajnë ditën
- Dëshmi e kalbëzimit të ,,vetadministrimit" titist
- Bashkëatdhetarë të shtrenjtë
- Vëllezër punëtor në mërgim
- Shqipja bën edhe pa gjëmë, i mjafton lavdia
- Zemra speciale
- Të gjithë shqiptarët Mic Sokola
- Letër e hapur punëtorëve kosovarë në mërgim
- Thellohet kriza ekonomike në Kosovë
- Trakti kundër tradhtisë
- Materialin për radhët e brendëshme ,,Pararoja"
- Zëri i Kosovës, disa numra
- Zëri i atdheut
- Revolucioni
- Teoria dhe praktika e revolucionit
- Programin e LPK-së
- Materialin : Në luftë për liri, popujt s`kanë çka të humbin, pos prangave të robërisë
- Zëri i Popullit:Shtypi botëror rreth ngjarjeve në Kosovë
- Zëri i Popullit: Një dëshmi e re e politikës antishiqptare të udhëheqjes jugosllave
- Radiotelevizionin shqiptar


LËNDA: ANKESË KUNDËR AKTAKUZËS
LËSHUAR NGA PROKURORIA E
QARKUT (PUBLIKE);
PP nr 295, PP nr 298/85
datë 15 prillë 1986
Prishtinë

PPM nr. 133/84
PPM nr 144/85

ANKESË

Për mungesë të aktakuzës, lëshuar nga Prokuroria Publike e Qarkut, PP nr 295, PP nr 298/85 PPM nr 133/84, PPM nr 144/85 e shoqëruar të mangëtme, të autorizuar në bidhje me mungesë Aktakuza në mes të tjerash ka gjetur të kanë prapë funksionimi e Sekretariat për propagandë dhe agjitacion, e' kuadër të KOMITETIT TE QEETHIT PER KAÇANIK

- Pikë së pari, as që ka gjetë e formuar ky komitat i vetëm ka i përbat funksionit të Sekretariat për propagandë dhe agjitacion" që gjoja në çdatë caktuar nga Rexho Elezi (sipas në faqen 14 të aktakuzës) prova jendrian
- Nyjat në bazë gjetë shumë e rëndësuar me provime prapa fakultetit teknik dhe shumë pse mundësi të gjë ndrenjë aktivitet me të gjallë, në çdatë caktuar gjë të angazhuar në sektorin e propagandës (gjegjësisht të propagandës dhe problemë të çmuë

ankesën:
AVOKATURA LUMA
BARON i QARKUT
PRIZREN

me datë:
21 prill 1986.
Prizren

Faksimil nga dorëshkrimi i dëshmorit Gafurr Luma nga burgu i Prizrenit në kundërshtim të aktakuzës së ngritur

Si u përball me hetuesit e UDB-së Gafur Luma gjatë burgut të parë

Veprimtaria e Komitetit Organizativ të MLK-së u zbulua më 4 nëntor të vitit 1985. Në të njëtën ditë, që në orët e hershme të mëngjesit, nën pranga u gjetën jo vetëm krerët e Komitetit Organizativ, por edhe shumë drejtues të Komiteteve të Rretheve.

Komiteti Organizativ, qëllim të drejtëpërdrejtë kishte formimin e Republikës. Në Statutin e tij thuhet se ,, Komiteti Organizativ udhëheq punën ndërmjet dy Mbledhjeve të Përgjithshme... dhe ka këto organe: Sekretariatin, Redaksinë, Këshillin dhe Byronë Ekzekutive".

Kjo Qendër Organizative, përkatësisht Komiteti Organizativ, në fakt arriti t`i bashkojë katër grupe domethënëse, ndërsa në shtrirjen horizontale, vepronte nëpërmjet Komiteteve të Rrethit.

...Gjatë vitit 1983, duke qenë si bosht forcat e OMLK-së të pazbuluara nga armiku, u formua Qendra Organizative, rreth së cilës u bashkuan shumica e grupeve... patriotike. Qendra kishte dy objektiva të mëdha organizative: themelimin e Partisë dhe organizimin e Frontit. Për të realizuar objektivën e parë, ajo kishte caktuar Kongresin e grupeve, Kongres i cili përfundimisht ishte caktuar të mbahej në gjysëmvjetorin e parë të vitit 1984. Mjerisht, edhe ky hap i madh i bashkimit nuk u arrit sepse prapë UDB-ja arriti të zbulojë shokët ilegalë të Qendrës Organizative, të cilët i rrethoi dhe likuidoi Rexhep Malën e Nuhi Berishën, si dhe burgosi dhjetra militant të tjerë. Humbjet ishin të mëdha, mirëpo përkundër terrorit, ideja e bashkimit u fuqizua edhe më tepër. ... Fillimisht u formua Komiteti Organizativ, i cili i shtroi vehtes për detyrë t`i

bashkojë të gjitha grupet dhe të vazhdojë rrugën drejt themelimit të Partisë. Këto përpjekje u kurorëzuan në prill të vitit 1985, kur u bashkuan katër grupe dhe formuan MLK-në nën drejtimin e Komitetit Organizativ... Duke ndërmarrë hapa konkret për ta konsoliduar bashkimin e posaarritur, UDB-ja prapë arriti të godas organizatën e re dhe ta dëmtoj mjaftë lëvizjen... thuhet ndër të tjera në broshurën ilegale të majit 1986, botuar nga redaksia e ,,Pararojës".[51]

Nga këto që u thanë më lartë, Gafur Luma me shokë, bënte pjesë në një Organizatë ilegale politike që vehtes i kishte shtruar detyra të rënda. Themelimi i Partisë dhe krijimi i Frontit ishin domosdoshmëri që të bëheshin, që Lëvizja ilegale të kalon në një stad më të rëndësishëm organizativ, më cilësor dhe më konkret, që të realizohej ajo që duhej, Republika e Kosovës.

Komiteti i Rrethit për Kaçanik, në strukturën e tij organizative vepronte mbi disa shtylla. Në shtyllën e parë ishte Remzi Elezi, Gafur Luma, Remzi Krraba e Bexhet Luzha dhe në themele kishte veprimtarinë me revolucionarët Ferid Qallakun e Berat Luzhën, në shtyllën e dytë ishin Bajram Dernjani, Shaban Çupi, Naser Dernjani e Sejdi Dernjani dhe në themel të tyre qëndronte revolucionari Gafurr Loku, ndërsa shtylla e tretë ishte ajo e grupit të Ismail Malsiut, në të cilin bënin pjesë Kadri Raka, Muhamet Qorri, Mefail Vishi dhe Emrush Tafili ku në themel të tyre ishte jehona e demonstratave të vitit 1981, pastaj secili veq e veq kanë vepruar në degëzimin e Komitetit me anëtarë të rinj.

Grupi i fshatit Paldenicë ishte grup në vete dhe ka

[51] Driloni ,, Çështja e partisë…'' maj 1986, Redaksia e ,,Pararojës'', broshurë e huazuar nga Arkivi personal i Shefqet Jasharit, Ferizaj

vepruar nga viti 1981 pastaj shkrihet në Komitetin e Rrethit për Kaçanik, përkatësisht në Komitetin Organizativ. Ky grup ka propaganduar Republikën e Kosovës me mjete legale dhe ilegale, duke u shërbyer edhe me materiale ilegale nga Fronti Nacionalçlirimtar i Kosovës(FNÇ), ku bënte pjesë dëshmori Afrim Zhitia, është marrë me shkrime dhe shpërndarje të parullës Kosova-Republikë, gjithkund ku ka qenë e mundur, madje edhe në monedha metalike. Ka pasur fondin e caktuar të librave e gazetave të cilat shërbenin për ngritje ideore, duke mos përjashtuar incizimet në audiokaseta nga radiotelevizioni shqiptar, si dhe ka përpiluar vetë trakte. Ka vepruar në disa drejtime, por më të theksuar kanë qenë studentët, punëtorët arsimor dhe punëtorët e fabrikës së Çimentos. Grupi ka pasur makinë shkrimi dhe ka tentuar të krijoj shamblonin me parullën Kosova – Republikë në formë të vulës si dhe kanë mbledhur ndihma për familjet e të burgosurve politik. Arteria kryesore e grupit ishte juristi Bajram Dernjani.

Mjaftë aktiv ishte edhe grupi i Ismail Malsiut i cili ka arritur me shumë sukses të shpërndaj trakte e të shkruan parulla në shumë vende publike, veçmas në shtratin e lumit Neredime[52],Te stacioni i autobusëve në Kaçanik[53], pastaj në vendin e quajtur Te Lushi[54] si dhe të shpërndanë Traktin kundër tradhëtarëve[55] i cili kishte këtë përmbajtje:

[52] Aksioni u krye me 2 prill 1985

[53] Parullat: Kosova –Republikë, Poshtë spiunët, Poshtë serbomëdhenjtë, Lironi shokët nga burgu, u shkruan me datën 28.8.1984

[54] Aksioni u krye me 2 prill 1985

[55] Trakti është shpërndarë natën e 11/12 marsit 1985

Trakt kundër tradhtarëve

S`janë shqiptarë or popull, s`janë shqiptarë ata që ja hedhin hekurat në dorë lules së Kosovës - Rinisë. Ç`të duash i ke ata, serbomëdhenjë e sllavomëdhenjë, tradhëtar e spiun edhe xhelat të popullit i ke, veç shqiptarë nuk i ke.

I ka verbuar buka e gojës dhe rrena e pseudomarksistëve të mallkuar me shokë dhe prej të verbuarit çka pret pos greminës, ata shtrijnë dorën për lëmosh edhe te hasmi i vet, se nuk e njeh.

Pra u bëhet thirrje e fundit tradhëtarëve të kombit që devijuan rrugën e revolucionit të heqin dorë nga tradhëtia se i pret plumbi.

Pashtë tradhtarët!
Poshtë spiunët!

Dhoma numër 13 në burgun e Gjilanit ku qëndroi Gafur Luma në vitin 1986, fotografi e vitit 2017



Nr i Het. 569/85

RAPORTI – IZVEŠTAJ

MBI SHIQIMIN TEKNIKO KRIMINALISTIK TË VENDIT TË NGJARJES
O KRIMINALISTIČKO-TEHNIČKOM PREGLEDU LICA MESTA

1. Llaji i veprës penale ose ngjarjes / Vrsta krivičnog dela ili dogadjaja: Vepristeri armiqësore

2. Data e kryerjes së vendshiqimit / Datum vršenja uvidjaja: Me fillim pune me 2.04.1985 rreth orës 23.45 min kurse kemi mbaruar me 3.04. rreth orës 02.

3. Data, koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale / Datum, čas i mesto izvršenja krivičnog dela: 2.04.1985 viti në rrugën e asfaltuar Lushi-Gllobogicë në mes të punëtorisë së sharrës dhe pilares te Lushi-Doganaj

4. Në vendshiqim muarën pjesë / Uvidjaju prisustvovali: Milicionerët: Lubisha Boshkoviq? Ibush Berjani? Nemsi Aliu

5. Të dëmtuarit dhe adresat e tyre / Oštećeni sa njihovim adresama: Sistemi socialist Vetëqeverisës i RSFJ.

6. Mënyra e kryerjes së veprës penale / Način izvršenja krivičnog dela: Në rrugën Lushi-Gllobogicë në mes të pilares dhe punëtorisë së sharrës në kthesë nga personat e pa njohur shkruan parulla armiqësore me. Parullat u shkruan në anën e majt të rrugës shiquar në drejtim të të Doganajve. Parullat kishin këtë përmbajtjë? KOSOVA REPUBLIK? LIRONI SHOKËT, POSHTË [illegible].

Parullat kanë qenë të shkruara me ngjyrë të kaltërt të qelët dhe ajo e yndyrës. Të gjitha shkronjat kanë qenë të shtypit me dimention 0.60 cm kurse parulla ka qenë e gjatë 14 m.

Këjo veprimtari armiqësore së pari u vërejt nga punëtorët e pyltarisë të cilët kanë qenë duke u kthyer nga pylli.

7. Punët kriminalistiko teknike (mënyra e fiksimit të vendit të ngjarjes) dhe cilat mjete teknike kriminalistike janë përdorë / Kriminalističko-tehnička radnja (način fiksiranja lica mesta) i koja sredstva kriminalistička tehnike su upotrebljena:

Vendi i ngjarjes u fotografua dhe pas asaj u skicua

Faksimil nga raporti policor rreth shkrimit të parullave në vendin e quajtur ,,Te Lushi" më 2.4.1985

Sekretar organizativ i Komitetit të Rrethit për Kaçanik

ishte Remzi Elezi me pseudonimin ,,Ramizi" i cili ishte i ndërlidhur me veprimtarët në Ferizaj, përkatësisht me Agron Morinën. Sekretar për propagandë e agjitacion ishte Gafur Luma me pseudonimin ,,Avdiu", arkëtar ishte Remzi Krraba me pseudonimin ,,Dema", ndërsa anëtar ishte Bajram Dernjani me pseudonimin ,,Bujari". Të përmendurit e mësipërm ishin koka e udhëheqjes, por edhe arristemet e para u bënë pikërisht mbi këto veprimtarë.

Se si u zhvilluan hetimet, çfarë dhune përdori UDB-a ndaj tyre dhe çfarë informata të dhunëshme nxjerrte UDB-a nga këta të arrestuar dhe të arrestuarit e tjerë, shpalosim pjesërisht disa nga process-verbalet e UDB-së së Kaçanikut në krye të të cilëve ishin: Afet Rexhallari, Halit Loku e Qenan Hajdini duke mos përjashtuar edhe udbash të tjerë si nga Ferizaj, Prishtina e Gjilani.

Gafur Lumës që në fillim, me nene e aline jugosllave i ndalohet që të ketë mbrojtësin e vet dhe në dokumentin hetimor Hep.nr. 293/85 thuhet se ,, Në bazë të nenit 168, paragrafi 5 lidhur me nenin 73 paragrafi 2, të pandehurit Avdilgafur Luma, i mohohet e drejta që të ketë mbrojtës gjatë veprimit hetimor". Pra që në fillim, UDB-a nuk dëshiron që të ketë dëshmitarë në procesin hetimor që do të zhvillohet në kthinat e saj e që nënkupton se të gjitha informatat që do të merren nga i arrestuari janë informata të nxjerrura nga dhuna dhe këtë e vërtetojnë të gjitha ata të burgosur që kanë pasur ,,fatin" të jenë në trajtim të UDB-së.

Me 12 nëntor 1985, tetë ditë pas arrestimit të krerëve të Komitetit Organizativ, u arrestua edhe Gafur Luma dhe për të kuptuar se si u zhvilluan hetimet ndaj këtyre veprimtarëve, si ishin përcjellë ata, dhuna që u zbatua

mbi këto të arrestuar, më së miri e mësojmë nga disa procesverbale hetimore, por së pari i referohemi procesverbalit të UDB-së të datës 13.11.1985, një ditë pas arrestimit të Gafur Lumës:

,, Aktiviteti im fillon diku në janar të vitit 1984, pas takimit me Bexhet Luzhën të cilin e kam takuar në Kaçanik dhe pastaj pas bisedës me atë, jemi takuar edhe herën e dytë ku nga Bexhet Luzha kam marrë detyrë që të bëj shpërndarjen e pamfleteve në Prishtinë.''

Gafur Luma që në momentet e para të hetuesisë, me mjeshtri e fsheh veprimtarinë e tij të hershme ilegale, sëpaku për katër vite me radhë, pasiqë tanimë dihet nga burime të shumta se Gafurr Luma aktivitetin atdhetar e fillon në vjeshtën e vitit 1979 me veprimtarin Ferid Qallakun.

Lidhjet me Bexhet Luzhën i pranon pasiqë Gafuri e dinte se Bexhet Luzha ka ikur nga Kosova në vitin 1984 dhe këtu bëhet edhe prerja e lidhjeve ilegale, por në anën tjetër e ka ditur edhe faktin tjetër se UDB ka pasur disa informata të dyshimta rreth aktivitetit të tij që kur u arrestua Avdyl Bajrami i Vitisë.

,,*Pasiqë në ndërkohë Behxhet Luzhën e kanë përcjellë organet e sigurimit... ky aksion nuk është kryer, ashtuqë prej asaj kohe e kam ndërprerë një aktivitet të tillë,* deklaron Gafur Luma para udbashëve gjakatar.

Veprimtarinë time e kam vazhduar përsëri në fund të vitit 1984, apo fillim të vitit 1985 kur jam takuar me Remzi Elezin me pseudonimin ,,Ramizi'' dhe pas dy takimeve me atë ne kemi vendosur që të aktivizohemi dhe të kontribojmë në drejtim të kërkesës Kosova –Republikë. Pastaj Remziu më ka treguar se si e ka gjetur një lidhje dhe se mund të oraganizohemi, por si detyrë duhet ta

kemi zgjerimin e radhëve të kësaj Lëvizjeje, ashtuqë unë ndërkohë jam angazhuar dhe kam gjetur dy shokë: Zenun Muriqin[56] nga Rugova dhe Bajram Dernjanin nga Hani i Elezit. Për këtë i kam treguar Remzi Elezit dhe ai më ka sjellur një fletë në të cilën ka qenë i shtypur teksti dhe kam dhënë betimin. Njëkohësisht kemi vendosur edhe për anëtarësi të cilën unë ia kam paguar Remziut dhe njëkohësisht kam marrë pseudonimin ,,Avdiu''. Gjatë takimeve me Remzi Elezin dhe me këta dy shokët e tjerë bisedat janë zhvilluar në drejtim që të lexojmë materialet-librat të cilat janë të lejuara ..., ndërsa si detyrë e kemi caktuar që mos të lexojmë materiale i cili nuk është i lejuar''

Nga kjo pjesë e deklaratës para UDB-së e cila zakonisht jepej nën dhunë të shfrenuar, shifet se Gafuri jep informacione të pakta, të dozuara, vetëm ato informata që UDB-a afërsisht i kishte në njohuri, por mohon se ka lexuar materiale ilegale. Pranon se e ka pseudonimin ,,Avdiu" sepse në atë kohë flitej nga shokët e arrestuar se rreth 114 pseudonime janë kapur nga UDB-a, kështuqë pranimi i pseudonimit ishte i domosdoshëm. Por në tortura të mëtejme të zbërthimit të cilat zgjatnin me orë të tëra, në procesverbalin e të njëjtës ditë, Gafur Luma deklaron:

Remzi Elezi më ka sjellur edhe Projekt-programin të cilin unë e kam lexuar dhe jam pajtuar me atë. Ndërkohë në fillim të muajit qershor të vitit 1985 kam shkuar në Zvicërr me qëllim që të punoj, ashtuqë në Zvicërr kam qëndruar deri në fund të korrikut apo muajit gusht dhe gjatë qëndrimit tim në Zvicërr nuk jam marrë me kurfarë

[56] Remzi Elezi deklaron se Zenun Muriqi në pjesën e parë të pranverës iu ka përcjellë si anëtar Komitetit të Rrethit të Pejës.

aktiviteti. Pasi jam kthyer nga Zvicrra jam takuar me Zenun Muriqin dhe Bajram Dernjanin dhe në këtë rast Zenuni e ka shprehur dëshirën që ai të punoj në rrethin e Pejës, pasiqë është nga ajo anë dhe për këtë unë i tregova Remziut. Pastaj Remziu tha se do të bisedoj me shokët të vet në këtë drejtim dhe do t`më tregoj, ashtuqë një ditë ka ardhur dhe më ka treguar një pseudonim i cili tani nuk po më kujtohet dhe se Zenuni me këtë person duhet të takohet në vendin e caktuar në Prishtinë dhe ashtu është vepruar, por unë nuk kam qenë në Prishtinë, kur këta dy janë takuar sepse mënyra e organizimit nuk lejonte që unë të takohem me atë person. Pasiqë Zenuni u largua nga grupi im, aktivitetin e kemi vazhduar unë, Remzi Elezi dhe Bajram Dernjani. Sipas fjalëve të Remzi Elezit, ne është dashur të organizohemi në formë të Komitetit të Rrethit për Kaçanik, por megjithatë gjeri në formim nuk ka ardhur. Gjithashtu deklaroj se me Remzi Elezin jam njohur në rastin kur Bexhet Luzha e ka caktuar takimin lidhur me pamfletet që është dashur t`i sjellë, dhe në atë takim e kam parë se Remzi Elezi është ideologjikisht i orientuar si unë. Tjetër nuk kam çka të deklaroj, thotë Gafur Luma në procesverbalin e UDB-së 13.11.1985.

Nga gjithë shokët që deri më tani kanë dhënë prononcimet e tyre, në formë kujtimi për veprimtarinë e dëshmorit, shihet qartë se Gafur Luma me mjeshtri ka fshehur para UDB-së veprimtarinë e saktë që lë të kuptohet se ai ka qenë shumë i përgatitur për rrethana ku siç thotë heroi i Kosovës Rexhep Mala ,, ku nga torturat e UDB-së, buka bëhej miell". Në vetë pasuesin e fundit, kur flet për njohjen me Remzi Elezin, ai nuk zbulon njohjen dhe veprimtarinë e hershme me Remziun, ai e ,,rrudhë" informacionin deri në mundësinë që është

e mundur, ndërsa në anën tjetër nuk e tregon aktivitetin politik që ka pasur në Zvicërr me veprimtarin Abaz N.(Ali Ahmetin sqarimi im).
Gafur Luma nuk zbulon as themelimin e Komitetit të Rrethit që u formua në Sllatinë të Lepencit ku morën pjesë Remzi Elezi, Gafur Luma, Bajram Dernjani e Remzi Krraba dhe njëkohësisht nuk zbuloi as rrjetën e shokëve të tjerë ilegal.
Për të zbardhur për sa është e mundur të zbardhet veprimtaria ilegale e dëshmorit Gafur Luma, nga dokumentacioni arkivor i UDB-së, ofrojmë dëshmi të tjera të shokëve të arrestuar, në veçanti të Gafur Lumës, Remzi Elezit, Bajram Dernjanit e Remzi Krraba si një bërthamë substanciale e Komitetit të Rrethit për Kaçanik.
Atyre ditëve të nëntorit 1985, nën pranga ishte edhe drejtuesi i Komitetit të Rrethit për Kaçanik, Remzi Elezi nga Sllatina e Lepencit dhe në procesverbalin e UDB-së të datës 19.11.1985, Remziu, deklaron:
Sa i përketë aktivitetit tim mund të them vetëm se në vitin 1984 në banesën e Avdyl Bajramit në Prishtinë ku bashkë me Gafur Lumën kam biseduar me Bexhet Luzhën që ne të tre të bëjmë shpërndarjen e komunikatës në Prishtinë, por deri te shpërndarja nuk ka ardhur, pasi që komunikatën nuk e kemi marrë prej Bexhet Luzhës. Agron Morinën e njoh vetëm si kamarier në çajtore në Ferizaj, ndërsa me atë kurrë nuk kam biseduar në drejtim të veprimtarisë armiqësore dhe për asgjë tjetër, ndërsa me Skënder Luzhën jam njoftuar në Karate-Klub dhe aty kemi patur kontake, por jo për ndonjë veprimtari. Unë jam student me korespondencë dhe nuk kam punuar me asnjë grup dhe as që di lidhur me atë diçka. Sa i përket

deklaratës të cilën e kam dhënë, deklaroj se të njëtën e kam dhënë nën dhunë dhe asgjë s`ka prej asaj deklarate të vërtetë. Tjetër nuk kam çka deklaroj, thot Remzi Elezi para gjykatësit hetues Haki Lecaj.

Duke pasur parasysh se tanimë në burg ndodheshin shumë anëtarë nga Komitetet e Rretheve, madje edhe vetë organizatorët e Komitetit Organizativ, Remzi Elezi, ashtu si Gafur Luma veprimtarinë e tij ilegale e redukton që nga vitit 1984, duke mbetur e pazbuluar veprimtaria e hershme ilegale që në celulën e Berat Luzhës, njëkohësisht duke mohuar para gjykatësit hetues deklartën e dhënë nën dhunë.

Po me datën 19.11.1985 kemi edhe deklaratën e anëtarit tjetër të Komitetit të Rrethit për Kaçanik, juristit Bajram Dernjanit i arrestuar më 16.11.1985, ku ai deklaron se:

,,*Sa i përketë veprimtarisë armiqësore nuk di asgjë, por mund të them vetëm se diku në muajin qershor të vitit 1985 kam ardhur në kontakt me Gafur Lumën në fshatin tim dhe kemi filluar të bisedojmë rreth ngjarjeve në Kosovë dhe kërkesës që Kosovës t`i njihet statusi i Republikës dhe gjatë bisedës Gafuri më ka treguar se ekziston Lëvizja për Republikën e Shqiptarëve në Jugosllavi dhe nëse unë dua të kontriboj në këtë drejtim duhet të lexoj materiale-libra ... ashtuqë takimi i parë me Gafurin ka përfunduar me kaq, sepse ai ndërkohë ka shkuar në Zvicërr. Pastaj një kohe të gjatë nuk jam takuar me Gafurin, por kur është kthyer nga Zvicrra jemi takuar edhe një herë dhe ai më tha që unë duhet të lexoj sa më shumë me qëllim të ngritjes ideore. Tjetër aktivitet apo bisedë me Gafurin nuk kemi patur, ndërkohë jam burgosur.*

Deklaroj se me Gafurin nuk kemi biseduar rreth organizimit apo aktivitetit tjetër, sepse siç deklarova edhe

më parë, unë nuk kisha ndërmend të organizohem, nuk kam lexuar material propagandistik, nuk kam dhënë betim dhe nuk kam paguar anëtarësi. Shtoj edhe një herë se përveç se e kam përkrahur kërkesën për Republikë si të drejtë, aktivitet tjetër nuk kam patur, ndërsa takimin e parë me Gafurr Lumën e kam patur në Prishtinë te Menza e Studentëve, tjetër nuk kam çka të deklaroj.''

Ashtu si Gafuri e Remziu, edhe Bajram Dernjani, si një shtyllë tjetër me rëndësi e Komitetit të Rrethit, nuk jep të dhëna konkrete, i përgjithëson gjërat dhe e fsheh veprimtarinë ilegale që e kishte që nga viti 1981, leximin e materialeve ilegale, rrjetin e shokëve ilegal, konstituimin e Komitetit të Rrethit ku vet ishte pjesëmarrës, pjesë-marrjen në demonstrata të 11 marsit 1982 e të ngjajshme.

Torturat e përditshme që UDB-a bënte mbi veprimtarët e burgosur, arrestimi i bërthamave drejtuese të Komiteteve dhe argumentet e tjera që UDB-a tanimë i kishte, bënë që edhe ,,lëmshi" organizativ të zgjidhet, ashtu siç do të shohim edhe më poshtë në poceverbalet e UDB-së gjakatare.

Nga procesverabali tjetër i UDB-së i përpiluar me datën 10.12.1985, Gafur Luma , deklaron se:

Me veprimtarinë time kam filluar të merrem nga viti 1984. Në indoktrinimin tim kanë ndikuar demonstratat e vitit 1981, kam përcjellur edhe Radio Tiranën. Bisedat me Bexhet Luzhën kanë pasur të bëjnë me situatën që zhvillohej. Pas këtyre bisedave , ai më caktoi një takim ilegal në Prishtinë. Gjatë një takimi ilegal, kah dhjetori i vitit 1983 në banesën e Avdyl Bajramit, kemi marrë pjesë këta persona: Unë Gafur Luma, Remzi Elezi, Bexhet Luzha dhe Avdyl Bajrami. Gjatë këtij takimi, Bexheti na ka folur

për ekzistimin e organizatës PKMLSHJ. Ai fliste për këtë Parti duke i dhënë karakteristikat themelore të saj. Pastaj na tregoi për ekzistimin e një organizate tjetër ,,Grupi marksist-leninist i Kosovës'' si dhe organizatën ,,Fronti i Kuq''. Pos tjerash Bexheti thoshte se organizata më aktive është GMLK-ja e cila ka kuadër mjaftë të aftë. Takimi i fundit me Bexhet Luzhën ishte në mbrëmjen e datës 23 janar të vitit 1984 para banesës së Avdyl Bajramit në Prishtinë dhe kemi caktuar datën 24 janar për shpëndarjen e pamfletit i cili i kushtohej vrasjes së Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës. Mua mu caktua lagjja Ulpiana, Remzi Elezi në Dragodan, Avdyl Bajrami në Taukbahqe, kurse Bexheti në një lagje tjetër... Të nesërmen Bexhet Luzha ka sjellur rreth 500 pamfleta, ndërsa ky aksion nuk është kryer sepse lindi dyshimi i përcjelljes nga ana e UDB-së.

Pas tri – katër dite jam takuar sërish me Bexhetin në Prishtinë dhe ai më njoftoi se Avdyl Bajrami është arrestuar. Pas arrestimit të Avdyl Bajramit dhe arratisjes së Bexhet Luzhës, veprimtarinë e kam vazhduar me Remzi Elezin. Takimin e kam pasur kah muaji gusht i vitit 1984, pasi Remziu doli nga burgu (60 ditësh). Pas shumë konsultimesh, në një takim tjetër Remzi Elezi më solli Projektprogramin, Projektstatutin, Rregullat e konspiracionit, të cilat i kam lexuar jashtë konviktit në natyrë.

Në një procesverbal i UDB-së i datës 12.12. 1985, Remzi Elezi deklaron se:

Veprimtaria ime nga platforma e organizatës ilegale ka qenë e caktuar nga udhëheqësia më e lartë e organizatës, dmth, nga vet Komiteti i Rrethit të Ferizajt dhe detyrat e mia i kam marrë nga Agron Morina të cilin e kam njohur

me pseudonimin ,,Sokoli". Pas shumë takimeve në Ferizaj e Prishtinë, mua më është caktuar detyra e sekretarit organizativ për Kaçanik... Përmes Agronit jam njoftuar me një person me emrin ,,Tefiku" emrin e të cilit nuk e di....Betimin e kam dhënë para Agron Morinës, afër fabrikës së tjegullave në Ferizaj. Detyrat që i kam marrë nga ,,Tefiku'' janë këto: Rreth çështjes së organizimit, përfshirja e anëtarëve të rinjë, ngritja ideore e anëtarëve dhe nga ,,Tefiku'' emrin e të cilit nuk e njoh, por që është lidhje e Agronit, kam marrë materiale; Projektprogramin, Projekt-statutin, dy ekzemplarë të Zërit të Kosovës si dhe një fletushkë me emrin ,,Pararoja''.

Thamë më lartë se zbulimet që u bënë më 4 nëntor 1985 të Komitetit Organizativ dhe pjesa dërmuese e Komiteteve të Rretheve, dhe torturat që bëheshin mbi të arrestuarit, ndikuan që ,,lëmshi" i zbulimit të anëtarëve të tjerë të zhvillohet më me shpejtësi.

Në një proceverbal tjetër të datës 10.2.1986, Gafurr Lumës i zbulohet edhe veprimtaria në Zvicër me Ali Ahmetin i njohur me emrin ilegal Abaz Gjuka.

,,*Unë në Zvicër kam shkuar kah mesi i qershorit 1985 më saktësisht në kantonin e Lucernit. Një ditë duke blerë artikuj ushqimorë në vetshërbim mu ka ofruar një person me emrin Abaz nga Kërçova. Gjatë bisdës me Abazin, vlerësoi se edhe unë isha i orientuar në drejtim për të cilin ai më foli më parë, edhe pse unë nuk e njoftova se jam i angazhuar në veprimtari ilegale. Ai më caktoi një takim tjetër. Në takimin e dytë, Abazi më solli librin ,,Titistët'' dhe tre ekzemplarë të revistës ,,Zëri i Kosovës''. Para se të kthehem për Kosovë, kam pasur edhe një takim tjetër me Abazin nga Kërçova...''*

Gafur Luma i përballur me hetuesi të rëndë, ku ne

ilustruam vetëm disa pjesë nga hetimet e pandërprera katër mujore, në deklaratën e tij të datës 27.2.1986, dhënë në burgun e Prizrenit, ai thotë:

Si kam deklaruar në proçesverbalet e mëparshme në procedurën hetimore, jam munduar që në mënyrë të sinçertë ta sqaroj veprimtarinë time dhe të shokëve të mi, në kuadër të organizatës nga fillimi e deri në ditën e arrestimit. Në këtë drejtim nuk kam lënë asgjë të pa sqaruar gjatë procedurës hetimore.

Sa i përketë platformës të organizatës ilegale të ,,MLK''-së unë mendoj se është platformë e drejtë dhe nuk pendohem për të gjitha veprimet që kam ndërmarrë në kuadër të organizatës''



2- Avdilgafur Luma

Si që kam deklaruar në proçesverbalet e mëparshme në procedurën hetimore, jam munduar që në mënyrë të sinqert ta skjaroi vepritarinë time armiqësore dhe të shokëve të mij, në kuadër të organizatës ilegale të "MLK" prej fillimit të inkuadrimit tim në këtë vepritari gjatë në ditën e arrestimit. Në këtë drejtim nuk kam lënë asgjë të pa sjaruar.,Gjatë procedurës hetimore.

Sa ipërket platformës të organizatës ilegale të "MLK" unë mendoi se Është platformë e drejt , kërkesat e saja , qëllimet dhe platforma e saj dhe për ate nuk pendohemp për të gjitha veprimet që kam ndërmarr në kuadër të organizatës ilegale të "MLK".

Marrja në pyetje përfundoi në ora 15,oo Prizren.

Proçesverbali më Është diktuar me zë, përmbajtjen e tij e kam kuptuar në tërsi dhe të njejtin e pranoj si timin dhe e nënshkruar pa krrfar vërtetje.

I pandehuri
Avdilgafur Luma
Avdilgafur Luma

V ë r t e t o j m ë :

Personi i autorizuar zyrtar i SBSH
Afek Berhallari

Proçesmbajtësi
Halit Loku

Faksimil nga procesverbali i UDB-së i datës 27.2.1986

Megjithatë Gafur Luma, gjatë hetimeve të rënda për katër muaj me radhë, para hetuesve të UDB-së nuk u zbërthye. Ai pas vetes la shumë shokë të organizuar dhe i doli nga goja vetëm ajo pjesë që ishte e domosdoshme të dilte. Në vlerësimin kritik të aktivitetit të tij, konstatojmë se për t`i shpëtuar shokët që ishin brenda në Kosovë dhe që mund të kërcnoheshin nga arrestimi, ai përqëndrohet në shokët që ishin në perëndim si Abaz Gjuka (Ali Ahmeti) e Behxhet Luzha, pasiqë ata nuk kishin

mundësi arrestimi.
Si do që të jetë, me këto arrestime që ndodhën, Komiteti i Rrethit për Kaçanik u dëmtua mjaftë, por nga secila shtyllë e këtij Komiteti mbetën anëtarë të pazbuluar. Çdo arrestim që bëhej, armiqësia ndaj pushtuesit shtohej, tanimë pushtuesin nuk e urrenin vetëm të burgosurit, por edhe familjet e tyre dhe farefisi i gjërë. Jo më kot, të burgosurit e përdornim shprehjen ,,Burgjet plotë-Liria në derë". Edhe pse hetimet përfundonin dhe shqiptohej dënimi nga gjykata, i burgosuri hetohej në vazhdimësi nga personeli i burgut dhe shpeshherë merrej në pyetje për të verifikuar ,,risocializimin" e tij. Kështu veprohej edhe me Gafur Lumën.
Në një rast më saktësisht me datën 13.10.1987, para personelit të burgut deklaron:
,,...*Po kam qenë i mendimit se Kosovës duhet t`i njihet statusi i Republikës dhe këtë e kam shprehur lirisht në bisedë me ndonjë moshatar timin, por s`e kam konsideruar mëkat të madhë, jam bir i një fshatari të varfër që plotë 35 vjet të jetës së tij i ka kaluar në horizontet e nëntokës duke shembur mineralet me muskujt e tij dhe nga djersa e tij kam kryer tri vite të fakultetit elktroteknik, andaj nuk e urrej klasën punëtore, nuk i urrej as popujt e tjerë, as gjuhën, as kulturën as traditën e tyre, andaj edhe nuk pajtohem me kualifikimin e veprës sime si nacionaliste, irredentiste e seperatiste...*"
Ndërsa në ankesën e tij të datës 21 prill 1986, shkruar në burgun e Prizrenit, pas marrjes së aktakuzës, Gafur Luma thotë:
,,*Aktakuza më ngarkon se kam pasur funksionin e sekretarit për propagandë e agjitacion në kuadër të Komitetit të Rrethit për Kaçanik, ndërsa në anën tjetër as*

që ka qenë i formuar ky Komitet''[57]
Ndërsa avokati i tij i autorizuar nga gjykata, *kërkon që dënimi t`i zbutet dhe vepra t`i kualifikohet nga neni 133.*

[57] Duke e ditur se gjatë hetimeve, konstituimi i Komitetit nuk u zbulua, Gafur Luma, mohon rolin e tij brenda këtij Komiteti

I burgosuri Hyzer Haxhiu nga Ferizaj, tani i ndjerë, i dënuar me 4 vite burg, me të cilin Gafur Luma qëndroi në burgun e Gjilanit gjatë muajve janar e shkurt të vitit 1986

Gafur Luma ishte njëri nga 23 shokët e arrestuar dhe secili anëtar i këtij Komiteti ka përjetuar një odisejadë vuajtjesh, por siç thotë kreu i OMLK-së Mehmet Hajrizi,, ishin tri forca që e mbanin të qëndrueshëm në burg veprimtarin e çështjes kombëtare: njëra quhej ideal, e dyta ideal dhe e treta ideal dhe se vetëm ideali i lartë i jep kuptim trimërisë, qëndresës dhe vendosmërisë së luftëtarit të lirisë"[58]

Se si zhvilloheshin këto ideale brenda Komitetit të Rrethit për Kaçanik, do ta ilustrojmë me veprimtarinë e anëtarëve më të rinj për nga mosha, me grupin e Ismajl Malsiut tek i cili u gjet edhe një fletore me shënime.

Fletorja është e formatit A4 dhe ka të shkruara 16 faqe.

Faqja e parë mban titullin **Programi i punës** ku ndër të tjera shkruante:

Lufta ilegale është formë kryesore e veprimtarisë sonë. Qëllimet e celulës dhe konditat në të cilën vepron ajo prezupozojnë domosdoshmërinë e organizimit dhe veprimtarisë në ilegalitet të thellë... në kushtet tona. Dmth në kushtet e një tërbimi të egër të të gjitha mjeteve të agjenturave policore, kuptimi i drejtë nga çdo njëri prej nesh i metodave të punës thellësisht ilegale, profesionalizimi i pandërprerë dhe zbatimi i tyre i drejtë, përbën një detyrë të madhe dhe të vazhdueshme të celulës...

,,Udhëheqësit e mëdhenjë na kanë mësuar se krahas luftës ilegale, duhet të organizoj-më edhe luftën legale, por lufta ilegale është garanca më e madhe për sigurimin e

[58] Agim Sylejmani ,,Në rrugë drejt lirisë''Prishtinë 2016, fq. 70

fitores''
Qëllimi i armikut është të asgjësoj veprimtarinë tonë revolucionare... dhe pushtimin e kalasë sonë nga brenda.
Në anën tjetër, radhët tona po përgatiten dhe forcohen çdo ditë nga ana ideologjike, politike dhe organizative...dhe një nga armët e mbrojtjes sonë kemi konspiracionin. Po zbatuam drejtë rregullat e konspiracionit, po vepruam në ilegalitet të thellë, armiku nuk do të mund të na zbuloj kurrë...
Një problem tjetër është edhe respektimi i kritereve të futjes së shokëve të rinj në radhët tona si dhe vigjilenca e lartë revolucionare. Mos ta harrojmë mësimin, shokëve besim t`u japim, por edhe vigjilencë të kemi ndaj tyre. Përpara kësaj vigjilence dhe uniteti ideologjik dhe organizativ, do të dështojnë të gjitha përpjekjet e armikut... u shkruan shokëve të tij të celulës Ismajl Malsiu i lindur në vitin 1966 nga fshati Rekë të Kaçanikut, i cili në këtë kohë kishte vetëm 19 vjet.
Po kush ishin shokët e celulës të mbushur me ideale për Kosovën – Republikë?
Muhamet Qorri ishte i lindur në vitin 1966 dhe kishte të kryer vetëm shkollën fillore, por që kishte një emër karakteristik ilegal ,,Gjin Bua Shpata". Karakteristikë tjetër e këtij veprimtari ishte se në aksione ilegale shkonte me armë. Shoku tjetër ishte Emrush Tafili nga Kaçaniku i lindur në vitin 1964 dhe kishte të kryer shkollën e mesme dhe në kuadër të celulës mbante pseudonimin ,,Shpendi". Anëtari tjetër ishte i mituri Kadri Raka nga Kaçaniku i lindur në vitin 1967 dhe kishte të kryer shkollën e mesme, në kuadër të celulës barte pseudonimin ,,Kushtrimi", i të njëjtës moshë ishte edhe i mituri Mefail Vishi me pseudonimin ,,Meti" ndërsa

udhëheqësi i tyre ishte studenti Ismajl Malsiu me pseudonimin ,,Shkëmbi".
Në vazhdim sërish sjellim fragmente nga Fletorja e Ismajl Malsiut e cila gjatë arrestimit të tij ra në duartë e UDB-së:

Ngritja teorike dhe edukimi ideo - teorik

Kushti i parë dhe i domosdoshëm i fitores sonë është zbatimi i drejt i teorisë marksiste-leniniste në kushte tona konkrete. Pa këtë armë, pa këtë busullë, ne do të pësonim disfatë të sigurtë .

Që të zbatohet drejt kjo teori ajo duhet të studiohet thellë në mënyrë revolucionare. Që të bëhet kjo, duhet bërë punë të madhe, punë e gjatë. Disa shokë akoma nuk e kanë kuptuar se sa është kaq e rëndësishme kjo punë...

Duhet punuar shumë që të kemi aftësi për të edukuar drejt masën dhe të luftojmë në çdo fushë armikun. Duhet gjithashtu punë e madhe për të njohur ligjet e revulucionit, strategjinë dhe taktikën e tij. Kjo nuk arrihet me mbledhje që bëjmë as me leximin e një apo dy librave, po me një punë të palodhshme...

Të mobilizohemi të gjithë për kryerjen në përpikmëri të detyrave në ngritje teorike dhe edukim ideo-politik, të studiojmë thellë dokumentet e klasikëve dhe dokumentet e PPSH-së... Të përcjellim me kujdes ngjarjet e punëtorëve ne botë dhe t'i komentojme drejt ato. Të ndjekim emisionet e Radio Tiranës dhe ato më kryesoret, t'ua shpërndajmë shokëve. Të shtojmë vrullin revolucionar në punën tonë revolucionare.

Kritika dhe autokritika, armë të fuqishme në duar tona

Kritika dhe autokritika janë mjete të fuqishme të shokëve tanë. Ato i pastrojnë dhe i forcojnë shokët,

shtojnë aftësinë e tyre luftarake. Kritika dhe autokritika në punën tonë rrjedhin nga demokracia e brendshme e shokëve tanë. Është jo vetëm e drejt, por edhe detyrë e çdo njërit prej nesh të kritikojë dobësitë, të metat dhe gabimet. Kudo në radhët tona, duhet t`i krijohen kushte që secili të kritikojë lirisht dhe pa ndrojtje... Lufta jonë kundër të metave dhe gabimeve, qofshin ato të mëdha apo të vogla , duhet të jetë një detyrë e jona e përditshme ...,,Për mbarvajten e partisë, ka thënë shoku Enver, ka rëndësi të madhe kritika e drejt, parimore dhe e sinqert''...

Për një disiplinë të hekurtë në rradhët tona

Diciplinën tonë e kemi përcaktuar dhe duhet ta forcojmë vazhdimisht në kushtet tona konkrete. Disiplina jonë nuk ka asgjë të përbashkët me diciplinën mekanike. Ajo është e rrept dhe e çeliktë. Çdo lëshim në këtë drejtim, dobëson unitetin dhe u hap rrugë shfaqjeve të huaja dhe të dëmshme për ne. Pa disiplinë të rrept, s'ka zbatim të drejt të vendimeve ...Disiplina nga karakteri i sajë mund të jetë e imponuar dhe e ndërgjegjshme ...

Mbledhjet

Për të bërë nje punë sistematike revolucionare, për të shqyrtuar bashkëri-shtë probleme, që dalin në veprimtarinë tonë dhe për të përcaktuar detyrat është e nevojshme të mbahen mbledhje të rregullta. Duke pasur parasysh se mbledhjet e kanë efektin për edukimin e shokëve tanë, atyre duhet kushtuar rëndësi të madhe. Mbledhjet duhet mbajtur rregullisht, të organizohen mirë puna e tyre dhe të bëhen përgatitje nga çdo shok dhe mbledhje duhet të kenë një rend pune. Në mbledhje duhet të analizuar situata në vend dhe në botë dhe të nxjerrmi konkluzione të drejta politike.

Secili duhet të raportojë për punën e tij, duke analizuar këto punë, njxerrim të metat dhe gabimet që pastaj të përmisohen ato. Për çdo mbledhje duhet të përgatisim punime me shkrim dhe të gjithë shokët të diskutojnë për ato ... Nuk duhet lejuar as shfaqjen më të vogël të indiferentizmit te asnjë shok për problemet që shqyrton mbledhja. Mbledhja duhet të jetë çështje e të gjithë shokëve ... Diskutimet duhet të jenë të gjalla, luftarake dhe joformale e pa shpirtë revolucionar ...

Disa udhëzime per konspiracion

Pa një ilegalitet dhe konspiracion të thellë nuk mund të zhvillojmë me sukses veprimtarinë revolucionare. Që të zhvillojmë një veprimtari të thellë ilegale... po japim disa hollësi :

Për celulën tonë nuk duhet të dijë askush jasht nesh .

Shokët, materialet librat dhe sekretet nuk duhet t`i dijë askush jashtë nesh. Shokët e celulës dhe lidhjet nuk duhet treguar askujt. Anëtarët e celulës nuk duhet të banojnë, të shoqërohen ose të shëtisin së bashku dhe nuk duhet ta përshëndesim njërin tjetrin në rrugë apo në vendet tona publike .

Shokët tanë nuk duhet të dallohen në veshje, emblema, fotografi etj. Libra dhe materiale tjera konspirative nuk duhet mbajtur në shtëpi. Secili duhet të ketë vend të sigurt për fshehjen e tyre, të cilat duhen të dihen vetëm prej shokëve të celulës. Në libra të mos bëhen nënvizime, të mos shënohet asgjë e të mos lihen gjurmët e gishtërinjëve. Bartja e materialeve, teknikës dhe librave duhet të bëhet me kujdes të madh. Meterialet tona në asnjë mënyrë nuk duhet të binë në duart e armikut. Çdo militant duhet të jetë propagandist dhe agjitator i zellshëm, por duhet kujdesur që gjatë kësaj pune të mos

thyhet konspiracioni. Shpërndarja e librave të ndaluara të bëhet më kujdes. Lidhja me shokët të bëhet në fshetësi të madhe. Përdorimi i pseudonimeve, shenjave dhe alfabeteve është nevojë e domosdoshme. Letrat e dërguara me postë mundë të lexohen, ndërsa biseda telefonike të përgjohen. Që të mos vihet deri te shkëputja, lidhjet duhet caktuar qartë dhe në kohë. Kujdes shumë i madh duhet treguar gjatë zgjerimit të radhëve. Të mos lejojmë kursesi që në radhët tona të futen gjithfarë shokësh. Me vigjilencën tonë revolucionare do ta bëjmë të pamundur depërtimin e agjentëve në radhet tona. Çdo shokë duhet të sigurojë strehimoren e tij për kalim në ilegalitet ...

Respektimi rigoroz i rregullave të konspiracionit zvogëlon shumë rrezikun e arrestimit … Gjatë arrestimit duhet të qëndrojmë si revolucionar: krenar, ballëlartë, pa frikë dhe shqetësimin më të vogël. Por, duhet të kemi kujdes të mos humbim kontrollin dhe të mos bëjmë veprime të nxituara ... Tri herë mendo, një herë fol!

Këtu janë përmbledhur vetëm disa nga rregullat që kërkon aktiviteti revolucionar në kushtet e sotme, shkruan Ismajl Malsiu në fletoren e tijë 16 faqëshe të titulluar *Programi i punës* dhe si dëshmi e një pjese të historisë, Fletorja gjendet në Arkivin e Republikës së Kosovës.

Aktivitete të ngjajshme kishin edhe shokët e tjerë që u dënuan në Komitetin e Rrethit të Kaçanikut dhe nëpër kthinat e UDB-së gjakatare u dëmtua rëndë shëndeti i tyre. Vlen të theksohet Heroi i Kosovës Metush Krasniqi i cili 4 muaj pas lirimit, vdes si pasojë e torturave.[59]

[59] Metush Krasniqi është i lindur në vitin 1928, në fshatin Dajkoc të Dardanës, ndërsa vdes më 15 tetor 1986 në Prishtinë. Në vitin 1957 dënohet me 18 vite burg,

Madhështore ishte mbrojtja e prof. Ramadan Hazirit para gjyqit antipopullor dhe me argumentet e tija politike, mbështeti për muri trupin gjykues. Kështu ishte edhe inxhinjeri Sylejman Bytyçi, Nexhat Xhokli, Muzafer Lika, Ruzhdi Shkodra, Hyzer Haxhiu e Jahir Haliti.

Pas daljes nga burgu i parë më 11 nëntor 1988, Avdilgafur Luma vazhdon studimet e mbetura nga arrestimi i parë, por njëkohësisht përcjellë me vëmendje edhe situatën politike që zhvillohej në Kosovë. Në anën tjetër edhe UDB-a vëzhgonte lëvizjet e Gafurit. Kudo që shihej ai në lëvizje, ai përcillej nga policia dhe për këto lëvizje bënin raporte policore dhe kërkonin masa, por edhe protestat, grevat e demonstratat në mbrojtje të qenies shqiptare, vazhdonin.

Gafur Luma sërish bie në kontakt me veprimtarët ilegal dhe shtypin klandestin në të cilin pasqyrohej gjendja politike nëpër të cilën po kalonte populli shqiptarë në fund të shekullit XX.

Zëri i Kosovës, organ i Lëvizjes Populloree për Republikën e Kosovës, në numrin 11-12 të vitit 1988, krahas të tjerave shkruan:

,, Më 17, 18, 19, 20, 21 nëntor të këtij viti, i gjithë populli i Kosovës u hodh në protesta e demonstrata të përgjithshme, në të cilat morën pjesë mbi 500 mijë vetë. Shkas për të filluar shprehja e pakënaqësisë dhe dalja në rrugë për të protestuar dhe demonstruar ishte vendimi me

---

si themelues i ,, Partisë Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare'' ku i mban 8 vite. Në vitin 1976 ishte themelues i organizatës ,,Lëvizja nacional-çlirimtare e Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare në Jugosllavi'' LNÇKVSHJ. Riburgoset më 4 nëntor 1981 dhe për katër muaj torturohet rëndë nga udbashi Selim Brosha. Arrestohet sërish me 4 nëntor 1985 dhe torturohet për 7 muaj e 15 ditë. Vdes si pasojë e torturave të UDB-së. Metush Krasniqi është i shpallur Hero i Kosovës

diktat e presion i Serbisë për të shkarkuar udhëheqjen e Krahinës së Kosovës, mirëpo shkaku i vërtet i demonstratave kaq masive të popullit shqiptar në Jugosllavi ishte pushtimi i Kosovës' '
Demonstratat e këtij nëntori të popullit shqiptar në RSFJ kanë karakter popullor, kanë karakter përparimtar, kanë karakter liridashës. Ata janë të orientuara kundër ndryshimeve reaksionare të kushtetutës së vitit 1974, kundër marrjes së Autonomisë nga ana e Serbisë. Këtë të drejtë, Autonominë, populli ynë e fitoi me gjak dhe doli ta mbroj me gjak. Forma se si e filloi dhe e zhvilloi populli ynë demonstratat është taktikë e zgjuar e tij. Në rrethanat që kanë krijuar armiqtë e popullit tonë nuk mund të fillonte ndryshe demonstrate masive.[60]
Shkurti i vitit 1989, klasën punëtore e gjen në ballë të rezistencës në mbrojtje të Kushtetutës së vitit 1974. Mbi 1500 minatorë të Trepçës futen në grevë në horizontet 8,9 e 10. Krahas kësaj i tërë populli solidarizohet me grevën e punëtorëve.
E njëjta gjendje pason edhe në marsin e vitit 1989 gjatë dhe pas suprimimit të Autonomisë së Kosovës, torturohen, arrestohen dhe vriten protestues. *Zëri i Kosovës* nr.5. i majit 1989 shkruan se ,,*Demonstratat gjithëpopullore të muajit mars 1989, armiqtë dhe tradhtarët e popullit tonë i bënë të përgjakshme. Në përleshje me forcat e armatosura ushtarake-policore ranë dhe u plagosën në fushën e nderit qindra bij e bija të popullit tonë...* [61] " dhe kjo më së miri ilustrohet në ballinën e *Zërit të Kosovës*: ,,*Pushteti ushtarako-policor në*

[60] Burimi: Materialet e Mbledhjes së II-të të Përgjithshme të Degës së OMLK jashtë vendit. Nëntor 1988
[61] Zëri i Kosovës nr.5, maj 1989

*Kosovë nuk mund ta mposhtë luftën e drejtë të popullit tonë për liri,"*si dhe *Komunikata* e shpërndarë gjithandej nëpër Kosovë nga LPRK, ku ndër të tjera thuhej:
...Në këto rrethana, si kusht ekzistence, na imponohet vetëmbrojtja. Të dijnë mirë shovinistët serbomëdhenjë se si deri më tash, edhe në të ardhmën me gjakun e jetën tonë do ta luftojmë pushtimin e sërishëm të Serbisë mbi Kosovën, prandaj Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës Thirr mbarë popullin shqiptarë në Jugosllavi që edhe më me forcë të vazhdojë rezistencën në të gjitha format e mundshme, të dëmtojmë sa më tepër pushtuesin dhe t`i tregojmë mbarë opinionit jugosllav e atij botëror se kurrë nuk do të nënshtrohemi, kurrë nuk do të pranojmë zgjedhën e robërisë...[62]
Kurse në gushtin e vitit 1989, *Zëri i Kosovës,* sërish alarmonte opinionin vendor e ndërkombëtar për shkallëzimin e dhunës ushtarako-policore në zbatim të kushtetutës së tankeve në Kosovë.
Në nëntor të vitit 1989, Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës, po në *Zëri të Kosovës*, nr.11.1989, jepte kushtrimin:
Jo-jo Serbi - s`do të jesh perandori!
Për të vazhduar se ,,*Është fakt i pamohueshëm se sa herë që populli ynë u rrah, u burgos, u vra nga armiqët e lirisë, ai u ngrit edhe më me vendosmëri kundër vrasësve të organizuar nën mbrojtjen e shtetit. Por demonstratat e grevat gjithëpopullore që nga fillimi i luftë sonë e sidomos greva gjenerale e shkurtit`89, demonstratat masovike të mars-majit `89, pastaj grevat, demonstratat e tetor-nëntorit të këtij viti historik, janë dëshmitarët më besnikë*

[62] Ibish Neziri ,,Ahmet Haxhiu-një jetë të tërë në lëvizjen ilegale" fq. 131

se populli ynë është pjekur politikisht, është ngritur ideologjikisht dhe ka arritur një shkallë të lartë organizimi revolucionar...
Kosova në prag të çlirimit dhe shpalljes se pavarësisë nga Serbia... shkruhej në numrin 12 të *Zërit të Kosovës*, ngjarje të cilat i quante dramatike, por njëkohësisht edhe historike...
Në anën tjetër, për radhët e brendëshme të Organizatës, redaksia e ,,Pararojës" informonte radhët e organizuara se*:..Kabinetet e Beogradit, veçanërisht shtabi sekret ushtarak i gjeneralëve serbë, përgatitë plane fatale kundër popullit tonë, për të jetësuar ëndërrën shekullore të shovinistëve serbë për të serbizuar Kosovën. Shtabi sekret ushtarak i gjeneralëve po përgatitë një nga tragjeditë më të mëdha kundër popullit tonë...* thuhej në broshurën ilegale me titull *,,Punëtorë, më me forcë ta vazhdojmë rezistencën kundër agresionit policor e ushtarak"* [63] të cilën shqiptarët fatkeqësisht do ta përjetojnë gjatë luftës së vitit 1998/1999.
Kjo ishte ajo situata revolucionare që duhej shfrytëzuar deri në maksimum në realizimin e aspiratave popullore, kjo ishte ajo atmosfera ndërmjet grushtit e bajonetës, barikadës dhe kordonëve policor dhe thënë më së shkurti, kështu ishte gjendja politike në Kosovë, nëpër të cilën po kalonte Gafur Luma pasi u lirua nga burgu i parë.

[63] Driloni:Punëtorë, më me forcë ta vazhdojmë rezistencën kundër agresionit policor e ushtarak", janar 1990, broshurë marrë në shfrytëzim nga Arkivi personal i veprimtarit Shefqet Jashari, Ferizaj

Disa kujtime nga shokët e burgut të parë

Rexhë Abazi, ish i burgosur politik nga Peja, kujton[64]**:**
Unë isha i dënuar si i mitur në një proces gjyqësor për Republikën e Kosovës me bashkëveprimtarët e mi nga komuna e Pejës dhe burgun po e mbaja në burgun e Gurakocit. Krahas shokëve të tjerë, në këtë burg kam qëndruar edhe me dëshmorin Gafur Luma nga Kaçaniku. Një ditë derisa po shëtisnin në shëtitoren e burgut Gafuri me Remzi Krrabën, shkova dhe iu bashkangjita. Gafuri kishte qenë duke biseduar për veprimtarinë e rilindësve tanë, puna dhe angazhimi i tyre kombëtarë për të mirën e kombit. Në rrjedhë të kësaj, Gafur Luma fliste për gjuhën, kulturën, traditën dhe ardhmërinë e atdheut, fliste me një optimizëm të pashoq, saqë kjo shprehje e optimizmit të tij, në mua mbeti si një kujtim i pashlyer me dëshmorin.
Bafti Sopa, ish i burgosur politik nga Bukoshi i Therandës, kujton[65]
Isha i burgosur në një proces gjyqësor politik në armatën jugosllave me tri vite burg. Dikur më vonë më transferuan në burgun e Gurakocit. Krahas të burgosurve të anëve të ndryshme, aty gjeta edhe Gafur Lumën nga Kaçaniku dhe nga ky burg filloi shoqërimi me atë.
Kur në gushtin e vitit 1993, UDB-a filloi një valë të madhe arrestimesh në Kosovë, meqë sërish pas burgut

[64] Shënim i datës 15.7.2017, Pejë
[65] Shënim i datës 15.7.2017, Pejë

ishim të angazhuar në veprimtarinë ilegale, u rrezikova bashkë me Xhemajl Rudin për arrestim të sërishëm. Pas disa ditësh të qëndrimit nëpër male, shkuam te Remzi Krraba në Stagovë të Kaçanikut. Bashkë me Remziu shkuam në shtëpinë e Gafur Lumës në Glloboshicë dhe kërkuam ndihmën e tij për kalim ilegal të kufirit. E ku mund të gjenim lidhje më të sigurtë kombëtare se Gafur Lumën? Na priti më një kënaqësi të veçantë. Jo vetëm që arriti të na nxjerr me sukses andej kufirit, por na përcjelli deri në Tetovë dhe na strehoi në shtëpinë e një të afërmi të tij. Në Tetovë qëndruam dy ditë dhe pas dy dite rrugëtuam për në Tiranë.

Derisa po na përcjellte për në Tetovë, i thash të largohet nga shtëpia se është zullum i madhë në Kosovë. Ai më shikoi në sy dhe më tha: Shumë shokë sikur ju sot, kanë nevojë nesër për të ikur na arrestimet e pushtuesit dhe natyrisht ata kanë nevojë për ndihmën time, andaj unë do të qëndroj këtu dhe vetëm këtu. Nuk kisha fuqi ta bind. Gafur Luma ishte njeri i dashur, ishte shpresëdhënës, guximtar dhe shok besnik. Isha njeri me fat që e njoha.

Xhemajl Rudi nga fshati Savrovë komuna e Therandës, Berat Luzhës i dërgon një letër, ku ndër të tjera thotë[66]:

Pas bastisjes që më është bërë në shtëpinë time në fshatin Savrovë më 3.8.1993, ku dy-tri ditë më herët ishin bastisur dhe arrestuar shokët e veprimtarisë sonë, Hysen Gega dhe Ilaz Kadolli, pasiqë në këtë kohë ishte mbajtur mbledhja e 4-të e Përgjithshme e LPK-së në Prishtinë në shtëpinë e Fatmir Brajshorit më 28/29 korrik 1993. Pas kësaj mbledhje pasuan arrestime

Burimi: Letra e Xhemajl Rudit dërguar Berat Luzhës

masovike në rajonet e ndryshme të Kosovës. Bashkë me Bafti Sopën kaluam malet e Jezercës në Budakovë në shtëpinë e Haqif Kadriut dhe në Papaz te familja e Xhemajl Rexhës, ushtar i UÇK-së tashmë dëshmor i kombit. Pastaj kaluam te Ukzmajlt ku qëndruam dy a tri ditë te Shefki Ukzmajli. Pastaj morëm kontakte përmes vëllaut të tij Nazmiut me Remzi Krrabën të cilin Baftiu e njihte nga koha kur ishte në burg. Pasi arritëm te baca Remzi, ai na ndihmoi pahezitim për të kaluar kufirin në Maqedoni përmes dhëndrrit të Berat Luzhës - Gafur Lumës. Baca Remzi ishte një veprimtar i devotshëm dhe kishte respekt të madh për Gafurin dhe Beratin. Ai na dërgoi me traktor deri te Gafur Luma dhe më pas u kthye, ndërsa ne qëndruam te Gafuri deri në mbrëmje vonë dhe na priti shumë mirë. Kur erdhi koha për të kaluar kufirin, dolëm nga shtëpia e tij dhe kaluam së bashku matanë kufirit në Maqedoni. Pastaj me një veturë të një shoku të Gafurit, shkuam në Tetovë, te shtëpia e Bilall Sherifit dhe Gafuri u kthye prap në shtëpi të tij. Ne aty qëndruam një natë e mëpastaj kaluam në Strugë dhe vazhduam tutje... Ne nuk mund ta harrojmë kurrë pritjen dhe përcjelljen aq burrërore dhe me përkushtim të Gafurit...

Pas luftës së UÇK-së, me hidhërim e kuptuam lajmin se Gafuri nuk është më në jetë, por ai mbetet i pavdekshëm dhe do të kujtohet përjetësisht bashkë me familjen e tij atdhetare... Lavdi jetës dhe veprës së tij!

Qelia e Miliq Kerstes (të cilin e vrau Selman Kadriu) në burgun e Gurakocit në të cilën qeli, qëndruan shumë të burgosur politik.

Burgu i Gurakocit dhe dritaret e dhomës së burgut ku ka qëndruar Gafur Luma në vitin 1988. Fotografi e vitit 2017

Muzafer Lika[67], gjithashtu i burgosur në burgun e parë, për Gafur Lumën kujton:
Gafurin e njihja edhe më parë sepse kemi lidhje familjare. Nuk mund ta harroj një moment kur gardianët po na transferonin nga burgu i Prishtinës në atë të Gjilanit. Ishte nata e Vitit të Ri 1985/1986 dhe kemi qenë të lidhur me një palë pranga. Përkundër kërcnimit të gardianëve që ne të mos komunikojmë njeri me tjetrin, ai më përqafoi me mall, me një mall atdhetari. Përqafimi i tij, në mua u shndërrua në një forcë të pashpjegueshme dhe ky përqafim i tij më mbeti një kujtim i pashuar.
Pas lirimit nga burgu, shpesh shkoja tek ai në Qafshqipe. Pas darke u thoshte vëllezërve të tij: ,,Hajt merreni çiftelin dhe jepjani naj kënge". Gafuri e donte shumë Këngën e Lumës. Qaniu dhe Emini këndonin, ndërsa Zilqifi i binte çiftelisë. Të mirëpriste aq mirë, saqë sa herë që shkoja kalonim një natë pa gjumë.
Para se Gafuri të arrestohej për herë të dytë, disa herë e kam ftuar që të vjen në Gjermani ku unë isha, sepse e dija se ai është i rrezikuar, por përkundër falënderimit, nuk donte që të lëshonte Kosovën".
Një shok tjetër burgu që e njohu dhe qëndroi me Gafur Lumën ishte edhe **Emrush Tafili**[68] nga Kaçaniku. Në kujtimin e tij për dëshmorin , ai thotë:
Gafur Lumën, si figurë e kam njohur edhe më herët, sepse shoku im Merxhan Kuçi e kishte djal halle.
Me Gafurin u njohëm edhe më shumë kur u arrestuam në vitin 1985, por më konkretisht pata fatin ta njoh në

[67] Shënim i muajit maj 2017
[68] Shënim i muajit maj 2017

muajin janar e shkurt të vitit 1986[69] në burgun e Gjilanit. Unë kam qenë në katin e dytë të burgut në dhomën në fund të koridorit dhe me sa mbaj mend ishte dhoma numër 13. Fqinjë me dhomën tonë ishte Bajram Dernjani, ndërsa fqinj me Bajramin ishte Remzi Elezi dhe Agim Vishi. Gafurin në këtë burg e sollën nga burgu i Prishtinës bashkë me Hyzer Haxhiun nga Ferizaj dhe në Gjilan, në të njëjtën dhomë, kemi qëndruar : Unë Emrush Tafili, Gafur Luma, Hyzer Haxhiu dhe Musli Prebreza. E kam në kujtesë të pashlyeshme çastin kur u hap dera dhe brenda në qeli u fut si një malësor i vërtetë Gafur Luma. Më përqafoi me një ngrohtësi atdhedashësi që të jepte forcë. Me qëndrimin dhe humorin e tij të lehtë, të bënte që më lehtë t`i përballoje hetimet udbeske, t`i eliminoje të gjitha presionet fizike e psikologjike që udbashët bënin mbi ne. Me përvojën dhe pjekurinë e tij politike të ndihmonte që t`i kalonim situatat e rënda nëpër të cilat po kalonim gjatë hetimeve të vitit 1986.
Dy muaj ditë kaluan shumë shpejtë dhe një ditë e nxorën nga dhoma dhe e transferuan në burgun e Prizrenit, duke lënë në mua, një kujtim të përhershëm, kujton i burgosuri politik Emrush Tafili.
Kadri Raka[70], ish i burgosur politik nga Kaçaniku, kujton:
Më dëshmorin Gafur Luma kemi qenë në një organizatë ilegale politike, por jo në veprim individual. Fizikisht e njoha në gjyq në qershorin e vitit 1986 dhe pas lirimit nga burgu. Gafur Luma kishte një buzëqeshje karakteristike, buzëqeshje e cila shfaqte një afërsi

[69] Me 20.2.1986 Gafur Luma nga burgu i Gjilanit transferohet në burgun e Prizrenit. Burimi: Proceverbali i pranimit në burgun e Prizrenit.
[70] Shënim i muajit maj 2017

njerëzore, ishte njeri i qetë dhe shumë tolerant në biseda, veti të cilat unë ia vlerësova atëherë e sot.
Nga mosha ishte i burgosur i ri, sapo i kishte mbushur 18 vite, por veprën e kishte kryer si i mitur, andaj edhe u dënova me burg për të mitur, por kur u arrestua grupi i Heset Malësiut në vitin 1987, u rrezikova të dënohem për herë të dytë pasiqë kisha lidhje edhe me këtë grup, thot ai.
Se si e përjeton burgun Kadri Raka dhe se sa të vështira ishin kushtet e burgut në fundvitin e vitit 1985, përshkruajmë një rrëfim të tij:
Burgu hetues i Gjilanit ishte më ,,i mirë" kur e krahasojmë me burgun hetues të Prishtinës, ku dimrit detyroheshim të laheshim me ujë thuajase të ftohtë. Na banjon e shëtitores, këmbët i kishim mbi akull, pasi që ishte një banjo e shkatërruar. Në dhoma nuk kishim fare krevate, ndërsa për VC kishim kovat! Qelia kishte një krevat nga dërrasat si një dërrasë ping-pongu.
Në ditën e parë, në qelinë e burgut të Gjilanit, kuptova se çfarë është errësira e natës, pasiqë kur nga temperatura, si pasojë e torturave më doli gjumi, nga errësira nuk mund ta shihja as derën e qelisë, dominonte një errësirë e plotë, errësirë burgu, ndërsa nga banjoja e burgut të Prishtinës, kuptova dhe pashtë se çfarë është acari i dimrit... Ky është përjetimi që e kanë pësuar mbi kurriz gjithë të burgosurit politikë, idealistët e asaj kohe që sakrifikuan veten dhe familjet e tyre për të mirën e përgjithshme. Në mesin e këtyre idealistëve ishte edhe dëshmori Gafur Luma, duke shtuar se në burgun e Gjilanit kam qëndruar në një dhomë me Ruzhdi Shkodrën, Enver Ilazin dhe Sali

Konjufcën..[71]

Mefail Vishi[72], ish i burgosur politik nga fshati Dubravë i Kaçanikut, kujton:

Ishte krenari ta njihje Gafur Lumën sepse ai ishte një djalë patriot, intelektual, njerëzor e mbi të gjitha aktivist e veprimtar deri në flijim.

Unë isha më i ri në moshë se Gafuri për disa gjenerata. Për herë të parë Gafurin e kam takuar kur ai ishte maturant në shkollë të mesme dhe si të tillë ata vizitonin njëri-tjetrin. Para se të përfundonin vitin shkollor, Gafuri me shokë të klasës erdhën te kusheriri im Izija Vishi gjithashtu shok klase. Unë në atë kohë isha në klasën e tetë fillore. Shokët e ardhur te kusheriri Izija të gjithë ishin të shkëlqyeshëm, të afërt me njëri tjetrin. Bashkë me Gafurin ishte edhe Remzi Elezi, ku disa vite më vonë do të na ribashkoj ilegaliteti, rezistenca dhe gjyqi i pushtuesit.

Gafur Luma më mbeti në kujtesë nga fiziku i tij, komunikimi i afërt me mua gjatë ndejës në dhomën e kusheririt tim edhe pse isha disa vite më i ri se ai dhe shokët e tij. Që nga ajo kohë, pra që nga viti 1980 më nuk kam pasur kontakt me atë.

Por, kur erdhi qershori i vitit 1986, 23 shokë dolëm para gjykatës së Qarkut të Prishtinës, si nacionalist që kërkonim Republikën e Kosovës e në mesin e tyre edhe unë si i mitur dhe Gafur Luma me shokë të tjerë. Kur e kam parë në gjyq, atëherë mu ka kujtuar se vite më parë e kam parë te kusheriri im Izija Vishi në vitin 1980.

[71] Informatë e datës 20.6.2017

[72] Shënim i datës 4.6.2017

Mbas daljes nga burgu filloi njohja e vërtetë edhe e thellë me Gafurin. Ne takoheshim së paku një herë në javë, ndodhte që shiheshim edhe më shpesh. Vinte edhe në shtëpinë time, ku prindërit e mi e donin si djalin e tyre. Ai kishte afinitet e komunikonte me të gjitha shtresat e popullsisë, ishte person shumë i përgaditur, njohuritë e tij ishin të thella dhe të bënte ta dëgjoje me vëmendje. Ai ishte largpamës në politikë, nuk kishte komplekse provinciale, thjesht ishte i kompletuar dhe e shihte qartë të ardhmen.
Aktivitetet kombëtare të Gafurit ishin të gjithanshme. Ai ishte i kyçur në të gjitha format e rezistencës dhe në të gjitha këto veprime kishte rolin kryesor nga zona që vinte. Dhuna e okupatorit godiste të gjitha moshat dhe shtresat sociale të shoqërisë. Si rezultat i asaj dhune të shfrenuar u formua edhe KMLDNJ, kryesisht nga të burgosurit politik, ku Gafuri kishte një rol të jashtzakonshëm në kategorizim duke bërë që Këshilli të shtrihej në të gjitha nivelet, njëkohësisht elaboronte rëndësinë e krijimit të këtij trupi operativ, nën maskën e të cilit filluan përpjekjet e para që të ndërrohej kursi i rezistencës.
Gafuri ishte njohës i shkëlqyeshëm i rrethanave ndërkom-bëtare dhe të ndërthuerjeve që do të ndodhnin si pasojë e zhvillimeve të vrullshme, që zhvilloheshin në atë pjesë të Europës. Orientimet properëndimore ishin të qarta në vizionin e tij për të ardhmen.
Ndër të tjera kujtoj edhe ftesën që ma bëri për dasmën e tij. Atë natë kishte ftuar kryesisht të burgosur politik. Ishte një natë që nuk do ta harroj kurr. Modestia, afria, mikpritja, gazi e humori, jo vetëm nga Gafuri por edhe nga vëllezërit e tij që ishin aq të dashur e të

afrueshëm.Kënga e humori nuk kishin të ndalur deri në mëngjes. Aty pash dëshirën për jetë dhe të ardhme, Sado që Serbia mundohej të na e zymtonte jetën, të na e kthej në zezonë, nuk ia arrinte dot.
Gafuri kishte nënën të sëmurë dhe mjeku i kishte shkruar që të blinte tableta mjekësore. Shkuam te barnatorja, por tableta kushtonte më shumë se sa Gafuri kishte para. I tha farmacistit se a ka mundësi që t`i jepte tableta për aq sa kishte para, pra t`ia ndante ato. Farmacisti nxori gërshërët dhe ia ndau ato në mes..
Përkundër këtyre sfidave të jetës, Gafuri ishte i paepur në rrugëtimin e tij drejt lirisë dhe nuk kishte forcë që ta ndalte atë. Atë rrugë nuk e ndalnin dot as çizmet e përgjakura serbe, që shkelnin mi gjakun e rinisë së Kosovës. Nuk e ndalnin dot as tankset e tyre, nuk e ndalnin dot as burgjet çnjerëzore të tyre. Nuk e ndalte dot as gjendja e rëndë sociale, as farmacisti me gërshërë në dorë. Ai rrugëtim ishte i pandalshëm dhe i pakthyeshëm.
Gafuri kishte tri gjëra bazë, që rrallë i gjen tek njerëzit tjerë:
Fizikun (natyrën), etikën (karakterin) dhe diskursin racional (logjikën) e që ishin veçoritë e stoicizmit. Ai ishte stoik.
Rënia e Gafurit në altarin e lirisë ishte dhembje e madhe për ne dhe një humbje e madhe për Kosovën.Vepra e tij do të ngelet e pavdekshme dhe udhërrëfyese se si duhet atdheu.
Muharrem Kurti, ish i burgosur politik nga Gjakova, njëkohësisht bashkëvuajtës me dëshmorin, duke

komentuar në Facebook disa fotografi nga burgu i Gurakocit, kujton:
Këto fotografi të kujtojnë vitet e rënda, por të lavdishme të burgut politik dhe të dëshmorëve të kombit si Gafur Luma, të cilit i themi lavdi me zemër e shpirtë. Respekt, nderim dhe mirënjohje atyre që sakrifikuan jetën për lirinë e përgjithshme…
Murat Dauti, ish i burgosur politik nga Runiku i Skënderajt, kujton[73]:
Në burgun e Gurakocit më kanë transferuar në nëntorin e vitit 1987. Në majin e vitit 1988, Gafur Lumën me shokët e Kaçanikut i sollën nga burgu i Prishtinës. Me Gafur Lumën jam shoqëruar gjatë dhe jo vetëm që ishte i shoqërueshëm, por ishte edhe i burgosuri më i përgatitur në kuptimin e vazhdimësisë së të gjitha lëvizjeve shqiptare për çlirimin e tokave tona. Ishte patriot me logjikë të hollë e të thellueshme në vazhdimësi. Para lufte, Gafur Lumën e kam vizituar në fshatin e tij në Gllboshicë, në kohën kur i ka lindur djali, të cilit ia kishte vënë emrin Lirim. Ishte mikëpritës dhe kishte dëshirë të qëndroje sa më gjatë me atë. Përfundimisht kam ndjerë dhembje, kur pas lufte dëgjova se Gafur Luma është vrarë në burgun e Dubravës. I përjetshëm kujtimi për dëshmorin!

[73] Shënim i datës 29.7.2017

Shokë të dëshmorit Gafur Luma. Nga e majta: Mefail Vishi, Remzi Krraba, Shaban Çupi, Ekrem Jashari dhe Bajram Dernjani, fotografi e vitit 2015

Shokë të dëshmorit Gafur Luma në përvjetorin e rënies.Në këmbë: Skënder Ferizi, Muzafer Lika, Riza Xhakli, Bardh Frangu, Besim Zymberi, ndërsa ulur:

Raif Luma, Menduh Leka, Xhemil Ismani e Nexhat Xhokli

Qelia e burgut të Gjilanit, fotografi e vitit 2017

Lirimi nga burgu i Berat Luzhës më 4.12.1990

Berat Luzha, ndërmjet dëshmorëve Gafur Loku e Gafurr Luma

R E X H I S T R I

Per personat nen kontrollin politikë per vepra penale.

1.	Berat /Selman/ Luzha	nga f.Begracë	(Nish).
2.	Kadri/Ilmi/Luzha	nga f.Begrac	(ushtar).
3.	Ferid /Zimri/Qallaku	nga f.Gajre	(ne shtepi).
4.	Hisen /Ibush/Shehu	nga Kaqaniku	(ne shtepi).
5.	Naser/Islam/Kuka	nga Kaqaniku	(ne shtepi).
6.	Islam/Feriz/Vishi	nga Kaqaniku	(ne shtepi).
7.	Isa /Isman/Vishi	nga Dubravë	(ne shtepi).
8.	Ibush/Isman/Vishi	nga Dubrava	(ne burg)Sarajevë.
9.	Agim/Haki/Vishi	nga Dubrava	(ne burg)Sarajevë.
10.	Bexhet /Isman/Imishti	nga Dubrava	(ne burg).
11.	Hakip/Raif/ Rexhepi	nga Bajnica	(ne shtepi).
12.	Fadil/Janus/Hysa	nga Stagova	(Fush Kosovë jetonë).
13.	Hisen /Hasan/Shurdhani	nga Kaqaniku	"ED".
14.	Ekrem/Demir/Kqiku	nga Kaqaniku.	
15.	Avdulla Milaim Qallaku	nga Kaqaniku.	
16.	Themajl Murtezan Fiqi	nga Kaqaniku.	
17.	Ramiz/Bajrush/Shehu	nga Kaqaniku.	
18.	Fatime /Halim/Sopa	nga Kaqaniku	Prishtinë.
19.	Naser/Sherif/Tusha	nga Kaqaniku.	
20.	Remzi/Rrustem/Elezi	nga Sllatina.	
21.	Avdullg afur Murxhan Luma	nga Glloboqica.	
22.	Remzi/Rifat/Krraba	nga Stagova	(burg).
23.	Bajram/ Avdulla/ Dernjani	nga Paldenicë.	
24.	Shaban /Minir/ Qupi	nga Paldenicë.	
25.	Ismajl /Sherif/Malsiu	Rekë.	
26.	Kadri /Sabit/Raka	Kaqanik.	
27.	Emrush/Bedri/Tafili	Kaqanik.	
28.	Mifail /Kadri/Vishi	Dubrav	
29.	Muhamet /Zejnulla/Qorri	Rekë.	
30.	Skender /Liman/Luzha	Begracë.	
31.	Nexhat /Nuhi/Xhokli	Doganaj.	
32.	Muzafer/Rrustem/Lika	Ferizaj.	
33.	Adem /Sali/Saliu	Bajnicë.	
34.	Hisret/Hilmi/Kiqiku	Kaqanik.	
35.	Hemet Malsiu	Rekë.	
36.	Ibrahim /Bajrush/Curri	Hani Elezit.	
37.	Agim/Daut/Dauti	Kaqanik.	
38.	Nexhat /Haqif/Ballazhi	Hani Elezit.	
39.	Mehmet/Misim/Ballazha	Hani Elezit.	

Listë e hartuar nga UDB-a për të burgosurit nën kontroll

politik. Gafur Luma figuron në numrin 21[74]

[74] Dokument nga Arkivi personal i të burgosurit politik Naser Kuka, Kaçanik

Dëshmori Gafur Luma, fotografi gjatë mbajtjes së burgut të parë, zbuluar në dosjen e burgut. Fotografi e vitit 1988

KAPITULLI III - Veprimtaria atdhetare e dëshmorit Gafur Luma

(1990-1999)

Në këto rrethana, dhjetori i vitit 1989 solli edhe pluralizmin politik, formohet Lidhja Demokratike e Kosovës, ndërsa 2 korriku i vitit 1990, solli edhe Deklaratën Kushtetuese me të cilën Kosova shpallej e pavarur nga Serbia. Për këtë ngjarje të madhe *Zëri i Kosovës*, shkruante se *me 2 korrik të këtij viti delegatët shqiptarë, nën qiellin e hapur, proklamuan Deklaratën Kushtetuese, me të cilën shpallën Kosovën subjekt të pavarur dhe të barabartë me njësitë tjera konstituive të Jugosllavisë duke shtuar se vendimet historike të 2 korrikut për pavarësinë e Kosovës nga Serbia nuk mund t`i shfuqizojë askush sepse janë vullnet i popullit tonë.* [75]
Miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në Kaçanik më 7 shtator 1990, ishte edhe një akt tjetër i vullnetit popullor për të cilën organ i LPRK-së shkruante se ,,*Kushtetuta e Republikës së Kosovës - akti i ligjshëm historik*"dhe këto u përkrahën nga e tërë popullata shqiptare.
Situata e re e krijuar, determinoi rrethana të tjera, por me një problem të vjetër, çlirimin e Kosovës. Pluralizmi i shpallur, krijoi edhe LDK-në, parti e cila në fillim i kishte të gjitha tiparet e një lëvizje mbi partiake dhe

[75] Zëri i Kosovës nr.8,gusht, 1990. Material i huazuar nga Arkivi personal i Shefqet Jasharit, Ferizaj

gjithëpërfshirëse. Masat popullore u anëtarësuan në atë dhe flakën Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë.
Në letrën, që në emër të Komitetit Drejtues të OMLK-së brenda vendit, i drejtohet Komitetit të Degës së OMLK (Jashtë Vendit) duke bërë fjalë për situatën brenda në Kosovë, ndër të tjera thuhet:
Shokë,
Në Kosovë tash 10 ditë që nga 28.1.1990 po mbretëron dhuna e terrori barbar mbi popullin tonë të pafajshëm. Që nga 22.1.1990 në ora 13.00 kur u hap zjarrë...nga milicët serbomëdhenjë, ndaj demonstruesve në fsh. Bresotvc-komuna e Rahovecit, e deri më sot, kur po e shkruaj këtë letër drejtuar juve që megjithatë, nuk mund t`i parafytyroni besnikërisht, skenat rrënqethëse të këtyre ditëve, terrori shtetëror, nuk ka pushuar fare edhe pse pak, pas ndaljes së demonstratave, por jo edhe grevave, tubimeve protestuese, e bojkotimeve të çdo iniciative që buron nga pushtuesi, - ka ra nga intenziteti. Tash tre ditë, pjesëmarrësit po burgosen, në procedurë të shkurtër e aty për aty, me burg, rrahje shtazarake e deri te likuidimet fizike, pa nam e pa nishan siç thotë një fjalë e urtë popullore. Por krahas këtyre masave represive... populli ynë heroik as po frikësohet nga vazhdimi i dhunës, as po mashtrohet nga demagogjia e armikut. Dje dhe sot (5.2.-6.2.1990) me inisiativën e koalicionit demokratik të Kosovës i janë bërë nderime dëshmorëve të rënë për liri... Sot e gjithë ditën kudo nëpër Kosovë po dorëzohen librezat e Lidhjes së komunistëve... dhe po regjistrohen masovikisht në LDK- Lidhja Demokratike të Kosovës në krye të së cilës gjendet dr. Ibrahim Rugova....
Në bazë të deklaratave të kryesisë së LDK-së dhe dr. I.R.... mendojmë se janë për t`u përkrahur dhe po

përkrahen... Lidhja Demokratike e Kosovës e themeluar me 23 dhjetor (1989 vr.ime) tani ka kaluar 200 mijë të anëtarëve të vet. Në masa është shënuar një entuziazëm për t`u futur në te, një marrje frymë lirisht nga pozita legale, që është mirë, por janë mbjellë edhe një varg iluzionesh te një pjesë se u gjend forma e veprimit si më efikasja për rrethanat e Kosovës... Duke analizuar të gjitha rrethanat del se LDK ka krijuar një hapësirë për të vepruar OMLK e LPRK dhe këtë hapësirë brenda jemi duke e shfrytëzuar maksimalisht...[76]thuhet ndër të tjera në Letrën e dërguar Organizatës jashtë.

Gjatë kësaj periudhe, Gafur Luma bashkëpunoi me prof. Mejdi Dalloshin, Hebib Shehun, Bedri Kyçykun, dhe formuan Degën e LDK-së në Kaçanik, por nuk mungonin kontaktet as me tribunin Sali Bajra, të cilët ishin të njohur në rezistencë politike që nga vitet 60-ta të shekullit XX. Gafur Luma, ashtu si shumë shokë të tjerë, tanimë vepronin legalisht. Kjo shtresë e ish të burgosurve politik, gjithmonë rreth vehtes mbanin ,,shportën e vogël", por njëkohësisht vlerësonin përkrahjen ndërkombëtare evro-amerikane që vinte, fillimisht nëpërmjet Rezolutave dhe tentonin të kombinonin veprimin legal me atë ilegal.

Duke iu referuar librit ,,Habib Shehu-një jetë për Kaçanikun dhe Kosovën" të autorëve Muhamet Reka e Sevdije Shehu, na bëhet e ditur se: më 17 janar 1990 është një bisedë ndërmjet prof.Mejdi Dalloshit dhe Hebib Shehut për themelimin e degës së LDK-së në Kaçanik. Më 21 janar 1990 formohet Këshilli Nismëtar për themelimin e degës së LDK-së në Kaçanik. Pas formimit

[76] Më gjerësisht shih broshurën ,,Mbledhja e 8-të e KD të OMLK (JV), shkurt 1990

të Këshillit Nismëtar, më 3 qershor 1990 mbahet Kuvendi i parë i degës së LDK-së në Kaçanik dhe nga ky kuvend, Gafur Luma zgjedhet anëtar i kryesisë së degës. Kuvendi i dytë i degës së LDK-së u mbajt në dhjetorin e vitit 1993 dhe në kryesi të Degës, krahas të tjerëve u zgjodh edhe Gafur Luma.[77]

I pari nga e majta, dëshmori Gafur Luma në afërsi të veprimtarit Bajram Selmani, gjatë një manifestimi në Begracë në vitin 1992

Krahas këtij aktiviteti politik, nga viti 1990 e këtej në komunën e Kaçanikut zhvillohen aktivitete të ndryshme duke themeluar edhe Forumin Demokratik të Kaçanikut ku bënin pjesë edhe subjekte të tjera dhe në kuadër të aktivitetit të këtij Forumi shquhej edhe aktiviteti i Gafur Lumës. Gjatë kësaj periudhe organizohen disa tribuna politike dhe një e tillë u mbajtë edhe në fshatin Glloboshicë të cilën e udhëhoqi Gafur Luma.Tribuna u

[77] Më gjerësisht shih librin : Muhamet Reka & Sevdije A. Shehu ,,Hebib Shehu-një jetë për Kaçanikun dhe Kosovën'' Kaçanik 2013, fq.66-68

mbajt në qershorin e vitit 1991 në prani të 100 vetave.[78]
Gafurr Luma, me formimin e Këshillit për financim ishte anëtar i këtij Këshilli, por aktivitetin e zhvillon edhe në KMLDNJ, Këshill i cili mbronte të drejtat dhe liritë e njeriut.
Dëshmori Gafur Luma nuk do të mungon as në aksionin e madhë kombëtar të faljes së gjaqeve e ngatërresave brendashqiptare, është i zëshëm në të gjitha protestat popullore kundër dhunës serbe, por nuk do të mungon aktiviteti i tij as në fushën e mbledhjes së parave për armë dhe formimit të njësive guerile në komunën e Kaçanikut që në vitin 1990-1991, më konkretisht të formimit të Njësitit të parë të armatosur në ilegalitet.[79]
Muzafer Luma, si bashkëpunëtor më i afërt gjatë viteve të 90-ta në aktivitete legale të institucioneve paralele në atë kohë, kujton[80]
Përpos si bashkëfshatar dhe fqinjë, me Gafur Lumën kam filluar bashkëpunimin që nga fundi i viteve 80-ta, por intensivisht pasi që unë mbarova fakultetin në vitin 1993. Që nga ajo kohë, bartësit kryesor të aktiviteteve që organizoheshin aso kohe në fshat dhe që përfaqësonin fshatin në komunë, ishte Gafuri dhe unë. Kemi marrë pjesë në aksionin e pajtimit të gjaqeve, kemi organizuar referendu-min për pavarësi si dhe i kemi organizuar zgjedhjet e para. Kemi marrë pjesë në themelimin dhe bartjen e aktivitete kryesore të jetës institucionale në vitet 90-ta si në LDK, Këshill Komunal për Financim, Arsim, Emergjencë, Bujqësi si dhe në

[78] Po aty fq. 75
[79] Më gjerësisht shih librin: Naser Kuka ,, Nga lëvizja ilegale te UÇK-kujtime e dëshmi'' Prishtinë 2012, fq.274
[80] Informatë e datës 26.12.2017

Shoqatën Bëmirëse Humanitare ,,Nëna Terezë". Të gjitha këto aktivitete funksiononin në kuadër të sistemit paralel të asaj kohe dhe emërues të përbashkët kishin rezistencën kundër pushtuesit.
Gafuri i kishte fjalët e pakta, por punët i kishte të mëdhaja. Fliste atëherë kur duhej dhe ishte e nevojshme të fliste, por edhe heshte kur duhej ta bënte një gjë të tillë. Fatkeqësisht fotografitë që kemi pasur gjatë aksionit të madhë kombëtar të pajtimit të gjaqeve dhe organizimit të referendumit për pavarësi, janë zhdukur si pasojë e luftës. Gafur Luma ishte një politikan i pjekur dhe në aktivitete vinte si ish i burgosur politik. Kishte një përvojë të madhe në organizime, por ishte edhe konspirativ kur duhej të ishte. E dinte se policia serbe po e përcjellte. Në një rast më tha:,, A po i sheh Muzafer, personat brenda në këtë veturë janë të sigurimit, ata po na përcjellin". Pas disa ditëve u arrestua dhe kurrë më nuk u kthye.
Pasi Bajrush Xhemajli doli nga burgu, kuptuam edhe për fatin e Gafurit. Ishte një lajm i rëndë për të gjithë ne që e njohëm. Kam shkuar edhe në Rakosh për të identifikuar kufomën e tij dhe natyrisht ishim afër familjes së tij e cila brenda pak muajve humbi dy djem, Gafurin dhe Qaniun, kujton ndër të tjera Muzafer Luma.
E kishim bërë zakon që ditën e premte, si ditë tregu që ishte në Kaçanik, ishte edhe dita e takimeve tona, dita kur takoheshin ish të burgosurit politik. Takimet mbaheshin aty te Kafja e Nerkushit, ndërsa për biseda ,,më të holla" ecnim rrugëve të Kaçanikut. Për aq sa kishim mundësi, merrnim dhe jepnim informata rreth ngjarjeve që zhvilloheshin. Komentonim edhe ngritjen e

flamurit kombëtar te Guri i Shpum më 28 nëntor 1991 që e bënë disa atdhedashës si Flamur Çaka, Hysret Kyçyku, Mustaf Ahmeti e Abedin Tafili[81] e të cilin policia serbe s`dinte si ta hiqte pasiqë flamuri ishte vendosur me ndihmën e litarit. Kjo ngjarje krenonte kaçanikasit dhe jo vetëm ato.

Fotografi, me një pjesë të ish të burgosurve politik nga Kaçaniku e Hani i Elezit, më 11 mars 1991, në dhjetë vjetorin e demonstratave të vitit 1981.
Në këmbë nga e majta: Agim Dauti, Gafur Luma, Berat Luzha, Adem Salihaj, Bexhet Imishti, Hysret Kyqyku, Agim Vishi, Ibush Vishi.
Ulur: Mehmet Ballazhi, Sejdi Dernjani, Bajram Selmani, Kadri Raka, Shaban Çupi, Heset Malsiu, Mefail Vishi, Bajram Dernjani e Muhamet Qorri

Viti 1990 vërtetë krijoi rrethana të tjera, por shtypja

[81] Rexhep Shehu „Ismail Raka- Sytë e lirisë''Tiranë ,2014 fq. 144

serbe mbeti e njejtë. Të gjitha segmentet që kishte Autonomia e Kosovës u suspenduan bashkë me atë dhe në të gjitha nivelet u krijua gjendje e rëndë. U rrënua sistemi arsimor, punëtorët u larguan nga puna, u mbyll radiotelevizioni, ushtarët që me detyrim shërbenin në armatën jugosllave, ktheheshin në arkivole, ndërsa dhuna e reprezaljet në popull ishin kryefjala që përshkruante periudhën historike që po kalonim. Në kuadër të këtyre rrethanave jetonte dhe vepronte edhe dëshmori Gafur Luma.

Gafur Luma së bashku me autorin e librit (rrethi i kornizuar me ngjyrë të zezë) në vizitë ikonës së Kushtrimit të Lirisë, Rafi Halilit në Tetovë, në qershorin e vitit 1992 të sapoliruar nga burgu famëkeq i Idrizovës[82]

[82] Shokët e Tetovës, me rastin e lirimit të Rafi Halilit nga burgu i fundit, ftuan ish të burgosur politik nga anët e ndryshme të atdheut, që të merrnim pjesë në këtë takim. Gafurr Loku, Shaban Çupi e Sejdi Dernjani udhëtuan nga Hani i Elezit për në Tetovë, ndërsa Gafur Luma erdhi nga Globoshica. Jo vetëm që ishim në këtë manifestim shokësh, por vizituam edhe lokacionet, përkatësisht shpellat dhe

Në këtë fotografi e cila është kryesisht me ish të burgosur politik, në rreshtin e parë, me këmishë ngjyrë të kuqe ulur këmbëkryq është dëshmori Gafur Loku, në të djathtë të tij është Mehmet Gega, ndërsa afër tij është Rafi Halili.

Themelimi i Këshillit për Financim në komunën e Kaçanikut

Këshilli Komunal i Financimit në komunën e Kaçanikut është konstituar më 01.04.1992 nga të gjitha subjektet politike që vepronin në Komunë.[83]

Këshilli Komunal i Finacimit (K.K.F.) si institucion i veçantë për grumbullimin dhe shpërndarjen e të hyrave publike në komunën e Kaçanikut, sikundër edhe në mbarë Kosovën u themelua për mirëvajtjen e veprimtarive prioritare shoqërore si në vijim: Arsimit, Shëndetësisë, Kulturës, Sportit dhe veprimtarive tjera duke mos lënë anash asistencën sociale.

Në këtë kohë Këshilli ka vepruar në përbërje prej 11 anëtarëve duke përfshir Kryetarin, Nënkryetarin dhe Sekretarin, si dhe në kuadër të Këshillit ka vepruar Shërbimi Profesional dhe Komisi-onet; ai Financiar dhe i Kontrollit.[84]

Në kuadër të këtij Këshilli 11 anëtarësh ka vepruar edhe dëshmori Gafur Luma, gjithnjë duke mbajtur gjallë arsimin, përkatësisht shkollën shqipe dhe asistencën sociale e cila për çdo ditë rritej.

---

vendet tjera konspirative të cilat i kishin përdorur shokët e Tetovës gjatë veprimtarisë së tyre ilegale. Burimi i fotografisë: Selajdin Halili, Tetovë.

[83] Burimi : Arkivi komunal-Kaçanik

[84] Po aty

Përbërja e Këshillit Komunal të Financimit të komunës së Kaçanikut, nga 01.04.1992 deri 20.03.1995[85]

Nr.	Emri e mbiemri	Funksioni	Profesioni
1.	Ismet Koraçi	Kryetar i Këshillit	Ekonomist
2.	Mehmet Guri	Nënkryetar	Biolog
3.	Ilaz Loku	Anëtar	Gjeograf
4.	Isa Livoreka	Anëtar	Ekonomist
5.	Izahir Troni	Anëtar	Prof. i Kimisë
6.	Imer Tifeku	Anëtar	Sociolog
7.	Xhelal Gashi	Sekretar i Këshillit	Jurist
8	Beçir Prushi	Anëtar	Stamotolog
9.	Reshat Shehu	Anëtar	Ekonomist
10	Zekirja Loku	Anëtar	Kimist
11	Gafur Luma	Anëtar	Arsimtar

,, Me pietet të veçantë do thënë këtu se plot veprimtarë të Këshillit, u bënë luftëtarë dhe kuadro udhëheqës të Luftës çlirimtare, shumë nga të cilët ranë dëshmorë, si komandanti i lavdishëm, Zahir Pajaziti, Isa Kastrati etj. Nga radhët e Këshillit ranë me armë në dorë, si luftëtarë të lirisë ose u ekzekutuan këta veprimtarë: Zahir Pajaziti dhe Shefki Latifi nga Besiana (ish Podujeva), Isa Kastrati nga Prishtina, Qazim Jashari, Ajet Beqiri, Zaim Bajrami, Isuf Rushiti e Zymer Sheqiri nga Skenderaj, Reshat Shehu dhe **Gafur Luma** e Daut Selim Rakoci nga Kaçaniku, Gafurr Loku nga Hani i Elezit, Agim Efendia nga Gjakova, Hafir Shala (i zhdukur), Sokol

[85] Burimi: Arkivi komunal i Kaçanikut

Helshani, Gani Helshani, Halim Bajraktari, e Zejnullah Elshani nga Drenasi (ish Gllogoci), Ahmet Kaqiku dhe Demir Sylejmani nga Shtërpca, Ramadan Kastrati nga Dardana (ish Kamenica), Izet Qazim Greiçevci nga Kastrioti (ish Obiliqi), Pashtrik Krasniqi, Ilir Kelmendi e Agim Duraku nga Klina, Bedrush Avdi Gashi dhe Shaip Bellaqi nga Rahoveci, Skënder Xhafer Alushaj nga Peja, Ibrahim Demalijaj dhe Rrustem Bruqi nga Deçani, Haki Morina dhe Hashim Hasanaj nga Malisheva, Xhavit Syla nga Theranda (ish Suhareka) etj.[86]

Kushtet e vështira ekonomike dhe situata gjithnjë e më e rëndë që pasoi pas viteve 1990-ta të shekullit XX, ndikuan që Gafur Luma për një kohë të punoj si mësues i sistemi paralel shqiptar, pranë shkollës ,,Kongresi i Manastirit" në Qafshipe e më pas edhe si sekretar i kësaj shkolle. Ndërkohë ai martohet me Hydajete Luzhën nga Begraca e Kaçanikut nga e cila martesë e shkurtër u lindën dy fëmijë, djali Lirimi dhe vajza Kaltrina. Krahas përballjeve me kushtet e vështira ekonomike, kontributin e tij Gafurri e jep edhe në jetën politike qoftë në LDK, qoftë në Këshillin e Financave, qoftë në KMLDNJ dhe rreth këtij aktiviteti Gafuri për disa herë ftohet nga sigurimi i armikut në të ashtuquajtura ,,biseda informative".

Për të zbardhur sado pak veprimtarinë e dëshmorit Gafur Luma, aktivitetin e tij legal dhe ilegale për liri të Kosovës, ne sërish do të ofrojmë kujtimet e shokëve, kujtimet e atyre shokëve bashkëveprim-tarë me të cilët kishte punë konkrete dëshmori.

Në fshatin e tij, kujton bashkëveprimtari **Berat Luzha**[87],

[86] Mehmet Hajrizi, Ismail Kastrati, Bajram Shatri ,,Këshilli Qendror i Finacimit''

[87] Shënimet janë marrë në vitin 2016

Gafur Luma udhëhiqte të gjitha aktivitetet, si ato politike, ashtu edhe ato humanitare, kulturore dhe për të drejtat e njeriut. Njihej për urtësi e aftësi organizuese. Ishte tip politikani dhe diplomati, por që aftësitë e tij nuk mundte t'i zbatonte, përveç në biseda dhe në punë konkrete me shokët e tij të idealit e të veprimit, duke shtuar se Gafuri ishte një personalitet vizionar, me prirje të një politikani profesionist, i fjalës, i besës, i përkushtuar për çështje dhe i matur e serioz në veprimet e tij.

Zekirija Loku, kujton[88]
Pata nderin të njihem e më pastaj edhe të bashkëpunoj në shumë aktivitete me dëshmorin Avdilgafur Luma. Me të punuam në Këshillin Komunal të Financimit, Këshillim për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut si edhe në përgaditjet, organizimet dhe furnizimet për fillimin e luftës së shenjtë të UÇK-së, në komunën e Kaçanikut.
Në ditët e para, pas lirimit nga burgu i veprimtarëve të '81-tës, në kafe-çajtoren "Lepenci" nëpërmjet Berat Luzhës e takova për herë të parë Gafën. I çetë, me gjykim të mprehtë e vizionar, i gatshëm për të dëgjuar mendimin e të tjerëve dhe i buzëqeshur çdo herë, tipare këto që më bën të ndjehem i afërt me atë, si t'a kisha njohur për një kohë të gjatë.
Në vitet '90 kur okupimi sllav në Kosovë po merrte një formë më të egër të zhvillimit, duke u mohuar shqiptarëve çdo të drejtë, lindi nevoja për formimin e një organizmi që do të mbante gjallë jetën dhe funksionimin

[88] Shënim i datës 14.8.2017

paralel të organizimit shoqëror në përgjithësi, e procesit arsimor në veçanti.
Përgjegjësinë për ngritjen e Këshillit Komunal të Financave e kishte marrë Berat Luzha, i cili në një ndej në shtëpinë time më informoi për planet e organizimit dhe shokët që mendonte t'i angazhonte. Kur më tregoi se kishte plan të angazhoj Gafën, Reshën (Shehun), Ismajl Rakën e shumë shokë të tjerë, nuk hezitova dhe përnjëherë pranova të kyçem edhe unë pasi që këtë ma kërkoi Berati.
Shumë kujtime i kam të freskëta edhe sot për Gafën, punën dhe angazhimin e tij të madh në KKF. Ai nuk ndalej ditë e natë duke grumbulluar mjete financiare nga qytetarët dhe bizneset për të mbajtur gjallë arsimin në komunën tonë. Nuk i trembej vëzhgimit të vazhdueshëm që na bënte policia serbe, e në veprim në teren ishte zjarr. Buzëqeshja e vazhdueshme në fytyrë i shtohej edhe më shumë kur arrihej që të siguroheshin pagat për arsimtarët në fund të muajit.
"... edhe bukën e gojës duhet ta ndajmë për ta mbajtur gjallë arsimin sepse pa arsimim të brezave nuk do të kemi Liri dhe këtë duhet ta bëjmë për t`i treguar Serbisë se ne nuk e kemi ndërmend të dorëzohemi e nënshtrohemi asnjëherë" këto fjalë shpesh i thoshte Gafa gjat takimeve në terren.
Një ditë, kur unë po bëhesha gati për të shkuar në Prishtinë, në Këshillin Qendror të Financave, për të tërhequr pjesën financiare të mbështetjes për komunën tonë, para zyreve të Këshillit (në lagjen Rakoc) u takova me Gafën. Pasi u përshëndetëm dhe i tregova se për ku isha nisur, sigurisht duke e ditur që ishte përgjegjesi që me tërë atë shumë parash ta bëje rrugën nga Prishtina

në Kaçanik, ku në çdo hap kishte policë, patrolla dhe punkte të policisë serbe, i buzëqeshur si zakonisht më tha se do të vijë me ty. U ndjeva shumë i lehtësuar dhe atë moment nuk e harroj kurrë. Gafa për shokët ishte i gatshëm të flijohej çdo herë.
Pra, Gafa me shokë ishte një ndër themeluesit e KKF-së për të cilin dha shumë mund e djersë, kaloi shumë sfida e rreziqe duke e kuptuar tërë këtë si një formë të luftës kudër pushtuesit serb.
Me Avdilgafur Lumën, punuam edhe në KMLDNJ-Dega në Kaçanik si dhe në përgaditjet dhe organizimet e rezistencës së armatosur.
Gafa ishte i pandalshëm, i dashur për shokët, i çetë, modest por shumë dinamik në veprim dhe kurrë i gjunjëzuar. Tërë jeta e Gafës, siç e quanim, ishte sfidë e vazhdueshme.

Ndërsa **Naser Kuka**[89], ish i burgosur politik, gjithashtu një veprimtar i dalluar i ilegales, për Gafur Lumën, kujton se ishte një veprimtar i përmasave që e tejkalonte kulturën provincialiste të formimit intelektual dhe politik të kohës që i përkiste. Ishte krejtësisht i liruar nga dogmat e së kaluarës, me një kulturë të gjerë intelektuale dhe formim atdhetar. I përkushtuar gjerësisht dhe jetësisht në Lëvizjen kombëtare për çlirimin e Kosovës. Ishte kontribues i pandalshëm, orfe i ilegales çlirimtare, i cili gjith-monë bashkonte fuqi dhe energji atdhetare, i organzonte ato dhe i vente në shërbim të kauzës së lirisë. Avdilgafur Luma, ishte nga veprimtarët e rrallë që punën e bënte pa zhurmë, por me

[89] Shënim i muajit prill 2016

përkushtimin e intelektualit revolucionar, që asnjëherë nuk u ndal në rrugën për të cilën ishte betuar që në rininë e hershme të tij. Përveç tjerash, ai në dy anët e kufirit ka pritë e përcjellë, ka strehuar veprimtarë të shumtë të lëvizjes sonë çlirimtare, ka ndihmuar ata në kryerjen e detyrave e të halleve që kishin. Veprimtaria e Gafur Lumës duhet zbardhur, me emrin e tij lidhen disa prej veprimtarive kulmore guerilo-ushtarake të viteve 1996-1997, veprimtari këto që i tejkalojnë kufijtë e komunës së Kaçanikut, kujton Naser Kuka, duke shtuar edhe një detaj se Gafuri kishte shprehur dëshirën për t`u ndërlidhur me UÇK-në në Kaçanik dhe këtë dëshirë të tij ia kishte shprehur Ismet Kukës.[90]

[90] Naser Kuka „Nga lëvizja ilegale te UÇK-Kujtime e dëshmi”Prishtinë 2012, fq.396-397

Martesa e dëshmorit Gafur Luma me Hydajete Luzhën nga Begraca në vitin 1992

Fotografi e dëshmorit Gafur Luma me shokë në Ferizaj, i dyti nga e majta, ish i burgosuri politik Elmi Reçica

Raif Luma (1954) nga fshati Qafëshqipe, kujton[91]:
Dëshmorin Gafur Luma e kam djalë të vëllaut. Të mirën e të keqen e kemi ndarë bashkë, andaj edhe kujtimet për dëshmorin nuk shuhen kurrë, fillon rrëfimin e tij prof. Raif Luma.
Në vitin 1982, derisa si studentë po udhëtonim me autobus për Prishtinë, Gafuri kishte një çantë të mbushur me afishe dhe mua më thotë: ,, Raif, nëse policia futet brenda në autobus për kontroll, çantën të mos e pranojmë që është e jona". Nga ky moment unë e kuptova që Gafur Luma merrej me veprimtari ilegale.

[91] Shënimet janë marrë me datën 19.5.2017, Paldenicë

Pos bisedave politike që bënim me Gafurin, në atë kohë kam lexuar edhe këto materiale ilegale: disa numra të gazetës *Liria*, librin *Titistët* dhe gazetën *Punëtori*[92]. Është me rëndësi ta themi se këto materiale ilegale i merrja nga motra e tij Hamdija, tani e martuar në Orasht të Tetovës dhe të njëjtës ia ktheja. Që don të thotë se tërë familja Luma ishte një Celulë e organizuar për liri.

Në vitin 1984, gjatë një aksioni për shpërndarjen e pamfleteve në Prishtinë, gati se zbulohen pasiqë në vendin ku gjenden pamfletet kanë qenë Remzi Elezi, Gafuri dhe një shok i tyre, nga Verbani i Vitisë. Si të dyshuar burgosen Remzi Elezi dhe ai shoku(Avdyl Bajrami vërejtja ime) , por nuk zbulohet veprimtaria e vërtetë ilegale, pasiqë Bexhet Luzha, arriti të ikë dhe u ndërpre zinxhiri i zbulimit.

Kujtoj se Gafur Luma lidhje ka pasur edhe me profesorin e biologjisë Arif Cekën në Tetovë i cili ka pas mbledhur ndihma materiale për familjen e të burgosurit politik, Bexhet Imishtin.

Ndihma për familjen e Gafur Lumës(pas burgosjes së tij) ka sjellur edhe Menduh Leka i cili ka bashkëpunuar me Gajur Lekën dhe të hollat ia ka dërguar babait të Gafurit, Merxhanit. Mbledhja e ndihmave për familjet e të burgosurve bëhej ilegalisht dhe po të hetonte UDB-a

[92] „Punëtorët'' është gazetë informative, politike, propagandistike dhe programoro aksionale e cil del kohë pas kohe. Me dokumentet e bashkimit të 17 shkurtit 1982 u muar vendim që LRSSHJ të organizohet në organizatat e brendëshme dhe si rezultat i punës që u bë për të realizuar këto vendime të rëndësishme historike u themelua Organizata Sindikale e Bashkimit të Punëtorëve të Kosovës si repart pararojë i klasës punëtore të Kosovës...

të burgoste, nuk ishte kjo punë e lehtë, ishte solidaritet me të burgosurit politik.
Gjatë verës së vitit 1985, Gafuri shkon për të punuar në Zvicërr, në firmën ku punonin Mustafë Lika nga Shtraza e Kaçanikut dhe Aqim Berisha nga Gurana e Hanit të Elezit dhe nga kjo kohë më kujtohet kur Gafuri më ka thënë se në Zvicërr është takuar me Fazli Veliun dhe Ali Ahmetin.[93]
Në rrjedhë të këtyre aktiviteteve, Gafur Luma arrestohet më 11 nëntor 1985. Arrestohet në mal, derisa po barte drunj me motrat e tij. Arrestohet nga udbashët Afet Rexhallari e Halit Loku dhe e dërgojnë në burgun e Prishtinës. Nga burgu i Prishtinës e dërgojnë në atë të Gjilanit dhe nga Gjilani në atë të Prizrenit, nga Prizreni në atë të Prishtinës ku edhe dënohet me 4 vite burg. Pas dënimit dhe mbajtjes së gjatë në izolim në burgun e Prishtinës, më 18 maj 1988, bashkë me shokët e tjerë si: Remzi Krraba, Muhamet Qorri, Sabit Gashi e Shaban Çupi, transferohet në burgun e Gurakocit. Në të gjitha burgjet e kam vizituar bashkë me familjen. Vizitat përcjelleshin nga UDB-a dhe koha e vizitës ishte shumë e shkurtër, por Gafuri çdo herë ka qenë i fortë.
Pas daljes nga burgu, Gafuri ka marrë pjesë në të gjitha protestat që zhvilloheshin në vitin 1989,1990…dhe më kujtohet edhe porosinë që ia jepte nëna e tij ,, Gafur, ruaju se po të marrin përsëri" e ai pasi e përqafte nënën e tij, qeshte.
Kur u martua, në dasëm ftoi shumë shokë, pothuajse të gjithë të burgosur politik. Ishte viti 1992 dhe policia

[93] Takimin e Gafur Lumës me Fazli Veliun dhe Ali Ahmetin (Abaz Gjukën) në Zvicër e konfirmon edhe Mustafë Lika. Informatë e datës 25.5.2017 nga Muzafer Lika, vëllau i Mustafës.

serbe i malltretonte edhe dasmorët, madje ua merrte edhe flamurin kombëtar. Por, që të mbrohet flamuri, detyrën e mori Remzi Krraba i cili ishte edhe i armatosur.

Nga e majta: axha i Gafurr Lumës, prof.Raif Luma i cili kurr nuk iu nda dëshmorit në vizita burgu, ndërsa djathtas Ziber Luma, kusheriri i tij.Në mes autori i librit, maj 2017

Në vitin 1992, unë (Raif Luma) bashkë me Gafurin, me makinën time kemi shkuar në Tetovë, të cilën adresë e dinte Gafuri dhe atje kemi marrë një shaptilograf me të gjitha pjesët, një fotokopjues, makinë shkrimi dhe gjëra të tjera. E di që nuk i ka nxënë gepeku i makinës dhe i dërguam te Shahini i Sahitit në Jazhincë, lidhje kjo tjetër ilegale e Gafurit. Pastaj Shahini, bashkë me Ramadan Cekën e Gllobosh icës, me kuaj i kanë sjellur malit, te shtëpia e Gafurit. Pastaj erdhi Bexhet Luzha dhe i futën më tej në Kosovë. Këto mjete vinin nga

Zvicrra. E di që Gafuri e Bexhet Luzha kanë kryer shumë punë në mes veti, nuk i di detajet tjera.[94]
Një lidhje tjetër e Gafurit ka qenë edhe Llokmani i Fetishit nga Jazhinca, të cilin Gafuri e kishte djalë teze. Veprimtarë që vinin ilegalisht nga perëndimi, Llokmani i sjellte te Gafuri e pastaj Gafuri i përcjellte për në brendi të Kosovës.[95]
Tek ne në Glloboshicë, pas vitit 1992 ose 1993, rreth dy javë ditë Bexhet Luzha ka qëndruar ilegalisht në shtëpinë tonë. Ai ndiqej, madje te shtëpia e tij në Begracë, e qoja natën, madje disa herë. Bexheti bashkë me Gafurin shpesh shkonin në Meqedoni. E di që Bexheti kishte dokumentacion falso. Nuk i di detajet e punëve që kryente me Bexhet Luzhën.[96]
Kur erdhi nga burgu i parë, erdhën për ta vizituar shumë shokë, disa i njihja e shumë të tjerë nuk i njihja. Gafuri më thoshte se janë shokë burgu. Pas burgut të parë, si shumë shokë të tij, edhe ai aktivizohet në Lidhjen Demokratike të Kosovës, në alternativën kosovare siç i thonim ndryshe, në KMLDNJ dhe në Këshillin për Financim. Krahas kësaj, shtëpia jonë ishte e mbushur edhe me barna, që kalonin ilegalisht në kufi e pastaj Gafuri i përcjellte në destincione të caktuara. E di që rreth këtyre barnave, në shtëpinë tone ka qenë Nazif Reka, madje me një ekip të infermierëve na mësonim se si t`i lidhnim fashat në rast lufte. Barnat pastaj futeshin më thellë në Kosovë. Për aktivitete të tilla, policia serbe shpesh herë e kanë marrë në biseda informative. Gafur Luma këtë veprimtari e kishte legale,

[94] Informatë e datës 14.1.2018, Qafshipe
[95] Informatë e datës 14.1.2018, Qafshipe
[96] Informatë e dates 14.1.2018, Qafshipe

por ai kurrë s`ka qenë i shkëputur nga veprimtaria ilegale.
Në fundin e vitit 1995 apo në fillimin e vitit 1996, në shtëpinë e Gafurit vjen Xheladin Gashi ,,Plaku", gjenerali i UÇK-së së më vonëshme i dërguar nga Azem Syla. Pasi Gafuri i tregoi për mua se jam axha i tij dhe mund të bisedosh për çdo çështje, atëherë Xheladin Gashi, tha: Një grumbull armësh na kanë mbetur keq dhe kërkoi ndihmën tonë. Gafuri kishte qenë i njoftuar për ato dhe më tha mua që të shkoj ,,Mbi Dragomac" dhe të kontrolloj mos ka ndonjë lëvizje të dyshimtë rreth armëve. Shkova kontrollova vendin ku ishin një grumbull çantash, rreth 15 sosh me armatim, por lëvizje dyshuese nuk vërejta.Të nesërmen, bashkë me Gafurin dhe Eminin, armëve ua kemi ndërruar vendin, i kemi strehuar në një vend më të sigurtë në ,,Osoj" dhe për t`i humbur gjurmët e lëvizjeve tona nëpër borë, Emini ato i mbuloi me lëvizje të deleve. Pas një apo dy ditë, erdhën luftëtarët nga Drenica dhe i morën.

Gjeneral Xheladin Gashi ,,Plaku"(1946 – 2005) me të cilin Gafur Luma u takua në janarin e vitit 1996
Gjatë kësaj kohe, Gafuri ka punuar si mësimdhënës e më pas si sekretar shkolle. Për të dytën herë, Gafuri arrestohet në mëngjesin e 10 gushtit 1998, atë ditë kur u vra komandanti i UÇK-së Agim Bajrami në Gabrricë të Kaçanikut. Pas arrestimit, Gafurin e dërgojnë në Ferizaj e nga Ferizaj në burgun e Gjilanit ku torturohet mizorisht. Në dhjetor të vitit 1998, nga Gjyqi i Prishtinës u dënua me 6 vite burg, por nuk arriti ta përfundoj pasiqë u pushkatua më 22 maj 1999 në burgun e Dubravës. Kur llogarisim të dy burgjet, Gafur Luma u dënua me 10 vjet burg.
Kurë gjatë muajit mars 1999[97], fshatrat e komunës të Kaçanikut po dhezeshin flakë nga luftimet ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe, policia dhe ushtria serbe bllokoi rrugën Glloboshicë-Kaçanik dhe ne nuk mund të shkonim për ta vizituar Gafurin në burgun e Gjilanit. Atëherë kemi kërkuar ndihmën e shokut të tij, Menduh Lekës që jeton në Ferizaj dhe ai ka shkuar ta vizitoj Gafurin në rrethana shumë të rënda. Nëpër vizita, në

[97] Më 8 mars 1999, një konvoj i përbërë nga 20 automjete të rënda ushtarake, tanke, autoblinda e kamionë, rreth orës 3.30 ka shkuar nga Dubrava për në Glloboshicë...Rreth orës 8 kanë filluar luftime të ashpra mes forcave të UÇK-së dhe forcave ushtarake policore serbe në Livadhet e Shtrazës, afër fshatit Glloboshicë të Kaçanikut. Luftimet po bëhen nga afersia e drejtpërdrejtë dhe ato janë shumë intensive... Në orët e mëngjesit është granatuar nga larg fshati Shtrazë, prej shtëpive të të cilave shihet të del tym. Nga ora 9 kanë filluar edhe granatimet nga Livadhet e Shtrazës, në drejtim të Kotlinës dhe Ivajës... Nga luftimet me intensitet të lartë, që po zhvilllohen sot në malësinë e Kaçanikut, deri tash është vrarë një dhe janë plagosur katër ushtarë të UÇK-së, të gjithë nga granatat...(Agjencia Shtetërore Informative KOSOVAPRESS, Arkivi i luftës, Vëllimi i dytë 1 mars 1999 - 10 prill 1999) të përgatitura për botim nga Berat Luzha, Prishtinë 2016, fq. 106-107

ndihmë me makinë, kur qarkullonte rruga, na kanë dalur në ndihmë edhe Nevait Luma dhe Nejazi Luma. Meqenëse Gryka e Kaçanikut e tëra ishte përfshirë në luftë, familjet tona për në Tetovë largohen më 8 mars 1999. Lajmin për vrasjen në luftime të vëllaut të Gafurit, Qaniut e kemi marrë në Tetovë. Qaniu u varros në rrethana lufte në varrezat e qytetit të Ferizajt më 12 mars 1999. Ishin situata tepër të rënda, dhembje të pamatshme. Jo vetëm që u vra Qaniu 23 vjeçar, por krahas kësaj u shkëputën lidhjet edhe me Gafurin në burgun e Gjilanit, i cili më 30 prill të atij viti transferohet në burgun e Dubravës, aty ku ishte planifikuar ploja ndaj të burgosurve. Për vrasjen e tij kemi kuptuar pas përfundimit të luftës, atëherë kur nga burgu i Serbisë u lirua Bajrush Xhemajli nga Komogllava. Krahas rivarrimit që bëmë për Qaniun, merreshim edhe me gjetjen e trupit të pajetë të Gafurit. Rreth dy javë ditë kemi shkuar në Rakosh të Istogut për të identifikuar kufomën e Gafurit e cila mbante numrin 77. Atje kemi shkuar bashkë me Emin Lumën, Irfan Lumën, Menduh Lekën e Xhemil Ismanin nga Ferizaj dhe nëpërmjet këpucëve, këmishës, jaknes dhe një letre për pranimin e të hollave që i dërgonim me postë sa ishte në burgun e Gjilanit e kemi identifikuar trupin e pajetë të Gafurit. E rivarrosëm dëshmorin Gafur Luma në Varrezat e Dëshmorëve në Kaçanik, pranë shokëve të tij dëshmorë, kujton Raif Luma, axha i dëshmorit Gafur Luma, duke shtuar se nga viti 1979 kur Gafuri filloi veprimtarinë atdhetare e derisa u vra më 22 maj 1999, për 20 vite me radhë nuk u ndal së vepruari për Lirinë e Kosovës.

Rreth kësaj ngjarje, **Bislim Zogaj** nga Komorani, anëtar i Shtabit Operativ të UÇK-së, veteran i luftës dhe ish i burgosur politik, kujton[98]:

Në janar të vitit 1996, unë Bislim Zogaj, Xheladin Gashi e Nait Hasani shkuam në Gllobosh icë për t`i marrë disa armë që i kishin sjellur shokët nga Perëndimi. Para se të shkojmë te Gafur Luma, kontrolluam vendin ku gjendeshin armët dhe konstatuam se ato janë vendosur në një vend të papërshtatshëm. Xheladin Gashi dhe Nait Hasani shkuan te shtëpia e Gafur Lumës dhe biseduan me atë se si t`i tërheqin armët. Xheladin Gashi, Gafur Lumën e njihte si lidhje e Azem Sylës i cili Gafur Lumën e kishte pasur edhe më herët si lidhje kontaktuese ilegale. Pas bisedës që bënë Xheladini dhe Naiti me Gafurin, Gafur Luma pahezitim merr përsipër që armët t`i tërheq nga ai vend dhe t`i vendosë në një vend tjetër më të sigurtë dhe që pastaj ne të shkojmë e t`i marrim në një ditë tjetër. Ashtu edhe u bë. Pas disa ditëve një grup shokësh: Nait Hasani, Rexhep Selimi, Sokol Bashota, Sylejman Selimi, Mujë Krasniqi dhe disa shokë të tjerë që s`po më kujtohen emrat, shkuam në Gllobosh icë. Unë isha me Xheladin Gashin dhe Nait Hasanin në një veturë, të tjerët në veturën tjetër. Në Gllobosh icë shkuam rreth orës 21 të natës. Unë dhe Xheladini shkuam në shtëpinë e Gafur Lumës, ndërsa Gafur Luma bashkë me vëllezërit e tij shkuan në mal, morën armët dhe i ngarkuan në makina. Deri te Shtëpia e Gjuetarëve kemi shkuar me makina, ndërsa nga ky vend, pastaj armët janë bartur në krah deri në Drenicë

[98] Informatë e datës 4.12.2017 dhënë autorit në Prishtinë

dhe këto armë janë përdorur për aksione të UÇK-së. Ishte një prej aksioneve të rënda.
Me Gafur Lumën, kujton më tej Bislim Zogaj, jam takuar në burgun e Dubravës në rrethana mes jetës dhe vdekjes. Pas vrasjes së tre shokëve të Pavijonit ,,C" Enver Topalli nga Ferizaj, Avdullah Tahiri nga Gjilani e Gjokë Ndrecaj nga Gjakova, krahas këtyre të burgosurve të vrarë ishin edhe dy të plagosur rëndë. Kam shkuar te Pavijoni ,,C" për të dhënë ndonjë ndihmë. Aty vërejta dy të plagosur rëndë dhe me pavetëdije. I kishin vendosur në batanije që t`i dërgojnë deri te amulanta e burgut. Aty kishte qenë edhe Gafur Luma i lënduar nga copëzat e betonit në kokë dhe kokën e kishte pasur të lidhur me fashë. Njërin nga këta dy të plagosur e kemi bartur unë dhe Gafur Luma deri te një makinë e ndihmës së shpejtë e cila gjendej brenda hapsirës së burgut. Gjatë kthimit për në Pavijon kemi biseduar me Gafën dhe ai ka pyetur për fatin e shokëve të tjerë si Nait Hasanin, Bajrush Xhemajlin e Avni Klinakun, kujton Bislim Zogaj duke shtuar se me dëshmorin Gafur Luma u njohëm në rrethana të rënda dhe u ndamë po në rrethana të rënda. I përjetshëm kujtimi për dëshmorin Gafurr Luma!
Ndër shokët e tjerë, me të cilët Gafur Luma ka vepruar dendur ilegalisht, është edhe **Bexhet Luzha** nga Begraca e Kaçanikut, dhe për dëshmorin Gafur Luma, kujton[99]:
Veprimtaria ime ilegale me Gafur Lumën daton nga viti 1982 dhe kjo veprimtari ka zgjatur derisa kam shkuar në Zvicërr në vitin 1984, pasiqë në Kosovë u zbulua

[99] Informatë nga Bexhet Luzha e datës 16.1.2018

veprimtaria ime ilegale. Me Gafurin pastaj jam takuar në vitin 1985, kur ai ka ardhur në Zvicërr për punë sezonale dhe më ka bërë një vizitë atje. Në Zvicërr kemi diskutuar gjerë e gjatë rreth organizimit ilegal në Kosovë. Gafuri ka qenë afër Lucernit dhe pos meje është takuar edhe me disa veprimtarë të tjerë të Lëvizjes. Kjo veprimtari dhe këto lidhje ilegale kanë vazhduar deri sa Gafuri bie në burg në nëntor të vitit 1985. Kontaktet me Gafur Lumën i kemi rivendosur kah fundi i vitit 1991 ose në fillim të vitit 1992, pasiqë Gafuri përfundoi burgun e parë. Në fillim të vitit 1992 e kam organizuar në njësitin e armatosur në atë kohë, me detyra të posaçme për kalimin e kufirit nga Meqedonia në Kosovë dhe anasjelltas. Që nga kjo kohë, Gafur Lumën e kam njoftuar me Azem Sylën dhe Ramadan Avdiun. Bashkë me Gafurin kemi studijuar terrenin atje për rast lufte dhe si do të duhej të vepronim në raste të tilla. Shtëpinë e tij e kemi pasur bazë, por jo vetm unë, por edhe shokë të tjerë të Lëvizjes. Më 30 qershor 1994 kam rënë në burg në Maqedoni dhe prej atëherë më nuk e kam parë Gafurin, por ky e ka vazhduar veprimtarinë me shokët e UÇK-së, derisa është arrestuar për herë të dytë, në gushtin e vitit 1998, kujton veprimtari i njohur çështjes kombëtare, Bexhet Luzha.

Pjesë kujtimesh për dëshmorin Gafur Luma, sjell edhe kusheriri i tij, **Ziber Luma**, i cili thotë[100]:

Viteve të 90-ta të shekullit të kaluar, Gafuri na ftonte në aktivitet, na ftonte në bashkim forcash. Kur në fillim të vitit 1993 jam kthyer nga Berlini, ku atje isha kryetar i degës së UNIKOMB-it të Mr. Halil Alidemës, Gafuri më

[100] Shënim i datës 19.5.2017

thoshte se pavarësisht mospajtimeve me lëvizjen paqësore, ne duhet të homogjenizohemi dhe veprimtarinë tonë reale ta fshehim prapa sajë, derisa të krijohen rrethana dhe kushte të reja.
Kur në vitin 1994 po e komentonim një komunikatë të UÇK-së të cilën e botuan gazetat shqipe në Maqedoni dhe dyshimet që ngriteshin nga opinion rreth këtyre aksioneve të armatosura, Gafuri më tha: Ziber, kurrë mos të kesh dyshim, kjo vepër është e shqiptarëve. Vitin 1994 e mbaj mend mirë pasiqë në familje kishim një rast të sëmurë dhe po e vizitonim atë në spital, kujton Ziber Luma.
Meqë situata politike në Kosovë, gjithnjë e më tepër ashpërsohej e dhuna kishte prekur pothuajse çdo derë të shqiptarëve, Gafur Luma i humb shpresat se çështja e Kosovës do të zgjidhet me mjete paqësore dhe në rrjedhë të aktivitetit të tij, bie në kontakt me veprimtarin e njohur Ekrem Jasharin nga Ferizaj dhe nga ai do të mësoj më shumë për ekzistimin e UÇK-së.
Siç dëshmon veprimtari dhe ish i burgosuri politik **Berat Luzha,** Gafur Luma ka pasur lidhje më të hershme me Azem Sylën dhe në kuadër të kësaj lidhjeje, Gafuri do të jetë personi kyç në përcjelljen e pjesëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së nga Kosova për në Maqedoni dhe anasjelltas. Në rrjedh të këtij aktiviteti ai do të përcjell për disa herë ilegalisht në kalimin kufitar edhe vetë Azem Sylën, Sokol Bashotën, Rexhep Selimin, Ekrem Jasharin si dhe ushtarë të tjerë, armë dhe municion. Gjatë një bisede, Gafuri më ka treguar se si ai i ka strehuar në mal një sasi armatimi të një grupi, si tha ai, nga Drenica duke shtuar se nga kufiri deri në

Drenicë ushtarët me armatim kanë udhëtuar në këmbë, kujton Berat Luzha.
Veprimtari i dalluar i kauzës kombëtare, **Ekrem Jashari**(1951) nga Ferizaj, rreth kontakteve me Gafur Lumën, rrëfen[101]:
Kur me 5 gusht të vitit 1993 u arrestua Bajrush Xhemajli me shokë, unë për t`i ikur arrestimit u largova nga Ferizaj dhe konakun e parë e bëra te Remzi Elezi në Sllatinë të Lepencit. Të nesërmen kam shkuar te Gafur Luma në Gllloboshicë dhe i kam treguar për valën e arrestimeve të 5 gushtit 1993 duke i kërkuar që të më ndihmoj për kalim ilegal të kufirit. Pasi kalova kufirin, pas 10 dite jam rikthyer nga Tirana në Tetovë në shtëpinë e Bilall Sherifit dhe angazhova Isak Sherifin (vëllaun e Bilallit) që të shkoj te Gafur Luma në Gllloboshicë dhe t`i tregoj Gafurit se të fton që të vish në Tetovë, Ekrem Jashari.
Gafuri, natyrisht se vjen menjëherë në Tetovë dhe i tregova se në Ferizaj ka mbetur një grup shokësh të krahut ushtarak të LPK-së: Rexhep Bislimi, Vezir Jashari e Xhavit Gashi.
Në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së që u mbajt më 24 prill 1993 në Kollare të Kërçovës, u muar vendimi për formimin e krahut ushtarak të Lëvizjes, e në kuadër të këtij krahu, ishin edhe anëtarët e Komitetit të Rrethit të LPK-së për Ferizaj, Rexhep Bislimi me shokë.
Me të kuptuar problemin, kujton më tej Ekrem Jashari, Gafur Luma më tha se në këtë valë arrestimesh, shokët nuk bën të lëvizin, por vetëm të ndrrojnë vendstrehimin

[101] Shënimet janë marrë me datën 15.5.2017 në Ferizaj

dhe ashtu u bë, por që nga kjo datë, pra nga mesi i gushtit 1993, lidhjet ilegale me Rexhep Bislimin mi ka mbajtur Gafur Luma.
Në të njëjtën ditë kur Isak Sherifi shkoi në Glloboshicë që ta ftoj Gafur Lumën në takim në Tetovë, nga Tirana vijnë në Tetovë: Hashim Thaçi, Kadri Veseli e Azem Syla dhe takohem me ata. Gjithnjë në bisedë për organizime të mëtejme lufte, Azem Syla më tregoi se është takuar me Gafur Lumën dhe nga kjo kohë, Gafuri ka qenë në dy lidhje ushtarake; me Azem Sylën në krahun e Drenicës dhe me mua për Ferizaj, thot Ekrem Jashari.
Pas dhjetë ditësh të qëndrimit në Shqipëri, Ekrem Jashari kthehet në Tetovë dhe në malet e Sharrit, përmes Avdylgafur Lumës, nga fshati Glloboshicë i Kaçanikut, veprimtarit që u vra në Burgun e Dubravës më vonë, takohet me Rexhep Bislimin, me të cilin u morën vesh që të mos ndërpritet veprimtaria për konsolidimin e krahut ushtarak, por të vazhdohet me vetëpërmbajtje në ndërmarrjen e aksioneve luftarake për një kohë të caktuar, derisa të konsolidoheshin më mirë këto radhë.[102]
Puna parësore e këtij krahu luftarak ishte njohja me situatën në terren, shënimi i pikave më të rrezikshme për popullatën që kishte formuar armiku dhe mundësitë e marrjes së aksioneve për eliminimin e tyre. Kjo bëri që pa shkuar shumë kohë nga krahu luftarak të krijohej njësiti gueril i qytetit, të cilin e udhëhiqte Rexhep Bislimi'.[103]

---

[102] Xhabir Morina,,Shembull qëndrese dhe pathyeshmërie'' (Monografi për Rexhep Bislimin) Ferizaj 2008, fq. 33
[103] Citat i cituar nga Xhabir Morina në librin ,,Shembull qëndrese dhe pathyeshmërie - Monografi për Rexhep Bislimin", Ferizaj 2008, fq. 32

,,Në këtë njësit, kujton Afrim Nuha [104](bashkëluftëtar i Rexhep Bislimit, sqarimi im) ishim angazhuar që nga viti 1995, edhe pse ne njiheshim edhe më herët, për veprimtari të drejtpërdrejtë. Për mua ka qenë pak e çuditshme, kur në vitin 1995, (Rexhep Bislimi sqarimi im) më thotë: Afrim tashti e tutje do të bëjmë punë tejet të rëndësishme dhe tepër sekrete. Rexhepi më tha se duhet të pres dhjetë ditë, derisa të bëhet komunikimi i nevojshëm me Bacin. Atëherë Bacin nuk e kam njohur dhe pastaj e kam kuptuar se fjala ishte për Ekrem Jasharin".

Në janar të vitit 1996, vazhdon rrëfimin e tij Ekrem Jashari, një sasi armësh nga Maqedonia[105] duhej që të futeshin në Kosovë. Në ndihmë për strehimin e këtyre armëve na doli sërish Gafur Luma me vëllezërit e tij. Këto armë nga Gllboshica i kanë tërhequr për në Drenicë: Nait Hasani, Sokol Bashota, Mujë Krasniqi , Rexhep Selimi, Ramë Bashota, Agim Pantina(?) dhe në këmbë i kanë bartur për Drenicë.

Në fillim të vitit 1996, njësitin ushtarak, tanimë të UÇK-së, në krye me Rexhep Bislimin e kam vënë në lidhje të drejtpërdrejtë me Nait Hasanin, kujton Ekrem Jashari, duke shtuar se dëshmori Gafur Luma ishte njeri i çiltër, besnik, organizator dhe që dinte ta mbante konspiracionin.

Ndërsa Nait Hasani thot se,, Unë te Rexhep Bislimi erdha përmes kontaktit që pata në Tiranë dhe Durrës me Ekrem Jasharin, Azem Sylën dhe Xhavit Halitin-Zekën. Ne si Shtab Qendror i UÇK-së, kishim për qëllim

[104] Citat i cituar në librin ,,Atdheu i dëshmorit'' të Prof.dr. Emin Kabashi, fq 189

[105] Ekrem Jashari mendon se nga kanali i Maqedonisë këto ishin armët e para që po futeshin për UÇK-në

dhe i kishim vënë vetes për detyrë shtrirjen e UÇK-së në tërë territorin e Kosovës.[106]

Prof.Dr.Isak Sherifi

Prof.dr.Isak Sherifi është i lindur në Tetovë në vitin 1971. Rrjedh nga një familje e cila çështjes shqiptare i dha shumë. Vëllau i tij Bilall Sherifi, për veprimtari ilegale politike u dënua më 15 vite burg, vëllau tjetër Isufi me 6 vite, ndërsa Isaku, edhe pse i mitur, në vitin 1989 u dënua me një dënim kapital prej 5 viteve, ku i mban dy vite të plota. Ka doktoruar në Tiranë në shkencat e historisë për marëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci dhe tani është profesor universitar. Isak Sherifi është autor i dy librave ,,Kosova 1981-1991-Reflektimi në Maqedoni" dhe ,, Dezintegrimi në Maqedoni"
Isak Sherifi është njohës i mirë i dëshmorit Gafur Luma. Nga bashkëbiseda [107] që kishim në ndriçim të

[106] Prof.dr.Emin Kabashi „Atdheu i dëshmorit''(dëshmorit të kombit Rexhep Bislimi), Prishtinë 2017, f.66
[107] Bashkëbisedim me datën 12.1.2018 në Han të Elezit

veprimtarisë politike të dëshmorit Gafur Luma, ai kujton:
Me Gafur Lumën jam njohur pas daljes sime nga burgu. Atë e kam njohur nga pozita e ish të burgosurit politik dhe e kam vizituar disa herë në shtëpinë e tij në fshatin Glloboshicë dhe anasjelltas. Gafuri shquhej për një thellësi politike, andaj edhe shoqërimi me atë ishte i këndëshëm. Kujtoj se Gafur Luma ndiçte me saktësi rrjedhat politike dhe ishte në njohuri të plotë edhe me mbledhjen ilegale të LPK-së që po mbahej në Kollare të Kërçovës në korrikun e vitit 1993, nga e cila mbledhje u formua edhe krahu ushtarak i Lëvizjes. Gjatë kësaj kohe, në shtëpinë time në Tetovë, kanë qëndruar tanimë dy dëshmorët Gafurr Loku nga Hani i Elezit dhe Gafur Luma nga Glloboshica për të na ndihmuar në strehimin e delegatëve të kësaj mbledhje me rëndësi. Madje Gafur Luma një delegat të Lëvizjes e futi ilegalisht në Kosovë, nëpërmjet rrugëve të tij që i ruante vetëm për këto punë dhe që pak kush ia dinte. Gafur Luma ishte një pikë sekrete e Lëvizjes brenda zonës kufitare Kosovë-Maqedoni dhe kryente vetëm shërbime të caktuara.
Në vitin 1991 ka depërtuar material luftarak nëpërmjet Glloboshicës, përkatësisht Gafur Lumës për nevojat e Lëvizjes. Me këtë punë është marrë Azem Syla dhe aktivitetet e Gafur Lumës me Azem Sylën datojnë nga viti 1991.
Në vitin 1993, pas mbledhjes së Kollares, në shtëpinë time kanë qëndruar Nait Hasani dhe ,,Luli" Kadri Veseli dhe në këtë kohë kam njohur Kadriun. Arrestimet që ndodhën në gushtin e vitit 1993, Lëvizjen e dëmtuan rëndë. Jo vetëm që u arrestuan shokë me ndikim, por ranë edhe disa baza me armatim si në Pudujevë e Pejë.

Po në vitin 1993, në Tetovë, bashkë me Ekrem Jasharin jam takuar me Hashim Thaçin e Kadri Veselin dhe po në këtë kohë, Gafur Luma është takuar edhe me Azem Sylën.
Mbaj mend se në vitin 1993, një kompjuter të Lëvizjes e kam dërguar te djali i tezës në Jazhincë, te Llokmani, ndërsa Gafur Luma e merr dhe e nxjerr në kufi dhe shokët e Lëvizjes e marrin për nevojat e tyre.
Pas rënies së shokëve në burg në vitin 1993, qoftë nga LPK-ja , qoftë nga LKÇK-ja, Lëvizja u dëmtua rëndë, disa aktivitete u ndërprenë dhe duhej nga fillimi të ndërrmerreshin aksione.
Pas kontakteve që kisha me Emrush Xhemajlin, Bilall Sherifin e Azem Sylën, bëhej fjalë për mënyrën se si të fusin material ushtarak në Kosovë, tanimë për nevojat e UÇK-së.
Armatimi që erdhi nga Shqipëria, në shkurtin e vitit 1996, fillimisht e kam pranuar unë, pastaj materialin e kemi strehuar në shtëpinë e Ismail Vlashit. Unë dhe Ismaili me autobus e kemi dërguar deri në Jazhincë te Abdurrahmani. Pastaj grupi i Tetovës: Daut Rexhepi, Afrim Rexhepi, Skënder Iseni, Ismail Vlashi e Abdurrahmani kanë arritur që t`i fusin armët brenda në Glloboshicë. Pas dy dite, nga direktivat e Azem Sylës që në atë kohë ishte ilegal në Maqedoni, unë bashkë me Afrim Rexhepin kemi shkuar në Ferizaj dhe jemi takuar me Xheladin Gashin ,,Plakun" i cili ka qenë edhe me një shokë tjetër. Pastaj bashkë me ata, jemi ardhur nga Ferizaj në Glloboshicë ku takohen me Gafur Lumën dhe pas katër dite vijnë ushtarë të tjerë nga Drenica dhe i marrin armët me të cilat armë në Drenicë e gjetiu janë kryer shumë aksione ndaj forcave pushtuese serbe.

Me Gafurin kam pasur shumë kontakte, shkoja dhe vinte, binte dhe nxjerrte ilegal në dhe nga Kosova dhe këto punë kanë qenë të shpeshta dhe nuk mbahen mend të gjitha. Një herë i tha Azem Sylës se për punë konspirative, ndërlidhës të jem vetëm unë, pra Isak Sherifi. Unë pos që kam qenë ndërlidhës ndërmejt Azemit dhe Gafurit, ndërlidhës kam qenë edhe ndërmjet Ekrem Jasharit e Gafur Lumës dhe meqë në atë kohë nuk kishte mjete komunikimi si sot, të gjitha lëvizjet i bënim në kushte të vështira, pra në këmbë dhe gjithnjë duke u ruajtur nga shërbimet armike. Kujtoj se dëshmori Gafur Luma ishte me shpirtë e zemër një akitivist i denjë i Lëvizjes për Liri, besnik dhe konspirativ, i çetë, por i thellë, kam nderin që e kam njohur dhe kam vepruar me atë, kujton ish i burgosuri politik dhe veprimtari i dalluar i çështjes kombëtare prof.dr. Isak Sherifi nga Tetova.

Mehmet Ballazhi, ish i burgosur politik, kujton:[108]
Me Gafur Lumën njiheshim që nga viti 1990, pas lirimit tonë nga burgjet. E njihja si një veprimtar domethënës të ilegales, fjalë pak dhe me një çartësi politike. Në vitin 1996 nga Gjermania ku punoja, ilegalisht u futa në Kosovë dhe në të njëjtën mënyrë duhej edhe që të dilja. Kërkoja hapsira kufitare në Glloboshicë dhe atje takova Gafurin. Pasi u sigurua për vendndodhjen e patrullave serbe, me zhdërvjelltësinë e tij, arriti që t`më nxjerr andej kufirit, në Maqedoni dhe udhëtova sërish për në Gjermani ku Lëvizja po zhvillonte një aktivitet të dendur

[108] Informatë e dates 26.1.2018

në organizimin e luftës së armatosur.E kujtoj si shok besnik, atdhedashës e konspirativ.

Bajram Selmanaj ish i burgosur politik nga Doganajt e Kaçanikut, kujton:

Unë me Gafur Lumën jam njohur vetëm nga viti 1990-1994 në aktivitete të LDK-së. Mirëpo kah fundi i vitit 1993 dhe në fillim të vitit 1994, unë isha duke qëndruar ilegalisht pasiqë më kërkonte policia serbe. Me Gafurin jam takuar në fshatin tim, në Doganaj dhe kemi biseduar për problemet që na preukoponin. Me atë rast, Gafuri mi dha disa materiale për t`i lexuar e shpërndarë, ishte Platforma e LKÇK-së. Ky ishte takimi im i fundit para se të largohem nga Kosova. Gafur Lumën e kujtoj si një atdhedashës të vërtetë.[109]

Fatmir Vata, ish i burgosur politik nga Ferizaj, kujton:

Me Gafur Lumën njiheshim që në burgun e parë në Gurakoc. Kur në vitin 1994 u rrezikua nga arrestimi tanimë dëshmorja Hyrë Emini ,,Mira" nga Ferizaj, shtegdaljen e gjetëm te Gafur Luma në Glloboshicë. Ai jo vetëm që na priti, por me saktësinë e tij konspirative, arriti ta kaloj ,,Mirën" andej kufirit në Maqedoni dhe nga andej, Mira kaloi në Tiranë, ndërsa më vonë në UÇK-ë. Gafur Luma ishte njeri besnik, i dashur dhe i respektuar nga të gjithë.

Bashkëshortja e Berat Luzhës, **Hatixhja**,kujton:[110]

Një javë para se të arrestohej për herë të dytë Gafur Luma, erdhi tek ne në Begracë. Berati veç iu kishte bashkangjitur UÇK-së. Në momentin që erdhi Gafuri, në televizion ishte duke folur Jakup Krasniqi. Gafuri na foli me vullnet të pashoq se liria e shumëpritur po vjen,

[109] Informatë nga Bajram Selmanaj e datës 25.5.2017

[110] Shënim i datës 30.7.2017

Kosova do të jetë e lirë, pa marrë parasysh sakrificat që do të bëhen, ndërsa neve na tha që për shkaqe sigurie të dalim në Maqedoni me ndihmën e tij nëpërmjet kufirit në Glloboshicë. Një javë më pas u arrestua edhe ai. Më nuk e kam parë të gjallë.

Kolonel Hajrush Kurtaj në librin e tij ,,Në rrugën e lirisë" thotë: Mëngjesi i ditës së 10 gushtit 1998 e gjen të rrethuar fshatin Gabrricë. Një rrethim tjetër të hekurt forcat serbe i bëjnë shtëpisë së Miftar Kurtajt, aty ku gjendej komandanti Agim Bajrami me bashkëpunëtorët e ngushtë, Xheladin Kurtajn dhe Besnik Begun-cën, trimat që bartnin barrën e rëndë të organizimit të luftës këtu... Saktësisht në orën 4 të mëngjesit, nga dritaret – frëngji krisën pushkët e para çlirimtare të `98-tës në anën e Kaçanikut...Luftojnë komandant Agimi, Xheladini e Besniku. Një luftë tërësisht e pa-barabartë. Beteja zgjati deri në orën 8, aq sa luftëtarët e lirisë patën municion. Agimi, Xheladini e Besniku bien dëshmorë, e gjaku i tyre u bë themel i kështjellës së lirisë. Gjatë kësaj beteje të madhe, ku ra edhe komandanti Agim Bajrami ,,Zefi", arrestohen Danush Kurtaj, gruaja e tij Bylkizarja dhe kunata Havushja si dhe Fatmir Kurtaj. Në të njëjtën ditë, forcat serbe arrestojnë edhe disa ushtarë të UÇK-së në komunën e Kaçanikut, si: Hasan Dalloshin, Mejdi Dalloshin, Avdilgafur Lumën e Tefik Rakën...[111]

Dr. Nejazi Luma [112] , bashkëvendas i Gafur Lumës, kujton:

Me Gafur Lumën, pos që ishim bashkëvendas dhe njifeshim mirë, bashkë kemi qenë edhe në studime në

[111] Kolonel Hajrush Kurtaj „ Në rrugën e lirisë'', Prishtinë 2012, fq.27-28

[112] Shënim i muajit maj 2017

Prishtinë. Gafuri në Fakultetin Elektroteknik, ndërsa unë në atë të mjekësisë. Gafuri banonte në konvikt, ndërsa unë bashkë me Menduh Kaloshin (tani i ndjerë) në banesë private. Gafuri gjithmonë na informonte gajarisht për lëvizjet politike dhe aktivitetet kombëtare që ndodhnin, por na jepte edhe materiale, si: *Zëri i Populllit* dhe broshura të tjera. Pas burgut të parë dhe kur gjatë viteve të 90-ta, gjendja e sigurisë gjithnjë vinte më e rëndë, ne e dinim se rreziqet për arrestime të sërishme të Gafurit ishin evidente, andaj shpesh herë e kemi këshilluar që të largohet nga Kosova, por ai vazhdimisht refuzonte një gjë të tillë dhe fatëkeqësisht, në një mëngjes të hershëm të gushtit 1998, oborri i shtëpisë së Gafur Lumës u mbush me policë serb. Me duar të lidhura e hipën Gafurin në ,,pizgauerët" e tyre dhe më nuk e pashë për të gjallë, kujton Dr. Nejazi Luma.

Në këtë valë arrestimesh, krahas Gafur Lumës u burgosën edhe i vëllau i Xheladinit, Danushi, Hasan Dalloshi, Fatmir Kurtaj, Mejdi Dalloshi, Tefik Raka, Xhevat Haziri, ndërsa ndaj Berat Luzhës, Hajrush Kurtajt, Qamil Ilazit, Naser Kukës, Reshat Salihajt, Bexhet Imishtit, Remzi Elezit dhe Naim Bekës, aktakuza u ngritet në mungesë, por është karakteristike të theksojmë se nga ky grup të akuzuarish, 6 pjesëtarë kanë rënë dëshmor, 4 në burgun e Dubravës, ndërsa Naim Beka e Komandanti i Brigadës, Qamil Ilazi, fushëbetejave për lirinë e Kosovës.

Me hetime të rënda, plotë dhunë e terror, Gafur Luma do të përballet në Ferizaj e Gjilan, por para hetuesve, përkundër dhunës, Gafurri nuk do të pranoj akuzën.

Për torturat që përjetonte ky grup i arrestuar, si: Danush

Kurtaj, Hasan Dalloshi, Fatmir Kurtaj, Gafurr Luma, Mejdi Dalloshi, Tefik Raka e Xhevat Haziri, shkruan edhe *Zëri i Kosovës* i datës 23 korrik 1998, ku ndër të tjera thuhet se:

,, Ndaj veprimtarëve politikë të kësaj ane që gjenden në këtë burg si, Besim Zymberi, Sylejman Bytyqi, Skënder Ferizi, Gafur Luma e shokë të tjerë, janë duke u ushtruar metodat më çnjerëzore të torturimit fizik e psikik, duke mos përjashtuar as elektroshokun. Përpos inspektorëve serbë të ardhur enkas nga Ferizaj, në torturim dhe dhënien e instruksioneve kundër veprimtarëve politikë shqiptarë, janë të inkriminuar edhe udbashët nga Gjilani të njohur si antishqiptarë të përbetuar, kryeudbashi për Anamoravë, Vladica Miliqeviq nga Leskovci, pastaj Bozhidar Trajkoviq, Dushko Cvetkoviq, Dragan Peroviq, Dragan Gjekiq, Stanisllav Karaxhiq, Branko Kovaqeviq, Dejan Svetkoviq, Dragan Jevriq, Zhivojin Deniq, Sinisha Paviq etj, duke vazhduar më tej se gjaku i veprimtarëve politikë shqiptarë që po derdhet nëpër lokalet e UDB-së dhe qelitë e burgut të Gjilanit, dora hakmarrëse shqiptare do të godas pamëshirshëm dhe do të jetë e pafalshme".

Megjithatë, aktakuza e pushtuesit e ngarkonte Gafurin dhe shokët e tjerë të arrestuar se që nga fillimi i vitit 1998 është bërë pjesëtar i UÇK-së, ndërsa nga maji i të njëjtit vit ka formuar Shtabin lokal të UÇK-së në rrethinën e Kaçanikut. Më tej thuhet në aktakuzë se, ata kanë mbajtur mbledhje të fshehta dhe kanë planifikuar sulme terroriste mbi forcat serbe, duke formuar kampe për stërvitje ushtarake me 10-30 anëtarë të UÇK-së dhe njëkohësisht kanë ngritur bunker për fshehje të armëve në afërsi të shtëpisë së tij.

Këtë akuzë, Gafur Luma nuk e pranon as në hetuesi e as në procesin gjyqësor pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i cili filloi më 15 dhjetor 1998 dhe kryetar i trupit gjykues i të pestëve ishte antishqiptari Dragolub Zdravkoviqi. Përkundër mungesës së fakteve, Gafur Luma u dënua me 6 vite burg të rëndë, ndërsa i tërë grupi u dënua me një shekull burg.
Këtë gjykim e përcjellën një numër i caktuar mediash, ndërsa brenda në sallë ishin edhe veprimtarja e Fondit për të Drejtën Humanitare, Ariana Zherka, dhe zyrtari i Komisariatit të Lartë për të Drejtat e Njeriut pranë OKB-së, Sylvian Roy.
Rrënqethëse ishte edhe deklarata e të akuzuarit Hasan Dalloshi i cili tha se: ,, Në një moment më thanë se do ta nxjerrin miun e madh. Së pari mendova se është fjala për ndonjë mi biologjik, por pastaj mora vesh se është një aparat që të ndrydhte mishin. Së pari me atë më munduan në bark e pastaj në gjithë trupin".
Kështu mohuan aktakuzën edhe të akuzuarit e tjerë se deklaratat në hetuesi janë dhënë nën dhunë dhe këtë e pasqyroi më së miri Enver Topalli [113] ,, Kur e kam nënshkruar këtë deklaratë e kam pasur lakun në fyt". Mr. Tefik Raka[114] deklaron se, në hetuesi është përdorur dhunë e papërshkruar si dhe kam përjetuar kërcnime të vazhdueshme ,, Së pari do të vrasim ty, pastaj familjen dhe pastaj do ta shkatërrojmë shtëpinë".
Kështu u mbrojtën edhe Danush Kurtaj [115] , Mejdi Dalloshi [116] , Fatmir Kurtaj, Gafur Luma [117] e Xhevat

[113] Enver Topalli u vra në burgun e Dubravës më 19 maj 1999
[114] Tefik Raka u vra në burgun e Dubravës më 22 maj 1999
[115] Danush Kurtaj u vra në burgun e Dubravës më 22 maj 1999
[116] Mejdi Dalloshi u vra në burgun e Dubravës më 21 maj 1999

Haziri, por përkundër mohimit të kësaj vepre që inkriminohej nga ligjet e pushtuesit, ata u dënuan me një shekull burg.
Krahas këtyre torturave të rënda, Gafur Luma nuk do të zbuloj veprimtarinë e tij të vërtetë ilegale. Ai nuk do t`i zbuloj lidhjet e tija ilegale me UÇK-në, përkatësisht me Azem Sylën, as lidhjen ilegale me Xheladin Gashin ,,Plakun", as lidhjet me Ekrem Jasharin dhe njësitin e UÇK-së në Ferizaj i udhëhequr nga dëshmori Rexhep Bislimi, e as lidhjet ilegale me LKÇK-në të vitit 1993. Gafur Luma, edhe pse në tortura të rënda, që nga dita e arrestimit më 10 gusht 1998, para UDB-së në Ferizaj e Gjilan, nuk do të zbuloj as kanalin e armëve që po futeshin në Kosovë nëpërmjet vëllezërve Ceka të Glloboshicës (Qafshqipes) si : Ilaz Cekës, Bilall Cekës, Rushan Cekës si dhe Mustafë e Brahim Ceka, të cilit ishin në lidhje më komandantin Agim Bajrami.
Gafur Luma edhe në gjyq do të shfrytëzon pozitën legale që kishte në degën e LDK-së në Kaçanik, duke qenë anëtar i kryesisë së saj, por UDB-a e dinte se kjo është një komuflim i tij, andaj edhe pse nuk kishte prova për veprën që akuzohej, gjyqi i pushtuesit ia shqiptoi dënimin prej 6 viteve, por Gafur Luma, nuk arrin ta përfundoj pasiqë pas një viti u pushkatua në burgun e Dubravës më 22 maj 1999.
Gafur Luma, në burgun e Gjilanit qëndron deri më 30 prill 1999. Të njëjtën ditë, bashkë me shokët e tjerë të Kaçanikut dhe Ferizajt dhe në rrethana krejtësisht lufte në mes të UÇK-së dhe forcave serbe dhe NATO-s që bombardonte caqet serbe, transferohet në burgun fame-

[117] Gafurr Luma u vra në burgun e Dubravës më 22 maj 1999

keq të Dubravës. Para se të futen në burg, të burgosurit torturohe-shin rëndë para derës hyrëse të burgut të Dubravës dhe pastaj siste-moheshin në pavijone ku i priste e njëjta gjë. Gafur Luma u sistemua ne Pavijonin " C" siç i thonim atëherë, në të njëjtën dhomë me Enver Topallin.

Gafur Luma, në burgun e Dubravës do të sjellet nga burgu i Gjilanit më 30 prill 1999 bashkë me shokët e tjerë të burgosur nga komuna e Kaçanikut dhe Ferizajt. Besim Zymberi nga Ferizaj, thotë se më 30 prill 1999, jam transferuar nga Gjilani në Dubravë, ishim 35 të burgosur. Gjatë rrugës për në Dubravë çdo gjë ka qenë e shkretë, shtëpitë duke u djegur. Në Dubravë hyrja ishte me tortura dhe duhej të hynim përmes një kordoni të gardianëve, ndonjëherë duhej të bartnim ndonjë të burgosur pasi alivanosej nga të rrahurat.[118] Në këtë grup prej 35 të burgosurve që po transferoheshin nga Gjilani në Dubravë ishte edhe Gafur Luma.

PRISHTINË

Në gjykimin e 15 të akuzuarve, dështuitari kyç i prokurorisë mohoi deklaratën e dhënë para gjyqtarit hetues

Topalli: "Kur e kam nënshkruar këtë deklaratë e kam pasur lakun në fyt"

"Së pari do të vrasim ty, pastaj familjen dhe pastaj do ta shkatërrojmë shtëpinë", citonte Tefik Raka kërcënimet e inspektorëve të policisë, duke mohuar akuzën

Faksimil nga ,,Koha Ditore" rreth gjykimit të Gafur Lumës me shokë

[118] Ukë Thaçi ,,Masakra në burgun e Dubravës''Prishtinë 2011, fq.326

Kosovë

Në Gjykatën e Qarkut përfundi procesi kundër të akuzuarve shqiptarë nga Kaçaniku

Për 15 shqiptarë - një shekull burgim

Faksimil nga ,,Koha Ditore" rreth shqiptimit të dënimeve e datës 25 dhjetor 1998[119]

Njëri nga shokët e burgosur me dëshmorin Avdylgafur Luma dhe më i afërti edhe në momentin kur u vra dëshmori, është **Xhevat Haziri** nga Vitia. Për dëshmi ai sjellë këtë rrëfim:

Avdylgafur Luma i takon brezit të luftëtarit të lirisë, i cili, me vetëdije të plotë dhe me tërë qenien e tij, i ka qëndruar besnik veprës së vet dhe deri në kohën e ekzekutimit ka qëndruar kryelartë dhe i patrembur. Kishte sjellje burrërore, ishte mendjemprehtë dhe i vetëdijshëm për pozitën në të cilën gjendeshim. Ishte i gatshëm për të dhënë çdo gjë nga vetja e tij për t`i dalë zot idesë së tij, idealit të tij për liri dhe çlirim. Gafur Luma ishte i dashur me shokë, solidar dhe i gatshëm për t'i ndihmuar shokët, për ta ndarë edhe ushqimin,

[119] Burimi: Kolonel Hajrush Kurtaj dhe Arkivi komunal i Kaçanikut

edhe rrobat, për të flijuar edhe veten për ta. Kur flas për të, këtë e dëshmon qëndrimi i tij në burgun e Dubravës. Jemi mbajtur në të njëjtën dhomë, së bashku edhe me shumë shokë tjerë. Të gjitha këto tipare ishin të njeriut të ngritur dhe me përvojë, si i dënuar politik edhe në vitet e mëhershme.

Për gjendjen shëndetësore dhe shpirtërore të periudhës së hetuesisë dhe plagëve të shkaktuara ndaj Avdylgafur Lumës nuk mund të flas, sepse kemi qenë të ndarë gjatë qëndrimit në burgun hetues të Gjilanit. Por dihet se ndaj të gjithëve torturat janë bërë në shkallën më mizore, kanë qenë të tmerrshme, me përdorim të dhunës me mjete të ndryshme, si ato me rrymë elektrike, me djegie me mjete metalike e deri te inskenimi i nxjerrjes së të burgosurit në terrene të panjohura gjatë natës me pretekst të likuidimit e me qëllim për t'i treguar emrat e shokëve të veprimtarisë. Si pasojë e torturave të tilla, kanë mbetur të mbytur në hetuesi Rexhep Bislimi (tash Hero i Kombit) dhe Cenë Dugolli (tash Dëshmor i Kombit).

Avdylgafur Luma është mbajtur në Burgun e Gjilanit, në dhomën numër 15, bashkë me Skënder Ferizin, nga Ferizaj dhe të tjerë. Unë isha në dhomën numër 16, bashkë me Avdullah Tahirin (tash Hero i Kombit) dhe me tre të burgosur të tjerë. Nga dhoma ku ishte Gafuri na ka ndarë një mur. Këto dhoma – qeli të burgut të Gjilanit ishin në katin përdhes.

Me Gafurin për herë të parë jemi takuar më 11 dhjetor 1998, kur milicia serbe na ka futur në të njëjtin automjet, bashkë edhe me Prof. Mejdi Dalloshin, për të na dërguar për gjykim në Prishtinë. Në automjetin ku gjendeshim ne, në pjesën e pasme të automjetit, në

mesin tonë është futur edhe një gardian serb i burgut, me qëllim të mos na lejojnë të bisedojmë mes vete, pasi po na dërgonin për gjykim. Megjithatë, gjatë rrugës kemi ndërruar ndonjë fjalë për shëndetin tonë, të shokëve dhe të familjes. Bisedat kanë qenë të shkurtëra, edhe pse të ndaluara, por ne nuk i lejuam vetes të zbatonim urdhrin e gardianit serb që të mos këmbejmë asnjë fjalë. Biseda me Gafurin, në këtë rast, shfaqej me një ndjenjë të thellë vëllazërore.
Gjykimi për grupin gjashtanëtarësh të Kaçanikut po mbahej në Prishtinë, kurse unë isha përfshirë në aktakuzën e këtij grupi, edhe pse nuk kemi pasur aktivitet të përbashkët. Në hetuesi, me siguri, i kishin pyetur anëtarët e grupit të Kaçanikut edhe për mua, por ata nuk kanë deklaruar asnjë fjalë në ngarkesë, sikur edhe unë për ta. Mua në aktakuzë me grupin e Kaçanikut më kanë përfshirë shkaku i raporteve të mira që kisha para luftës me Berat Luzhën, i cili, për fat, i kishte shpëtuar arrestimit. Në grupin e Kaçanikut ishin të arrestuar: Avdylgafur Luma, Mejdi Dalloshi, Hasan Dalloshi, Fatmir Kurtaj, Danush Kurtaj dhe Tefik Raka, kurse tetë të tjerë po gjykoheshin dhe dënoheshin në mungesë.
Gjykimi i grupit në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë ka filluar më 14 dhjetor 1998. Ishte kohë tepër e rëndë kjo, si për ne, të arrestuarit, ashtu edhe për familjet tona. Sipas procedurës gjyqësore, të gjithë janë pyetur një nga një. Në njërën prej ditëve të seancave, kur më erdhi radha të deklarohem para trupit gjykues, gjatë deklarimit për fjalën përfundimtare, i kam njohur edhe fizikisht shokët, me të cilët po gjykohesha. Atëherë arrita të mësoj për secilin se cili ishte me emër, sepse

emrat i kisha mësuar nga aktakuza. Salla ku po gjykoheshim ne ishte e mbushur me gjykatës, milicë e gardianë serbë. Shqiptarë ishim vetëm ne, që po gjykoheshim, familjet tona dhe avoketërit.
Në fjalën përfundimtare, para gjyqit serb, Gafuri mbajti qëndrim burrëror. Atë që duhet veçuar në fjalën e tij përfundimtare është kur iu drejtua trupit gjykues me thënien e Xhordano Brunos: "Zotëri gjykatës, ne këtu që po gjykohemi, të gjithë jemi shqiptarë, ndërsa trupi gjykues është serb. Kjo po më kujton rastin e Xhordano Brunos, kur ai është gjykuar, i dënuar me djegie në turrë të druve për shkak të bindjeve të tij. Më vonë është amnistuar, sepse kishte pasur të drejtë, por amnistimi ndodhi pasi ai u dogj në turrën e druve". Thënia e tij në gjykim, me zhvillimin e mëvonshëm të ngjarjeve, u vërtetua plotësisht. Lufta mbaroi, Kosova fitoi lirinë, në krah të kësaj lufte të drejtë ishin edhe forcat progresive ndërkombëtare, por Avdylgafur Luma mbeti, së bashku me shumë shokë tjerë, në burgun famëkeq të Dubravës më 22 maj 1999.
Gafur Luma ishte njeri i formuar kombëtarisht, ishte një luftëtar i vendosur për t`u flijuar për ideal. Kishte vetëdije të lartë kombëtare, i përgatitur shpirtërisht edhe për sakrifica, me qëllim të arritjes së qëllimit sublim – lirisë.
Gjykimi i grupit, në atë dimër të ftohtë, është mbajtur nga 14 deri më 25 dhjetor 1998. Dënimet u shqiptuan ashtu si deshi trupi gjykues serb. Asnjëri nga të pandehurit nuk u lirua. Mua më kanë kthyer më 27 dhjetor në Burgun e Gjilanit, së bashku me Mejdi Dalloshin, kurse të tjerët nuk më kujtohet a janë kthyer të njëjtën ditë në Gjilan. Ishim të mërzitur dhe, më

shumë ishim të preokupuar për familjet tona, ngase ishte kohë lufte. Më kujtohet se Mejdi Dalloshi, tash Dëshmor i Kombit, edhe në ato çaste tepër të rënda gjatë kthimit në Burgun e Gjilanit, krijonte çaste relaksuese. Gjatë tërë rrugës, sa ishim në automjetin policor, Mejdiu pinte duhan pandërprerë.
Avdylgafur Luma duke pasur përvojë edhe nga burgu i parë, rrallë herë i ka shpëtuar rasti pa gjetur ndonjë formë të kujdesit për shokë, ose ndonjë përshëndetje së paku me kollitje, ndërsa në mbrëmje pas rënies së ziles për të fjetur, rrallë herë ka ndodhur që të bie në gjumë pa lëshuar trokitje në mur në shenjë përshëndetjeje me shokët.
Ditët kalonin e ne kishim mungesë të madhe të informimit për gjendjen në Kosovë dhe kjo na brengoste shumë. E mësonim ndonjë të re vetëm kur sillnin në dhomë ndonjë të burgosur të ri.
Sjellja e gardianëve me të burgosurit ishte e ashpër. I vetmi ndryshim më i butë i sjelljes së tyre ndaj nesh, që kemi vërejtur, ka qenë në mbarim të shkurtit 1999, në kohën kur kishte filluar Konferenca e Rambujesë, por kjo sjellje nuk zgjati shumë.
Bombardimet e NATO-s në Jugosllavi filluan ditën e mërkurë, më 24 mars 1999. Ne, në Burgun e Gjilanit kemi vërejtur një heshtje befasuese dhe të frikëshme të gardianëve, pa ditur se çka është duke ndodhur.
Të premten në mbrëmje, më 26 mars, pas ziles për të fjetur, ka ndodhur një shpërthim trishtues. Për ne ishte dyfish trishtues, sepse nuk dinim çka po ndodhte. U ngritëm nga shtretërit. U thyen xhamat e dritareve të dhomave të burgut. Pak më vonë erdhëm në përfundim se kanë filluar bombardimet e NATO-s ndaj Jugosllavisë

dhe, me ne ose pa ne, liria do të vijë. Ditën tjetër, pas detonimit, na i ndërruan dhomat; nga kati përdhes – gjysëmbodrumi na zhvendosën në katin e dytë dhe një pjesë në të tretin. Gardianët ishin tërbuar, por edhe te ata vërehej një shqetësim i madh. Të theksojmë se në Burgun e Gjilanit atë kohë të gjithë të burgosurit ishin shqiptarë.
Mëngjesin e hershëm të 30 prillit 1999 dëgjohej hapja e dyerve të metalta të dhomave të burgut dhe dëgjoheshin thirrjet me emra të të burgosurve. Me shpejtësi na nxorën në korridorin e burgut. Nga dhoma ime na nxorën, pos meje, edhe Avdullah Tahirin dhe Enver Topallin. Në dhomë mbetën disa të burgosur. Na dërguan në korridoret e pjesës së poshtme të burgut. Aty i kishin grumbulluar të burgosurit të mbështetur me kokë për muri, siç na detyruan të veprojmë edhe neve. Në një moment filluan të na nxjerrin dy nga dy nga korridori dhe nga burgu në rrugë, të rrethuar me kordonë policorë në të dy anët tona. Në dalje, te porta e burgut, qëndronte një autobus, në të cilin na detyruan të hyjmë e të uleshimm, sipas radhës. Çdo njërin na lidhën me zinxhir për këmbë, për duar e për beli dhe, në fund, zinxhiri mbyllej me dry. Kështu, të burgosurit ishin lidhur dyfish edhe me një zinxhirë të gjatë, që të mos mundnin të iknin.
Në ulëse isha afër me Avdullah Tahirin, prapa nesh ishin të lidhur Avdylgafur Luma dhe Danush Kurtaj dhe kështu, me radhë. Në momentin e nisjes u dëgjua urdhri: -
Numëroni, a janë 23! Në mesin e milicëve dhe gardianëve kishte edhe persona civilë serbë, të armatosur, të cilët na qëndronin mbi kokë.

Gjatë rrugës kemi mësuar se po na dërgonin në drejtim të Prishtinës. Tërë rruga ishte rraskapitëse, sepse ishim të lidhur, por edhe nga trajtimi që na bëhej. Kështu ishte derisa mbërrimë para portave të Burgut të Dubravës. Krahas gardianëve tjerë që ishin shfrenuar ndaj të burgosurve politikë shqiptarë, shquhej edhe gardiani i burgut të Gjilanit, Mitiqi, që rridhte nga Fshati i Ri (Novosella), komuna e Vitisë, të cilin e njihsha edhe nga burgu im i parë në vitet e tetëdhjeta. Ai qëndronte në derën e autobusit dhe, para se të na nxirrnin pran murit të Burgut të Dubravës mua dhe Avdullah Tahirin, para nesh e goditën Enver Topallin, i cili ra përtokë.
Para se të na fusnin në burg, na kanë torturuar mizorisht. Torturat ndodhnin nga milicia, nga paramilitarët dhe nga gardianët, që kishin qenë në pritjen tonë. Mitiqi i urdhëronte të na torturonin. Të gjithëve na shkaktuan plagë e lëndime në trup, kush më të rënda e kush më të lehta. Pranë portave të burgut na rreshtuan dhe pastaj na dërguan në një objekt - në Pavijonin C. Edhe në korridorin e burgut na rreshtuan. Na vendosën në katin e dytë të pavijonit. Pos të burgosurve nga Burgu i Gjilanit, me ne ishte edhe Gjokë Ndrecaj, të cilin e morën nga burgu i Prishtinës.
Ishim të dërmuar nga torturat, të rraskapitur nga rruga e mundimshme. Për fat, në dhomë kishte ujë, kurse për ushqim as që mendohej, sepse që nga fillimi i fushatës së bombardimeve, edhe ushqimin e patën reduktuar në një masë ekstreme. Mbaj në mend që Gafurr Luma nuk ankohej, edhe pse më vonë kuptuam se ishte i goditur në shumë pjesë të trupit me shqelma dhe plagët i trajtonte me ujë të ftohtë.

Na vendosën 12 të burgosur në dhomë, ku nuk kishte as shtrojë e as mbulojë. Më vonë na sollën disa pjesë të sfungjerave të ndotur dhe tre dyshekë, të cilët nuk mjaftonin as për t'u ulur në to, jo më për fjetje. Unë isha i lënduar në hundë dhe gjakderdhja më zgjati disa ditë. Shokët tjerë, si Tefik Raka, Mejdi Dalloshi, Sylejman Bytyçi e të tjerë mbeten në dhomën tjetër.
Atë ditë nuk na dhanë aspak ushqim, kurse ditëve në vijim për 12 persona sillnin aq ushqim sa nuk mjaftonte as për ushqimin e dy vetëve. Ishte bërë kohë e gjatë që nuk kishim pasur vizita të familjeve tona. Nga valixhet që kishim me vete, na kishte mbetur vetëm pak duhan. Atëherë, Gafuri nxori cigare nga valixhja e tij dhe na u drejtua: "Vëllezër, unë i kam 10 pako cigare dhe këto do t`i pimë së bashku, aq sa do të na zgjasin". Ai asnjëherë nuk e ka ndezur cigaren pa ua zgjatur pakon të gjithëve.
Edhe në Burgun e Dubravës qëndrimi i Gafur Lumës ishte i një njeriu të denjë dhe i një burri fisnik, i dashur dhe me edukatë të lartë, si në pikëpamje të sjelljeve, ashtu edhe të qëndrimit, si person i ngritur politikisht. Ishte i matur në biseda, i qartë në komente dhe me gjykim politik, i kujdesshëm në raport me shokët, me zgjuarësi të lartë dhe gjithnjë me fytyrë të qetë. Vazhdimisht ka vepruar në ngritjen e moralit të shokëve, sepse në mesin tonë kishte edhe djemë të moshës së re. Pas disa ditëve në dhomën tonë i sollën edhe tetë të burgosur nga burgu i Pejës.
Kemi thënë më lart se kur arritëm në Prishtinë, nga burgu i Prishtinës e morën në autobusin tonë edhe pesë të tjerë, ndërsa njëri prej tyre edhe Gjokë Ndrecajn. Gjoka kishte pasur plagë të rënda në trup. E kishin

mbajtur në Burgun Qendror të Beogradit (CZ), prej nga pastaj e kishin transferuar në Prishtinë dhe tash e sollën me neve në Dubravë. Ai, pos gjendjes së rëndë shëndetësore, ishte edhe i traumatizuar psiqikisht. Në dhomë me neve Gjoka fliste rrallë dhe nuk kishte fuqi për t`u ngritur në këmbë. Përherë, kur futeshin gardianët në dhomë, pos tjerëve, gjithnjë i vërsuleshin atij me shqelma në bark, aty ku i kishte plagët. Në këndin e dhomës qëndronin Avdylgafur Luma, Enver Topalli dhe Avdullah Tahiri. Duke e parë pozitën e Gjokë Ndrecajt, që ishte më e rëndë se të gjithë ne, Avdylgafuri, në marrëveshje me Enverin, e futën atë në mesin e tyre. Kjo gjendje e rëndë mbytëse e me sjellje barbare e vrastare, edhe thuaja fare pa ushqim, zgjati deri më 19 maj 1999.

Më 19 maj, në orët e paraditës, edhe pse gati për çdo ditë dëgjoheshin fluturimet dhe bombardimet e aeroplanëve të NATO-s, kohë pas kohe edhe gjuajtjet e ushtrisë serbe, ndodhi granatimi i pavijonit ku ndodheshim ne. Granata e mori këndin e pjesës kulmore të dhomës, ku ishim 20 të burgosur në dhomë. Në momentin e goditjes në dhomën tonë, përmes zhurmës së detonimit u dëgjua zhurma e aeroplanit në fluturim e sipër. Dhoma jonë u godit përsëri në këndin ku qëndronin të ulur Avdullah Tahiri, Enver Topalli dhe Gjokë Ndrecaj, kurse Avdylgafuri atë moment nuk ndodhej te këndi i dhomës, ku rrinte zkonisht, po ishte afër Skënder Ferizit, ku ishim mbështetur për njëri tjetrin. Në radhë ishte Besim Zymberi dhe shokët tjerë në krahun e kundërt të dhomës.

Me rastin e granatimit të këndit të dhomës ndodhi që masa e betonit, e rënë nga tavani i dhomës, goditi për

vdekje Avdullah Tahirin, Enver Topallin dhe Gjokë Ndrecajn. Plagë të rënda, me rrezikim jete, morën edhe tre të burgosur tjerë, të cilët atë moment qëlluan të ishin ngritur në këmbë, si Gjergj Karaçi, Kamer Hima dhe Agimi (mbiemri nuk më kujtohet). Plagë mora edhe unë nga goditja e betonit, një prerje në kokë nga një armaturë, e cila më shkaktoi gjakderdhje të madhe. Nga copat e betonit dhe nga rënia e furishme e një dere plagë morën edhe Skënder Ferizi e Gafur Luma. Goditje të tilla, kush më shumë e kush më pak, kanë marrë të gjithë shokët e dhomës.
Në ato momente, nga rrëmuja e krijuar e detonimit dhe nga pluhuri i dendur askush askend nuk e ka parë. Unë, nga ngulfatja prej pluhurit, kam lëshuar një zë: - Shokë, kush është afër, thyeni xhamat e dritareve. Qelqi i dritareve ishte thyer dhe thërmuar i tëri nga detonimi dhe shumica e qelqit të thyer kishin dalë jashtë hapësirës së dhomës përmes grilave të dritareve të dhomës.
Pas bombardimit, të burgosurit nga jashtë pavijonit tonë kanë ardhur dhe i kanë thyer dyert e dhomave të pavijonit. Ky pavijon kishte qenë i blinduar dhe të burgosurve nga jashtë iu ka dashtë që me mjete të forta t`i thyejnë muret rreth dyerve e pastaj t`i nxjerrin dyert, prej nga pastaj kemi dalë jashtë objektit.
Me Avdylgafur Lumën jemi takuar në hapësirat jashtë pavijonit, ku kishin qenë të grumbulluar të gjithë të burgosurit pas daljes nga pavijoni i bombarduar. Me gjasë kisha mbetur i fundit apo i parafundit për shkak të shokëve të mbetur të vdekur në dhomën ku ndodheshim.

Atë ditë Avdylgafuri ka pësuar plagë të hapur - një prerje në fytyrë në pjesën e sipërme të nofullës, afër ballit. Në hapësirën ku ishin grumbulluar të gjithë të burgosurit e pavijonit, u pa se të burgosurit e dhomës sonë nga bombardimet ishin të gjithë të lënduar, ndërsa, fatmirësisht, nga ata të dhomave tjera askush nuk kishte pësuar lëndime.
Nuk shkoi shumë dhe erdhën disa gardianë, në mesin e tyre edhe një civil. Ata filluan, në praninë tonë, të bisedojnë mes vete se ku të na vendosin. Ata u përcktuan për objektin "shkollë". Personi zyrtar civil u tha gardinëve se duhet t`i vendosni në korridorin e objektit e jo nëpër dhoma. Edhe pse gardiani i tha se janë 254 vetë e nuk i zë korridori i pavijonit, civili serb e urdhëroi, duke i thënë: - Veproni si ju them unë! Ashtu edhe ndodhi.
Avdylgafurit, Skënder Ferizit, mua dhe një djali, që kishte ardhë nga Burgu i Pejës, gardianët na thanë: - Pritni para ambulancës se do të vijë ndokush të jua lidhi plagët! Pas një kohe që pritëm, edhe ne u kthyem dhe iu bashkëngjitëm shokëve tjerë dhe hymë brenda hapësirës mbytëse në korridorin e "shkollës", ndërsa lidhjet e plagëve nuk u bënë, sepse ata e kishin hallin se si të na i rrisin plagët dhe jo të na i shërojnë.
Mbrëmjen e 19 majit, në atë korridorin e ngushtë ne qëndruam derisa u errësua dhe pastaj shumica e të burgosurve u futën nëpër dhoma, sepse aty mungonte oksigjeni. Në atë mbrëmje bashkoheshin mes vete secili me secilin që njiheshin e që nuk ishin parë deri atëherë. Kështu ndodhi edhe me ne që kishim ardhur nga burgu i Gjilanit, u futëm në një dhomë sëbashku.

Në dhomën, e cila kishte qenë me derë jo të ngujuar, jemi futur pothuajse të gjithë të burgosurit të ardhur nga Burgu i Gjilanit, po edhe të tjerë. Kanë futur edhe dy vëllezër nga Prizreni. Aty, në atë dhomë, e kemi kaluar natën, secili me plagë nga më të ndryshmet. Avdylgafuri për asnjë çast nuk është larguar nga ne, vazhdimisht kemi qëndruar bashkë. Qëndrimi pranë njëri- tjetrit ishte edhe qëndrim për të rezistuar. Në mëngjesin e hershëm të 21 majit përsëri filluan bombardime aeroplanët e NATO-s. Në fillim u bombarduan objektet jashtë mureve të burgut. Në ato rrethana, të gjithë përnjëherë kemi dalë jashtë objektit "shkollë".

Çdoherë, kur ndodhnin bombardimet e burgut, gardianët serbë humbisnin nga faqja e dheut, ata dilnin jashtë mureve të burgut për t'u shpëtuar bombave, ndërsa ne, të burgosurit, të gjithë shqiptarë, rreth 1000 vetë, mbaheshim "mish për top".

Ne kishim mbetur potencialisht për t`u vrarë, kudo të qëndronim në burg. Gjatë dy ditëve të bombardimeve, qëndrimi në objektet e burgut ishte me rrezik të drejtpërdrejtë. Këtyre dy ditëve u vranë tre të burgosur në Pavionin C dhe 16 të tjerë më 21 maj. Të plagosur mendohet se kanë qenë 17 - 18 vetë. Me rastin e bombardimeve më 21 maj, pos objekteve tjera është goditur kuzhina e burgut dhe objekti i quajtur "shkollë", në të cilin na patën vendosur dhunshëm. Shkolla u godit me tri granata dhe atë në qendër, por ne, të gjithë në atë kohë, ishim jashtë objektit dhe arritëm të shpërndaheshim zhagas në një hapësirë të kufizuar.

Me rastin e rënies së një granate në rrugë, janë vrarë Ahmet Hoxha dhe Mejdi Dalloshi, ndërsa rëndë është

plagosur Sylejman Bytyçi, të gjithë të ardhur nga Burgu i Gjilanit.
Në ndërkohë kemi vërejtur se të burgosurit po lëviznin në drejtimin verior të hapësirës. Kjo hapësirë ishte më e gjerë dhe më larg objekteve – pavijoneve të burgut. Pasditën dhe mbrëmjen e 21 majit e kaluam jashtë, në fushën e sporteve.
Ne, të gjithë, shkuam afër Sylejman Bytyçit, i shtrirë në një shtrat, të cilin shokët e kishin sjellë nga vendi, ku ishte plagosur. Natën e kemi kaluar nën qiellin e hapur. Gjatë natës, krahas të tjerëve, kam qëndruar edhe me Gafur Lumën.
Në orët e hershme të mëngjesit të 22 majit dhe pas lindjes së diellit në horizont, në këndin verior të mureve të burgut, ku këndet i bashkonte karakolli i gardianëve serbë, me anë të megafonit u dëgjua zëri në gjuhën serbe: "Ngrihuni dhe rreshtohuni në rreshta. Tash do të vijnë autobusët dhe do t`ju transferojmë në Burgun e Nishit. Kjo bëhet për të mirën tuaj".
Kur i dëgjuam fjalët e gardianit për transferim "për të mirën tonë", menjëherë e kemi komentuar këtë me Avdylgafur Lumën. Në afërsinë tonë kanë qenë edhe shokë tjerë, që ishin sjellë nga burgjet brenda Serbisë. Nuk di kush ka thënë: "Sido që të bëhet, mos merrni me vete aktakuzat". U ngritëm në këmbë, kishte huti e shqetësim, por rreshtimi ishte i detyruar. Avdylgafuri më tha: "Baci Xhevat, t'i fusim sendet bashkë, në një valixhe, sepse mua më kanë mbetur edhe pak rroba por më është shkyer valixhja". Valixhen time, të cilën vazhdimisht e mbante Qamil Abazi nga Pojatishta e Ferizajt, me vendbanim në Han të Elezit, ma dha menjëherë. - Qamil, shiko çka ka mbetur prej biskotave

të thata, që i kemi ruajtur nga Burgu i Gjilanit për këto rrethana! Doli se kishte mbetur edhe një katror i biskotave në celofan, të cilat unë me Avdylgafurin ia dhamë Sylejman Bytyçit. Pasi Sylejmani nuk i mori të gjitha, biskotat i ndamë përgjysmë dhe u përqafuam me të.
Me Avdylgafur Lumën jemi nisur në drejtim të rreshtit. U radhitëm në rreshtin e katërt që ishte para nesh, kurse Gafuri u radhitë para meje, por dikush na u fut mes nesh. Doli se ishin rreshtuar afërsisht gjysma e të burgosurve, sepse shumë të burgosur ishin shpërndarë nëpër kënde dhe hapësira të ndryshme të burgut, ku edhe e kanë kaluar natën.
Brenda pak sekondave mbi murin e burgut kemi parë dalje të njerëzve me uniforma ushtarake. Në krahun e djathtë të rreshtit e kishim karakollin, prej na ftonin të rreshtohemi. Në ato çaste në mënyrë të koordinuar ka filluar të na godasin me armë të të gjitha llojeve. Goditja bëhej nga të tri anët e rreshtave: nga përpara, nga djathtas dhe nga shpina.
Nga breshëria e madhe e plumbave, granatave, automatikëve e snajperëve, që vinin nga të gjitha anët, unë kam parë të bien para meje shokët dhe shpejt jam mbuluar prej trupave të tyre. Unë, me Ylber Topallin e Agim Reçicën jemi tërhequr zvarrë nëpër plumba, sikur kanë bërë edhe shumë të tjerë. Duke i ndihmuar njëri - tjetrit kemi arritur të strehohemi në një sipërfaqe më të ulët nga niveli ku ishim në rreshtat e ekzekutimit.
Në këtë masakër mbi të burgosurit shqiptarë kanë mbetur të vrarë rreth 100 vetë dhe mbi 150 – 180 të plagosur, shumë prej tyre me plagë të rënda vdekjeprurëse. Pas dy - tri orëve të plagosjes, vdiq

Danush Kurtaj. Në rreshtin e transferimit - ekzekutimit i kam njohur të vrarët Avdylgafur Lumën, Tefik Rakën dhe një djalë të ri nga Dardana (Kamenica), Musa Morinën. Avdylgafuri ishte vrarë nga një plumb i rënë nga shpina. Kur kemi tentuar t`i vëmë shenjë identifikimi Gafurit, që të mund të identifikohet më vonë, kemi parë se ai kishte të veshura të brendshme të leshta dhe kemi thënë se mjaftojnë ato për t`u identifikuar nga familja apo nga shokët, nëse mbeten gjallë, kujton Xhevat Haziri nga Vitia.

Me Gafur Lumën, gjatë burgut të dytë, jam takuar më 19 maj 1999 në burgun e Dubravës, pasi i thyem dyert e burgut dhe dolëm në oborr, por mbetëm brenda mureve të burgut pasiqë ai ishte i rrethuar në të katër anët nga forcat serbe. Bashkë me mua ishin edhe Sherif Berisha, Shefket Topojani e Valon Berisha, të cilët Gafurin po e njihnin për herë të parë. Që në takimin e parë më pyeti: Shaban, a din gjë për familjen dhe vëllezërit e mi? E vërejta se nga shqetësimi që kish, ia kishte ndier zemra se diçka kishte ndodhur në familjen e tij. E binda se familjen e ke ,,mirë“ dhe se kanë shkuar në Tetovë, ndërsa për vëllezërit i thash që i ke në luftë. Nuk i tregova se i është vrarë vëllau i tij Qaniu më 8 mars 1999, nuk munda. Në fakt kisha në plan t`i tregoja në ndonjë rrethanë pak më të mirë, por...
Gafur Luma vritet në burgun e Dubravës nga forcat pushtuese serbe në mëngjesin e datës 22 maj 1999. U vra në të ashtuquajturën Fusha Sportive e burgut, bashkë me 150 shokë të tjerë, pasiqë paraprakisht niveli më i lartë shtetëror serb, kishin sajuar kurthin dhe ftuan të burgosurit që të tubohen kinse për t`i transferuar në

burgun e Nishit. Në momentin kur të burgosurit tubohen, fillimisht nga karakolli, të burgosurit sulmohen me granatahedhës dhe pastaj në të gjitha anët me mitraloz, bomba, automatik e snajper. Ishte një krim i organizuar shtetëror serb. Sipas dëshmisë së të mbijetuarit Xhevat Haziri nga Vitia, Gafur Lumën plumbi e mori nga shpina dhe i doli në gjoks dhe pos Gafur Lumës u vranë edhe: Prof. Mejdi Dalloshi, Mr.Tefik Raka e Danush Kurtaj, ndërsa nga Hani i Elezit, i mituri 17 vjeçar, Suad Brava.

Informatën për vrasjen e Gafur Lumës në Fushën Sportive, e kam marrë në bodrumin e menzës, ku pas sulmit, arritëm që të barikado-hemi. Lajmin e mora nga Avni Klinaku, shok burgu i imi dhe i Gafurit që nga burgu i parë. Ishte një lajmë i rëndë.

Në fakt, Gafur Luma u plagos në kokë (nga copat e betonit) edhe më 19 maj, tri ditë para se të vritej. Gafurri ishte në një dhomë me shokët e vrarë: Enver Topalli nga Ferizaj, Avdullah Tahiri nga Gjilani e Gjokë Ndrecaj nga Gjakova.[120] Fashoja e mbështjellë rreth kokës së plagosur të Gafurit, i përngjante plisit të bardhë kombëtar me të cilin ai krenohej edhe gjatë aksioneve ilegale, edhe gjatë demonstratave popullore për Republikën e Kosovës.

Bislim Zogaj[121], ish i burgosur politik nga Drenasi, kujton:

Më 19 maj ka bombarduar NATO për herë të parë në pavijonin "C" , aty kanë mbetur të vrarë 3 të burgosur dhe dy të plagosur i kemi bartur unë, Gafur Luma që

[120] Raif Qela: Gafur Luma ishte i plagosur dhe ka qenë në një dhomë me Enver Topallin (Ukë Thaçi ,,Masakra në burgun e Dubravës" fq.321)

[121] http://www.pashtriku.org/?kat=63&shkrimi=412

tash është dëshmor, dhe dy të tjerë nga Pavioni "C" sepse kanë qenë shumë të plagosur, u dashtë t'i bartim me batanije, kam menduar që ata do të vdesin por pas një viti kam kuptuar që ata kanë mbijetuar, ka qenë e tmerrshme njëri e ka pasur kafkën të thyer krejt dhe tash ashtu e ka...

Skënder Ferizi [122], ish i burgosur politik nga Ferizaj, kujton:

Një detaj, në rrethana tepër të rënda në bugun e Dubravës, e tregon edhe i mbijetuari i kësaj masakre, Skënder Ferizi nga Ferizaj të datës 19 maj 1999. ,, Kur kemi dalur nga pavijoni unë isha në mesin e tre të plagosurve dhe ndihmën e parë na e ka dhënë një mjek serb, pas bombardimit të parë të NATO-s. Gafurit i thanë shko te biblioteka, mua më thanë që të shkoj te dera dhe të pres jashtë. Bisedova me Gafurin dhe po i them nëse shkoj atje do të na vrasin. Gafuri tha: Mos shko, eja me mua! Kjo ndihmë e Gafurit për mua, ishte vetë jeta."

Bajrush Xhemajli [123] , ish i burgosur politik nga Komogllava e Ferizajt, kujton:

Kur vendosëm për t`i dërguar te një pavijon të plagosurit, më mungonte Gafur Luma. Pyesja, din kush ku është Gafuri? Më treguan se është vrarë me një plumb. E kam dashur shumë atë djalë dhe fillova të qaj aq shumë, qava si fëmijë...

Ish i burgosuri tjetër nga komuna e Kaçanikut, **Hasan Dalloshi**[124], gjatë burgut të dytë të Gafur Lumës, kujton se ne u burgosëm në ditën që u vra dëshmori Agim Bajrami, përkatësisht komandant ,,Zefi". Torturat ndaj

[122] Ukë Thaçi ,,Maskra në burgun e Dubravës'' Prishtinë 2011, fq.324
[123] Ukë Thaçi ,,Masakra në burgun e Dubravës'' Prishtinë 2011, fq. 338
[124] Shënimet janë marrë në muajin prill 2017

nesh e rrjedhimisht edhe ndaj Gafur Lumës ishin të rënda. Në Gjilan, Gafuri ka qëndruar në katin e parë dhe dhoma e tij ishte afër kantajnerit të mbeturinave. Kur zbrazja shportën në shëtitore, duke u ruajtur nga karakolli vëzhgues, ndërroja ndonjë fjalë me Gafurin nëpërmjet dritares, pasi ai e linte dritaren gjysëm të hapur sa për të marrë ndonjë informacion nga shokët nga ana e jashtme. Përgjigjen nuk e prisja, sepse mund të më hetonin gardianët, por porosia futej brenda në dhomë. Kishte raste kur me Gafurin shkëmbenim informacione edhe në gjuhën frenge për aq sa e dinim që edhe nëse eventualisht dëgjoheshim nga gardianët të mos na kuptojnë dhe të gjitha këto i bënim vetëm kur ishte koha e shëtitjes. Kaq ishin mundësitë. Kujtoj se, kur dolëm në gjyq, ai mbajti një qëndrim dinjitoz, ishte i palëkundëshëm në qëndrimet e tij dhe i mohonte ngarkesat e aktakuzës. Kur na transferuan në burgun e Dubravës, pësuam tortura të rënda. Pasiqë u takuam me atë edhe fizikisht më 19 maj 1999 në Dubravë, kur tanimë ishte sulmuar burgu, Gafur Luma kishte parandjerë vdekjen e tij dy ditë para se të vritej. Hasan, më tha ai, ne në këtë burg do të vdesim, le ta gëzojnë lirinë fëmijët tanë ! - kujton shoku i burgut Hasan Dalloshi.

Raif Qela, ish i burgosur politik nga Mitrovica, kujton[125]: Ditën e fundit para se Gafuri të binte nga refalet e trupave serbe, kemi qëndruar pothuajse tërë ditën bashkë. Kokën e kishte të lidhur nga plagët që mori gjatë bombardimit të datës 19 maj 1999. Nën kërcnimet e sulmeve ajrore, qëndronim barkas dhe ndërmjet dy

[125] Shënim i datës 28.7.2017

sulmeve bisedonim për jetën. Nuk e dinte se pas disa orëve do të vritej.

Prof.dr. Sali Bytyçi, ishi burgosur politik nga Rahoveci, kujton:

Nuk shkuan shumë minuta kur fillova të dëgjoj disa krisma që, krahasuar me krismat e një dite më parë, dukeshin si një shaka pa kripë... Po shumë shpejtë e kuptova se kjo ishte një shaka tragjike: plumba mitralozi, bomba dhe granata dore u hedhën sa mundën mbi kokat tona. Unë isha ende pa lëvizur nga vendi, duke u përpjekur të di çfarë po ndodh, kur rreshtat e parë më ranë mbi. Nuk mund ta di se sa veta më ranë mbi, po ata ranë mbi mua siç bien fijet e barit nga kosa. Gjatë kohës kur isha nën këta trupa të kositur nga rafalet, mbi trupat e tyre që ishin mbi mua, pikërisht mbi trupin tim, mirë i dëgjova edhe dy shpërthime granatash dhe bërtimën e atyre që po masakroheshin... Ashtu siç isha nën ata që po masakroheshin, prej grumbullit të tyre dola dhe me shpejtësi u largova në drejtimin e kundërt...

Një kujtim domethënës për dëshmorin ndanë edhe **Ukshin Qallaku**[126], vëllau i ish të burgosurit politik Ferid Qallaku nga fshati Gajre të Kaçanikut: Me Gafur Lumën jam njohur që herët, pasiqë vëllau im ka bashkëvepruar me atë që nga viti 1979. Krahas të tjerave mund ta veçoj dy detaje. Derisa ishim duke biseduar me Gafurin, afër stadionit të futbollit në Kaçanik, për herë të parë nga ai kam mësuar se është formuar Ushtria e Kosovës, pra UÇK-ja. Vitin nuk e mbaj mend sakt, por mendoj se ishte

[126] Shënimet janë marrë më datën 4 maj 2017 dhe 5 qershor 2017

pjesa e parë e vitit 1995[127] ose 1996, kujton ai.

- Ukshin, është formuar ushtria, - më tha Gafuri.
- Nuk e besoj, - i thash.
- Seriozisht e kam, - më tha Gafuri.
- Nga kush është formuar - e pyeta në vazhdim.
- Nga njerëzit më të mirë të kombit- u përgjigj ai.

Kjo ishte para se të flitej për UÇK-në, ishte hera e parë që e dëgjoja këtë lajm. Edhepse kisha kontakte me shokë të ndryshëm, këtë nuk ma pat thënë askush, mendoj se ishte i pari që dinte këtë gjë në trevën tonë.

Edhe një takim që kam pasur para shkollës së mesme ,,Skënderbeu" nuk mund ta harroj kurrë. Derisa i pari ishte lajm i gëzuar, i dyti ishte i zymtë. Ishte dita kur policia serbe e kishte ftuar në bisedë informative dhe ai kishte humbur,,qeren". Ky ishte edhe takimi im i fundit me Gafurin e shtrenjtë, kujton Ukshin Qallaku nga fshati Gajre i Kaçanikut.

Pas vrasjes së Avdylgafur Lumës me 22 maj 1999 në burgun e Dubravës, serbët kufomën e tij dhe të burgosurve të tjerë do t`i varrosin në varrezën masive të fshatit Rakosh të Istogut, ku pas lufte bëhet edhe zhvarrimi i tyre. Pjesëmarrës në gjetjen, identifikimin dhe zhvarrimin e dëshmorëve ishte edhe zv.komandanti i Brigadës 162 ,,Agim Bajrami" të UÇK-së, **Kolonel**

[127] Mendoj se është pjesa e parë e vitit 1995, pasiqë të njëjtin lajm ma ka thënë edhe mua derisa po shëtisnim te Kalaja në Kaçanik. Nuk mund të jetë viti 1996, pasiqë nga Kosova jam larguar në qershorin e vitit 1995, ndërsa muaji shkurt dhe mars 1996 më ka gjetur në Tiranë, përkatësisht në spital dhe në atë kohë e kam ditur për ekzistimin e Ushtrisë, por më shumë nuk dija sepse më shumë as Gafuri nuk më tregoi.(Plotësim i autorit)

Hajrush Kurtaj[128], njëherit i vëllau i dëshmorit Danush Kurtaj, i cili në vazhdim jep këto të dhëna rreth zhvarrimit:

Në javët e para të gushtit 1999 kam shkuar në burgun e Dubravës disa herë me bashkëluftëtarët Haki Tronin, Shefket Tronin, Shefket Palloshin, dhe Musa Tronin. Kemi hyrë nëpër ambientet e burgut sepse në fillim nuk kishte kurrfarë mbikqyrje. Gjatë vizitës së ambienteve të burgut kemi parë gjurmët e krimit, por në bisedë me disa qytetarë aty përreth kemi mësuar se të burgosurit që janë vrarë forcat serbe i kanë varros me një varrezë masive në fshatin Rakosh në periferi të burgut të Dubravës. Një nga masakrat më të mëdha që kishin bërë forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe në Kosovë, është edhe masakra e bërë në burgun e Dubravës. Të vrarët e të masakruarit, serbët i kishin varrosur në fshatin Rakosh. Nga 20 gushti kemi bërë kërkimin e trupave të pajetë të vëllaut Danushit ku më 22 gusht 1999 është bërë identifikimi. 25 gushti 1999 ishte një nga ditët më të rënda në jetën time. Përjetime të njejta kanë shprehur edhe antarë të tjerë të familjes. Pothuaj tërë ditën ishim të angazhuar në zhvarrosjen e vëllaut Danush Kurtaj i cili ishte i varrosur në varrezën masive në fshatin Rakosh. Dua të theksoj edhe një gjë, në një mënyrë, e ndjenim lehtësinë shpirtërore. Kjo ndodhi pasiqë dinim ku do të jetë varri i Danushit dhe fati i tij tani na ishte i qartë. Nga ana e familjes sime, në fshatin Rakosh ishim: unë, Bedri Kurtaj, Isuf Kurtaj, Qazim Kurtaj, kushërinjtë tanë, Shaban Rexha nip i yni,

[128] Shënim i Kolonel Hajrush Kurtaj i cili i është përcjellë autorit më 15.7.2017. Më gjerësisht shih librin: Kolonel Hajrush Kurtaj „ Në rrugën e lirisë'', Prishtinë 2012, fq. 452-457

Sevdije Rexha mbesë e jona, Emine Kurtaj nëna e imja, e Danushit dhe Xheladinit, Bilkizare Kurtaj bashkëshorte e Danushit, Lebibe Kurtaj-Ahmeti kushërirë e Danushit. Nga familja e Avdylgafur Lumës ishin: Hydajete Luma bashkëshorte e Gafurit dhe vëllezërit e Gafurrit dhe kushëriri. Nga familja e Tefik Rakës ishin: Demush Raka vëlla i Tefikut, Sanije Raka bashkëshorte e Tefikut, Jeton Raka djali i Tefikut. Nga familja e Mejdi Dalloshit ishin: Isa Dalloshi vëlla i Mejdiut, Valon Dalloshi djalë i Mejdiut, Artan Dalloshi djalë i Mejdiut si dhe motrat e vëllezërit e Mejdiut. I angazhuar me kamionetë ishte bashkëluftë-tari i ynë Hajrullah Shehu me dy të tjerë. Ishte një udhëtim i përbashkët i familjarëve që i morëm trupat e pajetë të bijëve, vëllezërve tanë, tani dëshmorë të kombit. Qëndrimi i përafërt në një mënyrë ishte ngushëllim i madh për të gjithë ne. Siç thashë edhe më lartë, për çdo ditë kemi udhëtuar në drejtim të fshatit Rakosh, komuna e Istogut deri sa e bëmë identifikimin e trupave të pajetë, kujton Hajrush Kurtaj.

Pjesa e të burgosurve që mbetëm të paekzekutuar nga masakra me 22 maj 1999 në burgun e Dubravës, më 24 maj na transferuan për në burgun e Lypjanit e nga Lypjani me 10 qershor 1999 na tërhoqën si pengje lufte për në burgjet serbe ku përjetuam gjithë tmerrin shovinist antishqiptarë. Në mesin tonë ishin edhe shokët e plagosur rëndë nga sulmi më 22 maj, ku torturoheshin edhe nga mjekët dhe gjendja e tyre ishte shumë e rëndë. Ishte një transferim i tmerrshëm dhe me shpirtëra të thyer. Jeta jonë vlente jo më shumë se një fishek pushke dhe në çdo moment prisnim edhe pushkatimin tonë. Krahas 150 të burgosurve të tjerë të

komunave të ndryshme, në burgun e Dubravës mbetën të vrarë edhe pesë të burgosur të komunës së Kaçanikut: Gafur Luma, Danush Kurtaj, Mejdi Dalloshi, Tefik Raka e Suad Brava nga Hani i Elezit i cili ishte i mitur me vetëm 17 vite e tre muaj jetë dhe nuk kemi ditur më për fatin e kufomave të tyre. Se ata kanë përfunduar në varrezën masive të Rakoshit, kemi mësuar pas lirimit tonë nga burgu. Nga vetë shkrimi në numrin e varrit i datës 26 maj 1999, kuptojmë se varrimi i tyre është bërë po me këtë datë.
Pasi dola nga burgu më 10 gusht të vitit 2000, në përvjetor të rënies së shokëve, bashkë me shokë të tjerë vizituam burgun e Dubravës dhe vendin e rënies së shokëve tanë. Kur në mbrëmje u ktheva në shtëpi, në gjumë mu shfaq vendi se ku u ekzekutuan mizorisht të burgosurit. Nga toka shpërthenin pisha të vogla rrubullake në formë të dritës vezulluese që t`i verbonin sytë. Nga këto drita vezulluese më doli edhe gjumi, rrjedhimisht edhe ëndërra. S`dita çka të bëj tjetër, pos që ngrita duartë në drejtim të qiellit dhe u luta për shpirtërat e shokëve të mi fisnik.

Varri me numrin 77 është vendi ku u varros Gafur Luma në varrezën masive në Rakosh të Istogut. Nga e majta, vëllau Emini dhe axha Raifi si dhe shokët e Gafurit, Xhemil Ismani e Menduh Leka.

Familjet e dëshmorëve, me trupat e pa jetë të më të dashurve të tyre: Prof.Mejdi Dalloshi, Mr.Tefik Raka, Gafur Luma, Danush Kurtaj e Suad Brava në varrezën

masive të Rakoshit[129]

Dëshmori Gafur Luma, farën e lirisë e kishte mbjellur kudo. Ai me aktivitetin e tij ilegal, që nga viti 1979 e këtej e kishte përhapur zërin e lirisë. Krahas bashkëmendimtarëve të tij që i kalonin caqet e komunës së Kaçanikut, Gafur Luma një aktivitet të tillë e kishte edhe në familjen dhe farefisin e tij. Që të ndriçoj rrugën e lirisë, ai materiale ilegale iu dha edhe matrave dhe vëllezërve të tij dhe kjo dëshmohet gjithanshmërisht. Shpirtin luftarak për liri, Gafuri e kishte mbjellur edhe te vëllau Qaniu i lindur në vitin 1976. Ai iu bashkangjit radhëve të UÇK-së që në mundësinë e parë duke luftuar ballë për ballë me armikun. Qania, kujton **Hydajete Luma** bashkëshortja e Gafur Lumës, njëherit kunatë e Qaniut, ishte një njeri me plotë energji për liri. Qaniu në vazhdimësi kryente aktivitete atdhetare. Kalonte edhe njerzë të plagosur në kufi. Një natë na tregoi se andej kufirit, nxori një vajzë të plagosur, një natë tjetër më tregonte se futëm armatim e të ngjajshme. Gjitherë thoshte, unë me flamur do të mbulohem dhe ashtu ndodhi. Qani Luma, ra heroikisht me 8 mars 1999 si pjesëtarë i UÇK-së në fshatin Ivajë të Kaçanikut në përballjet frontale me pushtuesin serb, si ushtar i Brigadës 162 ,, Agim Bajrami ".
Me Gafurin, kujton më tej bashkëshortja e tij Hydajetja, u martuam më 26 korrik 1992. Bëri një dasëm me miq e shokë. Ishte një njeri me vyrtyte të larta njerëzore dhe krejt qenia e tij ishte e përqëndruar në lirinë e Kosovës dhe për këtë liri flisnim gjatë. Ai ëndërronte lirinë.

[129] Fotografitë janë siguruar nga Hajrush Kurtaj

Pothuajse çdo natë vinin mysafirë nga anë të ndryshme. Vinin shokë që kërkonin ndihmën e tij për t`i nxjerrë andej kufirit në Maqedoni. Nuk mund t`i mbaj mend të gjithë, pasiqë disa i kam njohur e disa jo. E di që në kufi ka kaluar një shok të burgut të parë Bashkim Mazrekun nga Prizreni të cilit Gafuri ia dha edhe një kaçketë. Nga jashtë, në Kosovë futi edhe një mik të Mehmet Hajrizit. Për t`i ikur një arrestimi, andej kufirit nxori edhe tanimë dëshmoren Hyrë Eminin. Andej kufirit i nxori edhe dy shokë nga Suhareka. Shumë, shumë, shumë shokë ka nxjerrur andej kufirit për t`iu shpëtuar serbëve, nuk mund t`i mbaj mend të gjithë, pasiqë disa i kam mbajtur mend, shumë të tjerë jo. Më 13 qershor 1993 u lind Lirimi, ndërsa më 17 shkurt 1995 lindi Kaltrina. Ishte gëzim i madh familjarë...
Në shtëpinë tonë ishin edhe Xheladin Gashi, Nait Hasani, Bislim Zogaj. E di që merreshin me armë. Ishte janari i vitit 1996, kujton Hydajetja, por sikur të ishte gjallë Emini do t`ju sqaronte më shumë. Pyeteni edhe Bacin (Raif Lumën) për këto punë. Ai di më shumë. Ishte një jetë e tëra luftë. Para se ta arrestojnë për herë të dytë, policia serbe tri herë e ftoi në biseda informative në Kaçanik dhe e pyesni për gjithçka.
Në orët e hershme të mëngjesit të 10 gushtit 1998 e arrestuan me forca të mëdha policore.Ishte rrethuar shtëpia dhe lagjja. E rëndë ishte ajo ditë për ne, kujton Hydajetja, për të vazhduar se Gafurin e mbyllën në burg të Gjilanit dhe e kemi vizituar rregullisht. Bisedat ishin nën përcjellje të policisë, por vërehej se ai torturohej edhe në burg. Shpesh herë merreshim vesh vetëm me sy. Për ta dënuar e dërguan në Prishtinë dhe gjykimi zgjati disa ditë. Në vizita na ndihmonte migja Raifi, duke na

dërguar me makinë, pastaj dr. Nejaziu, Sheip Luma, Izahir Luma, Nevait Luma... ishte një solidaritet shoqëror e familjar.
Pasi u dënua me gjashtë vite, i kërkoi që në vizitë t`ia qoja edhe fëmijët Lirimin e Kaltrinën. Si më tha edhe bëra...
Me 8 mars 1999 zhvilloheshin luftime të rënda në fshatin Ivajë e rrethinë. U detyruam të ikim nga fshati, dolëm në Jazhincë e nga Jazhinca në Orasht te motra e Gafurit, Nexhmija e pastaj te halla Latife. Në mbrëmje morëm vesh se është vrarë Qaniu. Ishte dhembje e madhe. Tentoja t`i jepja ,,gajret" vjehrrës Zylfije. Krahas kësaj, vazhdon rrëfimin e saj Hydajetja, na u shkëputën totalisht lidhjet me Gafurin në burg. Nuk dinin më asgjë. Kështu në pritje dhe ankth kaluam muajë të tërë, derisa pas lufte nga burgjet serbe u lirua Bajrush Xhemajli i cili edhe solli lajmin e rëndë për Gafurin. Mu duk se ra qielli. I mora në përqafim fëmijët e mi Lirimin e Kaltrinën dhe ja bashkërisht po i përballojmë edhe këtyre dhembjeve të cilat i shpaguan vetëm liria e Kosovës, vetëm liria për të cilën Gafa e ëndërronte shumë e për të cilën dha edhe jetën.[130]

Familja Luma, ishte çerdhja e lirisë dhe e qëndresës shqiptare në krye me nënëshqiponjën Zylfijen, një grua burrëresh, tanimë e ndjerë e cila me të gjithë bijtë e saj luftonte për lirinë e vatanit dhe nga katër djem që kishte, dy i fali atdheut; Gafurin dhe Qaniun, ndërsa Eminin tanimë edhe ai i ndjerë, veteran i UÇK-së. Kjo familje me taban të shtresuar kombëtarë priti e përcolli ditën e natën, qëndrestarë nga vende të ndryshme.

[130] Bisedë e zhvilluar më 9.12.2017 në Kaçanik

Besnikëria kombëtare e Gafur Lumës, jo vetëm që nderonte familjen, fisin e fshatin, por ajo nderonte edhe Sharrin Dardan e bashkë me atë edhe atdheun epik.
Kur u martua në vitin 1992, në dasmë ftoi shumë shokë të ilegales. Mbaj mend një diskutim të tij para shokëve dasmorë:
,, Qerrja ka mbetur keq në baltë. Me ne janë të gjithë ata që synojnë dhe përpiqen që këtë qerre ta nxjerrin nga balta. Me ne nuk janë dhe nuk mund të jen vetëm ata që qerres i kanë hipur sipër dhe dëshirojnë që ta fundosin edhe më thellë".
Dëshmori Gafur Luma, nga instrumentet muzikore preferonte fyellin, ndërsa prej këngëve, atë të Malësisë së Lumës.
Sa ishim bashkë në burgun e Gurakocit, në vitin 1988, gjatë shëtitjeve që bënim në oborr të burgut, krahas bisedave rreth ngjarjeve që po zhvilloheshin, Gafuri recitonte me një ndjenjë të veçant poezi nga shypi ilegal të lexuara para se të bie në burg, sa që njeherë i thash ti je *Bilbili i Këngëve të Lirisë*.
Një ditë nga biblioteka e burgut të Gurakocit, mora një libër me poezi të autorit Nuhi Vinca me emrin ,,Aty buzë liqenit". Krahas poezive të tjera, në këtë libër ishte edhe një poezi e bukur që i kushtohej Kaçanikut dhe Grykës së tij famëmadhe. Me që ishim të kësaj ane, poezinë e lexuam dhe e komentuam bashkërisht me Gafurin. Sa për ilustrim po e rikujtojmë një pjesë të saj:
Gryka e Kaçanikut:
Nëpër këtë grykë
Kaluan hordhitë e
Sulltanëve
Dhe thyen qafën

Bashkë me shekujt e zinj
Pa mund të ta përtypin
Emrin tënd gur
Emrin tënd shkëmb
Emrin tënd rrufe.
Ua hëngre kafkat
Ua dërmove eshtrat
Ua tërbove kuajt-
Hingëllimat
Ushtimë shpërndajnë
Si zë varresh natën
Si këngë vajtimi pagan…

S`kam si të mos e rrëfej edhe një kujtim nga burgu i parë në Gurakoc:
Një fyell, s`di se kah i erdhi në duart e Gafur Lumës, ndoshta nga të burgosurit që ishin në ,,tipin e lirë" dhe më tha që t`ia ruaja derën nga gardianët derisa të çmallej me melodinë e bukur të fyellit. Si më tha, ashtu veprova dhe derisa i dëgjoja melloditë e bukura nga fyelli i Gafur Lumës, në vetvete thash:
Eh, sa mall ka shqiptari për atdheun e tij, për këngën dhe melodinë baritore shqiptare! Eh,...!
Pas vrasjes së tij, në shenjë nderimi e krenarie, shkolla fillore në Qafshqipe mori emrin e tij dhe në oborr të shkollës, bashkëfshatarët kanë ngritur bustin e dëshmorit, aty ku edhe mori mësimet e para dhe për çdo muaj maji; nxënës, arsimtarë e veprimtarë anë e kënd Kosovës, Shkupit e Pollogut, me lulekuqet e Kosovës, përkujtojnë Bilbilin e Këngëve të Lirisë.

Veprimtari Bajrush Xhemajli i sapoliruar nga burgjet serbe (pas lufte), në gjirin e familjes Luma. Në fokus nëna e dy dëshmorëve, Zylfije Luma.

Dëshmori Qani Luma (1977-1999), rënë më 8 mars 1999 në Ivajë të Kaçanikut si ushtar i UÇK-së

Momente nga varrimi i dëshmorit Qani Luma në varrezat

e Ferizajt

KAPITULLI IV - Gafur Luma nëpër shkrime e përkujtime të autorëve të ndryshëm

Menduh Leka, njëri nga shokët e dëshmorit, në përkujtim të jetës dhe veprës së Gafur Lumës

Menduh Leka, shok i Gafurit, kështu kujton momentin kur e viziton Gafurrin në burgun e Gjilanit:
Më 19 mars 1999 për shkak të luftimeve dhe masakrave në zonën e Kaçanikut, rrugët ishin bllokuar dhe popullsia kishte lëshuar brezin kufitar. Gafa ishte në burgun e Gjilanit i dënuar me 6 vite heqje lirie nga gjykata serbe. Anëtarët e familjes nuk mund t`i shkonin në vizitë, prandaj me një autorizim nga avokati shkova në burgun e Gjilanit për ta vizituar dhe për t`i dërguar ndërresat e trupit, bashkë me to edhe pak gjëra ushqimore e cigare, sepse kohëve të fundit e pinte shumë duhanin. Kur më pa u ngazëllye dhe pas grilave më jepte kurajo se patjetër do të bëhet mirë pasi ia bëra me dije në mënyrë simbolike për rrethanat në fshat dhe mosardhjen e familjes. I kisha dërguar këmishën time të

dimrit dhe ndërresa tjera. I mora të tijat për t`i pastruar. Kjo ishte vizita e fundit dhe takimi im i mbramë, të cilin e bartë si medaljon në kujtime...

Lajmin për ekzekutimin e Gafës, vazhdon më tej Menduh Leka në shkrimin e tij, e konfirmoi Bajrush Xhemajli, i cili si dëshmitar i ngjarjes dhe shok i tij na e kumtoi të vërtetën. Të gjithë të ekzekutuarit i kishin varrosur në varrezat afër fshatit Rakosh. Identifikimi i kufomave u bë përmes teshave. Disa herë shkuam me të familjes derisa identifikuam ndërresat, këmishën e dimërit, jelekun karakteristik(të leshtë) që çdo herë e mbante. Ai gjak i përzier me dheun e tokës së Kosovës, Gafës iu bëftë dritë![131]

Duke folur për virtytet e dëshmorit, Menduh Leka kujton se Gafuri kishte bujarinë e krahas kësaj kishte edhe trimërinë për t`u flijuar për idealet më të shtrenjta. Ai në çdo kohë, kishte trasuar rrugën e lirisë dhe ndërtimin e sajë e kishte përcaktim jetësor. Kur për shumëkend, fjala ideal ishte harxhuar, ai projektonte shtigje lirie sepse ishte i bundur se kombi pa ideale shkonte drejt zhbërjes. Pjekuria e tij politike nuk rridhte nga kurset atdhetare për atdheun, por ajo ishte shprehje e formimit të tij të thellë kombëtar. Gafa ishte operativ dhe taktik dhe ishte i gatshëm të flijohej cdo herë për lirinë,[132] kujton shoku i tij, Menduh Leka.

[131] Burimi: Menduh Leka „ I denjë për lapidar lirie'' pjesë nga ky shkrim.
[132] Burimi: Arkivi i familjes së dëshmorit:Fjala e Menduh Lekës në video

Rexhep Selimi

Në përkujtimorin e vitit 2002, krahas veprimtarëve të tjerë, në tubim ishte edhe anëtari i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së **Rexhep Selimi**, i cili këtyre shkrepave kishte qenë që në shkurtin e vitit 1996 dhe pasi bëri zbulimin e bustit të dëshmorit, para të pranishmëve, ndër të tjera tha:

Jam i lumtur që sot marr pjesë në tubimin përkujtimorë për dëshmorët e kësaj ane dhe në veçanti për dëshmorin të cilin e kujtojmë sot. Njëkohësisht kam nderin që sot gjendem në mesin tuaj, që gjendem në maje të këtyre shkrepave që janë mburoja morale dhe fizike e kufinjëve të Kosovës. Prandaj, për ta realizuar amanetin e dëshmorëve dhe dëshmorit që kujtojmë sot, na dalin shumë detyra përpara dhe këto detyra janë një kompleks në vete, kompleks i cili formohet në shumë drejtime dhe shumë mënyra dhe ne duhet të jemi shumë të përpiktë dhe shumë të gatshëm, qoftë edhe për t`u sakrifikuar që amaneti i dëshmorëve të realizohet deri në fund. Dëshmorët janë dëshmia më e madhe se kush ishte UÇK dhe kush ishte populli i Kosovës, njëkohësisht janë dëshmia më e madhe se çka

synon populli i Kosovës dhe si duhet të jet populli i Kosovës. Prandaj, për ta realizuar amanetin e dëshmorëve, çdo shqiptarë duhet ta ndjej si obligim moral dhe qytetarë se toka e Kosovës, kufijtë e sajë dhe shqiptarët kudo që janë, nëqoftëse nuk mbrohen nga të tjerët, ata duhet t`i mbrojmë vet, tha ai.

Besim Zymberi nga Ferizaj ishte bashkëvuajtës politik me dëshmorin Gafurr Lumën në burgun e dytë dhe njohës i mirë i tij. Në manifestimin e organizuar në pesë vjetorin e rënies së dëshmorit, kujton:

Unë me Gafurin isha në dhomën 31/2 të ndërtesës C të burgut të Dubravës. Kishim marrë një urdhër të ashpër që të mos flisnim fare qoftë edhe me zë të ulët, ndaj një shpirt artisti, një shpirt atdhetari nuk mund të duronte dot atë ndrydhje. Nga ne sa ishim të pranishëm në dhomë, afro 20, ishte pikërisht Gafuri ai që filloi ta thyejë heshtjen i pari. Ishte Gafur Luma ai që kishte një dell më të madh artisti dhe kur fliste nga dhoma 31 e burgut të Dubravës, nuk qante hallet, por bënte poezi qoftë kur tregonte se si nisej nga Gllloboçica për Ferizaj apo se si i dërgonte fëmijët e tij te dajot në Begracë dhe vazhdimisht ankohej se ishte dëmi i madh se nuk kishte një laps[133]

Gafur Luma, nëpër kohë të ,,serta", formësonte personalitetin e tij. Personaliteti i tij nuk krijohej në dhoma të mbyllta, sepse tanimë Gafuri, kishte një përvojë të thellë me grupe ilegale, kishte një përvojë edhe të ballafaqimit me mekanizmat e shtetit okupues, UDB-së, por megjithatë ai nuk pranonte mbylljen në vetëvete, nuk pranonte izolimin, por kërkonte edhe hapësira të tjera. Në rrjedhë të këtyre hapsirave ai bashkëpunonte

[133] Gazeta ditore ,,Epoka e Re'', 23 maj 2004

edhe me rrethe të tjera shoqërore si të artit e të kulturës dhe kishte kohë që kishte tejkaluar veprimin provincial. Gafur Luma, viteve të `90-ta, shquhej në bashkëpunim me shumë veprimtarë e në këtë rast edhe me Bardh Frangun në Ferizaj dhe grupin rreth tij dhe ky i fundit, me rastin e përurimit të bustit të dëshmorit në Qafshqipe, dëshmorit ia kushtoi këtë poezi:
Bardh Frangu
Leximi i ëndrrës që s`vdes[134]
(Dëshmorit Gafur Luma)

Më prit në oborr të shkollës
Asnjë fjalë mos ma thuaj hesht
Vetëm ballin le shpaluar
Të ta lexoj ëndrrën që s'vdes.

Kafeja është ftohur në "Kështjellë"
Është thyer edhe filxhani i saj
Kohë e gjatë është arnuar me plagë
Tash kudo që preku më dhemb.

Mbaju he burrë në këtë mal me sy
Kam frikë kush mund të të marrë mësysh
Dritaret e shkollës të bëjnë dritë përmbi
Ka shumë diell këtu ka edhe shumë fëmijë.

Bëjmë lum o Lumë që të kemi
Që s'do ta kalosh më kufirin ilegalisht
S'do t'i lidhin më duart me pranga
Të pastë hije jeta në këtë bust o mik!

[134] Poezia është marrë nga Arkivi i familjes së dëshmorit

Gllboçicë, maj 2002

Në përvjetorin e 17 të rënies së dëshmorit, në ditën kur kremtohej Dita e Shkollës, para të pranishmëve lexova një poezi si në vijim:
Gafurr Lumës
(Akrostik) në 17 vjetorin e rënies
Grushtin ngritur lartë, n`përballje me stuhitë
Amanetin e gjyshërve ta kurorëzoje me lirinë
Flamurshqipe ishe e shqipesharri, mbete
Urtësi e largpamësi në shpirt e mendje kishe
Rrugës tënde atdhetare, mbushur me lavdi.

Liri e Çlirim kërkoje, gjithandej kah udhëtove
Urë bashkimi ishe, me pietet sot të kujtojmë
Mal me lisa mbete, Ti kryengritësi dëshmor
Avdylgafur Luma i shtrenjtë, në rrënjë t`atdheut rron.

Në një shkrim, në përvjetorin e rënies, kështu e përkujton veprimtari dhe ish i burgosuri politik Berat Luzha, dëshmorin Gafur Luma:

Vëllezërit Luma - krenaria e Sharrit plak

,,Të paktë ishin ata që ishin të lidhur aq shumë me vendin e tyre, si ishte Avdilgafur Luma. Gafuri, apo Gafa, siç e quanin shkurt, në çdo rast ai i thurte lavde Sharrit dhe fshatit të tij të lindjes, Qafëshqipes, nga i cili nuk mund të largohej asnjëherë. Nuk mund të

largohej, sepse në shpirt kishte dashurinë e tij të madhe për vendlindjen dhe për Atdheun, sepse ishte i mishëruar aq shumë me idealin për çlirimin e vendit nga robëria shekullore. Gafuri ishte i lindur e i rritur në këto anë, në këto male të larta të Sharrit plak, nën Lybetenin plisbardhë, në fshatin e bukur malor. Por, ishte rritur bonjak, me skamje e vuajtje, duke i pasur edhe hallet e familjes në krye. Dhe, jo vetëm të familjes. Ai tashmë i kishte bërë të vetat edhe hallet e Kosovës. Qysh si nxënës i shkollës së mesme në Kaçanik, duke qenë në grupin e nxënësve përparimtarë e atdhetarë, ai nuk do të qëndrojë anash, nuk do të frikësohet për asnjë çast, por do t'i kushtohet e përkushtohet, me zell çështjes sonë madhore kombëtare. Kështu, edhe futet në organizmat e fshehta të kohës, për ta dhënë edhe Ai kontributin e tij të madh, veçanërisht në propagandimin e ideve dhe të idealeve kombëtare. Dhe, për pikëpamjet e tij atdhetare e demokratike, për veprimtarinë e fshehtë politike, regjimi okupues Gafurin do ta dërgojë në burg, do ta dënojë e do ta torturojë mizorisht. Burgun e mbajti, por, në vend se të "risocializohet", ai merr përvoja edhe më të mëdha, mëson në shkollën e madhe të jetës. Njihet e shoqërohet me atdhetarë të shquar nga e tërë Kosova, kompletohet me përvojë e njohuri, me cilësitë e një revolucionari të vërtetë, i gatshëm dhe i aftë t'i shërbejë Atdheut me forcë dhe elan në çdo kohë e në çdo vend. Kështu, burgu i bëhet shkollë e çmueshme e jetës, i cili Gafurin nuk do ta thyejë asnjëherë. Përkundrazi, do ta bëjë një patriot edhe më të përkryer. Pas lirimit të tij nga burgu, për të do të fillojë etapa tjetër, ajo e marrjes me veprimtari atdhetare, duke e kombinuar shumë mirë veprimtarinë

e fshehtë dhe veprimin e hapur. Në të vërtetë, Gafuri i nevojitej ilegales aq shumë, sidomos kur ishte problemi i kalimit të kufirit sapo të krijuar ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë. Ky kufi përshkonte, si një gjarpër i zi, tokën tonë vetëm disa qindra metra larg nga shtëpia e Gafurit. Shumë nga veprimtarët e dalluar, të cilët rrezikoheshin të qëndronin në Kosovë dhe për t'u ikur burgosjeve apo vrasjeve, ia mësynin të arratiseshin drejt kufirit dhe patjetër ia mësynin Gafurit, shtëpisë dhe fshatit të tij. Kurse, Gafuri, pa hezituar fare, me ndihmën edhe të vëllezërve dhe të familjes së tij, i mirëpriste dhe u dilte gjithnjë në ndihmë. Gafuri, prandaj, nuk ishte i vetëm në familje që merrej me veprimtari atdhetare. Ai i kishte me vete vëllezërit e tij, të cilët e ndihmonin në çdo kohë, duke kryer detyra dhe veprime me përgjegjësi të lartë, që ua caktonte vëllai i tyre më i madh. Ato detyra ishin: të përcilleshin andej e këndej atdhetarë të shquar për ta kaluar në mënyrë klandestine kufirin "shtetëror", për të ndihmuar për bartjen, kalimin dhe strehimin e armëve, që i sillnin me vete ata. Ishte tërë familja që i ndihmonte. Ishte edhe nëna që u ndihmonte bijve të vet, ishin motrat, ishte edhe nusja e tij, të cilën Gafa njëkohësisht e kishte edhe shoqe të idealit. Por, Gafurit do t'i ndihmonte sidomos vëllai i tij më i vogël, Qani zemërzjarrti, i cili asnjëherë fjalën nuk ia bënte dy. Ai ishte aq i shpejtë e i vendosur, kur duhej të kryhej një punë a një detyrë. Gafuri ishte i angazhuar në veprimtari të hapur politike në fshatin e tij dhe në komunë, sidomos pas "legalizimit" të pluralizmit edhe në Kosovën tonë të robëruar. Ishte përfshirë në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, në Këshillin Komunal për Financim, në

Degën e LDK-së në Kaçanik etj. Kudo ku kërkohej, aty gjendej Gafuri. Sidomos, Ai i mbante lidhjet mes fshatit të tij të largët dhe strukturave komunale në Kaçanik. Në fshatin e tij udhëhiqte të gjitha aktivitetet, si ato politike, ashtu edhe ato humanitare, kulturore, për të drejtat e njeriut etj. Njihej për urtësi e aftësi organizuese. Ishte tip politikani dhe diplomati, por që aftësitë e tij nuk mundte t'i zbatonte, përveç në biseda dhe në punë konkrete me shokët e tij të idealit e të veprimit.Kështu, si udhëheqës lokal i LDK - së në fshat dhe si anëtar i Kryesisë së Degës në Kaçanik, nuk ishte i kënaqur me punën që bëhej, sidomos me pozicionin politik të partisë, të cilës i takonte. Në prag të luftës së armatosur, partia e tij paraqitej si një parti e vendnumërimit dhe e mosveprimit. Prandaj, edhe e kishte lëshuar atë, i zhgënjyer tej mase, në fillimin e vitit 1998, kur në Kosovë gjithandej po vinte era e luftës, të cilën Ai do ta nuhaste me kohë dhe për së afërmi. Ishte Gafuri ai që kontribuoi drejtpërdrejt për organizimin dhe zhvillimin e kësaj lufte. Armët dhe luftëtarët e kalonin andej – këndej kufirin me ndihmën e tij. Ai madje merrte përsipër strehimin e armëve të UÇK-së për kohë të caktuar në afërsi të fshatit, në malet e Sharrit. I kishte ndihmuar edhe vet komandantit të UÇK-së, Azem Sylës, pastaj pothuaj të gjithë anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm; Hashim Thaçit, Sokol Bashotës, Rexhep Selimit, Nait Hasanit, Bislim Zogajt dhe kush e di kujt, pasi as vet Ai, për shkak të konspiracionit, nuk ua kishte mësuar emrat. Pikërisht, duke e parë autoritetin e tij të madh dhe duke e pas parasysh veprimtarinë e tij atdhetare, regjimi okupues serb kishte vendosur ta likuidonte Gafurin, e me këtë ta

dëmtonte rëndë Lëvizjen në rrethinën e Kaçanikut e më gjerë. Me gjithë torturat e rënda në hetuesi, Gafuri nuk kishte zbuluar asgjë, asgjë nuk ishte nxjerrë prej tij. Pa fakte relevante, megjithatë, e kishin dënuar dhe e kishin dërguar në mbajtje të dënimit, me qëllimin e fundit, likuidimin e tij. “Fajet” që i ngarkoheshin ishin krejt të ndryshme nga “fajet” që vërtet i kishte bërë. Regjimi serb e kishte ditur se NATO-ja do ta bombardonte Burgun e Dubravës, ngase më parë ai u kishte shërbyer si bazë forcave policore e ushtarake serbe. Ndaj, si e tillë figuronte edhe në dokumentacionin që dispononte Aleanca Veriatlantike. Kështu, nga të gjitha burgjet në Kosovë dhe nga ato të Serbisë, regjimi serb i mblodhi të burgosurit shqiptarë, pavarësisht nga vepra e tyre, dhe i dërgoi në Burgun e Dubravës, për t’i bërë kështu, si thuhet, mish për top. Dhe, vërtet NATO e kishte bombarduar burgun. Nga predhat e saj kishin pësuar rreth njëzet të burgosur. Por, kriminelët serbë të burgut, qofshin ata zyrtarë apo të burgosur, kishin vendosur t’i likuidojnë edhe ata që kishin shpëtuar nga bombat e NATO-s. E kishin organizuar masakrën më makabre, masakrën në Burgun e Dubravës, ku, bashkë me mbi 120 të tjerë, me pushkë snajpere, kishin vrarë edhe Gafur Lumën, trimin e madh të Sharrit plak dhe të Kaçanikut legjendar. Veprimtaria e Gafur Lumës, për shkak të konspiracionit të thellë të veprimit, nuk ka munduar ende të zbardhet sa e si duhet. Ajo mbetet të zbardhet nga ata me të cilët ka bashkëvepruar. Ndaj, mbesim të shpresojmë se shpejt personaliteti i tij do të paraqitet i kompletuar, çfarë edhe ishte, me të gjitha të bëmat e tij në favor të kauzës kombëtare e të luftës sonë çlirimtare. Derisa Gafuri ishte burgosur dhe po mbahej

nëpër burgje, vëllai tjetër i tij, Qaniu i ri, i ishte bashkangjitur nga të parët radhëve të UÇK-së, të cilat tashmë operonin edhe nëpër malet e Sharrit, në afërsi të drejtpërdrejtë të shtëpisë dhe të fshatit të tij. Qaniu energjik, i kompletuar me idealet atdhetare nga Gafuri dhe familja e tij, ishte gjithnjë në radhët e para, i gatshëm prore të flijohej për Atdhe. Predhat e armikut e zënë në një moment në ballë të luftës dhe e bëjnë edhe atë Dëshmor të Kombit. Dy vëllezërit Luma, si të gjithë dëshmorët e kombit, janë bërë sot simbole të lirisë së Kosovës, janë bërë sinonim i jetës në Kosovën e Lirë. Duke i pasur dëshmorët e kombit tregues të rrugës së lirisë, në mesin e të cilëve janë edhe Gafuri e Qaniu, Ne duhet dhe do ta ndërtojmë një Kosovë të re e të bukur, ashtu siç e kishin ëndërruar ata, Gafuri, Qaniu e mijëra dëshmorë tjerë".

KOSOVËS DËSHMORËT

Vëllezërit Luma - krenaria e Sharrit plak

Faksimil nga shkrimi i Berat Luzhës në përkujtim të dëshmorëve

Shkrim për dëshmorin Gafur Luma nga autori i këtij libri në portalin: pashtriku.org

Për dëshmorin Gafur Luma u shkrua edhe në librin ,,**Në kërkim të dijes dhe të lirisë** *(Dëshmorët dhe viktimat e Universitetit të Prishtinës 1997 – 1999),* Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2004 (Shqip & Anglisht).

Berat Luzha: Vëllezërit Luma-krenaria e Sharrit plak-gazetë

Saime Isufi: Vlerat historike, studimore e shkencore të librit ,,Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981" në portalin pashtriku.org

Mehmet Hajrizi: Historia e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981-libër

Ahmet Qeriqi: Të burgosurit politikë, këta dinjitarë të lirisë…

Ukë Thaçi: Masakra në burgun e Dubravës-libër

Kolonel Hajrush Kurtaj: Në rrugën e lirisë-libër

Hajrush Kurtaj: Shungullon Gryka e Kaçanikut-libër

Feniksët e lirisë -libër

Naser Kuka: Nga lëvizja ilegale te UÇK- kujtime e dëshmi-libër
Muhamet Reka&Sevdije Shehu: Hebib Shehu-një jetë për Kaçanikun dhe Kosovën-libër
Afrim Mustafa: Mos më dalt shpirti, pa e parë Avdylgafurin... gazeta ,,Fakti" 11 maj 1999
Afrim Mustafa: Bardhësitë e atdheut-libër
Skënder Idrizi: Një jetë e tërë përkushtimi për lirimin e vendit, gazeta Epoka e Re
Menduh Leka: I denjë për lapidar lirie-gazetë
Ramadan Asllani: Ai ishte ideali i çështjes kombëtare për lirinë e Kosovës, Bota Sot
Shaban Çupi: Bilbili i këngëve të lirisë, Epoka e Re
Skënder Idrizi: Dëshmorët nderohen atëherë kur të jetë sendërtuar amaneti i tyre, Epoka e Re
Mr.sc. Metush Zenuni : Lladrovci e Shala themelues të Partisë së luftes http://vvv.albaniapress.com
Daut Shehu: Ai u bë lapidar që reflekton shembëlltyrë mburrjeje dhe krenarie-gazetë
Ilir Axhami: Pikturë
Poezi nga nxënësit e shkollës fillore,,Gafur Luma" në fshatin Glloboshicë
Milaim Mezini: Këngë për dëshmorin Gafur Lumën
Shaban Çupi : Buzëqeshje lirie-poemë(libër)

TUBIM PËRKUJTIMOR PËR ABDYLGAFURR LUMA NË GLLOBOÇICË TË KAÇANIKUT

Ai u bë lapidar që reflekton shembëlltyrë mburrjeje dhe krenarie

Kaçanik, 22 maj

Në oborrin e Shkollës Fillore të Gllobocicës së Kaçanikut, sot u organizua një manifestim përkujtimor kushtuar dëshmorit të kombit Abdylgafurr Luma, nga po ky fshat, i cili u vra më 22 maj 1999, në burgun e Dubravës, afër Burimit (ish-Iaogut).

Për ietën dhe veprimtarinë e Abdylgafurr Lumës foli Hasan Ceka, drejtor i shkollës fillore "Kongresi i Manastirit" e këtij fshati. Abdylgafurr Lumës (1961), dha ai i mbesin pa i përfunduar studimet në Fakultetin Elektroteknik në Prishtinë, për shkak të burgosjes së tij më 1985. Edhe pas daljes nga burgu, ai e vazhdon aktivitetin politik në rrethanat e pluralizmit, i cili mund të shfrytëzohej për realizimin e aspiratës shekullore për liri. Për shkak të këtij aktiviteti, ai përsëri arrestohet më 10 gusht 1998 dhe dënohet me 6 vjet burg. Ekzekutohet më 22 maj nga dora kriminale serbe, në burgun e Dubravës. Menduh Leka, një shok i Gafur, sic e quajti ai Abdylgafurrin, thekson se në atë sfond ai u bë lapidar që reflekton shembëlltyrë mburrjeje dhe krenarie. Folën edhe Eshref Vishi, përfaqësues i Këshillit Komunal administrativ të Kaçanikut, Ilar Ceka, në emër të Zonës së Gjashtë të TMK-së, veprimtari Ekrem Jashari, kurse në emër të familjes falënderoi Emin Luma, vëllai i dëshmorëve Abdylgafurr dhe Qani Luma.

Familjes së dëshmorëve iu dorëzua një portret i punuar nga Xhemil Jamani. Manifestimin e përbliten edhe një program me këngë dhe recitime.

D. SHEHU

Shkrim i gazetarit Daut Shehu nga tubimi përkujtimor për dëshmorit Gafur Luma

Gjeneral Rexhep Selimi, Xhafer Zharku dhe vëllau i dëshmorit Emin Luma, gjatë zbulimit të bustit të dëshmorit Gafur Luma, 22 maj 2002

Veprimtari Ekrem Jashari në zbulim të pllakës së shkollës me emrin e dëshmorit

Një nga manifestimet e shumta për nderë të Ditës së Shkollës më 22 maj

Në radhë të parë, Gafur Luma

Pjesë nga biblioteka e dëshmorit Gafur Luma

Në 57 vjetorin e lindjes së dëshmorit Gafur Luma, në vitin 2018, botuam librin (poemën) ,,Buzëqeshje lirie" dhe e shpërndamë nëpër shokë e miq, ndërsa përurimin e parë e bëmë me fëmijët e dëshmorit Gafur Luma, Kaltrinën dhe Lirimin

Kaltrina e Lirimi, fëmijët e dëshmorit Gafur Luma

Në përkujtim të maskrës ndaj të burgosurve shqiptarë në burgun e Dubravës në majin e vitit 1999

Fjalë rasti në 19 vjetorin e masakrës në burgun e Dubravës

Të nderuara familje të dëshmorëve!
Të nderuar përfaqësues të Organizatave të dalura nga lufta!
Të nderuar bashkëvuajtës të masakrës në burgun e Dubravës!
Të nderuar udhëheqës të Institucioneve komunale!
Pjesëmarrës të nderuar!

Sot është 19 vjetori i rënies së të burgosurve politik në burgun e Dubravës: të Prof Mejdi Dalloshit, Gafurr Lumës, Mr. Tefik Rakës, Danush Kurtajt e Suad Bravës, andaj duke pasur parasysh ditët dhe muajin që po e kalojmë, lutemi që shpirtërat e këtyre dëshmorëve dhe gjithë dëshmorëve të tjerë, Zoti i Madh i pastë në mëshirën e Tij!
Masakrën serbe ndaj të burgosurve shqiptarë në burgun e Dubravës, në 19 vjetorin e rënies, do të mundohemi ta trajtojmë në një mënyrë tjetër, në një kënd tjetër, duke i lënë anash torturat, vuajtjet, mungesën e ushqimit dhe gjërave të tjera më elementare për jetë. Këto janë trajtuar nga shokët e mi nëpër përkujtime të viteve të kaluara dhe unë nuk do t`i përsëris.
Fjalën time të rastit e kam ndarë në tri pjesë, ose në tri tabllo:

Tabloja e parë: Masakra në burgun e Dubravës ishte krim i organizuar shtetëror

1. Masakra në burgun e Dubravës duke filluar nga 19 maji 1999 e deri më 24 maj 1999 ishte një krim i organizuar shtetëror serb me zinxhir

komandimi prej niveleve më të larta serbe e deri te përgjegjësit e burgut.

2. Të burgosurit në këtë burg ishin të dënuar dhe nën akuzë nga gjykatat e pushtuesit në Kosovë dhe ky është argumenti dytë për krim kundër njerzimit dhe shkelje e rëndë e të gjitha Konventeve ndërkombëtare, të cilat i kishte nënshkruar pushtuesi serb.
3. Të burgosurit u vranë brenda objektit të burgut e jo jashtë tij, madje brenda dhomave e qelive, madje duke kërkuar strehim edhe në bodrume e puseta e kudo tjetër brenda hapsirës së burgut e që don të thotë që të burgosurit u qëlluan gjakftoftë nga gardianët e burgut, militarët dhe paramiltarët e organizuar nga shteti serb
4. Masakra ndaj të burgosurve u bë nga organet serbe të armatosura me armë nga më të ndryshme, duke filluar nga automatikët, mitralozët, granatat, snajperët, ndërsa të burgosurit ishin duarthatë dhe nuk kishin asnjë mjet mbrojtës.
5. Maskra ndaj të burgosurve shqiptarë u bë edhe nga individ serb të burgosur e që u amnistuan nga burgu dhe u mobilizuan në luftë me vendime shtetërore, edhe një argument tjetër se krimi ishte i organizuar dhe shtetëror
6. Krimi shtetëror serb, jo vetëm që përfshinë grupmoshat e ndryshme madhore të të

burgosurve, por kjo masakër shoi edhe jetën e të miturit Suad Brava nga Hani i Elezit, i cili kur u vra, kishte vetëm 17 vite e 3 muaj.

Tabloja e dytë: Masakra në burgun e Dubravës ishte krim kundër njerëzimit

Përkundër gjithë këtij krimi kolektiv, ku u pushkatuan mbi 160 të burgosur e mbi 200 të tjerë mbetën të plagosur, Tribunali i Hagës nuk e trajtoi këtë krim kundër njerëzimit. Disa hetues të Tribunalit bënë qëllimisht hetime të lehta mbi këtë krim, gjithnjë duke e shpëtuar shtetin serb nga dënimi ndërkombëtar për krim e gjenocid, madje UNMIKU shkatërroi edhe gjurmët e krimit në këtë burg gjatë ndërtimit të tij. Kjo është një fyerje ndaj të burgosurve, qoftë të vdekur, qoftë të gjallë si dhe ndaj familjeve të tyre dhe popullit shqiptarë në përgjithësi. Këtë lloj të trajtimit të këtij krimi e gjenocidi, nuk e pranojmë as sot, nuk do pranojmë as kurrë, sepse krimi ishte i organizuar dhe në nivel shtetëror dhe Tribunali i Hagës i dinte me emër e mbiemër kriminelët dhe shkallën e organizimit.

Kur themi se Tribunali i dinte me emër e mbiemër kriminelët, e ofrojmë faktin se Shoqata e të Burgosurve Politik të Kosovës ka bërë kallëzim penal pranë Gjykatës së Pejës , dhe në akuzë janë me emër e mbiemër të gjithë kriminelët, por edhe kjo lëndë nuk u aktivizua kurrë, madje është tepër e habitshme se ky vullnet mungon edhe nga Prokuroria e Kosovës me arsyetime bajate se ,,nuk na lejojnë ndërkombëtarët".

Të gjithë gardianët dhe personeli i burgut të Dubravës që u tërhoqën nga Kosova më 10 qershor 1999 bashkë me të burgosurit që mbetën gjallë nga kjo masakër, torturat ndaj këtyre të burgosurve si pengje lufte i

vazhduan edhe në burgjet serbe dhe të gjitha këto i ka ditur edhe Kryqi i Kuq Ndërkombëtarë, sepse shënimet dhe informatat ua kemi dhënë ne në kushte mizerje.
Me nje fjalë, Gjykata Ndërkombëtare në raport me masakrën në burgun e Dubravës, ka rënë në provim historik. Dikush u përkujdes shumë që shteti serb të shpëtoj nga dënimi për gjenocid mbi popullin shqiptarë dhe në kundërvlerë, për habi e për mjerim, shqiptarët ,,fituan" Gjykatën speciale ku UÇK-ja do të dënohet për krime lufte.

Tabloja e tretë: Qëndresa e të burgosurve ishte flijimtare

Të burgosurit shqiptarë, pothuajse të gjithë ishin të burgosur politik, organizues lufte ose luftëtarë për çlirimin e Kosovës,
Përkundër torturave të rënda, ata ruajtën dinjitetin shqiptarë,
Përkundër mizerjes që përjetonin, ata solidarizoheshin me njëri tjetrin,
Edhe përballë plumbave e mitralozëve armik, ata ishin fort të lidhur me lirinë e Kosovës, andaj nderi e lavdia iu takon meritueshëm për jetë e mot!
Mirë e thotë gjeniu i shkencës Ajnshtajni ,, Shpirtërat e mëdhenjë gjithmonë kanë hasur në kundërshtim të dhunshëm nga mendjet mediokre."
Si përjetues i kësaj masakre, bashkë me shokët e tjerë që janë brenda kësaj salle, ndajë kujtime të mira për shokët e rënë pasiqë që të gjithë i njihja edhe më parë. Njihja në thellësi të shpirtit Gafurr Lumën, pasiqë ishim në një organizim politik ilegal që nga burgu i parë, pra që nga viti 1985, njihja profesorin e nderuar Mejdi Dalloshin, pasiqë e kisha profesor në shkollë të mesme

e më vonë ishim në aktivitete të përbashkëta politike, njihja mr. Tefik Rakën e bashkë me atë edhe librin e botuar me rëndësi historike për Kaçanikun, njihja Danush Kurtajn dhe rënien e madhe në Gabrricë të Komandant Agim Bajramit, Xheladinit e Besnikut, njihja Suad Bravën bashkë me plagët vdekjeprurëse të cilët tentonim t`ia shëronim deri në frymën e fundit.
E ne që mbetëm gjallë, e nuk e di se si mbetëm gjallë, mbetëm për t`i kujtuar e nderuar ata, me një fjalë, po Rrnojmë me kallzue, siç ka thënë At Zef Pëllumi.
I përjetshëm kujtimi për gjithë dëshmorët e kombit!
Lavdi!

Fjalë ime e rasti në 19 vjetorin e rënies së dëshmorëve në burgun e Dubravës, fjalë e cila u mbajt në Kaçanik më 22 maj 2018

Gafur Luma
Prof.Mejdi Dalloshi

Suad Brava

Mr.Tefik Raka
Danush Kurtaj

Dëshmorët e rënë në burgun e Dubravës më 22 maj 1999

Përmbyllje

Të shkruash një monografi për veprimtarinë e një dëshmori i cili më shumë se gjysmën e jetës e ka aktivitet, dhe në fund ia fali atdheut edhe jetën, nuk është punë e lehtë. Nuk është në pyetje koha dhe mundi që bën në hulumtim të veprës, por ajo që të rri si shpatë mbi kokë, është sfida se me fuqinë e penës, a do të mundesh t`ia arrish qëllimit në profilizimin e saktë të dëshmorit, jetës dhe veprës së tij sublime.

Dilemat kanë qenë të shumta, megjithatë, këto dilema i mposhti vullneti për të bërë diçka të vogël për këtë njeri të madh të kombit, në këtë rast për Avdilgafur Lumën i cili në të dy burgjet ishte bashkëvuajtës me autorin, madje edhe në momentet kur kaloi në përjetësi.

Jemi të vetëdijshëm se vitet dhe dekadat po kalojnë, ndërsa kujtimet po veniten, ndërsa një pjesë e shokëve, nga mosha edhe po vdesin, por në anën tjetër është krijuar edhe distanca e domosdoshme kohore që të kalohet subjektivizmi në shkrim dhe më tepër vepra e dëshmorit të trajtohet edhe në syrin kritik.

Në hartimin e kësaj monografie, si metodë pune kemi zgjedhur kujtimet nga shokët, me shokët që Gafuri kishte veprimtari të caktuar, luftë e sakrifica dhe shikuar nga ky këndvështrim, kujtimet e shokëve janë origjinale, pa ndërhyrje të autorit, me të vetmin qëllim për të ruajtur argumentin historik, përkatësisht substancën e ngjarjes.

Pos shokëve veprimtarë, nga burgu i parë dhe i dytë që ishin dëshmitarë të ngjarjeve, kemi shfrytëzuar rrethin ku jetoi dhe veproi dëshmori, familjen dhe farefisin dhe

nga këto burime nxorëm fakte me vlerë dhe domethënëse në aspektin historik.
Një anë tjetër që shfrytëzuam si lëndë për trajtim në shkrimin e kësaj monografie, janë materialet ilegale që shtypeshin në mënyrë klandestine nga Organizata politike e të cilat jo vetëm që u lexuan nga dëshmori, por edhe ua dha në lexim të tjerëve dhe kostoja e këtij aktiviteti ishte burgu me vite të tëra, ndjekja e përhershme nga UDB-a dhe në fund të priste likudimi fizik. Këto materiale ilegale shfaqnin situatën politike që mbizotëronte në dy dekadat e fundit të shekullit XX, gjendjen reale të shqiptarëve në ish Jugosllavi dhe është e pamundur të kërkohet veprimtaria e dëshmorit Gafur Luma jashtë këtyre kornizave, duke mos përjashtuar as pikëpamjet ideologjike që mbizotëronin atyre viteve.
Një fushë tjetër që shfrytëzuam si material bazë për hartimin e kësaj monografie ishte edhe hulumtimi i Arkivit komunal të Kaçanikut e sidomos të Arkivit të Kosovës, ku gjetëm procesverbale të UDB-së, në të cilat spikatet qëndrueshmëria e Gafur Lumës gjatë hetimeve të cilat aspak nuk ishin të lehta. Duhet pasur kujdes që çdo proceverbal i UDB-ës, përpilohej pas torturave fizike që bëheshin mbi të burgosurin politik dhe çdo deklaratë e dhënë nga i burgosuri nxjerrej me dhunë të shfrenuar.
Shfrytëzuam edhe materialet nga burgu si aktvendime, aktakuzë e aktgjykim dhe të gjitha këto në formë mozaiku formuan tërësinë e hulumtimit që kishim synim.
Që monografia të jetë krejtësisht e plotë, duhet plotësuar edhe dy fusha, e që aktualisht nuk janë në mundësinë e hulumtimit. Dosja hetimore nga burgu i dytë, për të cilën duhet kaluar 30 vite që të

deklasifikohen nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe dosja sekrete e UDB-së të cilat aktualisht nuk janë në Kosovë. Vetëm atëherë, kur në duar t`i kemi edhe këto dokumente, mund të themi se monografia për dëshmorin do të jetë e plotë.
Nga ajo që ka mbetur e pathënë në këtë monografi, është vetëm ajo pjesa që autori nuk ka arritur ta identifikoj sepse në kohën kur është vepruar, punët kanë qenë klandestine dhe në konspiracion të thellë dhe ato aktivitete s`ke pasur të drejtë t`ia kumtosh askujt, as shokut më të ngushtë, andaj çdo veprimtari e re që del pas botimit të këtij libri, shënimet mund t`i adresohen familjes së dëshmorit ose autorit të këtij libri për plotësim në botimin e dytë eventual.
Tanimë lexuesi dhe institucionet përkatëse si ato komunale, shkollore, familjare dhe historike, në duarë kanë një brum me vlerë për jetën dhe veprën e dëshmorit Gafur Luma. Themi brum me vlerë, sepse është i mbështetur në kujtimet ekzakte të dëshmitarëve, pa ndërhyrje të autorit me të vetmin qëllim që të ruajmë origjinalitetin e veprës, mbi të cilën lëndë, historianët, sociologët, psikologët dhe hulumtuesit e fushave të tjera mund ta hulumtojnë dhe zhvillojnë edhe më tej veprën e pavdekshme të dëshmorit Gafur Luma.
Krejtësisht në fund, falënderojmë familjen e dëshmorit për ndihmën e dhënë, falënderojmë të gjithë ato shokë të ilegales që autorin e këtij libri e furnizuan me kujtimet e tyre me vlerë.

Autori

Fotografi e autorit të librit, gjetur në dosjen e burgut.
Fotografi e vitit 1988

Shaban Çupi është i lindur më 2.1.1961 në fshatin Paldenicë, komuna e Hanit të Elezit. Ka të kryer Fakultetin e Edukimit dhe në arsim punon nga viti 1980. Është dy herë i burgosur politik dhe ka mbajtur 6 vite burg. Është përjetues i masakrës në burgun e Dubravës në majin e vitit 1999. Ka qëndruar në këto burgje: Gjilan, Prishti-në, Lypjan, Gurakoc, Dubravë dhe në Nish të Serbisë.
Deri më tani ka botuar këto libra:
1.*Nga gjaku i tyre rrjedh liria*, poemë
2.*Gafurr Loku (1949-1999)* monografi

3.*Shënime në kohë të mugëllt-publicistikë*
4.*SHKA,,Sharri-në 40 vjetorin e aktivitetit" në Han të Elezit*-monografi
5.*Jatakët e lirisë*- monografi
6.*Gjurmime etnografike në trevën e Hanit të Elezit*
7.*Shkolla popullore shqiptare në fshatin Paldenicë,* me bashkautor
8.*Trashëgimia kulturore në trevën e Hanit të Elezit* me bashkautor
9.*Historiku i xhamive dhe shkrimet mbivarrore në trevën e Hanit të Elezit*
10. *Gafurr Loku në kthetrat e UDB-së*- dramë
11. *Veprimtaria poetike e grupit letrar ,,Luigj Gurakuqi'' (1991-1993) në Han të Elezit*
12.Buzëqeshje lirie, poemë kushtuar dëshmorit Gafur Luma
13. *Gafurr Loku simbol lirie e bashkimi* - monografi
14. Nositët e lirisë, poemë kushtuar dëshmorëve të komunës së Hanit të Elezit
15. *Gafur Luma - kujtime e dëshmi*- monografi

Përmbajtja

Në vend të parathënies.....5

Kapitulli I- Shtingjeve të jetës.....10

Kapitulli II – Veprimtaria politike ilegale e dëshmorit Gafur Luma (Vjeshtë 1979 – pranverë 1990).....17

Kapitulli III – Veprimtaria e dëshmorit Gafur Luma (1990 – 1999).....113

Kapitulli IV- Gafur Luma nëpër shkrime e përkujtime të autorëve të ndryshëm.....166

Përmbyllje.....183

Shënime për
autorin.....
.....185